monumentet

DO NOT COPY



3, 1972

DO NOT COPY

ertina e parë: Basoreliev në Kishën e Mesopotamit – Sarandë

MINISTRIA E ARËSIMIT DHE E KULTURËS
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
TIRANË

monumentet

DO NOT COPY

3, 1972

ë Kishën e Mesopotamit – Sarandë

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

ARTIKUJ

Neritan CEKA
Vështrim arkeologjik mbi rrethin e Elbasanit. 7

Koço ZHEKU
Zbulime epigrafike në muret rrethuese të kalasë së Durrësit 35

Aleksandër MEKSI
Arkitektura e kishës Mesopotamit 47

Stilian ADHAMI
Të dhëna rreth fizionomisë urbanistike të qytetit mesjetar të Voskopojës. 95

Emin RIZA
Burhan STRAZIMIRI
Vështrim mbi arkitekturën e qytetit të Korçës 119

M. PAPA
Mbrojtja ligjore e pasurive kulturale të vendit tonë 139

MATERIALE DHE KUMTESA

Gjerark KARAISKAJ
Të dhëna të reja për datimin e kalasë së Elbasanit 147

Kasem BIÇOKU
Kështjella e re (Jenixhekalaja) dhe Elbasani 159

Vili KAMSI
Fortifikimi i hyrjes kryesore të kështjellës së Shkodrës 163

Hysen NALLBANI
Shënime mbi masat restauruese në pikturën e xhamisë së Beqarëve në Berat 171

Emin RIZA
TH. KAMBERI
Kullat në fshatin Goranxi 179

F. ZARSHATI
Të dhëna mbi banesën e fushës së Zadrimës 189

Apollon BAÇE
Gjerark KARAISKAJ
Vrojtime arkeologjike në rrethin e Gramshit 199

Neritan CEKA
Apollon BAÇE
Vrojtime arkeologjike në rrethin e Pogradecit, luginën e Devollit dhe Shkumbinit 205

KRONIKË

Jeta shkencore 215
Ligji i ri: «Mbi mbrojtjen e monumenteve kulturale e historike dhe pasurive natyrale të rralla 223
Rregullore për mbrojtjen e monumenteve kulturale dhe historike 225

DO NOT COPY

INST. MON. KULTURES
BIBLIOTEKA
INV. 4597

DO NOT COPY

TABLE DES MATIERES

Page

ARTICLES

Neritan CEKA
Archaeological survey of the Elbasan region 7

Koço ZHEKU
Découvertes épigraphiques sur les murs d'enceinte de la citadelle de Durrës 35

Aleksandër MEKSI
L'architecture de l'église de Mesopotame 47

Stilian ADHAMI
Aspects urbanistes et architecturaux de la ville médiévale de Voskopoje. 95

Emin RIZA
Burhan STRAZIMIRI
Aperçu de l'architecture de la ville de Korçë 119

M. PAPA
La protection légale du patrimoine culturel dans notre pays 139

COMMUNICATIONS ET DIVERS

Gjerark KARAISKAJ
New data for the dating of the castle of Elbasan 147

Kasem BIÇOKU
La nouvelle citadelle (Jenidjékala) et Elbasan 159

Vili KAMSI
La fortification de l'entrée principale de la citadelle de Shkodër 163

Hysen NALLBANI
Notes sur la restauration des peintures de la mosquée des «Beqars» à Berat 171

Emin RIZA
TH. KAMBERI
Les «Kullas» du village de Goranxi 179

F. ZARSHATI
Données sur la maison type de la plaine de Zadrime 189

Apollon BAÇE
Gjerark KARAISKAJ
Observations archéologiques sur la région de Gramsh 199

Neritan CEKA
Apollon BAÇE
Observations archéologiques faites dans la région de Pogradec et dans les vallées du Devoll et du Shkumbini 205

CHRONIQUE

La vie scientifique 215

La nouvelle loi «Sur la protection des monuments culturels et historiques et des sites naturels d'un intérêt particulier 223

Ordonnance sur la protection des monuments culturels et historiques 225

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Neritan CEKA

DO NOT COPY

VËSHTRIM ARKEOLOGJIK MBI RRETHIN E ELBASANIT

Pasi kemi përcaktuar që në titull kuadrin gjeografik të vështrimit tonë në kufijt administrativë të rrethit të Elbasanit [1]), shtojmë se kufiri kronologjik do të shtrihet që nga prehistoria deri në fund të kohës antike. I ndihmuar nga një konfrontim i të dhënave të pakta historike, ky vështrim do të përbënte edhe provën e parë për historinë e lashtë të kësaj zone.

Burimin kryesor për temën tonë e përbëjnë të dhënat e gërmimeve arkeologjike të cilat filluan në rrethin e Elbasanit në vitin 1960 me hapjen e tre tumave të periudhës së bronxit në fushën e Pozhokut [2]). Vitet e fundit u vendos një lidhje e pandërprerë e materialit arkeologjik gjatë gjithë periudhës që trajtojmë në saje të gërmimeve e sondazheve në Gradishtën e Belshit, Shkambin e Shënlliut, Bradashesh, Kalanë e Elbasanit dhe Kodrën e Tepes. [3]) Gjithashtu vrojtimet kalimtare të Prashnikerit, [4]) Sestierit, [5]) Betzit, [6]) Vidmanit [7]) u pasuan nga një punë sistematike për një hartë arkeologjike të rrethit të Elbasanit. [8])

Ka një rregullsi në shpërndarjen e vëndbanimeve të epokave të ndryshme në zonat e veçanta që përfshihen në rrethin e Elbasanit (Tab. I). Për epokën e bronxit, nga e cila kemi të dhënat e para të sigurta arkeologjike, vëmë re një grumbullim të tumave, pra dhe të vendbanimeve, në brrylin e Devollit, fushën e Cërrikut dhe në pjesën qendrore të krahinës së Dumresë. Kjo është zona e fushës më pjellore dhe e kodrinave të buta që favorizonin jetën sedentare për shkak të mundësive të një bujqësie të kufizuar drithrash të mbështetur në zhvillimin e njëkohshëm të blegtorisë.

Në periudhën e parë të hekurit vendbanimet kryesore qenë të shpërndara në zona të larta kodrinore si Shpati e Krraba, zakonisht pranë qafave ku kalonin rrugët ndërkrahinore. Duket se për këtë vendosje, përveç faktorëve të mësipërm ekonomikë, luajti një rol edhe nevoja për t'u mbrojtur në kushtet e reja shoqërore-politike të krijuara nga çthurja e komunës primitive. Nuk duhet përjashtuar edhe fakti se këto zona paraqesin kondita më të mira për zhvillimin e frutikulturës dhe të bujqësisë me vaditje me vija të vogla uji, që mund të bëhet edhe nga një grup i kufizuar njerëzish.

Periudha qytetare ka po këto veçori në shpërndarjen e vendbanimeve, me një shtim të kështjellave pranë rrugës kryesore që kalonte nëpër luginën e Shkumbinit (Kalaja e Saragut, Kodra e Malit, Shkambi i Shënlliut, Shkambi Mbret, kalatë e Bixëllenjës). Zona e banuar më dendur mbetet Dumreja, por ka një zhvillim edhe Shpati, Gryka e Shkumbinit, e Za-

1) Në kufijt e tij administrative rrethi i Elbasanit përbën në përgjithësi edhe një trevë gjeografiko-historike, që kufizohet qartë në veri nga ujëndarjet e Shkumbinit dhe në lindje nga Mali i Shmilit dhe i Bukanikut. Në jugë kufiri gjeografik do të ishte ujëndarje e Devollit me Shkumbinin, megjithatë, një zonë e gjerë në luginën e mesme të Devollit ka qënë e lidhur tradicionalisht me Elbasanin. Nga perëndimi kufiri administrativ përputhet përsëri me atë gjeografik-historik.

2) Shih S. Islami, H. Ceka – **Të dhëna të reja mbi lashtësinë ilire në teritorin e Shqipërisë, Konferenca e parë e studimeve albanologjike,** Tiranë 1965, f. 446-447 **(Nouvelles données sur l'antiquité Illyrienne en Albanie,** «Studia Albanica», 1964, 95-97).

ranikës dhe zona e Peqinit që janë tepër malore dhe me pak ujra mbeten më pak të populluara.

Në shekujt e parë të erës sonë të dy brigjet e Shkumbinit me fushën dhe kodrat buzë saj si dhe Dumreja, populloheh dendur me vendbanime fshatare që kishin si qendër Skampinin. Vendbanimet në zonat e larta kodrinore dhe ato malore, humbin rëndësinë dhe rallohen mjaft. Së fundi, periudha e vonë antike nga pikëpamja urbane karakterizohet nga një ringjallje e tabllosë së periudhës qytetare ilire, por e frymëzuar kësaj here nga motive jo ekonomike.

I. EPOKA E BRONXIT.

Tumat e Pazhokut, me numurin e madh të tyre të përqëndruar në bregun e djathtë të Devollit, dëshmojnë për praninë e një vendbanimi të afërt të kësaj periudhe, ende të pazbuluar. Të vendosura në grupe, ku në çdo tumë dallohen varret qendrore dhe diferencime në inventarin e varreve, ato përfaqësojnë karakterin patriarkal të shoqërisë në periudhën e bronxit të hershëm dhe të mesëm. Armët që gjënden që në fazën më të hershme (1800-1700 p.e.r.), janë shënja më e qartë e fillimit të çthurjes së komunës primitive. Një rëndësi të veçantë merr fakti, se armët metalike janë të tipeve mikene dhe se vijnë që nga Mesdheu [9]), ku po zhvillohej një shoqëri skllavopronare. Tërheqja e krahinave ilire në këtë sferë bëhet sigurisht në saje të shkëmbimeve që, në fazën e dytë, bëhen më të dëndura. Kjo provohet nga zgjerimi i tipeve të armëve mikene dhe nga një enë balte e importuar.[10] Një kohë më të vonë (L H III), i takojnë edhe dy shpata bronxi të tipit miken, të gjetura njëra në Cërrik (Tab. II, 4) dhe tjetra pranë Gradishtës së Belshit. [11]). Këto i takojnë një grupi të afërt vendbanimesh të shtrira në pjesën verilindore të krahinës së Dumresë. Si gjetje të veçuara përmëndim edhe dy sopata të tipit shkodran të gjetura rastësisht në Shelcan të Shpatit dhe Tërbaç të Krrabës [12]), (Tab. II, 1), që shënojnë shtrirjen më jugore të këtij tipi në vëndin tonë.

Nga pikëpamja e arkitekturës dhe e riteve të varrimit tumat e Pazhokut përmbajnë elementet kryesore që përcaktojnë fizionominë e varreve tumulare ilire të Shqipërisë së Jugut dhe të Veriut që nga fundi i epokës së bronxit dhe gjatë gjithë periudhës së hekurit. Të tilla janë ngritja e një tume të vogël mbi varrin qendror, të qarkuar nga një rreth gurësh, varrimi me trup dhe vendosja e armëve dhe e enëve të pijes me dy vegje të zhvilluar mbi buzë. [13]).

Zë fill këtu problemi se ç'rol ka luajtur zona e Elbasanit në proçesin dialektik të formimit të kulturës ilire. Materialet e tumave të Pazhokut, përderisa mungojnë të dhëna sinkrone të të njejtit karakter nga krahinat e tjera të vëndit tonë, na shërbejnë në këtë kuadër si **terminus post quem** për të përcaktuar kristalizimin e mënyrës dhe riteve të varrimit si një element i përbashkët në fondin e kulturës së ilirëve në vëndin tonë. Për fundin e epokës së bronxit këtë vështrim kemi mundësi ta zgjerojmë duke u mbështetur në materialet e shtresës së parë kulturale të Belshit. Sondazhet e vitit 1969 në rrafshet në perëndim të Gradishtës ranë në shtresat kulturale të një vendbanimi të hapur, fillimet e të cilit kapen që në periudhën e fundit të bronxit. Materiali i shtresës së parë kulturale përbëhet nga keramika, (Tab. III, 1-4), format e së cilës janë mjaft të ngjashme me ato të

3) Gërmimet në Shkambin e Shenlliut dhe në Belsh u bënë respektivisht më 1968 dhe 1969 nga autori; në Bradashesh më 1968 nga autori dhe L. Papajani, në Tepe nga autori dhe A. Meksi; në kalanë e Elbasanit nga Gj. Karaiskaj. Rezultatet përfundimtare nuk janë botuar ende.

4) C. Praschniker, A. Schober, **Archäologische Forschungen in Albanien und Montenegro,** Wien 1919, 48-61.

5) C. Sestieri, **Antiche acropoli illiriche. Drini** 12. 1942, 14.

6) A. Betz, **Eine neue Inschrift aus Elbasan in Albanien. Jahrbuch der ost. arch. Inst. Bd.** XXX. 1936.

7) L. Vidman, Voyage épigraphique à Elbasan, Listy Filologične, 85 (1962).

8) Një paraqitje e shkurtër e këtyre rezultateve është dhënë në **Materiale të sesionit arkeologjik,** Tiranë, 1968, 106-117. Për qëndrat e pagërmuara duhet t'i referoheni artikullit tonë në këtë përmbledhje materialesh dhe bashkëpunimit tonë me Ll. Papajanin, **Rrugët antike në luginën e Shkumbinit,** Monumentet, I/1971.

9) M. Korkuti. **Marrëdhëniet kulturale ilire egjejane në epokën e bronxit. Studime historike,** 3, 1970, 163. Përsa i përket rrugës së futjes së tyre si eksport miken, duhet marrë parasysh në radhë të parë rruga detare, me që në pjesën bregdetare ato përbëjnë një fenomen më të rëndomtë se në krahinat e Shqipërisë së brendëshme, ku duhet të kalonin nëpërmjet Greqisë veriore ose Maqedonisë.

10) S. Islami, H. Ceka, **vep. e cit.,** 97.

11) Ruhen në muzeun e Elbasanit.

12) E para është botuar nga F. Prendi, **Sopata të pabotuara të epokës së bronxit të zbuluara në Shqipëri. B.SH.SH.,** 1. 1958, 209. E dyta ruhet në muzeun e Elbasanit.

DO NOT COPY

shtresës sinkrone të Gajtanit I [14]) ndërsa elementet (vegje dhe zbukurime) afrohen më tepër me ato të Maliqit. [15]). Ka edhe forma e elemente që janë të përbashkëta për të tri qëndrat. Në këtë mënyrë roli i zonës së Elbasanit del jo vetëm në lidhjet verijugë, por edhe në integrimin e qëndrave kulturale të rëndësishme të lindjes ndërmjet luginës së Devollit.

II. Periudha e parë e hekurit.

Në periudhën e parë të hekurit vendbanimi i hapur i Belshit zhvillohet duke dhënë një shtresë kulturale me dy faza, ndërsa një pjesë e kufizuar e vëndbanimit ngjitet në shkëmbin e Gradishtës. Materialet e fazës së parë (Tab. III, 5, 6, 7, 9) ruajnë lidhjen me zonat lindore nëpërmjet ngjashmërisë së formave me keramikën e Trenit III. [16]).

Me Gajtanin II [17]) vihet re një aferësi e madhe e formave, fakturës dhe elementëve sa mund të themi që kemi të bëjmë me të njejtin grup kultural. Duket se ka në këtë kohë një stabilizim të lëvizjeve të popullsisë dhe vendosje të lidhjeve të rregullta ndërkrahinore, ku zotërojnë ato jugë veri. Këtë e mbështet edhe fakti i zhvillimit të vëndbanimit të hapur në Belsh. Gjetja me shumicë aty e keramikës mikenase (L H III C) dhe protogjeometrike dhe imitacioneve të saj (Tab. IV, 9, 10) tregojnë se këto lidhje shtriheshin drejt Mesdheut. Një krahasim me gjetjet e Pazhokut ku kemi vetëm një enë të heladikut të mesëm flet për çthurjen progresive të komunës primitive. Shoqërimi i këtyre objekteve me keramikën e pikturuar të tipit devollit jep një bazë për kronologjinë e kësaj keramike, por kjo do të jetë objekt i një artikulli të veçantë.

Faza e dytë paraqet një forcim të traditave në keramikën e Belshit, (Tab. IV, 1-4) dhe një largim nga format e keramikës lindore, gjë që shpjegohet edhe me shkëputjen kronologjike prej saj. Bëhet një fenomen i zakonshëm në keramikën e Belshit pikturimi me ngjyrë kafe në të kuqe mbi sipërfaqen e lustruar ngjyrë okër të enës. Vihen re ngjashmëri në teknikën e pikturimit me keramikën e Trenit, por motivet janë krejt të ndryshme. Mospërputhja e formave dhe e motiveve provon se kemi të bëjmë me një trashëgim të teknikës së Trenit në një fazë më të vonë të zhvillimit të keramikës së pikturuar. Lidhjet me veriun dalin nëpërmjet ngjashmërisë së formave me Gajtanin III; [18]) por këto janë mjaft më të dobëta se në shtresën paraardhëse. Keramika e pikturuar e të njejtit tip është vënë re sot për sot në Selcën e Poshtëme (Mokër), Shkambin e Shënlliut dhe në kalanë e Tërvolit në Gramsh. [19]). Në këtë mënyrë forcimi i një fondi kryesor në keramikën e Belshit, fizionomia e të cilit përcaktohet nga format e veçanta dhe përdorimi i pikturimit, është pjesë e një fenomeni që zhvillohet në luginën e Shkumbinit dhe luginën e mesme të Devollit me krahinat që shtrihen në mes të tyre. Kemi, me sa duket, formimin e një grupi kultural, që qëndron midis veriut, me të cilin afron për format, dhe jugut, ku takojmë të përdoret në mënyrë sporadike pikturimi i enëve. [20]) Vemë re gjithashtu një ngjashmëri të motiveve dhe të ndonjë forme (oinohe) me keramikën greke. Lidhjet e dobëta me krahinat lindore dëshmojnë se këto elemente kanë arritur këtu vetëm nëpër rrugën detare.

Gjetjet e tjera të kësaj periudhe vijnë nga Shkambi i Shënlliut në Krrabë (Tab. III, 8), ku kishte një vëndbanim të vogël të vendosur mbi një kodër shkëmbore mjaft të mbrojtur nga natyra, por të parrethuar me mure. Keramika e pikturuar dhe e thjeshtë ka të njejtat forma dhe motive me ato të Belshit. Të njejtin karakter ka edhe vëndbanimi në Lleshan, i vendosur në brigjet e një shkëmbi, maja e të cilit rrethohet me një mur prej gurësh të papunuar (Tab. V, 2). Të tre këto vëndbanime: Gradishta e Belshit, Shkambi i Shënlliut dhe Lleshani përfaqësojnë tipin e vëndbanimit të mbrojtur që është një hap

13) B. Jubani, **Tipare të përbashkëta në ritin e varrimit tek ilirët e trevës së Shqipërisë, Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve.** Tiranë 1969, 91 e vazhdim.
14) Takohen kryesisht format e tasave me grykë të gjerë dhe të tenxhereve me buzë të drejta. **Shih B. Rebani, Keramika ilire e qytezës së Gajtanit. «Studime Historike»,** I, 1968, 42, Tab. I, 7, 49, Tab. V, 4. Kjo e fundit çfaqet në Belsh si formë më parë se në shtresën sinkrone të Gajtanit.
15) Është fjala për vegjet e Maliqit III -d (me rudiment cilindrik dhe ato të tipit wish-bone). **F. Prendi, La civilisation préhistorique de Maliq. «Studia Albanica»,** I, 1966, Tab. XVII, 21 e 22 dhe Tab. XVI, 26.
16) Format e tenxhereve me grykë cilindrike dhe të tasave gjysmë sferikë me vegje shiritore të kapura në bark. Shih **M. Korkuti, Vendbanimi prehistorik i Trenit. Konferenca e dytë e studimeve albanologjike,** II, Tiranë, 1969, Tab. IX, 23 dhe 5.
17) Format e enëve me qafë të lartë konike të tipit urnë, qepshet me vegje në buzë etj. Shih **B. Rebani, po aty,** Tab. VI, 4; Tab. XII, 10; Tab. VIII, 7.
18) Forma e tasit gjysmë sferik me vegje shiritore të kapura në bark. **B. Rebani, po aty,** Tab. X, 8.

DO NOT COPY

për në vëndbanimin e fortifikuar. Këtë të fundit e kemi të përfaqësuar në kalanë e Bodinit në Krrabë, në qafën që lidh luginën e përroit të Paprit (degë e Shkumbinit) me luginën e Zhullimës (degë e Erzenit). Qyteza ka një sipërfaqe prej 10 ha të përfshirë midis dy rënieve të thikta të kodrës dhe harkut të një muri prej gurësh të mëdhenj të palatuar, të vendosur në dy parete me mbushje në mes. Linja e tyre është e thjeshtë, pa kthesa e kulla. Gjetjet janë shumë të rralla e të fragmentuara, shënjë e mungesës së një jete intensive. Nga këto tipare qyteza të kujton fazën e hershme të kalasë së Trajanit, pranë vëndbanimit të hapur të Trenit.[21]). Ka shumë të ngjarë që kemi të bëjmë me një tip fortifikimi që shërbente për strehimin e banorëve dhe të pasurisë së tyre në rast rreziku.

Mënyra e varrimit në këtë periudhë duket se mbetet ajo me tuma të cilat sot na ruhen vetëm në krahinën e Dumresë. Nga një nekropol tumular i fillimit të periudhës së parë të hekurit në Seferan vjen një shpatë hekuri, që përsërit formën tradicionale të shpatave të tipit miken të epokës së bronxit dhe një maje heshte bronxi (Tab. II, 2, 8).[22]).

Në një vështrim të përgjithshëm periudha e parë e hekurit karakterizohet nga zhvillimi i vendbanimeve të hapura dhe lindja e vëndbanimeve të mbrojtura dhe fortifikimeve-strehime. Në kulturën materiale vemë re ruajtjen e traditave të kohës së bronxit dhe zhvillimin e veçorive lokale në kuadrin e një grupi kultural në luginat e mesme të Shkumbinit dhe të Devollit. Duket gjithashtu një zhvillim i mëtejshëm i lidhjeve ndërkrahinore dhe një rivendosje kontakti me Mesdheun, që duhet shpjeguar me zgjerimin e lidhjeve ekonomike si rrjedhim i çthurjes progresive të komunës primitive.

III. PERIUDHA QYTETARE ILIRE

Në shekujt VI-V krijohet në vëndbanimin e hapur të Belshit një shtresë kulturale që përfaqëson një nga fazat më intensive të zhvillimit të jetës në këtë vendbanim. Keramika tradicionale e formuar mirë, (Tab. IV, 5, 6), shoqërohet aty me një numur të konsiderueshëm fragmentesh të enëve të importuara nga Dyrrahi e Apollonia, të cilat i takojnë shek. VI-IV p.e. sonë. Janë kryesisht enë tryeze për pije. (Tab. IV, 89). Në keramikën vendase vulën e jep ajo e pikturuar, në të cilën vemë re fillimin e përdorimit të çarkut dhe huazimin e ndonjë motivi nga keramika e importuar. Është e para herë që e kapim në mënyrë më të plotë këtë fazë kalimtare nga periudha e parë e hekurit në atë qytetare ilire gjë që në planin ekonomiko-shoqëror përfaqëson kalimin nga rendi i komunës primitive në atë skllavopronar. Në këtë fazë del në dukje edhe veprimtaria ekonomike e kolonive helene e cila luajti në këtë proçes një rol katalizator. Nëqoftëse mbajmë parasysh zhvillimin e brendshëm ekonomik që shprehej në shpeshtimin e lidhjeve ndërkrahinore dhe me Greqinë arkaike, themelimi i kolonive në bregdet dhe vendosja e marrëdhënieve më të afërta me ilirët është një fenomen i përcaktuar në radhë të parë nga ky zhvillim. Depërtimi i prodhimeve të kolonive në Belsh, i shoqëruar me përdorimin e çarkut dhe futjen e elementëve të reja në keramikë janë gjurmët materiale të zhvillimit të shkëmbimit për nevoja luksi dhe të kthimit të poçerisë në një zejtari. Nga pikëpamja kulturale keramika e Belshit dhe e Gajtanit janë larguar mjaft nga njëra tjetra. Si duket shkëmbimi zhvillohet në këtë kohë kryesisht në tregun e brendshëm dhe me kolonitë. Ky theksim i ndryshimeve është i përkohshëm dhe pregatit kalimin në një unitet më të gjerë e më të thellë.

Fenomenet që trajtuam më lart janë njëkohësisht edhe preludi i një proçesi urbanizues, që karakterizon kalimin në periudhën qytetare ilire, esenca e të cilit është vendosja e marrëdhënieve skllavopronare në prodhim.

Nga pikpamja arkitektonike ky proçes realizohet me lindjen e një sërë qëndrash të fortifikuara të cilat zënë pikat kryesore në rrjetin e qarkullimit të rrugëve në rrethin e Elbasanit. Saragu, Kodra e Malit, Shkambi i Shënlliut kontrollojnë drejtpërdrejtë rrugën në luginën e Shkumbinit. Kulla e Gracenit, kalatë e Bixellenjës, Valshi zotërojnë krahinat rreth saj dhe rrugët që i përshkojnë ato. Në tërë qytezat e para takojmë zbatimin e planeve arkitektonike në ndërtimin e mureve rrethuese, që karakterizohen ende nga linja të thjeshta të planimetrisë, me kulla dhe hyrje të pakta. Muret në Shkambin e Shënlliut (Tab. V, 2) dallohen për një trajtim të kujdesshëm

19) **Sh. Haxhihyseni, Kalaja e Tervolit, «Monumentet II»,** 139-145.
20) **F. Prendi, Mbi rezultatet e gërmimeve në fshatin Vodhinë të rrethit të Gjirokastrës, B.SH.SH.** 1, 1956, 184.
21) **Gj. Karaiskaj, P. Lera, Fortifikime antike dhe mesjetare në rrethin e Korçës.** Kumtesë në sesionin e II shkencor të Institutit të Monumenteve.
22) Objekte të ngjashme që i takojnë fundit të periudhës së bronxit janë gjetur edhe në tumën 1 të Vajzës. Shih **F. Prendi, Tumat në fushën e fshatit Vajzë.,** «B.SH.SH.», II, 1957, 83-84, fig. V, 9.

Pozitiv

të gurëve në forma trapezoidale me faqe të sheshta, që në një teren shkëmbor kalojnë në forma poligonale të rreshtuar, me trajtim të fryrë të faqes (Tab. V, 1). Në rastin e parë muri të kujton muret e periudhës së dytë të Zgërdheshit [23]), ndërsa në rastin e dytë ato të Lisit Illa [24]), pra tipologjikisht renditet në fundin e shek. IV p.e. sonë. Ky datim përforcohet edhe nga intensifikimi i jetës në qytezë, pikërisht në këtë periudhë.

Në kodrën e Saragut pranë Dervenit të Bishqemit (Tab. VI, 1) vëmë re të njejtën pamje të planimetrisë me kulla katërkëndëshe me dalje të cekët dhe hyrje në koridor të krijuar nga mbivënia e krahëve të murit. Stili i ndërtimit është përcaktuar këtu edhe nga materiali, që është shtuf. Format e gurëve janë katërkëndëshe me punim të rrafshtë të faqes (Tab. V, 3). Gjetjet më të hershme të Saragut të mbledhura në sipërfaqe i takojnë gjithashtu fundit të shek. IV, p.e.sonë. I njejti stil në punimin e mureve duket edhe në kodrën e Malit, pranë Xherijes, e cila ngrihet përballë Saragut në anën tjetër të Shkumbinit si dhe në kullën e Kamunahut, buzë Devollit (Tab. V, 4).

Ky interesim i menjëhershëm për rrugën në luginën e Shkumbinit lidhet sigurisht me shfrytëzimin e saj në dobi të nevojave ekonomike të zonës dhe të lidhjeve ndërkrahinore. Duket se kemi në këtë lindje të menjëhershme kështjellash edhe një veprimtari të organizuar që ka të bëjë me marrjen e masave nga ana e shtetit ilir kundër invazionit të shtetit maqedon të kohës së diadokëve.

Krahas këtij tipi kështjellash zhvillohen edhe vendbanime të fortifikuara të rrethuara me mure prej gurësh të papunuar që ruajnë të gjitha tiparet e mureve të periudhës së parë të hekurit. Vihet re vetëm një përpjekje drejt formash katërkëndëshe dhe rrjeshtimit të gurëve. Të tillë qenë vendbanimet: Kulla e Gracenit mbi shpatin perëndimor të Krrabës, Maja e Shën-Mërisë në zonën e pasur me kullota të Zaranikës dhe Kalaja e Valshit në qendër të krahinës së Shpatit.

Gradishta e Belshit, kalaja e Lleshanit dhe Shkambi Mbret përbëjnë tipin e vendbanimeve të mbrojtura të parrethuara me mure gurësh.

Së fundi kemi një përhapje vendbanimesh të tipit fshatar, sidomos në zonën e Dumresë (Qafshkallë, Deshiran, Dragot), që provohen nga materialet e nekropoleve që në shek. IV p.e.sonë. Vendbanimet e hapura i gjejmë edhe në lagje e bloqe banesash të ndërtuara jashtë mureve rrethuese në Shkambin e Shënlliut ose të vendosura pranë vendeve të mbrojtura me pak sipërfaqe banimi si në Shkambin Mbret dhe Belsh. Në këtë rast ato mbeten pjesë të qendrave qytetare.

Nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik vemë re një diferencim të qendrave të lartpërmendura. Gradishta e Belshit dhe kulla e Kamunahut kanë një karakter më të theksuar qytetar, d.m.th. një prodhim zejtar shumëdegësh. Në këtë grup mund të futet edhe kalaja e Lleshanit për një tregëti të brëndëshme të zhvilluar. Kalaja e Saragut, Shkambi i Shënlliut, Kodra e Malit mbeten gjatë shek. III-II qendra me rëndësi strategjike dhe me ekonomi konsumuese. Vetëm në shek. I. p.e.sonë vemë re tek to një zhvillim të zejtarisë, kryesisht të poçerisë. Një sërë qendrash të thella si Kulla e Gracenit, kalatë e Bixëllenjës, kalaja e Vaishit kanë një karakter të përzier qytetaro-fshatar, me të cilin duhet të kuptojmë lidhjen e funksionit të prodhimit bujqësor me atë të shkëmbimit me qendrat e tjera.

Më së fundi, kemi qendra fshatare, kryesisht si vendbanime të hapura, fizionomia arkitektonike dhe ekonomike e të cilëve është ende vështirë të kapet për mungesë të gërmimeve arkeologjike.

Zhvillimin e zejtarisë në vendbanimet e shek. IV p.e.sonë mund ta ndjekim në vija të përgjithshme nga materialet e gërmimeve të Belshit dhe nga gjetjet e rastit të qendrave të tjera. Prodhimi i keramikës në Belsh, që ka marrë karakter zejtar që në shek. V me përdorimin e çarkut, humbet në shek. IV tiparet tradicionale dhe fillon të përpunohet sipas shijeve të një jete qytetare. Kjo shprehet sidomos në huazimin e formave dhe të motiveve zbukuruese nga keramika helene. Kemi në fund të shek. IV një zgjerim të importit të enëve të stilit apul të prodhimit dyrrahas dhe apoloniat (Tab. VII, 1, 2). Këto zënë një vend të gjerë në sasinë e keramikës së Belshit dhe të varreve të zbuluara në Dragot, Deshiran dhe në Shkambin e Shënlliut. Shkëmbimi tregëtar bazohet edhe në përdorimin e monedhës prej argjendi të Dyrrahit, Apolonisë, Athinës dhe Maqedonisë. Nga fundi i shek. IV pranohen si ekuivalente edhe monedhat e bronxit të Dyrrahit dhe Maqedonisë, gjë që dëshmon krijimin e një tregu të garantuar për shkëmbimin e mallrave. Në këtë mënyrë proçesi i lindjes së qendrave me arkitekturë qytetare në shek. IV kondicionohet nga kalimi në prodhimin e mallrave, dhe të dyja këto formojnë gradualisht thelbin e jetës qytetare në rrethin e Elbasanit.

Jeta qytetare njeh një lulëzim progresiv më shek. III-I p.e.sonë. Prodhimi orientohet nga plotësimi i nevojave të kësaj jete me një zhvillim të

23) S. Islami, **Qyteti ilir i Zgërdheshit, «Monumentet»** I, 1971, 27.
24) F. Prendi, K. Zheku – **Qyteti i Lisit, «Monumentet»** II, 1971, 18.

Botim SOV

poçerisë, të punimit të metaleve, të punimit të gurit dhe zejtarisë artistike.

Poçeria është dega që kalon më shpejt dhe më me gjerësi mbi bazat e prodhimit zejtar. (Prania e punishteve të keramikës provohet në Belsh dhe Sarag). Megjithatë gjatë shek. III ndeshim edhe një prodhim të kufizuar shtëpijak që ruan format e keramikës tradicionale (Tab. VIII, 1, 2) por që dallohet për një repertor të kufizuar dhe teknikë të dobët punimi. Kjo gjëndet kryesisht në qendrat me karakter fshatar si Shkambi Mbret, Qafshkallë etj. por nuk mungon edhe në Belsh. Prodhimi zejtar i keramikës u përshtatet nevojave qytetare. Në sasinë e keramikës zotërojnë materialet e ndërtimit (kryesisht tjegulla) si dhe enët e përdorimit shtëpijak. Teknika e punimit dhe format, janë mjaft të ngjashme me keramikën helenistike të Dyrrahit dhe Apolonisë (Tab. VIII, 4-7). Dallimi vihet re në zgjedhjen e baltës, mungesën e vernikut në shek. III dhe futjen e një verniku të dobët në shek. II-I si dhe në preferimin e disa formave në keramikën e përdorimit. Në shek. III preferohen skifosat me fund të ngushtë (Tab. VIII, 7) dhe amforat me buzë të hapura; në shek. II-I tasat me buzë të kthyera brënda (Tab. VIII, 3, 8, 9) dhe qypat me trup të zgjatur dhe vegje brinore (Tab. IX, 1). Këto prodhime zëvëndësojnë pothuaj plotësisht keramikën tradicionale edhe në qendrat fshatare, qoftë edhe të zonave të thella si Zavalina.

Zhvillimin e metalurgjisë e ndjekin kryesisht në prodhimin e armëve: shpata që vazhdojnë të ruajnë formën e armëve të periudhës së parë të hekurit (Tab. XI, 2), përkrenaret, (Tab. XI, 1), heshtat ((Tab. XI, 3, 4), kamat, thikat (Tab. XI, 5) dhe hanxharët të tipit sica, që vazhdojnë të përdoren nga shek. III, në shek. I p.e.sonë.

Zejtaria artistike përfaqësohet nga prodhimi i zbukurimeve, ndër të cilat ndjekin më mirë fibulat e tipit palmetë për shek. III, të tipit heshtë për shek. II-I p.e.sonë, dhe të tipit auçiza (Tab. XI, 8).

Zhvillimi i bujqësisë mund të provohet nga dëndësimi i vëndbanimeve në zonat kodrinore (Dumreja) dhe maleve (Shpati, Gryka e Zaranikës, Krraba dhe Peqini) dhe numuri i madh i enëve të rezervave ushqimore në këto vëndbanime. Kultivimi i grurit dhe i leguminozeve provohet nga mbeturinat e gjetura në sondazhet e Shkambit të Shënlliut.

Përveç prodhimit zejtar, fizionomia e jetës qytetare plotësohet edhe nga zhvillimi i artit dhe kulturës, pikërisht në ato zona ku ky prodhim ishte në shkallë më të lartë. Dumreja na ka dhënë deri më sot një numur të madh skulpturash të shek. III-I p.e.sonë. (Tab XII, 1-3). Sigurisht kemi tek ato një përvetësim të teknikës dhe formave greke, por nga ana tjetër një konceptim praktik të artit që shprehet në zgjedhjen e modelit nga jeta, një përgjithësim formash, dallimin etnografik të modelit, etj. Vemë re edhe një evolucion nga imitimet standarte helenistike në një trajtim të lirë shpesh herë psikologjik, të portreteve. Gjithashtu nga Dumreja vijnë edhe mbishkrime të shek. III-I p.e.sonë, ku përveç formulave të shkurtëra të varrimit gjejmë edhe formula disa rreshtash që kërkonin një njohje të mirë të gjuhës greke. Lexojmë në to një sërë emrash ilire si: Γενθιος, Βαθουνα, Αμουλις, Μινα, Σαιμιος (dy të fundit për herë të parë) ndërsa emrat helene mungojnë plotësisht.

Zhvillimi i ekonomisë u shoqërua në shek. III-I me zgjerimin e shkëmbimit në bazë të monedhave. Qarkullimi i një numuri të madh monedhash bronxi të tipeve të ndryshme lidhet me zhvillimin e tregut të brëndshëm. Ky proçes prek edhe zonat malore si Shpati, nga na vjen pjesa më e madhe e monedhave të bronxit, gjë që dëshmon për kalimin e ekonomisë fshatare në prodhimin e mallrave.

Përsa i përket lidhjeve ndërkrahinore, rrethi i Elbasanit gjëndet në sferën ekonomike të Dyrrahit që e furnizon me keramikë me vernik të zi, prodhime artistike dhe monedha argjendi e bronxi. Këto të fundit qarkullojnë deri në mesin e shek. I. p.e. sonë siç del nga thesari i Gjonmit [25]).

Në radhë të dytë qëndron Apolonia, tregëtia me të cilën provohet nga numuri i madh i drahmeve dhe monedhave të bronxit. Nëpërmjet Apolonisë vijnë me sa duket monedhat e Republikës Epirote; Ambrahisë dhe Orikut. Monedhat e Maqedonisë që zinin një vënd me rëndësi në shek. IV [26]) p.e. sonë pothuaj zhduken krejt, ndërkohë që ato të Dyrrahit depërtojnë në zonën e Pogradecit. Të gjitha këto dëshmojnë për krijimin e një tregu të gjallë me Ilirinë e Jugut. Rrethi i Elbasanit gjendet në këtë rast në qendrën e kryqëzimit të rrugëve tregëtare.

Në mesin e shek. I p.e. sonë kemi një moment ndryshimi në fizionominë e jetës në rrethin e Elba-

25) H. Ceka, **Dy thesare drahmesh ilire e denarësh romakë të zbuluara në Tiranë. «Studime Historike»,** 1, 1966. 5.
26) Janë kryesisht monedha të Aleksandrit e Kasandrit, prandaj depërtimi i tyre lidhet padyshim edhe me fushatat luftarake në Iliri.
27) N. Ceka, **Vendi dhe roli i parthinëve në Ilirinë e Jugut. Konferenca e II studimeve albanologjike,** II, Tiranë 1969, 351.

DOKTORE

sanit. Në pikëpamjen urbanistike, kjo duket në ndërprerjen e jetës në qendrat qytetare të Shkambit të Shënlliut, Saragut, Lleshanit, kalatë e Bixellenjës. Me shkatërrimin e fortifikimeve të tyre merr fund periudha e ndërtimit të mureve rrethuese me gurë të gdhendur. Kemi një ruralizim të jetës që duket në lindjen e një numuri të madh vendbanimesh të hapura, të vendosura pranë fushave dhe rrugëve kryesore. Në elementët e kulturës materiale, keramika pëson vetëm ndryshime të pakta me futjen e tjegullave të tipit «romak» në gjysmën e dytë të shek. I p.e.sonë dhe të vernikut të kuq për lyerjen e enëve. Skulptura pëson një rënie, ndërsa shkrimi latin fiton gjithmonë e më tepër vend në mbishkrime duke ngushtuar atë grek, i cili pothuaj zhduket në shekujt e parë të erës sonë.

Historikisht fillimi i këtij proçesi lidhet me kryengritjen e Parthinëve kundër Romës në vitin 39 p.e. sonë, e cila, siç del nga burimet historike, qe një luftë e vërtetë.[27]). Shkaku i kësaj lufte duhet kërkuar në kalimin e romakëve në një politikë unifikuese në trajtimin e vendeve të pushtuara. Parthinët, të cilët kishin ruajtur një farë autonomie që nga koha e pushtimit të Ilirisë së Jugut, u përpoqën t'i qëndronin kësaj mase duke përdorur potencialin e tyre të fuqishëm ekonomik dhe kështjellat e tyre të forta. Romakët, që dërguan një ushtri konsullore, arritën ta shtypin kryengritjen vetëm pas përpjekjesh të mëdha dhe një terrori të egër që i dha Asin Polioni të drejtën të festonte triumfin në Romë.

IV. PERIUDHA E SUNDIMIT ROMAK

Pasojat e sundimit romak u ndjenë në të gjitha drejtimet e jetës në rrethin e Elbasanit në kapërcyellin e erës së re dhe përcaktuan një fizionomi të re të vëndbanimeve dhe arkitekturës, një raport tjetër në degët e ekonomisë dhe fenomene të reja në art dhe kulturë.

Këto proçese u zhvilluan në një periudhë të gjatë kohe, gjatë së cilës rendi skllavopronar njohu lulëzimin e fundit dhe kaloi në çthurjen e vet. Në bazë të këtij kriteri dallojnë dy faza, kufiri ndarës kronologjik i të cilave qëndron në mesin e shek. të IV.

A. Shekujt I-IV.

Sundimi romak shënon një ndërprerje të proçesit normal të zhvillimit të jetës ekonomike, duke e orientuar atë sipas kërkesave të ekonomisë së Perandorisë Romake. Për rrethin e Elbasanit, kjo u shpreh në përqëndrimin e jetës ekonomike në pak qendra të mëdha dhe në zvogëlimin e numurit të qëndrave qytetare. Pra, kemi një ruralizëm të jetës. Nga qëndrat e vjetra qytetare e ruan rëndësinë vetëm Gradishta e Belshit. Një karakter të tillë fiton edhe Skampini, me sa duket rreth shek. II të e.sonë, siç e tregon zgjerimi i nekropolit në këtë kohë.[28]). Zhvillimi i tij është i lidhur me funksionimin e rregullt të rrugës Egnatia që nga shek. I i e.sonë.[29]). Pranë kësaj rruge lindin një numur i madh vëndbanimesh të hapura me karakter fshatar si Karinë, Fatisha, Papri, Bradasheshi, Mansi, Krasta, etj. Shtimit të vëndbanimeve në zonat e ulta kodrinore, sidomos në Dumre, i përgjigjet një rrallim i tyre në zonat malore të Shpatit dhe Krrabës. Një tip i ri banimi janë «villae rusticae», që takohen në Kryezjarth dhe Qafshkallë dhe stacionet rrugore të tipit mutatio si Bradasheshi dhe Papri.

Qëndrat e fortifikuara zhduken krejtësisht, dhe kjo lidhet me largësinë e kufijve të Perandorisë Romake dhe me synimin e pushtuesve për të mos lënë në dorë të vendësve pikëmbështetje për kryengritje të mundëshme.

Ndër degët e ekonomisë ka prioritet bujqësia. Kjo kuptohet nga dendësia e vendbanimeve fshatare në zonat kodrinore e fushore dhe numuri i madh e i shumëllojshëm i veglave bujqësore të zbuluara në rrethin e Elbasanit ose të paraqitura në reliev. Midis tyre nuk mungon asnjëherë kosorja (Tab. XII, 7), e cila lidhet me hapjen e vazhdueshme të tokave të reja.

Prodhimi i keramikës vazhdon të përfaqësojë degën më të zhvilluar të zejtarisë. Dy qëndrat kryesore të punishteve të keramikës së përdorimit shtëpijak ishin Skampini dhe Belshi. Në shek. I-II prodhohen aty enë që ruajnë format e keramikës qytetare ilire (Tab. IX, 2, 3) dhe karakterizohet me një fakturë me lustër ngjyrë okër në të kuqe. Enët me vernik të kuq (Tab. IX, 4, 6) përbëjnë një grup të dytë, i cili nuk mbizotëron në masën e prodhimit të keramikës. Në shek. III-IV keramika e Skampinit dallohet për përdorimin e një verniku ngjyrë kafe në të kuqe, që shpërndahet në mënyrë të çrregullt mbi sipërfaqen e enës (Tab. VII, 4, 7), ose lihet të derdhet në rrypa vertikale (Tab. IX, 8). Në keramikën e Belshit fillon të zotërojë në këtë kohë prodhimi i tipeve të thjeshtë të enëve të guzhinës, ndërsa importi nga Skampini e Dyrrahi zëvëndëson prodhi-

28) H. Ceka, **Zbulimi i një nekropoli në Elbasan «B.U.SH.»,** I, 1948, 64-67. Varre të tjera të zbuluara rishtaz me materiale të shek. II-III të e.sonë, japin një datë më të hershme për nekropolin në anën lindore të kalasë.
29) N. Ceka, Ll. Papajani, **Vep. e cit.**

min e enëve të tryezës (Tab. VII, 5). Qendrat fshatare, nga ana tjetër, plotësojnë nevojat e tyre me keramikën e ndërtimit me furra të thjeshta si në Jagodinë e Fatishë.

Zejtaria artistike karakterizohet nga një standartizim i formave. Fibula e tipit kryq (Tab. XI, 9) është zbukurimi më i zakonshëm; por në zonat fshatare gjen të ruajtur ende ndonjë zbukurim të trashëguar nga fondi etnografik ilir.

Prodhimet e hekurpunuesve i përgjigjen kryesisht nevojave të bujqësisë me një shumëllojshmëri veglash, ndër të cilat thikat ruajnë ende pamjen e sicave të periudhës qytetare.

Ndërtimi ka një zhvillim më të gjerë në saje të punimeve në rrugën Egnatia dhe në qëndrat qytetare e fshatare. Shëmbulli më i mirë është nymfeu dhe termet e Bradasheshit të ndërtuar në një kompleks sipas një plani arkitektonik. Ndërtime të një cilësie të mirë, karakteristike për shek. II-III, gjejmë edhe në vilat e Kryezjarthit dhe Qafshkallës si dhe në Gradishtën e Belshit. Në ndërtimet e tjera fshatare vihet re ruajtja e traditave të ndërtimit nga periudha e mëparëshme dhe një përdorim i kufizuar i tullës në banesa.

Në një vështrim të përgjithshëm të të dhënave ekonomike periudha e shek. I-IV karakterizohet nga një zhvillim intensiv i jetës, sidomos në dy shekujt e parë të saj. Kriza e rendit skllavopronar, në ndryshim nga Italia, u ndje këtu më vonë, gjë që konstatohet edhe në Dyrrah e Apoloni. [30]).

Gjatë kësaj kohe arti humbi tiparet origjinale të periudhës qytetare ilire dhe karakterizohet nga prakticizmi dhe formalizmi. Dumreja mbetet përsëri qëndra e punimit të skulpturës, që përfaqësohet kryesisht nga relieve sepulkrale me skena e figura të standartizuara sipas tipeve të relievit provincial romak. Megjithatë, ndeshen edhe punime të mira, sidomos në shek. I-III (Tab. XII, 4), të cilat, në vazhdim të periudhës paraardhëse, ruajnë freskinë e formës dhe karakteristikat etnografike të ambientit.

Prejardhje jo të sigurtë kanë disa figurina bronxi që paraqesin Merkurin, si perëndi të udhëtarëve (Tab. XIII, 4), lidhur me rrugën Egnatia. [31]). Sidoqoftë vihet re tek to një trajtim helenistik i lëvizjeve dhe formave. Si punë e qartë romake dallohet një kalorës plumbi i gjetur rastësisht pranë Elbasanit (Tab. XIII, 3), që trajton një temë dhe tip të huaj për repertorin e deriatëhershëm të bronxeve të vendit tonë.

Ndërsa për shek. I të erës sonë kemi raste të rralla mbishkrimesh në gjuhën greke, të cilat përvetësojnë deridiku mënyrën e formulimit të mbishkrimeve romake, në shek. II-IV përdoret vetëm gjuha latine. [32]).

I ndikuar drejtpërsëdrejti nga Dyrrahi nga i cili varej administrativisht dhe nga roli i rrugës Egnatia, rrethi i Elbasanit hyri në sferën e përdorimit të gjuhës latine, ku përbën për përdorimin unik krahinën më jugore ilire.

B. Shekujt IV-VI.

Në gjysmën e dytë të shek. IV kriza e sistemit skllavopronar ndjehet me tërë fuqinë e vet edhe në rrethin e Elbasanit. Pasojat i vërejmë në një varfërim dhe kufizim të vendbanimeve fshatare dhe në militarizimin e vendbanimeve kryesore. Skampini rrethohet në një kuadrat muresh [33]) duke u bërë qendra e një sistemi fortifikimesh që mbrojnë rrugën Egnatia dhe degët e saj. Të tilla janë kalaja e Menglit dhe Shkambi Mbret në drejtim të rrjedhjes së sipërme të lumit. Në zonën e Shpatit kemi kalanë e Valshit dhe të Llixhës në degët e rrugës drejt Devollit, në Krrabë, Kullën e Gracenit dhe kalanë e Bodinit në rrugët që e lidhnin me luginën e Erzenit. Krahina e Dumresë që përshkohet nga rrugët për në Shqipërinë e Jugut zotërohet nga një kështjellë në Gradishtën e Belshit. Dy shekuj më vonë ndërtohet një kështjellë tjetër e fortë, kalaja e Qafës mbi vendin e daljes së Devollit në zonat bregdetare, e cila mbronte rrugën nëpër luginën e këtij lumi.

Arkitektura në këto qëndra është një pasqyrë e rëndësisë së tyre ushtarake dhe ekonomike. Skampini, i cili luan rolin e qendrës ekonomike e ushtarake të krahinës dhe e një qyteti nyje rrugore, ka një sistem të rregullt fortifikimi me një plan të studiuar dhe të realizuar me teknikë të lartë ndërtimi. Një kishë e konstatuar në qytet dhe bazilika e Tepes pranë tij paraqesin në fazat e para të ndërtimit vepra me vlerë arkitektonike. Mozaiket dhe elementet arkitektonike ruajnë në formë dhe cilësi traditat e periudhës paraardhëse, duke ju përshtatur në përmbajtje ideologjisë kristiane. Fazat e mëvonshme të bazilikës, me mënyrat e varfëra të ndërtimit, shoqërojnë rënien ekonomike të qytetit të shek. VI të erës sonë. Mengli, Llixha, Valshi dhe Belshi në shek. IV-VI dhe kalaja e Qafës në shek. VI janë

30) H. Ceka, **Probleme të numizmatikës ilire,** Tiranë 1965, 72.
31) S. Anamali, **Figura bronxi të Hermesit, «B.SH.SH.»,** 2, 1957, 132.
32) H. Ceka, S. Anamali, **Mbishkrime të pabotuara të Shqipërisë,** «B.SH.SH.», 1, 1961, 104-105, 121-126. Bën përjashtim për këtë periudhë një gur varri nga Lumasi (Kadipashaj) i shkruar greqisht. Pas shek. IV vemë re në Skampin rishfaqjen e shkrimit grek.

BOTIMET

tipi i kështjellave me karakter ushtarak, në të cilat veprimtaria ekonomike ka vendin e vet. Katër të parat karakterizohen nga një sistem shumë i thjeshtë rrethimi, me pak kulla e hyrje, me mure të trashësisë së vogël, të ndërtuar me shpejtësi me llaç të dobët. Sipërfaqja brenda mureve ka shërbyer për vendosjen e banesave të cilat mbështeten kryesisht në anën e brendshme të murit rrethues. Kalaja e Qafës ka një plan më të qartë të murit rrethues me dy kulla trapezoidale dhe një katërkandëshe (Tab. VI, 3), Ndërtimi është realizuar më me kujdes dhe paraqitet më i qëndrueshëm. Banesat në pjesën më të madhe janë vendosur larg mureve rrethuese.

Tipi i dytë i fortifikimeve përbëhet nga kështjella me karakter thjesht ushtarak, me sipërfaqe të vogël dhe jetë të kufizuar. Të tilla janë Shkambi Mbret, Kulla e Gracenit dhe kalaja e Bodinit.

Nga shpërndarja e këtyre fortifikimeve duken qartë se ato janë të lidhura me kontrollin ushtarak mbi rrugën Egnatia dhe degët e saj si dhe me vrojtimin e krahinave të brendshme. Situata që krijoi këtë tabllo është padyshim kriza e rendit skllavopronar, me të cilin duhet të kuptojmë, për rastin tonë, rrezikun e kryengritjeve të brendshme dhe mundësinë e depërtimit të barbarëve në rrugën Egnatia. Në drejtimin e fundit, rrethi i Elbasanit kishte një rëndësi të veçantë strategjike në mbrojtjen e njërës prej rrugëve kryesore të perandorisë.

Jetën ekonomike në vendbanimet e shek. IV-VI mund ta ndjekim në vija të përgjithshme në mbështetje të materialit arkeologjik të zbuluar në Gradishtën e Belshit. Prodhimi zejtar përfaqësohet aty nga veprimtaria e një punishteje tjegullash e vendosur brenda mureve rrethuese; ambientet e punishteve janë të thjeshta, përveç një stere uji të ndërtuar me llaç-shamot. Banesat e zbuluara janë në përgjithësi njëdhomëshe me kërkesa minimale ndaj kushteve të banimit, gjë që, në krahasim me banesat me hypokaust të periudhës pasardhëse, s'mund të shpjegohet ndryshe veçse me humbjen e karakterit qytetar të vendbanimit. Kjo përforcohet edhe nga gjetjet e pakta të keramikës që përfaqësohet në masën më të madhe nga enët e ujit dhe të guzhinës të punuara dobët dhe me forma të kufizuara. (Tab. X, 1, 5). Sendet metalike të zbuluara lidhur gjithashtu me bujqësinë dhe punimin e drurit (Tab. XIV, 1, 4, 5, 6). Monedhat u takojnë dy periudhave të kufizuara kohe: Valentinianit II apo Theodosit dhe Justinianit. Me sa duket pati në këto dy periudha një përpjekje për të gjallëruar edhe jetën ekonomike. Së fundi, gjetja e farërave të grurit dhe qiqrës ishte një gjë krejt e rëndomtë gjatë gërmimeve. Edhe në gjetjet në kalanë e Qafës (Tab. XIV 1, 2) pjesa më e madhe e sendeve metalike kanë të bëjnë me bujqësinë. Duket qartë se në kushtet e çthurjes së rendit skllavopronar ruralizimi i ekonomisë, karakteristik për periudhën pasardhëse, hapi rrugën për kalimin gradual në një ekonomi natyrale autarqike.

Përhapja e krishterimit në këto kushte ndiqet nga prania e kishave paleokristiane, kryesisht të tipit bazilikal, në Skampin; Belsh, kalanë e Qafës; Shkambin Mbret. Ato i takojmë edhe pranë vëndbanimeve të hapura si në Bixellenjë, Bale të Belshit e Kaziaj. Këto kisha janë të vetmet vende ku kemi konstatuar gjer tani ruajtjen e traditave në punimin e gurit. Gdhëndja e kapiteleve me reliev gjethesh akanthi e kryqe mjaft skematikë përfaqëson të vetmet përpjekje për të mbajtur të gjallë artin. Megjithatë, Skampini duket se ruan ende rolin e një qendre kulturale e artistike, po të gjykohet nga numuri i madh i punimeve artistike në gur dhe nga mbishkrimet latine të kishës së Tepes.

Shekulli i VI shënon fundin e jetës në shumicën e vëndbanimeve kryesore të rrethit të Elbasanit si Skampini, Kalaja e Qafës, Gradishta e Belshit etj. si dhe në kështjellat e vogla të zonave malore.

Shtresat e fundit kulturale në Belsh, kalanë e Qafës dhe Skampin i takojnë periudhës së Justinianit. Ato mbulohen nga një shtresë djegie dhe rrënojash, që dëshmojnë për një fund të dhunshëm, i cili s'është gjë tjetër veçse një pasojë e dyndjeve sllave. Ndonjëri prej vendbanimeve vazhdon të jetojë, siç është rasti i kalasë së Valshit, por me një kufizim të theksuar të sipërfaqes së banuar dhe të intensitetit të jetës.

Për zonën e Elbasanit është karakteristikë mungesa pothuajse e plotë e fortifikimeve mesjetare gjatë luginës së Shkumbinit. Duket se pas humbjes së rolit të rrugës Egnatia, lidhja me krahinat e brendshme bëhej nëpërmjet luginës së Devollit dhe Osumit, ku takojmë një numur të mirë kështjellash mesjetare dhe një metropol si Beratin. Sidoqoftë ky është një problem që del jashtë temës sonë, dhe ne u mjaftuam me një vërejtje që mund të shërbejë si pikënisje studimi për specialistët e periudhës së mesjetës.

33) Një përshkrim dhe datim më i saktë i mureve është bërë nga Gj. Karaiskaj, **Kalaja e Elbasanit, «Monumentet»,** I, 1971, 66-77.


DARDHA
AD DIANAM
PASHTRESHI
ZAVALINA
TERVOLI
TRAIECTO
VALESH
GRAMSHI
SHKAMBI MBRET
LLESHAN
SHELCAN
KALAJA MENGLIT
GALIGAT
SKAMPIS
BIXELLENJE
LLIXHA
GJONEMI
JAGODINA
KALAJA E QAFES
AD QUINTUM
KAMUNAH
SHENLLIU
PAZHOK
KULLA E GRACENIT
PAPER
GREKANI
TERBAÇI
SHALES
KAJANI
GRADISHTA E BELSHIT
BODINI
QAFESHKALLE
PETRELA
SARAGU
XHERIJE
DESHIRANI
FATISHA
DOREZI
CLODIANA
KARINA
Via Egnatia
Dego kryesore
Dega sekondare
Kala te periudh Romake
Ura
Varrezo Ilire
Tumo
Thesare
Stacione Ilire
Furra
Vend banime te hapura

DO NOT COPY



1



2



3



4

DO NOT COPY

INST. ZA NAR. KULTURU
BIBLIOTEKA
4597

DO NOT COPY





DO NOT COPY



1



2



3



4

DO NOT COPY


KODRA E SARAGUT
275.0
270.0
265.0
260.0
255.0
250.0
245.0
240.0
235.0
230.0
225.0
220.0
215.0
210.0
205.0


KALAJA E QAFES
750.00
800.00


SHKEMBI I SHENLLIUT
970.0
975.0
980.0
985.0
990.0
985.0
980.0
975.0
960.0
955.0
950.0
945.0

DO NOT COPY



DO NOT COPY

TAB. VIII



DO NOT COPY

DO NOT COPY





DO NOT COPY



DO NOT COPY









DO NOT COPY



DO NOT COPY



1



2



3



4



8



5



6



7

DO NOT COPY

NERITAN CEKA

ARCHAEOLOGICAL SURVEY OF THE ELBASAN REGION

DO NOT COPY

SUMMARY

This archeological survey encompasses the Elbasan region, whose administrative boundaries include a geographical entity historically characterized by a common economic and cultural life. The material mainly relies on data from archaeological excavations made in Pazhok (1960), Gradishta of Belësh (1969), the Rock of Shënlli and Bradashesh (1968), Castle of Elbasan (1970) and at the Tepe hill (1968), as well as on a systematic archaeological work carried out in the centers of this region. Such studies and surveys have greatly complemented and clarified those few studies made in the past.

A general view of the archaeological map of Elbasan gives a fair impression of the regular distribution of settlements during various periods. During the Bronze Age settlements were mainly concentrated in the fertile fields and hillsides near and around the meander of the Devoll river, which supplied every condition for a sedentary life relying on the cultivation of cereals and the raising of live stock at the same time. During the first period of the Iron Age (the XI-V centuries) the main settlements were distributed among the high hilly zones, near highway mountain passes connecting various regions. Such a position of the settlements must have been conditioned by the necessities of defence aroused under the new social-political circumstances, created with the deterioration of the primitive commune. Similar features in the distribution of settlements are observed also in the civic period, with the difference that the greater number of castles are huddled along the main highway crossing the Shkumbin river. Both sides of the Shkumbin river and the hilly zone to the south of the river were densly populated with rustic settlements with Skampini as their center, whereas the fortified settlements planted to the high mountain and hilly regions lost their importance during the first centuries of our era. The late antiquity period, from the urbanization viewpoint, is characterized by a revival of the Illyrian civic period, but this revival is not the result of economic motives.

1. THE BRONZE AGE

The tombs of Pazhok arranged in groups, with the central burial places differing from the rest and with their quantitative and qualitative differences of their inventaries, represent the patriarchal character of the society during the early and middle Bronze Age. The exchange of products and the wars, as new phenomena of this society, are brought out through the presence of objects of Mycenaean import consisting mainly of weapons. The exchange among regions on the basis of metalic objects is witnessed by the founding of two bronze axes of the Shkodran type.

From the architectonic aspect and the rites of burial the tombs of Pazhok contain in themselves the chief elements defining the features of the Illyrian tombs' cemetry dating from the end of the Bronze Age to that of the Iron Age. The middle Bronze Age might serve as a terminus ad quem for the establishment of the manners and rites of burial, as a common element in the Illyrian culture of our time. The part

played by the zone of Elbasan in the course of this process, especially in the integration of the centers of the upper valley of Devoll river, is brought out through the documents pertaining to the layer of the late Bronze Age in Gradishta of Belësh. The forms of ceramics of this zone are similar to those of synchronic layer of Gajtan I whereas the elements are inhereted from Maliq III c-d.

II. THE FIRST IRON AGE

The settlements of Gradishta of Belësh become larger in this period and are represented by a layer of two phases. The first phase harbors the connections with the eastern regions. This conclusion is reached with the aid of the similarity between the forms of ceramics of this zone and those of the Treni III, but the connection is much closer with Gajtan II and it could be said that it is a case of the same cultural group. It appears that at that time there must have existed a stability in the movements of the population and that regular connections must have been established among the various regions. The North-South connections are dominant.

The second phase is characterized by the consolidation of local peculiarities of the Belësh ceramics using a reddish paint to make designs on the polished ocre colored surface of the vessel. This technique is inherited from the upper valley of the Devoll river. Ceramics of this same type is found today also in the middle and upper valley of the Shkumbin river as well as in the middle valley of the Devoll river. It is characteristic of a cultural group being formed in this zone during the VIII-V centuries before our era. The relations with the Mediterranean area are represented in this layer by a few fragments of ceramics and the similarity of some forms or motives with the Protocorynthic ceramics.

Besides the open settlement of Belësh, there are brought into light a number of fortified settlements encircled by unchiseled rock, designed simply and without towers and a few entrances. Another type of settlement draws its defensive power from the position, especially, when situated on rocky heights fortified by nature, which is not encircled by walls.

The manner of burial is still that of tumuli and their inventaries represent some survivals of the Mycenaean types of weapons.

III. THE ILLYRIAN CIVIC AGE

During the VI-V centuries is observed a transfusion 'en masse' of ceramics material from Apollonia and Dyrrachium which was accompanied by the home-made ceramics with painted decorations. In the latter it can be observed that some pots have been made in the wheel. It is the first time that this transitory phase is ascertained as a phase between the first Iron Age to the Civic age, which on the economic plane marks the transition from the order of primitive commune to the slave-owning order. This is also the prelude of an urbanizing process to be realized during the IV-III centuries with the emergence of a series of fortified centers, mainly by the highways.

The bourgs of the IV century before our era were set up along the Shkumbin valley. They are characterized by simple design with towers and few entrances. In the Rock of Shënlli, the stones are chiselled into polygonal shape with protrusions like those of Lisi II, or with flat surfaces and trapezoidal forms like those of Zgërdhesh II. The walls on the Saragu hill and on the Mali hill are built of tetragonal blocks of flat surface.

The setting up of castles along the Shkumbin valley, besides economic reasons, might have been urged by an organized design of the Illyrian state against the Macedonian invasion by the end of the IV century before our era.

The hinterland areas of this region represent settlements of the same type, but having an additional encircling wall. These are topologically distinguished from those

DO NOT COPY

DO NOT COPY

of the first Iron Age only by the efforts to using the tetragonally shaped blocks. The Gradishta of Belësh which became an urban center still represents at that time the typical defended settlement.

The open settlements are mainly in the shape of villages in the Dumre zone or in the shaps of habitations around castles.

From the viewpoint of the economic development there are centers of accentuated urban character, that is, turning out various handicraft products or engaged in internal and inter-regional developed trade; strategic centers with consuming economy where only ceramics shops can be observed; fortified centers of urban-rural character where the function of agricultural production is connected with that of the exchange with other centers, and, at last, villages.

The process of the emergence of centers of urban structure is conditioned by the transition to the production of goods. At the beginning the exchange is based on the use of silver coins minted in Dyrrachium, Apollonia, Macedonia and Athens. By the end of the IV century the bronze coins minted in Dyrrachium and in Macedonia were accepted as equivalents of exchange too. This is a witness of the creation of a guaranteed marked for the exchange of goods. Ceramics, which as early as the IV century represented an almost entirely handicraft product, came to be processed according to the taste of civil life. The ceramics of the Apulian style produced in Dyrrachium and Apollonia is frequently met, too. These products completely substitute the traditional ceramics even in the remote rural areas. The processing of metals gave rise to the development of smithery, the production of work tools and weapons, which generally preserve the forms of the first Iron Age. Artistical handicraftsmanship assumed great development alongside with the former. The development of agriculture, as the excavations indicate so far, had brought about the extension of rural settlements and the cultivation of various varieties of wheat and vegetables. The transition of the peasant economies to the production of goods is supported by the finding of numerous bronze coins in the mountain area of Shpat. The features of the urban life are improved by the development of art and culture just in those areas where the urban life is most intensive. The region of Dumre has supplied us with a great number of sculptures of the III-I centuries before our era with distinct local features and with such inscriptions where only illyrian names are used (such as Genth, Bathuna, Amul, Minaz, Zaimi).

As far as the connections among regions are concerned, the zone of Elbasan is subject to the economic influence of Dyrrachium. The coins minted in Apollonia and Orik rank second and third after those minted in Dyrrachium. The macedonian coins, which used to occupy an important place in the IV century, are almost non-existant in the III century, while those of Dyrrachium have come to usage in such regions as Pogradec and Korça.

In the middle of the I century before our era there is a moment of change in the life of the Elbasan zone, which from the viewpoint of urbanization is expressed in the interruption of life in a series of urban centers. Historically this is due to the Parthian uprising against Rome in the year 39 before our era, which, in turn, should be connected with the Roman policy of unification pursued in the treatment of occupied lands.

IV. THE PERIOD OF ROMAN DOMINATION

The outcomes of the Roman domination were felt in all aspects of life on the eve of the new era, by remoulding the physionomy of the settlements and their architecture, by establishing a new ratio among the branches of the economy, by bringing about new phenomena in art and culture. Two distinct phases could be observed in the development of this process, with the IV century as a separating point between them.

DO NOT COPY

A. The I-II Centuries

The Roman domination interrupted the normal process of the development of the economic life by channelling it according to the demands of the Roman Empire. This was expressed in the concentration of the economic activity in a few large centers such as Skampini and Belësh and in the disappearance of many urban centers. The predominant type of settlement is the village mostly situated along the Egnatia highway and in the lowlands and hillsides. Stations and villas appear as new types of settlements.

The ruralization of the life corresponds to the predominance of the agricultural production over the handicrafts. The production of ceramics is still the representative of the most developed branch of handicraft. In the I-II centuries the shapes of vessels preserve the Illyrian urban tradition with the introduction of new technical elements. The preservation of traditions is also observed in smithery, whereas handicrafts produce standard models of Roman decorations and ornaments.

During this period arts lost their original features of the urban Illyrian period and is mainly represented by sepulcral reliefs with standard scenes and figures. The tradition is preserved only in the bronze statuettes representing Mercury and Apollo.

Following a sporadic use of the Greek language for the inscriptions of the I century, during the II century the Elbasan area was also included in the zone that used the Latin tongue and constitutes the southernmost region of Illyria using that tongue.

From a general review of the archaeological data it could be concluded that the I-III centuries are characterized by an intensive activity, especially during the first two centuries, and by the relatively retarded appearance of the crisis.

B. The IV-VI Centuries

In the second half of the IV century the crisis of the slave-owning society attained its acme in the Elbasan area. Its outcome is observed in pauperization and the reduction of the size of peasant settlements and the militarization of the principal settlements. Skampini is encircled by walls and becomes the center of a system of fortifications for the defence of the Egnatia highway and its ramifications. The architecture of these centers is the gauge of the military and economic importance of the settlement. Skampini as the chief place represents a regular system of fortifications realized with the aid of high building technique. The civil features of this place are supported by the finds of ceramics, inscriptions, and sculptures. Another category of settlements, mainly situated in the mountain zones, are the castles of military character, in which the economic life occupies a place in itself. There are also settlements of pure military character.

The handicraft product is chiefly represented by ceramics with the utensils and the building materials prevailing. The smiths turn out mostly agricultural work tools. Coins pertain to two limited periods: the end of the IV century (Theodosius, Valentinian II) and some decades of the VI century (Justinian). It is clear that under the conditions of the decline of the slave-owning order, the ruralization of the economy characterizing the I-IV centuries, paved the way for the gradual transition to an autarchic natural economy.

The dissemination of Christianity is followed by the setting up of paleochristian churches near castles or open settlements. About the middle of the VI century life is extinguished in the majority of the settlements of the Elbasan area by a sudden violent event which could not have been anything else but the effect of Slavic inroads. Afterwards, throughout the Middle Ages, the Elbasan area loses its importance as a center by the roadside on the banks of the Shkumbin river, and this role is transfered further south to the regions round the Devoll and Osum rivers with Berat as their center of the Middle Ages.

DO NOT COPY

bazë të të cilave mund t'i ndajmë në katër grupe kryesore: Në grupin e parë vendosen monogramet që mbajnë një numur gërmash të kompozuara në një lidhje apo thurje të vetme (fig. 5). Në të dytin, monograme të shoqëruara me mbishkrime (fig. 6-7), në grupin e tretë, monogramet që kanë nga një ose dy gërma të veçuara (fig. 8), dhe në të katërtin, kemi vendosur të gjitha shënjat e veçanta, që kemi gjetur të riprodhuara mbi tulla të ndryshme (fig. 9).

Nga këto, monograme të grupit të parë janë gjetur në shumë fragmente apo tulla të murosura në gjithë gjatësinë e murit jugperëndimor duke filluar që në rreshtat e parë të muraturës me tulla dhe deri në lartësinë e bedenave të kullave mbrojtëse të kalasë. Këto monograme deri tani janë diktuar të riprodhuara në dy variante (fig. 5), vetëm, ose të shoqëruara me një kryq të vogël në të majtë. Në variantin e parë, kur është i vetëm, monogrami ka përmasa 10 x 11,50 cm, dhe kur është së bashku me kryqin është pak më i vogël 9 x 10 cm. Në të dy këto variante, monogrami është i njëjtë përsa i përket kompozimit dhe gërmave; ata dallohen vetëm si riprodhime të dy kallëpeve me madhësi të ndryshme.

Për këtë lloj monogrami është treguar kujdes i veçantë si për kompozimin e gërmave ashtu edhe për gdhëndjen e tyre nëpër kallëpet e drurit. Si rrjedhim është arritur një riprodhim shumë i qartë.

Nga grupi i dytë i tullave me monograme të shoqëruar me mbishkrime janë gjetur tre ekzemplarë të murosura në kullën A të murit jugperëndimor (fig. 4). Në këto tulla gjejmë të riprodhuara të njëjtat monograme që përfshihen në grupin e parë, por në dy variante të ndryshme, në përmasa dhe në vendosjen e tyre jo më në mes të tullës, por anash, me kokë poshtë dhe bri tyre një mbishkrim të shkurtër.

Ekzemplarin e parë të monogramit me mbishkrim e dalluam me vështirësi nëpërmjet një plasjeje të muraturës, në qemerin e një nike që ndodhet në ballin e kullës **A.** Variantin e dytë të këtij monogrami me mbishkrim e gjetëm në një tullë të vendosur në një nga vrimat e skelerisë, në afërsi të gjetjes së parë. Në të dy këto variante mbishkrimi është me tekst pjesërisht të gjymtuar dhe vëndi ku gjinden tullat e murosura nuk lejonte mundësinë e fotografimit, as edhe të kopjimit të saktë të tyre. Ekzemplarin e tretë të monogramit me mbishkrim deridiku të plotë, e gjetëm në një tullë të rivendosur në muraturën e përzier të bedenave, shtesa këto të mëvonëshme të kullës **A.** Në këtë rast, tulla e shënuar është murosur në drejtim vertikal në faqen e murit të një frengjije. Faqja e mbishkruar e tullës është shumë mirë e dukshme, kështuqë patëm mundësi të riprodhojmë në allçi një kopje të monogramit së bashku me mbishkrimin që e shoqëronte atë (fig. 6).

Monogramet e grupit të tretë janë dy llojesh, me një dhe dy gërma. Me një gërmë janë gjetur tre ekzemplarë të ndryshëm, një me gërmën A (alfa) së bashku me një kryq të vogël në majë, të diktuar në afërsi të kullës D (fig. 8-A). Me gërmën N (ni) të riprodhuar anasjelltas janë gjetur dy tulla të murosura, njëra në qemerin e hyrjes së harkuar që gjëndet ndërmjet kullave **C-D** dhe tjetra tullë me gërmën Δ (Delta) është e murosur gati mbi themelin e kullës **C.** Gërmat e këtyre monogrameve janë riprodhuar afërsisht në mes të tullave me përmasa përkatësisht 3.5 x 4.5 cm; 5 x 8 cm., dhe 4 x 5 cm.

Nga monogramet me dy gërma janë gjetur tre ekzemplarë, (fig. 8, D); në të parin duken qartë gërma A (alfa) dhe X (hi) të vendosura këto së bashku, njëra sipër tjetrës; në të dytin, janë gërmat A (alfa) dhe π (pi) (fig. 6, H) dhe po të marrim parasysh se edhe në këtë rast gërmat duhet të lexohen anasjelltas, atëhere kemi në të vërtetë këtë lexim π-A (pi-alfa). Në monogramin e tretë, të kategorisë me dy gërma, kemi gjetur tulla që janë të vulosura me një katror në madhësitë e gërmave të monogrameve të tjerë; ky katror është i ndarë përgjysmë, në dy drejtkëndëshe (fig. 8, F). Për mendimin tonë, gërmat më të përafërta që mund të lexohen në këtë monogram janë E-Θ (epsilon-thita). Përmasat e këtyre monogrameve variojnë nga 3,5 x 5 deri 3,5 x 5,5 cm.

Në grupin e katërt, përfshihen të gjitha tullat e shënuara me kryq të riprodhuar me përmasa të ndryshme në të gjitha variantet që ai përdorej në fushën e artit dhe të arkitekturës bizantine. Tulla të tilla janë diktuar në muraturën përbrënda kullës C dhe për gjatë murit të rrethimit (fig. 4 dhe 9).

Nga gjithë ky material epigrafik, që kemi parasysh, një interes të veçantë paraqet monogrami i grupit të parë (fig. 5). Ky monogram është gjetur, siç thamë, në një numur tullash të murosura në gjithë gjatësinë e murit jugperëndimor. Një ekzemplar i tij është gjetur në një vrimë skelerie në rreshtat e para të muraturës me tulla, dhe fill mbi zokolaturën e themelit, në pjesën ku muri jugperëndimor humbet gjurmët e veta, në afërsi të kodrës me kuotë 59. Ekzemplarë të tjerë janë diktuar në gjithë gjatësinë e këtij muri (fig. 4), kështu që vërtetohet se tullat e shënuara me këtë monogram kanë qënë përdorur që në fillim të muraturës me tulla dhe kanë vazhduar edhe në lartësi; pra këtu nuk kemi të bëjmë me gjetje të rastit, apo me material që mund t'i përkasë ndonjë meremetimi ose shtese të mëvonëshme.

Një përshkrim edhe më i hollësishëm i këtij monogrami do të ndihmojë, për të dhënë një gjykim

BOTIMET

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5

DO NOT COPY



Fig. 6



Fig. 7



Fig. 8



Fig. 9

të drejtë lidhur me zbërthimin e gërmave të monogramit dhe me vendosjen e tyre në radhë, për leximin e emrit të vërtetë që përfaqësohet në këtë monogram.

Ashtu si është mbi tullë, këtë monogram nuk mund ta lexojmë, mbasi, sikundër thamë, ai është riprodhuar së prapthi (fig. 10). Kjo vërtetohet edhe një herë nga kryqi i vogël që shoqëron monogramin, i cili gjendet në të majtë, kurse në të vërtetë, ai vendoset gjithmonë në fillim në krahun e djathtë. Pra, që ne të fillojmë nga zbërthimi i monogramit duhet të vendosim atë së mbari (fig. 11). Në këtë rast ne dallojmë të qarta gërmën N (ni) dhe gërmën A (alfa), kjo e fundit formohet nga vija lidhëse e shtagës vertikale të N (ni) me vijën diagonale të saj. Sikurse duket shumë qartë, gërma N (ni) është gërma bazë e këtij monogrami dhe gërmat e tjera janë të lidhura nëpër të. Një gërmë O (omikron), me përmasa të vogla është e lidhur në majën e shtagës së parë dhe një Y (ypsilon), në majën e shtagës së dytë të gërmës N, ndërmjet dy këtyre shtagave lexohen dy gërma të njëllojta Σ (sigma) të vendosura njëra mbi tjetrën. Në shtagën e dytë, në krye, nën germën që përmendëm dallohet një vijë horizontale e cila, së bashku me këtë shtagë, mund të merret si T (taf), po kjo shtagë në fund të saj ka një pjesë të dalë, gjë që tregon edhe njëherë se kjo shtagë mund të merret si I (jota).

Nga ky lexim kemi këto germa të sigurta N-A-O--Σ-T-Y-I. Përpara se të kërkojmë një vendosje të drejtlexueshme të këtyre shkronjave, duhet të përmëndim këtu disa kritere karakteristike të vëna në dukje nga Weigandi, në kompozicionin e monogrameve gjatë shek. III dhe gjysmës së parë të shek. IV si edhe mbas kësaj kohe[3]). Në monogramet e shek. III shkronjat e emërit janë të lidhura vetëm për rreth një germe që ka vetëm një shtagë vertikale, p.sh. T-I-F. Nga fundi i shek. IV në qendër të kompozimit vendosen gërmat me dy shtaga vertikale siç janë H-N-X-M. Ky tip vazhdon deri në fund të shek. VI. Simbas të njejtit autor aty nga gjysma e dytë e shek. VI fillojnë të përdoren monogramet kristiane në formë kryqi, të cilët mbas një lufte gjysmë shekullore, arrijnë të mbizotërojnë mbi tipin me dy shtaga vetëm në fillim të shek. VII.

Të mbështetur në këto kritere të provuara me sukses nga Weigandi dhe autorë të tjerë, ne analizojmë nga ana stilistike monogramin tonë dhe vërejmë se ai bën pjesë në monogramet me dy shtaga vertikale, karakteristikë, siç e pamë, për periudhën e fundit të shek. IV deri në fund të shek. VI. Monogrami ynë është, pra, kompozuar duke patur si bazë germën N e cila bën pjesë në grupin e germave dyshtagore (H-M-N) që, simbas Weigandit, kanë filluar të përdoren në monogramet e hershme bizantine. Kjo vendosje kronologjike relative e monogramit të gjetur në tullat e murit jugperëndimor të kalasë së Durrësit, na shtyn të kërkojmë emrin e përfaqësuar në këtë monogram në një periudhë pak a shumë të përcaktuar në kohë.

Në historiografinë bizantine autorë të ndryshëm theksojnë se bazën e ndërtimeve fortifikuese për mbrojtjen e qytetit të Durrësit të dëmtuar rëndë nga tërmeti i madh i vitit 345 dhe rrënimet e shkaktuara nga pushtuesit e përkohshëm gotë, e ndërtoi Anastasi I (491-518). Ky perandor bizantin me origjinë durrsake e rrethoi qytetin e vendlindjes së vet me tre radhë muresh të fortifikuara me kulla të larta. Burimet historike bëjnë fjalë për ndërtime të tjera të bëra në Durrës nga pasardhësit e Anastasit I, perandorët Justin dhe Justinian I, të cilët ishin me origjinë ilire. Perandori Justin (518-527) modifikoi ndërtimet mbrojtëse të Anastasit I, kurse Justiniani I (527-565), përfundoi gjithë sistemin mbrojtës të qytetit.

Nga emrat kryesorë që gjejmë në burimet historike në periudhën e hershme bizantine, ai i Anastasit I mund të plotshkruhet me germat, që, sikundër e pamë, lexohen qartë në monogramin tonë. Për ta vërtetuar edhe një herë këtë lexim ne bëjmë një krahasim ndërmjet monogramit që kemi gjetur në tulla dhe, monogramit të vendosur nga perandori Anastasi I në monedhat e prera në periudhën e sundimit të tij[4]), (fig. 12). Në këtë krahasim duket qartë, se në tullat e përdorura në murin jugperëndimor të kalasë së Durrësit kemi një riprodhim të plotë të monogramit të Anastasit I të shkruar, në rastin tonë, në gjuhën greke.

Duhet të kemi parasysh, se në ndërtimet e kalave dhe në monumentet e kultit, përdorimi i emrit të perandorit që ishte në fuqi ka qënë i zakonshëm sidomos gjatë shek. V-VI. Me këtë rast po përmëndim këtu se kohët e fundit janë zbuluar në Histori të Dobruxhes[5]) një numur i madh tullash me përmasa 35 x 35 x 5,5 cm që mbanin një vulë me mbishkri-

3) K. Weigand — **Ein bisher verkanntes diptychon symmachorum, Jahrb. des Deutschen Archaologischen Institutes,** Bon, 52, 1937, f. 121-128.
4) H. Goodacre, **A. Handbook of the coinage of the Byzantine Empire,** 62.
5) I. Barnea — **Contributions to Dobrudja history under Anastasius I Dacia,** N. S. II, 1958, 338-339 fig. 7, 8.
6) I. Barnea, **po aty.,**
7) I. Barnea, **po aty.**

DOKTORATURA



Fig. 10



Fig. 11



Fig. 12



Fig. 13



Fig. 14

min: IMP(erator) ANASTASIUS. Këto tulla të mbishkruara vërtetojnë se muri mbrojtës në anën veriperëndimore të murit rrethues të kalasë, ka qënë i rindërtuar në kohën e Anastasit nga ana e ushtarëve të garnizonit të kalasë.

Nga gërmimet e bëra gjatë viteve 1950-59 në Dinogetia, [6]), gjithashtu u gjetën në vende të ndryshme të kalasë fragmente tullash të mbishkruara në njerën nga faqet e trashësisë së tyre me emrin e perandor Anastasit I. Tullat e mbishkruara janë gjetur së bashku me pjesë nga shtresa e llaçit ku dallohen qartë copa tulle të vogla të përziera me gëlqere, karakteristikë kjo e dallueshme për ndërtimet e periudhës së hershme bizantine.

Një objekt me vlerë artistike siç është disku i praruar i argjendë, që ndodhet sot në Muzeun e Ermitazhit në Leningrad [7]) ka të stampuar në shpinë në formë medalioni bustin e perandorit me një aureolë rreth kokës dhe me mbishkrimin: D(ominus) N(oster) ANASTASIUS P(ius) AUG(ustus) (fig. 13. 2. b.) Në afërsi të bustit të perandorit gjënden gjithashtu të stampuara dy vula, të cilat simbas J. Barneas, tregojnë peshën dhe sasinë e argjendit dhe të floririt të përdorur për punimin e diskut në fjalë. Duke vërejtur me kujdes ilustrimet e paraqitura nga autori i sipërpërmëndur, ne dallojmë qartë se në

DO NOT COPY

njerën nga këto vula (fig. 13.2.c.) është riprodhuar monogrami tashmë i njohur i Anastasit I (fig. 14). Ky monogram na vërteton edhe një herë se monogrami i Anastasit I ka qenë me një kompozim të mirënjohur për kohën e tij dhe i përdorur në shumë fusha: ndërtim, art, etj.

E kemi thënë që në fillim, se monogramin tani të identifikuar me atë të Anastasit I, e kemi gjetur edhe të shoqëruar me një mbishkrim të shkurtër (fig. 15) në gjuhën greke, me gërma shtypi në një rresht të vetëm. Tre gërmat e para kanë përmasa 4 x 6 cm, dy të fundit janë pak më të vogla, rreth 2x3 cm. Në njerin nga ekzemplarët e tullave të mbishkruara lexohen të qarta anasjelltas tre germat e para E-P-Γ (fig. 6) kurse në dy ekzemplarët e tjerë, arrihet të dallohen dy germa të tjera O-Δ dhe sipër tyre, një trakt – vijë e vogël (fig. 7). Këto germa të bashkuara i lexojmë ΕΡΓΟΔ (fig. 16) trakti që është vënë sipër dy germave të fundit tregon se, për mungesë vëndi, është bërë një shkurtim i kompozitës ΕΡΓΟΔ(OTHS) e cila e përkthyer në gjuhën shqipe, don të thotë punëdhënëse.

Mbishkrimi që shoqëron monogrami na tregon qartë se perandor Anastasi I ka qënë punëdhënës, pra ndërtuesi i kalasë së hershme bizantine në qytetin e Durrësit dhe se materiali kryesor i ndërtimit, tullat, janë prodhuar nga punishtet perandorake.

Për monogramet e grupit të tretë që janë me një ose dy germa, mendojmë se janë numura konvencionale të përdorur për numurimin e sasisë së tullave të prodhuara nga skuadra ose sektorë pune të ndryshëm.

Vulat e përdorura në stil të ajerë, me shënjën e kryqit në variante të ndryshme, lidhen me botëkuptimin fetar të kohës që i takojnë.

Gjetjet dhe vrojtimet tona, siç thamë, sot për sot i përkasin vetëm murit rrethues dhe kullave të ndërtuara në anën jugperëndimore të qytetit të lashtë të Durrësit. Ky mur, sikundër vërtetohet me saktësi nga materialet epigrafike që dhamë më sipër, i përket sistemit të fortifikimit më të hershëm bizantin të ndërtuar nga perandor Anastasi I.

Në saje të një sërë punimesh konservuese dhe restauruese të kryera disa vjet me radhë, muri jugperëndimor ka dalë në dukje në një gjatësi rreth 500 m.

Duke filluar që nga maja e kodrës me kuotë 59 m, muri zbret pothuaj në vijë të drejtë deri në bregdet. Ai ndërpritet çdo 60 m, nga kulla në formë pesëkëndëshe, me një kënd të ngushtë në mes. Nga këto kulla ruhen akoma në këmbë tri të parat, A,B,C, (fig. 4), duke filluar nga bregdeti, dhe vetëm disa gjurmë nga kulla e katërtë D. Në gjithë gjatësinë e ruajtur duket se muri jugperëndimor ngrihet mbi një themel të ndërtuar me mur guri të papunuar të lidhur me llaç harasani. Muri i themelit del vende-vende në sipërfaqe të tokës në një zokolaturë të shkallëzuar simbas pjerrësisë së terrenit. E gjithë muratura në lartësi është e ndërtuar me tulla të pjekura.

Tullat, materiali bazë i muraturës, po të vërehen me kujdes, dallohen ndërmjet tyre përsa i përket materialit, brumosjes dhe pjekjes. Këto ndryshime duken të qarta në nuancat e ngjyrave të tullave dhe rrjedhin, me sa duket, nga vendet e ndryshme të prodhimit të tyre dhe të përdorimit të lëndës djegëse. Këto faktorë kanë ndikuar gjithashtu edhe në përmasat e ndryshme të tullave, të cilat luhatin në gjatësi nga 35-37 cm, në gjerësi nga 28-30 cm. dhe në trashësi nga 4 në 5 cm.

Mendojmë se masa bazë për prerjen e këtyre tullave ka qënë «këmba romake» (pes = 27,8 cm) x x (palmipes = 35,77 cm).

Teknika e ndërtimit të këtij muri është karakteristike për sa i përket vendosjes së tullave në rreshta horizontalë në të gjithë trashësinë e murit, të mbështetur mbi një shtresë llaç 7-9 cm të pregatitura me gëlqere të përzier me zhavor dhe me copa tullash të thyera. Në këtë mënyrë, si muri dhe kullat janë të dallueshme shumë qartë nga gjithë ndërtimet më të hershme ose edhe më të vona, rrjedhimisht kjo teknikë përfaqëson një periudhë ndërtimi tashmë të datuar mirë (491-518)

Të bazuar në karakteristikat teknike dhe konstruktive që dallojnë murin jugperëndimor të kalasë së Durrësit, që përshkruam më sipër, shprehim mendimin se mbeturinat e sistemit mbrojtës që ruhen në Porto Romano, në veri të qytetit, nuk mund të lidhen me ndërtimet mbrojtëse të kohës së Anastasit I. Ky mendim, në kundërshtim me pretendimet e autorëve që përmëndëm në fillim, përforcohet edhe më tepër nga fakti, se në tullat e përdorura për muraturën e përzier të Porto Romanos nuk është gjetur as edhe një nga monogramet apo shënjat e gjetura në murin jugperëndimor të kalasë së qytetit. Edhe një kullë që bën pjesë në këtë sistem mbrojtës, po ta krahasojmë me kullat e murit jugperëndimor të kalasë së Durrësit, ka përmasa të vogla dhe formë të ndryshme.

Të mbështetur në rezultatet që përmëndëm në këtë punim, mund të themi se i gjithë sistemi mbrojtës, ku bënte pjesë edhe muri jugperëndimor që përshkruam më sipër, ka qënë ndërtuar dhe përfunduar në të njëjtën kohë. Në këtë mënyrë dalin si të dyshimta botimet historike që bëjnë fjalë për modifikimin dhe përfundimin e punimeve mbrojtëse të Anastasit I nga perandorët pasardhës të tij, Justin dhe Justinian I.

BOTIMI COPY

DO NOT COPY



Fig. 15



Fig. 16

DO NOT COPY

KOÇO ZHEKU

DECOUVERTES EPIGRAPHIQUES SUR LES MURS D'ENCEINTE DE LA CITADELLE DE DURRES

R E S U M E

Les récentes découvertes épigraphiques dont il est fait état dans cette communication jettent une lumière des plus nettes sur l'ouvrage de fortification le plus ancien subsistant aujourd'hui dans la citadelle de Durrës. Sur la base de ces documents épigraphiques, il est possible de déterminer nettement les plus anciennes constructions byzantines, la date de leur érection ainsi que l'identité du fondateur de cette citadelle.

Au cours des travaux de conservation et de restauration effectués sur le mur sud-ouest, on a mis au jour des briques emmurées qui portent empreints des monogrammes souvent accompagnés d'inscriptions, alors que sur d'autres figurent des lettres isolées ou des motifs du culte.

Les monogrammes, tout comme les inscriptions, sont accompagnés de lettres majuscules grecques, lisibles à l'envers.

Les briques portant des inscriptions peuvent être divisées en quatre groupes différents: 1) les briques à seul monogramme, 2) les briques à monogramme accompagné d'inscription, 3) les briques portant une ou deux lettres, 4) les briques comprenant des signes particuliers du culte.

Des matériaux épigraphiques présentés dans ce travail le monogramme du premier groupe présente un intérêt particulier. Tel qu'il nous apparaît sur la brique, il semble illisible, car, comme nous l'avons dit, il est reproduit à l'envers.

En renversant le monogramme on peut y lire clairement les lettres N et A. De celles-ci, la lettre N est la lettre de base et les autres sont agencées autour d'elle. Les autres lettres que l'on peut lire sont un O de petites dimensions, placé au sommet du premier jambage de la lettre, N, et un Y à la pointe inférieure du deuxième jambage. Entre les jambages de la lettre N on distingue aussi les deux lettres Σ (sigma) juxtaposées. Au sommet du deuxième jambage, sous la lettre Y, est tracée un petit trait horizontal qui, ajouté à ce jambage, peut être pris pour un T, mais à l'extrémité inférieure du même jambage se trouve un petit trait horizontal qui peut permettre de lire le second jambage de la lettre N comme un I.

Cette lecture nous donne avec plus ou moins de certitude les lettres suivantes N-A-O-Y-Σ-T-I. Avant de chercher à leur donner un ordre qui en permette la lecture, il convient de rappeler ici certains critères dégagés par Weigand quant à la composition des monogrammes au cours du IIIe siècle ainsi que dans la première moitié du IVe siècle, et même dans la période postérieure. Sur les monogrammes du IIIe siècle, les lettres du nom sont disposées autour d'une lettre ne com-

DO NOT COPY

prenant qu'un jambage vertical, comme par exemple T-I-F etc. Vers la fin du IVe siècle, au centre de la composition sont placées des lettres à deux jambages, comme H-N-M. Ce type subsiste jusqu'à la fin du VIe siècle.

Nous fondant sur ces critères, dont la justesse a été éprouvée par Weigand et d'autres auteurs, nous analysons notre monogramme du point de vue du style et relevons qu'il fait partie des monogrammes à deux jambages verticaux, caractéristiques, comme on l'a vu, de la période comprise entre la fin du IVe siècle et la fin du VIe siècle. Notre monogramme est donc composé sur la lettre N qui fait partie du groupe à deux élements verticaux (H-M-N). Cette datation, de précision relative, du monogramme trouvé sur les briques du mur sud-ouest de la citadelle de Durrës nous conduit à rechercher le nom reproduit dans une période plus ou moins déterminée dans le temps.

Divers auteurs de l'historiographie byzantine indiquent que ce fut Anastase Ier (491-518) qui construisit les fondations des fortifications de la ville de Durrës, gravement endommagée par le grand tremblement de terre de 345 et dévastée par l'invasion temporaire des Goths. Cet empereur byzantin, originaire de Durrës, entoura sa ville natale de trois lignes concentriques de remparts, renforcés de tours. Les sources historiques font état d'autres ouvrages élevés à Durrës par ordre des successeurs d'Anastase Ier, les empereurs Justin et Justinien Ier, tous deux d'origine illyrienne. Justin (518-565) modifia les ouvrages défensifs de son prédécesseur, cependant que Justinien Ier (527-565) acheva l'ensemble du système défensif de la ville.

Parmi les noms qui, historiquement, appartiennent à la première période byzantine, celui d'Anastase Ier peut être entièrement écrit à l'aide des lettres qui, comme on vient de le voir, sont facilement lisibles sur notre monogramme. Afin de confirmer encore une fois cette lecture nous avons effectué une comparaison entre le monogramme trouvé sur les briques et le monogramme que l'empereur Anastase Ier fit frapper sur les monnaies de son règne. Cette confrontation fait apparaître que les briques utilisées pour le rempart sud-ouest de la citadelle de Durrës portent une reproduction complète du monogramme de cet empereur, écrit en l'occurrence, en grec.

Sur un objet de haute valeur artistique comme le disque en argent doré qui se trouve aujourd'hui au Musée de l'Ermitage de Leningrad, on peut voir empreint au revers, sous la forme d'un médaillon, le buste de l'empereur, surmonté d'une auréole et de l'inscription D(ominus) N(oster) ANASTASIUS P(ius), AUG(ustus). A côté du buste, l'on note aussi deux estampilles, qui, selon J. Barne, indiquent le poids de l'argent et de l'or utilisés pour le travail de l'objet en question. Une observation attentive des illustrations étudiées par l'auteur précité, révèle qu'un de ces timbres reproduit le monograme déjà connu d'Anastase Ier. Il faut y voir une nouvelle preuve que ce monogramme comportait une composition bien connue pour son époque et utilisée dans de nombreux domaines: construction, art, etc.

La brève inscription évoquée plus haut et qui accompagne le monogramme, est écrite en lettres majuscules grecques. Sur l'une des briques portant des inscriptions, on peut lire, clairement écrits à l'envers, les trois premières lettres E-P-Γ, cependant que sur les deux autres on arrive à distinguer les deux lettres O-Δ et, au-dessus, un petit trait. Les lettres juxtaposées peuvent se lire comme étant EPO, le trait tracé au dessus des deux dernières lettres indique que, faute d'espace, il a été opéré une abréviation de la composition EPΓOΔ (OTHS), ce qui signifie employeur.

L'inscription qui accompagne le monogramme indique clairement que l'empereur Anastase Ier a été l'employeur, c'est-à-dire le constructeur de l'ancienne citadelle byzantine de Durrës et que les matériaux de constructions, les briques, étaient fabriquées dans les ate[illegible]

Quant aux monogrammes du troisième groupe, qui comprennent une ou deux lettres, nous tendons à croire que ce sont des nombres conventionnels utilisés pour

le dénombrement des briques produites par diverses équipes ou divers secteurs de travail.

Les timbres avec le signe de la croix, utilisés largement sur diverses variantes, se rattachent à la conception religieuse du monde qui prévalait à l'époque traitée.

Nos trouvailles et observations concernent pour le moment, comme on l'a déjà dit, uniquement les remparts et les tours, construits sur le côté sud-ouest de l'ancienne ville.

Ce mur, comme il est confirmé avec certitude par les matériaux épigraphiques précités, appartient à l'ancien système de fortifications construit par l'empereur Anastase Ier.

Les travaux de conservation et de restauration menés depuis plusieurs années ont permis de dégager le mur sud-ouest sur une longueur de quelque 500 mètres.

Sur la base des caractéristiques techniques et constructives qui distinguent le mur sud-ouest de la citadelle de Durrës décrite dans cette communication, nous estimons que les ruines du système défensif subsistant à Porto Romano au nord de la ville ne peuvent être associées aux constructions défensives de l'époque d'Anastase Ier. Ce jugement, en opposition aux interprétations des auteurs cités au début, est encore confirmé par le fait que sur les briques utilisées pour la maçonnerie mixte de Porto Romano, il n'a été retrouvé aucun des monogrammes ou des signes relevés sur le mur sud-ouest de la citadelle de la ville. Même une tour conservée et qui fait partie de ce système défensif, est de dimensions plus petites et de forme différente de celle des tours du mur sud-ouest de la citadelle de Durrës.

Nous fondant sur les conclusions énoncées dans cette communication, nous pouvons dire que l'ensemble du système défensif qui comprenait le mur sud-ouest décrit plus haut, a été construit et achevé à la même époque. Ainsi, les sources historiques qui font état de la modification et de l'achèvement des travaux défensifs d'Anastase Ier par ses successeurs, Justin et Justinien Ier, paraissent sujettes à caution.

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

DO NOT COPY

ARKITEKTURA E KISHËS SË MESOPOTAMIT

Rreth 15 kilometra në verilindje të Sarandës dhe 3 km. në lindje të Finiqit, në një kodër pranë fshatit Mesopotam, ndodhet manastiri i shën-Kollit. Nga ky sot kanë mbetur kisha, konakët, padyshim shumë të vonë, dhe rrënojat e mureve rrethuese.

Kisha e këtij manastiri, një ndër kishat bizantine më të mëdha që ruhen në vëndin tonë dhe e veçantë si tip arkitektural, ka arritur deri në ditët tona me mjaft merememtime që ja kanë ndrruar krejtësisht pamjen e parë. Për të sqaruar rindërtimet që ka patur kjo kishë dhe për të arritur në konkluzione të drejta lidhur me format fillestare të saj, janë ndërmarrë disa ekspedita studimi dhe rilevimi, paraqitja e rezultateve të të cilave përbën qëllimin e këtij punimi. [1]).

Zona e Finiqit, në të cilën është ndërtuar ky monument, është zonë e një kulture të vjetër. Nga të dhënat që kemi, në vitin 568 pas prishjes së Finiqit nga Totila, peshkopi i atjeshëm Eustahu transferoi selinë e peshkopatës në Mesapotam, duke e quajtur peshkopata e Finiqit dhe Mesopotamit, prej nga më vonë shkoi në Delvinë [2]).

Po Bara na thotë se ky manastir ka qënë shumë herë ekzarhi dhe kontrollonte fshatrat përreth.

Gojëdhanat na flasin për një manastir të fortifikuar, shumë të vjetër, të ndërtuar mbi një tempull pagan që ja atribuojnë Poseidonit. Aravantinos [3]) e përmënd Mesopotamin si qytet në kohën e Bizantit dhe e identifikon me Veshën.

Përmëndjen më të hershme të Mesopotamit e kemi në këngën e Robert Guiskardit, ku ndër komandantët bizantinë përmëndet dhe Vasil Mesapotamidhi, tek episodi i Baligandit që ka ngjarë në vitet 1062-1064 [4]).

Kantakuzeni [5]), në përshkrimin e kryengritjeve të shqiptarëve në krahinat e Beratit dhe të Vlorës, përmënd Mesapotamin ndër qytetet që nuk u shkëputën nga perandori në kryengritjen e vitit 1336. Ndër dokumenta, Mesapotamin e hasim në rregjistrat turke të vitit 1431-1432 si fshat në vilajetin e Vajonetës. [6]).

Më vonë këtë manastir e përmendin vizitonjës të huaj që kanë kaluar nëpër Shqipëri. Hjuz[7]), që e ka vizituar në vitin 1815, shkruan për kishën e manastirit, që sipas tij, është e ndërtuar me materialet e marra nga rrënojat. Përshkrimi që na jep Hjuz është mjaft i shkurtër; ai mjattohet të na thotë se interieri mbahej nga kolona dhe se muret kishin disa bloqe me skulptura të punuara mirë, ku paraqi-

1) Rilevimi është kryer nga autori, Gj. Karaiskaj dhe V. Shtylla me pjesmarrjen e O. Begës, G. Rusetit dhe N. Ballës. Vizatimet janë të S. Dashit, fotografit të R. Veselit, H. Çollakut dhe autorit.
2) V. Bara, **To Dhelvino,** Athinë, 1966, 151-153.
3) P. Aravantinos, **Hronografia tis Ipeiron,** Athinë, 1856, vol. II, 105.
4) K. Luka, **Toponimija shqiptare në këngën e Rolandit lidhur me disa ngjarje të viteve 1081-1085,** «Studime Historike», nr. 2, 1967, 139.
5) Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë, II, Tiranë, 1962, 163.
6) Po aty, 141.

teshin një luan, një shqiponjë, etj.

Mystalidhis [8]), që ka qënë mësues në atë zonë për një kohë të gjatë, na jep një sërë të dhënash të marra nga kapaku i një ungjilli të gjetur atje, që sot është çdukur. Nga ai mësojmë se në vitin 1510 ra një tërmet që bëri dëme dhe se në vitin 1511 një igumen vajti në Stamboll, ku përsëriti shkresat që duket se më vonë u dogjën.

Bara, thotë se, sipas gojëdhanave, manastiri është ndërtuar në kohën e mbretërimit të perandorit Konstandin IX Monomakut (1042-1054) [9]).

Studjuesi i parë i këtij monumenti, përsa njohim ne, është F. Versaqis, i cili në vitin 1914 boton një artikull [10]), ku trajton arkitekturën e kishës së manastirit dhe skulpturat që ndodhen aty. Më vonë Ugolini, që e vizitoi këtë kishë, trajton shkurtazi [11]) më tepër fragmentet me rëndësi arkeologjike që ndodhen të shpërndara rreth e qark. S. Betini, në një numurim të shkurtër të kishave të vjetra të Shqipërisë e përmënd këtë kishë duke e cilësuar bizantine primitive. [12]).

Tezën se kjo kishë është ndërtuar në kohën e mbretërimit të Konstandinit IX Monomakut e përsërisin dhe H. Ceka, S. Anamali dhe J. Adami [13]) në një raport të një ekspedite informative në jug të Shqipërisë, të cilët na thonë, veç të tjerash, se në këtë kishë është dorëzuar prift një oshënar shqiptar nga Lukova i quajtur Rifon, lindur më 1234 dhe vdekur në Malin e Shënjtë më 1330. Kjo datë jepet dhe në volumin I të Historisë së Shqipërisë. [14]). Së fundi kisha është vizituar dhe nga A. Dyselie, që lidhur me kohën e ndërtimit ngre hipotezën [15]) se kjo kishë mund të jetë dhe e shek. IX (po të qe e shek. XI, kemi të bëjmë me një shkollë provinciale që s'ka asimiluar akoma mirë tipin kryq të brëndashkruar).

Studjuesit e mësipërm sigurisht që nuk prekin vetëm problemin e datimit të kishës, ata japin mendime edhe për një sërë problemesh lidhur me formën e parë, shtesat dhe pjesët tashmë të humbura të këtij monumenti, për të cilat do të flasim më poshtë.

Gen-plani



Fig. 1

Përshkrimi arkitektonik

Manastiri i Shën-Kollit në Mesopotam është një manastir i fortifikuar, i vendosur në anën jugore të një kodre të ulët dhe të gjatë që shtrihet nga veriu në jug, në mes të dy shtretërve të lumit Bistricë. Në veri të shtratit të djathtë shtrihet fshati Mesopotam në të cilin herë pas here gjinden mbeturina objektesh të vjetra. Muret rrethuese (fig. 1) formojnë afërsisht një drejtkëndësh me brinjë 100 x 80 m. Sot muret janë mjaft të dëmtuara dhe, në anën veriperëndimore ku ata mungojnë, vetëm në relievin e

7) T. Hughes, **Travels in Greece and Albania,** London, 1830, II, 391.
8) A. Mystakidhis, **Delvina, Qyteti i vjetër Fenikas, Manastiri i Mesopotamit, Saranda,** Arkivi Inst. Hist. Gjuh., A. III, 46, 2-3.
9) N. Bara, Vep. cit., 213.
10) F. Versaqis, **Visantiakos naos en Dhelvino** në «Arkeollogjikon Dheltion», 1915, Nr. 1, 28-44.
11) L. Ugolini, **Albania Antica,** Roma, Milano, 1927, 142-143.
12) S. Bettini, **L'architettura bizantina,** Firenze, 1937, 60.
13) H. Ceka, S. Anamali, J. Adami, **Mbi ekspeditën në Sarandë e rrethe, në Raportet e vitit 1950,** vol. I, 23-25 (pranë Arkivit të sektorit të arkeologjisë të Institutit të Historisë dhe Gjuhësisë).
14) **Historia e Shqipërisë,** I, Tiranë, 1959, 191.
15) A. Ducellier, **Observations sur quelques monuments d'Albanie,** «Revue Archéologique», **1965, Vol. II, Octobre-Décembre, 188-190.**

FOTO COPY

terenit mund të kuptojmë gjurmët e tyre. Me përjashtim të një kulle në anën perëndimore dhe mureve pranë qoshes verilindore që ngrihen mbi tokën brënda manastirit, muret e tjera janë rrafsh me të, ndërsa nga ana e jashtme ngrihen dy-tre metra mbi tokë. Në pjesët që sot qëndrojnë në këmbë, dallohen 7 kulla. Në kullën perëndimore, një faqe e të cilës ngrihet 10 m. lartësi, ruhen gjurmët e disa ndërtimeve. Ajo ka një dritare të vogël në pjesën e sipërme, ndërsa nga ana e brendshme duken gjurmët e mureve tërthorë dhe, në dy nivele, gjurmë të trarëve të dyshemesë. Nga këto gjurmë del se kulla përdorej ose si kullë e veçantë, pra banesë e fortifikuar në rast rreziku, ose si vazhdim i godinave të manastirit, që tradita gojore thotë se ishin në anën jugore.

Kullat e tjera të vendosura në qoshet dhe në thyerjet e mureve janë të vogla dhe duhet të jenë përdorur si zakonisht vetëm për mbrojtje. Nga këto, vetëm kulla B, dhe ajo G. janë me boshllëk në mes, sepse janë më të mëdha se të tjerat. Kulla F është më e madhe dhe ka pjesën e mesit të rrëzuar. Ajo ruan në shpatullat gjurmë të qarta të portës që ndodhej diku në këtë anë. A është kjo porta e vetme apo ka patur dhe të tjera atje ku sot muret mungojnë, sot për sot nuk jemi në gjëndje të përgjigjemi.

Muret janë të ndërtuar me gurë dhe llaç gëlqereje; vetëm nëpër qoshet e kullave gurët janë të gdhëndur. Rrallë, si p.sh. në anët e portës, janë përdorur edhe tulla. Në murin lindor kemi një vrimë shkarkimi të rrjetit të kanalizimit. Sidoqoftë, nga madhësia dhe fortifikimi, mendojmë se kemi të bëjmë me një manastir pak a shumë të madh.

Sot, në pjesën veriperëndimore të manastirit ndodhen konakët që dallohen qartë se janë të vonë. Ata janë të ndarë brënda manastirit me një oborr. Konakët përbëhen nga dy godina, njëra njëkatëshe që përdoret për depo, ndërsa godina tjetër është dykatëshe dhe në katin e dytë ka dhomat e fjetjes. Kati i dytë, në anën e brëndshme, është me çardak me shtylla të drunjta. Është e qartë se konakët e sotëm janë bërë atëhere kur muret rrethuese e kishin humbur funksionin e tyre mbrojtës. Vënde vënde në muret e godinave kemi fragmente të ndryshme arkitektonike, që janë marrë edhe nga kisha. Terreni brënda manastirit sot është mbuluar nga bimësia dhe dherat, prandaj gjurmë të dukëshme të ndërtesave të vjetra nuk duken.

Kisha e Shën-Kollit (fig. 2), që përbën objektin e studimit tonë, është në anën jugore të manastirit, mbi një platformë pak më të ngritur se toka përreth. Për nga madhësia ajo të imponohet menjëherë. Kuptohet se kemi të bëjmë me një kishë jo të zakonshme, sidoqë është mjaft e dëmtuar. Sot tërë dritaret dhe dyert janë të zëna, hyrja e vetme në anën veriore është një portë e ulët e hapur më vonë. Një kundërforcë e madhe në anën jugore mban murin që ka bërë bark, ndërsa në anën veriore dalin nga toka disa shtylla guri. Të shpërndara rreth e qark, janë disa fragmente arkitektonike antike. Në anën lindore një blok i madh murature ndodhet disa metra larg apsidës së sotme. Terreni përreth kishës paraqitet jo i rregullt; nga jugu, veriu dhe lindja më i lartë, nga perëndimi më i ulët dhe kudo në kuotë më të lartë se dyshemeja e kishës.

Nga jashtë kisha ka formën e një kubi, me pjesën qëndrore që ngrihet më lart se të dy anët. Katër kupola, ato perëndimoret më të ulta, kurorëzojnë këtë pjesë qëndrore. Dy pjesët më të ulta mbulohen me nga tri çati dyujshe secila që, respektivisht në fasadat lindore dhe perëndimore, mbarojnë me frontone.

Kisha përbëhet nga narteksi, naosi dhe ambjenti i altarit (fig. 3). Naosi është pothuajse kuadratik, me një pilastër masiv në mes dhe i mbuluar me katër kupolat që përmendëm. Naosi ndahet nga narteksi dhe ambjenti i altarit me nga një arkadë me katër kolona secila. Kemi pra, tre volume të ndara qartë njëri nga tjetri, dhe që komunikojnë ndërmjet tyre nëpërmjet arkadave. E gjithë kisha është mbuluar me kupola dhe kalota sferike, që ngrihen mbi një rrjet kuadratik harqesh mbajtëse dhe harqesh të verbër. Harqet mbajtëse ngrihen mbi pilastra që dalin nga muret anësore dhe në arkadat naos-narteks dhe naos ambjenti i altarit. Ndërsa harqet konstruktivë të verbër janë ndërmjet pilastrave në mure dhe në murin mbi arkadën.

Interieri sot paraqitet jo i rregullt; pilastrat në mure janë të madhësive të ndryshme, një pilastër masiv (2.4x2.4 m) në kryqëzimin e katër harqeve mbajtës të kupolave, ndodhet si përforcim nën harkun e mesit të arkadës naos-narteks (fig. 4). Muret janë të suvatuar në mënyrë të çrregullt dhe vëndevënde, nga sipërfaqja e rregullt e suvasë, mund të kuptohet se aty ruhet suvatimi i vjetër me afreska. Një sipërfaqe e vogël e këtyre është në murin jugor të naosit, por ajo është e nxirë, aq sa mezi dallohet. Interieri është mjaft i errët, nga që tërë dritaret janë të zëna. Ai merr dritë vetëm nga disa vrima të lëna aty-këtu.

Muret e jashtme (Tab. I, 1) përbëhen prej tre brezash horizontalë, që nga struktura e tyre dallohen mirë nga njëri tjetri. Pjesa e poshtme është ndërtuar me gurë gëlqerorë, me përmasa relativisht të mëdha dhe me faqen e jashtme të skuadruar. Këta gurë janë të punuar mirë vetëm në anën e jashtme dhe për këtë u bindëm kur pamë nëpër vrimat që ka muri, si dhe në niket që zbukurojnë fa-

PHOTOCOPY

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 3

sadat në këtë brez. Gurët e nikeve nuk e kanë tërë thellësinë e tyre prej rreth 13 cm të punuar si faqja e jashtme dhe bile në disa vënde kthesa bëhet me kënd të ngushtë, gjë që tregon se gurët në anën e brëndshme kanë formën e pykës, për t'u lidhur më mirë me perden e brëndshme prej tullash. Llaçi në vënd takimin e tyre është i bollshëm, për të luajtur rolin e lidhësit dhe të mbushësit. Këtë gjë, Dyselie [16]) e merr për pjesë të një muri romak me «opus cementum» të ndonjë ndërtese, themelet e së cilës janë ripërdorur këtu. Ky brez, në faqet perëndimore (Tab. I, 2), veriore dhe jugore, shkon deri ku fillojnë harqet e nikeve të ndërtuara prej tullash të vëna në një rresht radial dhe në një rresht të dytë që rrethon të parin, me tulla të gdhëndura për të formuar një hark rrethor të rregullt. Faqja e nikeve është e ndërtuar me tulla. Gurët e skuadruar, për mendimin tonë, nuk mund të jenë marrë nga ndërtesa antike siç mendojnë Versaqis [17]), Ugolini [18]) dhe Ceka etj. [19]), as të shtuar më vonë kur u ndërtua hajati që sot mungon, siç mendon Versaqis, as dhe pjesë e ndonjë ndërtese më të vjetër. Para së gjithash, gurët nuk janë gurë antikë paralelopipedikë, por të punuar vetëm në faqen e jashtëme. Gjithashtu gjatë transportit apo rrëzimit, gurët do të ishin dëmtuar, gjë që vërehet vetëm në murin lindor, që është një rindërtim. Së dyti, vënia e kësaj veshje, për vetë formën e gurëve, do të ishte një operacion i vështirë, në mos i pamundur, dhe do të kishte shkaktuar, për vetë vështirësinë e lidhjes së mirë të dy faqeve, të çara dhe deformime që ne sot nuk i vërejmë.

Dy nike janë në faqen perëndimore dhe tri në faqen jugore (Tab. II, 1), prej të cilave dy janë të zëna me mur. Nga këto, ajo më nga lindja ka në murin mbushës një fugë vertikale 10 cm nga shpatulla e majtë. Brezi i sipërm është me teknikën e zakonshme bizantine të vonë kluasonazhë, ku faqja e jashtëme është ndërtuar me gurë të skuadruar çmërsi të rrethuar nga të katër anët me tulla të holla, ndërsa faqja e brëndshme me mur të zakonshëm me tulla. Të dy faqet lidhen nëpërmjet tullave horizontale që rrethojnë gurët e çmërsit dhe që janë brënda murit më thellë se gurët e çmërsit. Në këtë brez janë vendosur dritaret.

Ky brez mbaron me një frizë dhe kornizë. Korniza (fig. 5) përbëhet prej katër rreshta tullash, të nxjerra konsol ndaj njëri tjetrit dy nga dy. Ndër ta, i pari dhe i treti, janë në formë dhëmbë sharre.



Fig. 4

Vëndi ndërmjet tullave të këtyre dy rreshtave është mbushur me llaç për të theksuar edhe më tepër dhëmbët e sharrës. Në muret veriore dhe jugore, korniza është horizontale, ndërsa në fasadat perëndimore dhe lindore (këtu kemi një imitim, sepse muri nuk është i ri), ajo ndjek frontonet e alternuar me pjesë horizontale ndërmjet tyre dhe në qoshet ku lidhet me kornizën që vjen nga faqet e tjera.

Frizën e gjejmë të plotë vetëm në fasadën jugore, e vetmja që ruhet pothuajse në formën e parë (Tab. II, 1). Meqënëse dritaret treshe që janë në këtë anë arrijnë deri tek korniza, duke e ndërprerë atë, edhe friza nuk paraqitet e vijueshme dhe nuk është e njëllojtë në tërë fasadën. Vizatimi bëhet nëpërmjet tullave të vendosura në formë kurriz peshku, zig-zag, vijë horizontale, në breza, në ndonjë vënd dhe të mbivendosur. Në anën veriore (Tab. III, 1),

16) A. Ducellier, **vep. cit.**, 189.
17) F. Versaqis, **vep. cit.**, 36.
18) L. Ugolini, **vep. cit.**, 142.
19) H. Ceka, etj. **vep. cit.**, 24.

BOTIM COPY



Fig. 5



Fig. 6

muri në pjesën më të madhe i përket një ndërtimi të vonë, friza ruhet shumë pak dhe është me tulla të gdhëndura në formë «S» ndërmjet dy brezash me nga tre rreshta tullash horizontale secili.

Dritaret, që ndodhen në brezin e sipërm janë: tri në murin jugor dhe tri në atë perëndimor, nga një nën çdo fronton. Edhe muri verior duhet të ketë qënë i njëjtë me murin jugor. Për këtë mund të gjykojmë nga pjesa e vjetër, e njëjtë me atë të murit jugor. Nga muri verior, ruhet ana më nga perëndimi (fig. 6), ku janë të fragmentuara dy dritare, ajo që i takon narteksit dhe ajo nën kupolën e vogël.

Dritaret e mëdha të brezit të sipërm janë të gjitha trepjesshe dhe të zëna me mur të çrregullt, nëpër të cilin dallojmë kapitele dhe kolona ndarëse të tri pjesëve (fig. 7). Çdo pjesë e dritareve mbulohet me një hark me tulla, ai i mesit më i lartë se të tjerët. Të tre pjesët e dritareve përfshihen brënda një harku më të madh të formuar me disa rreshta tullash të vendosura në mënyrë radikale, sipas harkut, dhe në formë dhëmbë sharre. Fusha ndërmjet harkut të madh përmbledhës dhe harqeve të dritareve, e futur pak më brënda sipërfaqes së murit, është zbukuruar me tulla të vendosura horizontalisht dhe vertikalisht, zig-zag, kurriz peshku, etj. të gdhëndura në forma nga më të ndryshmet. Në dritaren lindore të fasadës jugore si dhe në atë qëndrore të fasadës perëndimore, një rresht tullash në formë dhëmbë sharre rrethon dhe tre harqet e pjesëve të dritareve. Kjo, dhe ndryshimi në madhësi i këtyre dritareve, janë bërë për të theksuar rolin e tyre në trajtimin e fasadave. Në fund të murit mbyllës të dy dritareve të mëdha ndodhet edhe sot një kornizë prej gurësh të butë të profiluar lehtë, që shtonte dhe më tepër madhështinë e dikurshme të këtyre dritareve. Rreshti prej dhëmbë sharre që rrethon harqet e dy dritareve të mëdha në murin jugor, vazhdon anash dritareve për tërë zonën që i takon naosit, pjesës më të ngritur të kishës.

Ndërmjet këtyre dy brezave ndodhet një i tretë. Në vështrimin e parë ai s'ka ndonjë rregullsi, është i ndërtuar me tulla, në pjesën e poshtme me gurë çmërsi e tulla, të cilat kanë mbetur nga një qemer me formuese, paralel me murin. Këto gjurmë, që i gjejmë nga ana perëndimore dhe jugore në tërë gjatësinë e murit, kurse nga veriu vetëm në pjesën e vjetër të tij, na shpien në përfundimin se në të tria këto anë të kishës ka patur portik.

Në murin perëndimor, pranë shpatullave të portës qëndrore, janë gjurmët e dy pilastrave mbi të cilat ngrihet një hark gjysmë rrethi, që ka mbetur

20) A. Ducellier, **vep. cit.**, 169.
21) F. Versaqis, **vep. cit.**, 2-3.

DO NOT COPY



Fig. 7



Fig. 8

nga një qemer që dilte mbi qemerin gjatësor. Muri, menjëherë mbi këtë hark, është ndërtuar vetëm me tulla, nga që përfshihet brënda çatisë së qemerit.

Shpatullat e portave janë ngritur me tulla, me sa duket, për t'u ndërtuar më lehtë. Disa nga gurët e murit hyjnë edhe nën pilastër, dhe në këtë rast janë punuar jo pastër dhe futen më thellë ndaj sipërfaqes së murit për t'u lidhur me gurin e pilastrit. Në të tëra portat, tullat e shpatullave ngrihen mbi dy gurë që mbarojnë me fugë vertikale. Harku i portës qëndrore është me tulla të përpunuara, jo nëpërmjet gdhëndjes, por të prodhuara të tilla. Nuk mund të jemi dakord me Dyselien [20]), kur thotë se kjo portë është e mëvonëshme dhe se porta e vjetër ishte qemeri tërthor i portikut.

Në murin perëndimor, në brezin e mesit, dy dritare të ngushta çajnë tejpërtej qemerin dhe janë të mbuluara, si dhe të tjerat, me hark tullash që është në brezin e sipërm me kluasonazhë.

Në murin jugor, të ruajtur mjaft mirë, i cili më tepër se të tjerat jep idenë e bukurisë së dikurshme të kishës, kemi dy porta në të dy anët e kundërforcës që përmëndëm më sipër. Porta në të majtë është e njëllojtë me portën qëndrore të fasadës perëndimore. Ajo kufizohet nga dy pilastra, nga të cilët ai në sipërfaqe të kundërforcës është ruajtur bashkë me gurin që shërbente si thembër e dy harqeve, njëri gjurma në mur e qemerit dhe tjetri që përfundonte në shtyllat e portikut. Në të djathtë të kundërforcës, në të dy anët e një dritareje të hapur në fillim të këtij shekulli, ndodhen të mbuluara me hark tullash një portë e mbyllur me mur dhe një nike gjithashtu e mbyllur. Mendojmë se njëra është portë, nga që është më e madhe nga niket, që janë kudo rreth 74 cm, dhe jo të dyja nike, siç mendon Versaqis. [21]). Mbi këtë portë ndodhet një dritare dyshe e mbuluar me një shtresë suvaje. Ky suvatim ndodhet vënde-vënde në gjithë sipërfaqen nën qemer të kësaj ane, deri dhe në murin nën kundërforcë. Meqënëse dritarja ndodhet në nivelin e gjurmëve të qemerit gjatësor, ai ndërpritet pranë saj në formë harku dhe del mbi dritaren. Duket se këtu qemeri ndrronte formë, për të lejuar dritaren.

Dy dritare të ngushta si ato të fasadës perëndimore janë njëra në zonën e narteksit dhe tjetra mbi portën e madhe nën qemer.

Qoshja juglindore e qemerit (fig. 8) na tregon më së miri se qemeri, pra dhe portiku, janë të një kohe me pjesët e ndërtesës mbi to.

Muri jugor në qoshen juglindore ka vetëm dy breza (Tab. III, 2), i poshtmi me gurë të skuadruar dhe i sipërmi me kluasonazhë, të ndarë me një kor-

DO NOT COPY

nizë prej guri që përshkon horizontalisht tërë murin jugor. Ky mur dy brezash ndodhet vetëm në qoshen juglindore dhe ndërpritet me një fugë vertikale që tregon kontaktin ndërmjet murit të vjetër dhe murit të ri lindor. Që kemi të bëjmë me një mur të ri, na flet qartë jo vetëm fuga, por edhe teknika e murit si në brezin e poshtëm të ndërtuar me gurë të skuadruar të ripërdorur dhe me copra tullash e gurë më të vegjël; kjo vihet re dhe në brezin e sipërm, me mur guri të zakonshëm. Në këtë mur dallohen në një farë rregullshmërie vrimat e brezave që formojnë një rrjet kuadratik që e gjejmë të njëllojtë edhe te kundërforca, e cila duhet të jetë vendosur kur u ndërtua muri juglindor. Në murin lindor del një apsidë katërfaqëshe me një dritare të ngushtë (Tab. IV, 1).

Fuga në kontaktin e dy mureve shkon vertikalisht deri tek korniza e çatisë (Tab. IV, 2). Për mendimin tonë, ana nga jugu nuk është e gjitha e vjetër. Rreth një metër nën çati, muri është i ri, dhe kjo na shtyn të mendojmë se muri i vjetër vazhdonte lart, në drejtimin jug-veri; muri i poshtëm bën kthesë nga që është mur i apsidës së dikurshme. Fuga e kontaktit ndërpret në mes një nike apo dritare dhe një rresht dhëmbësh sharre mbi të. Po të ribëjmë harkun e nikes, del se muri i ri lindor është më brënda nga ç'ka qënë më përpara.

Nën frontonin e mesit të murit të ri lindor, është murosur një pllakë (Tab. IV, 3), ku është gdhëndur një lule dhe data 1743 apo 1793, sigurisht data e rindërtimit të murit lindor dhe e një pjese të murit verior, përafërsisht deri ku fillon naosi. Muri verior, për tërë pjesën e naosit i takon një rindërtimi të bërë në një kohë të dytë. Ai është ndërtuar me gurë dhe ka disa breza tullash, dy prej të cilëve janë me tulla të vendosura pjerrtas në formë kurriz peshku. Ky mur i ri shkon në anën perëndimore sipër deri tek dritarja trefishe e mesit, të cilën e përgjysmon, ndërsa poshtë arrin deri tek shpatulla e djathtë e derës së madhe. Në lindje ruhet një pjesë muri me gurë të skuadruar, që arrin deri tek nikja e parë nga lindja e këtij muri. Kjo gjë na përforcon mendimin se të dy fasadat janë përafërsisht të njëjta. Nga lindja, ky fragment i vjetër shkon deri tek qoshja verilindore, përtej të cilës nuk vazhdon, dhe prandaj kthesa është ribërë me kënd të drejtë.

Vetëm duke i patur të qarta nga jashtë rindërtimet (merametimet) e ndryshme që ka pësuar kjo kishë, mund të shqyrtojmë strukturat në interier, sepse nga jashë kio është më e lehtë, nga që brënda gjithçka është e suvatuar.

Pilastri qëndror në naos është bërë për të përforcuar mbështetjen e dikurshme. Në anën lindore të këtij pilastri është murosur një mbishkrim (Tab. IV, 4), që tregon se ky është ndërtuar në vitin 1793.[22]). Kjo na bind që datën në murin verilindor duhet ta lexojmë 1793, përderisa të dyja këto i përkasin të njëjtit rindërtim. Një pilastër tjetër përforcues është vënë nën harkun e mesit të arkadës naos-narteks. Mbi të dy këto pilastra është hedhur një hark për të përforcuar harkun e vjetër mbajtës (Tab. V, 1). Edhe pilastri në mes të murit jugor është zmadhuar, duke ndërtuar një hark të ri përforcues nga ky tek pilastri qëndror.

Duke parë mbështetjen e arkadës naos-ambienti i altarit në murin jugor, do shohim që ajo bëhet me një pilastër-shtesë, dmth. se kjo arkadë bashkë me murin mbi të janë të mëvonshme (fig. 9). Rriedhimisht dhe harku mbajtës nga kjo arkadë deri tek pilastri qëndror është i ri (Tab. VI, 1). Harqet konstruktive të verbër në këtë arkadë, mbi të cilët ngrihen kupolat, janë më të ulët se të vjetrit, dhe nga një e çarë duket qartë kontakti i pjesës së vjetër me pjesën e re (fig. 10).

Ndihmë të madhe, për të analizuar pjesët që i përkasin çdo rindërtimi, na japin kupolat, po të vërehen nga jashtë dhe nga një ambient i vogël i krijuar në vëndtakimin e katër kupolave, për të lehtësuar kolonën qëndrore (Tab. VI, 2). Kupola e vogël nga jugu është e vjetër. Kupola e madhe nga jugu ka formë tetëkëndëshi në pjesët që s'janë në kontakt me kupolat e tjera. Faqet jugperëndimore dhe jugore të saj janë të vjetra. Mbi dritaret, nga një për çdo faqe, kalon një brez prej tre tullash dhe mbi të, dy gurë çmërsi pa kluasonazhë, mbi të cilët vjen korniza. Pse është bërë ky ndryshim nuk jemi në gjëndje ta spjegojmë, sidoqoftë kupola është e një dore, dhe jo meremetim siç mendon Versaqis.[23]). Për këtë flet lartësia e saj nga brënda dhe fakti se brezi me tulla është në pjesën e kupolës. Në faqen juglindore të tamburit, kemi një çarje që ndan pjesën e vjetër me atë të re, të ndërtuar me një imitim mjaft të shëmtuar të kluasonazhit me tulla të trasha ku ka dhe disa vrima që shërbejnë si dritare. Në ambientin e vogël, ndërmjet katër kupolave, shohim se pjesa ndërmjet kupolave të mëdha i përket këtij rindërtimi. Përveç mureve të tambureve, në këtë kohë janë meremetuar dhe pjesë të vetë kupolave (Tab. V, 1).

Kupola e madhe nga veriu ka nga rindërtimi i parë pjesët nga juglindja dhe jugu deri afër murit verior, ku fillojnë muret e rindërtuar në vitin 1845.

22) Mbishkrimi është: 1793 janar 20. Papa Thanasi i Papa Panos, katundi Rakadhës (përkthyer nga Th. Popa).
23) F. Versaqis, **vep. cit.,** 35, mendon se te brezi me tulla fillonte dikur korniza.

JO VOTOSKI



Fig. 9

DO NOT COPY



Fig. 10

Këta mure edhe në kupolë janë me gurë dhe me breza tullash në formë kurriz peshku.

Kupola e vogël nga veriu nga rindërtimi i vitit 1845 ka vetëm pjesët mbi murin e rindërtuar në këtë vit. Në këtë kohë janë ribërë dhe pilastri në këtë mur, harku nga ai tek pilastri qëndror, që është mjaft i vogël në krahasim me të tjerët, dhe pjesët e kupolës mbi to, Në përgjithësi, rindërtimi i vitit 1845 është mjaft primitiv; ndërtuesit nuk njihnin ndërtimin mbi trekëndëshe sferikë, dhe kështu tamburi është më tepër një prizëm me qoshet e përkulura se sa cilindër, ndërsa kupola është më shumë e rrafshtë se sa sferike.

Ambienti i altarit mbas rindërtimit të vitit 1793 ka marrë formën e narteksit dhe mbulohet me tre kalota sferike të cilat, për shkak të ndryshimit të planimetrisë, nuk janë të rregullta si të narteksit. Harqe mbajtës ka vetëm tek arkada, ndërsa në murin lindor ata mungojnë. Në murin jugor, në lartësinë e harqeve të verbër, kemi një dhëmb brënda murit (Tab. VII, 1), prej ku ai ngrihet lart i kurbët, deri në një të çarë, mbi të cilën, pak e çrregullt, ngrihet kalota sferike jugore. Menduam se muri i kurbët është çka ka ngelur nga mbulesa e vjetër e ambientit të altarit me qemer cilindrik me formuese lindje-perëndim.

Muret veriore dhe jugore kanë një dhëmbëzim vertikal që i takon kthesës që ato kanë dhe në anën e jashtëme. Në të dy muret, sidomos në atë jugorin, dallojmë se pjesët e murit të vjetër shkojnë nga lindja me një sipërfaqe konkave, që duket se u takon apsidave të dikurshme dhe që na shtyn të mendojmë se kisha e vjetër kishte më shumë se një apsidë.

Nga përshkrimi që u munduam t'i bëjmë kishës, del se gjatë ekzistencës së saj, ajo i është nënshtruar dy rindërtimeve kryesore. I pari në vitin 1793 dhe i dyti në vitin 1845. Këto rindërtime do të jenë bërë të pashmangshme nga dëmtimet e mëdha që do të kenë pësuar strukturat e sajë. Në vitin 1873 janë hequr portiku, muri lindor, arkada naos-ambienti i altarit, harku mbajtës nga kjo e fundit tek pilastri qëndror dhe pjesët e kupolave mbi to. Në këtë kohë janë ndërtuar pilastra dhe harqe përforcuese (Tab. VII, 2). Jemi të mendimit se së paku pilastri qëndror, në mos tërë përforcimet, janë vënë përpara se të jenë hequr krejtësisht pjesët e mësipërme, sepse pa pilastrin e madh qëndror shtytja e kupolave të vogla nuk do të kishte se si të ekuilibrohej. Në këtë kohë është ndërtuar dhe kundërforca në murin jugor.

Rindërtimi i dytë i përket vitit 1845, kur janë rrëzuar muri verior dhe harku mbajtës nga ai tek pilastri qëndror së bashku me pjesët e kupolave mbi to, që janë ribërë në mënyrë mjaft të keqe, duke gjymtuar krejtësisht këtë anë të kishës.

Gjatë historisë së tij shekullore, monumenti i është nënshtruar dhe riparimeve të vogla. Ndër këto po përmëndim riparimin e dritares së sipërme në murin verior të narteksit, e cila është mbyllur me kluasonazhë.

Dekoracioni

Kisha e Shën-Kollit në Mesopotam shquhet jo vetëm për arkitekturën, por dhe për dekorimin e saj të përbërë nga dyshemeja, kapitelet, dekoracioni me tulla i fasadave dhe nga relievet skulpturale në muret e jashtme. Dyshemeja e kishës është e ndërtuar me pllaka të mëdha guri gëlqeror të vendosura sipas një vizatimi, të cilin sot e shohim të ruajtur pjesërisht, sepse vite më parë dyshemenë e kanë meremetuar, duke shtruar me beton pjesët më të ulta dhe

24) F. Versaqis, **vep. cit.**, fig. 11.
25) **Po aty,** fig. 33; L. Ugolini, **vep. cit.**, 143; H. Ceka **etj., vep. cit.**, 23.

DO NOT COPY

pjesët e mozaikut që ndodhen ndërmjet pllakave. Këtë vizatim e gjejmë të plotë tek Versaqis [24]) dhe, pavarësisht se edhe ai e rikonstrukton, ne e pranojme, sepse shonim që ai përputhet me pjesët që sot shihen qartë. Bejme vetëm një ndryshim të vogël, sepse ndarja naos-narteks që ai paraqet, është shtuar më vonë, dhe se të dyja këto janë në të njëjtin nivel.

Vizatimi është formuar nga rrypa mozaiku, që janë një pjesë me gurë të vegjël e një pjesë me gurë të mëdhenj, të kuq, të zi e të bardhë, dhe që formojnë figura gjeometrike. Dy rozeta 16 pjesëshe brënda një kuadrati ndodhen nën secilën nga kupolat e mëdha. Vija të tjera të drejta kalojnë rreth tyre, rreth mbështetjes qendrore dhe pilastrave, duke formuar një si kryq jo lehtë të perceptueshëm, në krahun perëndimor të të cilit ndodhej dikur një mozaik me figurën e një gjeli [25]), nga i cili sot s'kemi as edhe një gjurmë.

Dyshemeja e narteksit ka një vizatim të veçantë nga ajo e naosit, tre rombe në mes dhe dy kuadrate anash, të theksuara dhe nëpërmjet rrypave të mozaikëve. Ajo që u ka shpëtuar studjuesve dhe vizitorëve të mëparshëm është se në majat e tre rombeve janë gdhëndur në mënyrë mjaft të rregullt tri lule zambaku (fig. 11). Për nga vizatimi i rregullt i secilës dhe i tërësisë mendojmë se këto janë të njëkohëshme me dyshemenë, pra dhe me kohën e përfundimit të ndërtimit të kishës.

Mendojmë se gurët e dyshemesë janë marrë nga e njëjta gurore ku janë nxjerrë dhe gurët e skuadruar të mureve anësorë. Në këtë mendim na shpie një mur në mes të shkallës që çon në ambientin e altarit, që nga forma duket se dikur ka qënë në pilastrat e jashtme të mureve anësorë të kishës, anës portave të mëdha, dhe që për shkak të fërkimit të këmbëve duken njëlloj me pllakat e dyshemesë.

Nga naosi, me një këmbë shkallë, kalohet në ambientin e altarit, të ndarë nga naosi me një ikonostas druri pa ndonjë vlerë i ndërtuar në vitin 1892 nga Anthim Papanikolla prej Muzine. Dyshemeja e ambientit të altarit është sot e shtruar me gurë të çrregullt, me përjashtim të pjesëve pranë mureve verior dhe jugor, që siç theksuam, janë të vjetra.

Një interier si dekoracion kemi afreskat, prej të cilave ruhet vetëm një fragment, kornizat e gurta që kalonin në thembrat e harqeve dhe në fundin e dritareve, që sot ruhen vënde-vënde.



Fig. 11

Sot gjejmë katër kapitele në arkadën naos-narteks dhe katër në arkadën naos-ambientin e altarit. Arkada e fundit është ndërtuar në vitin 1893, gjë që duket dhe nga forma e kolonave, bazamentave dhe kapiteleve. Kolonat janë ndërtuar me materiale të marra nga vende të tjera dhe me rrotulla guri gëlqeror. Bazamenti është në formë trungu piramide, prej gurësh gëlqerorë të punuar ashpër. Kapitelet janë po prej guri gëlqeror në formë trung piramide të përmbysur. I vetmi dekor që mund të gjëndet në ndonjërin prej tyre është kryqi në reliev brënda një rrethi.

Kolonat e arkadës naos-narteks janë të tëra njëcopëshe dhe duhet të jenë prurë nga ndonjë vënd tjetër. Bazamentet e këtyre kolonave sot dallohen me vështirësi, sepse janë të betonuar deri në mes, kështuqë është e vështirë të kuptohet në se kemi të bëjmë me bazamentet të bëra për këtë rast, apo janë ripërdorur kapitele të vjetra. Ato janë të gdhëndura me motive bimore të stilizuara dhe nuk dallohen për ndonjë vlerë artistike (fig. 12).

Të katër kapitelet janë të tipit të përbërë impost-kapitel, të formuara nga kapiteli dhe një jastëk mbi të, për të zmadhuar seksionin, dhe të pandarë nga njëri tjetri (fig. 13). Vetë kapiteli është

26) Ch. Diehl, **Manuel d'art byzantin,** Paris, 1925-26, I, 458; L. Brehier, **La sculpture et les arts mineurs byzantins,** Paris, 1936, 15; E. Stikes, **L'église byzantine de Christianou en Triphylie et les autres édifices de même type,** Paris, 1951, 52.

27) Në epokën e paleologëve kjo gjë ndodhte shpesh, shih O.M. Dalton, **Byzantine art and archeology,** Oxford 1911, 172.

PHOTOCOPY

më i vogël dhe përbën një kalim nga forma rrethore e kolonës, në atë katërkëndëshe të impostit. Dekoracioni i tyre bimor përbëhet nga gjethe të gufuara në të katër qoshet dhe kërcej të përdredhur që përfundojnë me gjethe të vogla në fushën ndërmjet qoshevet. Dekori është i punuar pjesërisht me trapano dhe pjesërisht me nxjerrjen e plotë të konturit (fig. 14). Nëpërmjet gufimit të gjetheve të plota në qoshet krijohet një volumetri e ngjashme me atë të kapitelit jonik. Menjëherë mbas kapitelit, duke dalë pak jashtë tij, fillon imposti, një trung piramide i përmbysur, brinjët e të cilit formojnë një kornizë. Brënda kësaj kornize kemi ornamente bimore të rrafshta, që ndjekin rrethin me nga një kryq në mes, në anët më të shkurtëra.

Në impost, fusha ndërmjet dekorit është mbushur me stuko të ngjyrosur në të kuqe, kafe dhe të



Fig. 12

zezë, duke nxjerrë në këtë sfond shumëngjyrësh vizatimin e gurtë në një pamje mjaft piktoreske (fig. 15).

Nga mënyra e punës në reliev të ngritur dhe e mbushjes me stukon këto kapitele mund t'i datojmë të shek. XI.[26]). Tre kapitele nga jugu janë të përafërta nga madhësia dhe forma, ndërsa ai nga veriu është më i vogël dhe ka disa ndryshime në formë (fig. 16).

Meqënëse përmasat e pjesës së sipërme të impostit janë më të vogla se sa thembrat e harqeve të arkadës që mbështeten mbi to, është dashur përdorimi i një imposti të dytë, të dekoruar me gjethe vetëm në anët më të shkurtëra. Nga mënyra e punës pa trapan, nga forma e gjetheve, niveli i gdhendjeve dhe vetë punimi i faqeve anësore, kuptohet që kemi të bëjmë me një impost jo të njëkohshëm me kapitelet. Kapitelet janë marrë nga ndonjë vënd tjetër dhe përdoren përsëdyti këtu, gjë që shpjegon kështu dhe nevojën e imposteve të dyta.[27]).

Në brezin e poshtëm me gurë të skuadruar të fasadave janë gdhëndur relieve në gurë të veçantë, një sërë kafshësh në skema apo të veçuara. Një pjesë sot janë të dëmtuara, kanë mbetur vetëm gjurmët e tyre në gur, duke na dhënë ide vetëm për vizatimin.

Në murin verior, në arkitraun e derës që shërben sot, kemi një skenë të dëmtuar së tepërmi me një derr të egër nga e majta në pozë luftimi, me trupin të tërhequr prapa dhe këmbët bashkë me kokën të tendosura përpara. Menjëherë mbas derrit vjen një pemë dhe nga ana e djathtë e saj, një qen që duket sikur po sulmon derrin. Për fat të keq, kjo skenë mund të shihet vetëm nga vizatimi dhe mund të vlerësohet vetëm nëpërmjet tij. Në një gur të qoshes verilindore të rindërtuar në 1793, rreth 3 m nga toka, ndodhet pjesa e përparme e një shpendi të përgjysmuar (fig. 17). I dëmtuar siç është, e kemi vështirë të caktojmë llojin. Megjithatë dallohen mirë pjesë të veçanta p.sh. këmba, e modeluar gati në formë të plotë, jo më në reliev, pjesa e kokës me qafën dhe gjoksin me një fakturë thuajse natyrale.

Në murin lindor në brezin e poshtëm të tij, ndodhen në lartësi të ndryshme një shqiponjë në anën më nga jugu dhe dy dragoj e një luan në faqet e apsidës. Shqiponja (fig. 18), e gdhëndur në një gur kuadratik, sot ruhet pa kokë dhe me kthetra të dëmtuara. Termi reliev këtu është më shumë figurativ se sa i përgjigjet realitetit, sepse me gurin ajo lidhet vetëm nëpërmjet krahëve të hapta e të shtrira dhe bishtit, ndërsa trupi dhe këmbët janë të ndërtuara normalisht. Shqiponja duket më tepër si e mbështetur me këmbët tek pjesë të gurit se sa e gdhëndur në gurë të muraturës. Me krahët e hapur dhe gjoksin përpara, shqiponja është në një pozë mjaft krenare, në pozën në të cilën ajo paraqitej për shekuj të tërë në artin bizantin si mbret i shpendëve, si personifikimi i fuqisë mbretërore. Tërë trupi dhe krahët e saj janë të punuar imët, gjoksi dhe pjesa e sipërme e krahëve janë veshur me

Fotokopy

DO NOT COPY



Fig. 13



Fig. 14



Fig. 15



Fig. 16

ca si luspa në formë U-je, të spostuar nga njëra tjetra ose në rreshta vertikale. Me mjaft hollësi janë punuar pendët e holla pranë krahëve dhe ato të këmbëve. Pendët e gjata të krahëve kanë secila një formë trekëndëshe të punuar me vija të pjerrta. Edhe pse të paraqiturit e secilës pjesë të trupit bëhet me të njëjtat mjete, që ne i gjejmë tek pjesa më e madhe e shqiponjave në artin bizantin, qofshin këto në skulpturë, në stofa ose ikona, ajo nuk është e stilizuar dhe dallohet për një dozë të konsiderueshme realizmi. Akoma më imponuese ajo të duket po ta shikosh në profil (fig. 19).

Në njërën nga faqet veriore të apsidës, është një gur me një kafshë mitologjike (fig. 20) me pjesën e përparme si të qenit, goja e së cilës është e hapur dhe gjuha e nxjerrë në mes të dhëmbëve. Pjesa e pasme është një bisht që vjen e përdridhet në fillim rreth qafës dhe pastaj rreth vetes. Trupi ka një përpunim plastik pak a shumë të ngushtë, ndërsa pjesët e tjera, si turiri i skërmitur edhe pse i dëmtuar, këmbët e deri tek bishti i përdredhur, dallohen për dinamikën dhe i japin figurës një gjallëri të madhe.



Fig. 17

Në anën tjetër të apsidës, ndodhet një kafshë tjetër mitologjike (fig. 21) me kokë si të qenit dhe me gjuhën të zgjatur përjashta. Ka vetëm dy këmbë, ato të përparmet, me kthetra më pak ekspresive se kafsha e mësipërme, me trupin që përfundon si bisht dhe përdridhet rreth vetes dhe me krahë të hapur lart. Trupin e ka të përpunuar të gjithë me luspa, krahu paraqitet i plotë dhe i punuar si krahët e shqiponjës.



Fig. 18

Po në muret e apsidës, është gdhëndur një luan (fig. 22) në lëvizje e sipër në mënyrë mjaft realiste, me kokën lart dhe gojën të hapur, që duket gati sikur do të sulmojë. Këmbët e përparme janë të hedhura përpara, ndërsa me dy të tjerat është i mbështetur në tokë. Gjithë zverkun e ka të punuar për të treguar perçen, ndërsa bishtin e ka me një xhufkë të hedhur përpjetë. Me pamjen e tij madhështore dhe në lëvizje e sipër, për shkallën e lartë artistike të të gdhëndurit në reliev të thellë, luani bën mjaft efekt edhe është një ndër skulpturat që të lë më tepër mbresë.

Një skenë e dytë, me pemë në mes dhe një qen që duket sikur ndjek një luan (fig. 23), është në qoshen jugperëndimore të fasadës perëndimore. Sot qeni është i tëri i gërryer dhe poza e tij mezi kuptohet. Në kontrast me lëvizjen energjike të qenit,

28) L. Ugolini, **vep. cit.**, 142-143.
29) A. Ducellier, **vep. cit.**, 189-190.
30) F. Versaqis, **vep. cit.**, 42.
31) V. Puzanova, Dh. Dhamo, **Njekotorie pamjatniki monumentalnoj zhivopisi 13-14 v. v Albanii**, «Studia Albanica», nr. 2, 1965, 149.

DO NOT COPY



Fig. 19



Fig. 20

përsa mund të kuptohet nga këmbët e tij të hedhura përpara dhe koka lart, në anën tjetër të pemës është një luan me fytyrë njeriu me një pamje mjaft të rëndë. Nga ana formale ai është punuar njëlloj si luani i faqes lindore, por ata dallohen së tepërmi midis tyre, sepse njëri është energjik ndërsa tjetri më i qetë dhe hijerëndë.

E kemi të vështirë t'i përgjigjemi pyetjes a janë të një dore këto gdhëndje. Nga niveli artistik ato ndryshojnë; të arritura dhe të një niveli më të mirë janë luani dhe shqiponja, edhe pse kjo e fundit është e konceptuar ndryshe nga relievet e tjera, me përdorimin e elementëve të stilizuar. Përbindshi me krahë i murit lindor është i një niveli më të ulët, më pak ekspresiv dhe larg nga gjallëria dhe forca që shprehin kafshët e tjera.

Lidhur me datimin e tyre janë shprehur mjaft mendime. Për Ugolinin [28]) skena e fasadës veriore është e periudhës romake, ndërsa të tjerat i përkasin artit bizantin të kohës së ndërtimit të kishës. Dyselie [29]) vëren se ato kanë një influencë romanike, siç vërehet dhe në skulpturat e kishës së Pojanit (Fier), sipas Versaqis [30]), ato janë helenistike ose romake, të marra nga ndonjë altar kafshësh nga Finiqi; ndërsa Puzanova dhe Dhamo [31]) mendojnë se janë paleokristiane. Ne jemi të mendimit se të gjitha këto skulptura janë të kohës së ndërtimit të kishës, kohë në të cilën një valë e tretë influencash orientale përshkonte artin bizantin dhe mjaft kafshë gdhëndeshin edhe në muret e kishave, duke mos përjashtuar këtu ndonjë influencë romanike, siç është vërejtur për skulpturat e katedrales së Artës [32]), dhe traditën vëndase, që çfaqet në punimin realist të tyre.

Që gurët janë të një kohe me vetë ndërtesën, na flasin edhe forma dhe mënyra e punës së tyre, e njëjtë me gjithë gurët e tjerë kuadratikë.

Sondazhet

Nga vrojtimi i hollësishëm i këtij monumenti krijojmë një tablo të qartë për transformimet që ai ka pësuar në kohë, por nuk jemi në gjëndje të gjykojmë për formën e parë të tij, dhe në këtë drejtim mbetet për t'u sqaruar ana lindore e kishës, forma dhe madhësia e portikut dhe mjaft detaje të tjera më të vogla. Për këtë e pamë të arsyeshme të ndërmirrnim një sërë sondazhesh në muret dhe terrenin pranë, të cilat do të na ndihmonin për zgjidhjen e problemeve të mësipërme.

Duke patur parasysh se pilastri i madh qëndror është ndërtuar në vitin 1793, ishte e rëndësishme për ne të sqaronim se çfarë mbështetje kishte para ndërtimit të tij. Për këtë qëllim sonduam në anën

32) Ch. Diehl, **vep. cit.,** 783.

DO NOT COPY



Fig. 21



Fig. 22



Fig. 23

perëndimore të pilastrit, ku mbas afro 50 cm gjetëm një mur me tulla të holla 4 cm me fuga llaçi 3 cm të punuar mirë (fig. 24). Në një lartësi rreth 80 cm nga toka, kishte një boshllëk ku ka qënë një brez me trarë 20 x 20 cm i lidhur në qoshe me dërrasa, gjurmët e të cilave në llaç duken mjaft mirë edhe sot. Duke kërkuar më tej në një thellësi rreth 86 cm nga faqja e pilastrit, gjetëm një kolonë të njëllojtë me ato të arkadës naos-narteks. Pra, në fillim ka qënë një kolonë. Në një kohë të dytë, të trëmbur se mos kolona nuk mbante dot ngarkesat, ose për shkak të dëmtimeve që mund të ketë pësuar në kohë, gjë që ka më të ngjarë, do të kenë ndërtuar pilastrin me tulla.

Për të vërtetuar prezencën e portikut dhe formën e tij, gërmuam një sipërfaqe të madhe të terrenit pranë mureve perëndimor, verior dhe jugor. Në të gjitha anët hasëm menjëherë në dyshemenë e shtruar me pllaka si ato të kishës, tek e cila zbritet me një këmbë shkallë prej 12 cm, të formuar nga pllaka guri, që dalin nën muret anësorë dhe që shkojnë gjatë tërë portikut. Në anën perëndimore, në cep të dyshemes arritëm në një mur pothuaj në një nivel më të (Tab. VIII, 1) dhe që vetëm në një sipërfaqe mjaft të vogël nga ana e brëndëshme ngrihet rreth 15 cm. Mbas këtij muri është trotuari me pllaka si të dyshemesë, por pak më të trasha. Në të djathtë të portës së madhe perëndimore, ndodhej një fragment pllake me relieve ornamentesh bimore dhe një fragment mbishkrimi i gdhëndur në një nga pllakat e dyshemesë. Ky mbishkrim, që do të kishte qënë mjaft sqarues, u gjet pa gjysmën e majtë, që e bën të pakuptueshëm, aq më tepër kur dhe pjesa që ruhet ka vende të palexueshme. Mjaft pllaka të tjera janë të thyera dhe shumë janë ato që mungojnë.

Në anën veriore gërmuam më shumë se gjysmën e sipërfaqes së portikut. Këtu, nga që mbeturinat ishin në një shtresë më të madhe, ishin ruajtur edhe disa nga pilastrat e portikut të mbështetura mbi pllaka guri të shtruara mbi murin anësor të tij. Në disa vënde pllakat mbi këtë mur qenë në pjesë të vogla të thyera, të cilat ishin mbushur më vonë me tulla e me llaç. Kjo na shtyri të mendojmë se dhe pjesa tjetër që ngrihej në murin anësor nga perëndimi më lart se sa dyshemeja do jetë një arnim i pllakave, i mbetur mbas heqjes së tyre. Në anën veriore, këto pllaka mbi mur nuk janë hequr, sepse mbi to ngrihen pilastrat e portikut. Në një vijë me murin perëndimor të kishës, gjetëm një pjesë muri tek i cili janë ripërdorur fragmente arkitektonike si një gjysëm kolone me kanelyra. Këtë mur, që vazhdon dhe jashtë portikut. duke e konsideruar si një shtesë të mëvonshme që nuk mund të lidhej

DO NOT COPY

me monumentin në studim, nuk e kërkuam më tej.

Në pjesën që pastruam gjetëm pesë pilastra të portikut në forma të ndryshme, nga të cilat disa ruhen deri në 50 cm. lartësi, ndërsa të tjerat vetëm në dy rreshta tullash. Për nga madhësia, forma dhe shkalla e ruajtjes, tërheqin vëmëndjen dy pilastra në formë kryqi, që përfshijnë dhe dy nga shtyllat që dilnin nga toka në këtë anë. Shtyllat e gurta dalin në sipërfaqe të pilastrave (Tab. VIII, 2) përballë njëra tjetrës, duke lënë të zbuluar këto faqe dhe pjesë të barabarta të faqeve veriore. Me sa duket këto shtylla janë vendosur për të krijuar një bordur të gurtë që duhej të vazhdonte në lartësi me një hark, për të nënvizuar këtë hyrje kryesore të arkadës, në një aks me portën e madhe nga veriu. Këta pilastra janë të ndërtuar me gurë çmërsi dhe tulla, me kluasonazhë dhe fuga të punuar në mënyrë të njëllojtë me atë të mureve të kishës (Tab. VIII, 3). Nga ana e brëndëshme e pilastrit gjetëm gjurmë suvatimi të ngjyrosur që na shtyn të mendojmë se portiku ishte pikturuar me afreska. Ndërmjet këtyre dy pilastrave ndodhen mbeturinat e një muri shumë të vonë të ndonjë aneksi, të shtuar mbas heqjes së portikut, por sidoqoftë përpara vitit 1845. Në murin e vjetër verior duket sikur dallojmë një rresht vrimash sot të mbyllura, që mund të kenë qenë të mbulesës së këtij aneksi. Dy pilastrat e tjerë nga lindja dalin pak mbi tokë, shumë të dëmtuara dhe me konture që identifikohen me mjaft vështirësi.

Në murin verior, përballë pilastrit të madh më nga perëndimi, është pilastri pranë portës së dikurshme. Mbi krahun jugor të pilastrit në formë kryqi të portikut dhe mbi këtë pilastër, ngrihej harku gjurmë të të cilit kemi në murin jugor. Ky pilastër (Tab. VIII, 4) që ruhet tërësisht në pjesën e poshtme, tregon qartë se portiku është konceptuar si i tillë me tërë kishën. Dhëmbi i shkallës që del përposhtë murit krijon një vazhdimësi të pilastrit nga dyshemeja sipër. Nga pilastri tjetër, përballë pilastrit të portikut, sot ruhet vetëm pllaka nën bazamenin.

Nga pilastri i pestë ruhet shtylla e tretë prej guri, të cilën nuk mundëm ta diktonim nëse qëndron në vëndin e vet.

Dallim tjetër me rëndësi është se pllakat mbi mur në anën veriperëndimore kanë një rrip rreth 20 cm me sipërfaqe të punuar pastër, ndërsa pjesën tjetër të pllakës e kanë me sipërfaqe të rrafshtë dhe jo të pastër. Mendojmë se kjo mund të shpjegohet me qënien mbi të të ndonjë muri të vazhdueshëm. Ishte ky një mur në tërë lartësinë, apo perde ndërmjet pilastrave, e kombinuar dhe me kolona, këtë nuk jemi në gjëndje ta themi.

Në këtë krah verior të portikut, pllakat e dyshemesë nga ana perëndimore janë të gjitha të hequra



Fig. 24

ndërsa ato më nga lindja për disa metra gjatësi ruhen (fig. 25). Në këtë zonë kemi një panel mozaiku. Paneli është me përmasa relativisht të vogla (80 x 80 cm.) dhe të orjentuar veri-jugë. Në një sfond të bardhë aty janë vizatuar katër gjela (fig. 26), dy prej të cilëve u mungojnë kokat. Gjelat janë të vizatuar me gurë të zinj, me krahët dhe bishtin të krijuar me anë vijash të bardha në mënyrë mjaft skematike, në përputhje me krejt vizatimin. Gjelat shikojnë njëri tjetrin, dhe ata të poshtmit kanë nga një këmbë të ngritur në pozë ecjeje. Në mes të dy të sipërmve është një enë, duket se kemi të bëjmë me skenën e eukaristisë. Duket se dhe mozaiku me gjela, që vite të shkuara ishte në naos, do ketë qënë i përafërtë me këtë. Sidoqoftë, ai nuk ka si të jetë marrë nga ndonjë ndërtesë antike sepse një operacion i tillë na duket mjaft i vështirë, dhe aq më tepër kur të tillë mozaikë gjejmë këtu në dy vende dhe rripa mozaiku ka tërë dyshemeja. Edhe pse skematik, vizatimi i tyre na duket jo pa një farë elegance.

Në krahun jugor të portikut, gërmuam pjesën në lindje të kundërforcës, që është e kufizuar në gjerësi, sepse vendi është përdorur deri vonë si varrezë. Dyshemeja këtu ruhet pranë kundërforcës të ndërtuar direkt mbi të (fig. 27). Në qoshen juglindore të portikut dolli një apsidë trefaqëshe me muret e ruajtura deri 40 cm, e ndërtuar në mes të murit anësor të kishës dhe të pilastrit të fundit të portikut, i cili sot nuk ruhet (fig. 28). Nga ky kemi vetëm gjurmën

DO NOT COPY



Fig. 25



Fig. 26



Fig. 27



Fig. 28

DO NOT COPY

e tij në vëndtakimin me murin e apsidës (Tab. IX, 1). Ky altar i dytë i mëvonshëm na tregon se në tërë lartësinë, portiku ka qënë i hapur. Apsida është ndërtuar me teknikën kluasonazhë me gur gëlqeror dhe me nga dy tulla vertikale. Teknika e murit na tregon se apsida është ndërtuar përpara pushtimit turk. Gjurma e takimit të kësaj apside me murin jugor të kishës, është një vijë llaçi vertikale që tregon se ky mur bashkë me qemerin, ku ruhen gjurmë llaçi, kanë qënë të suvatuara (Tab. IX, 2). Në këtë krah të portikut, ngjitur me murin jugor, gjejmë dy pilastra që ruhen deri në rreth 0.5 m lartësi, të ndërtuara me gur çmërsi dhe tulla horizontale dhe vënde-vënde vertikale, por ose nga përmasat e vogla, ose nga që pilastrat do të kenë qënë të suvatuara, kluasonazhi nuk është veçse një imitim. Njëri nga pilastrat që ruhet më mirë është ndërmjet portës së dytë dhe nikes së murosur (Tab. IX, 3). Fuga vertikale në murosjen e nikes është në një vijë me faqen lindore të pilastrit, pra pjesë e tij. Pilastri i dytë ruhet në mes të këtij dhe apsidës (Tab. IX, 4). Gjurmët e suvasë pranë tij tregojnë qartë se ai ngrihet në lartësi deri tek qemeri.

Na mbetet të përcaktojmë kur dhe përse janë ndërtuar këta pilastra. Para së gjithash, nevojën për to e lidhim me një hark që duhej të ngrihej nga secili prej tyre, si hark mbajtës për qemerin që duhej të mbështetej në një pilastër në anën tjetër, në një pilastër nga të portikut, ose një shtesë pranë tyre. Nga që në këtë anë nuk gjetëm pilastra, i referohemi pilastrave të krahut verior të portikut, që i korespondojnë afërsisht këtyre dhe që janë në formë kryqi. Është e vështirë që pilastrat në mur të jenë bërë mbas ndërtimit të portikut, sepse ndryshe krahu jugor i kryqit të pilastrave veriorë nuk do të kishte pse të bëhej. Kjo gjë mund të shpjegohet me qëllimin për të forcuar qemeret nëpërmjet harqeve mbajtës, qëllim i cili duhet të këtë lindur përpara ndërtimit të pilastrave të portikut dhe mbas ndërtimit të kishës. Po të këtë ndodhur kështu, kisha duhet të jetë ndërtuar bashkë me atë pjesë të qemerit që lidhet me murin, përafërsisht sa ruhet edhe sot, e pastaj të këtë filluar ndërtimi i qemerit. Në këtë rast, për arësye që ne nuk mund t'i kuptojmë, do të kenë përforcuar edhe qemerin, megjithë që, në pjesët e tjera nuk pamë gjurmë pilastrash të dyta.

E përcaktuam në vija të përgjithëshme, formën e portikut (fig. 29), në vartësi nga grada e konservimit të rrënojave dhe mundësitë e kërkimit që patëm. Mbetej për t'u përcaktuar forma e ambientit të altarit në interier dhe e murit lindor nga ana e jashtëme, pra numuri i apsidave. Nga përshkrimi që kemi bërë më lart, ne dinim fugat e kontaktit të murit të ri lindor me muret e vjetra dhe, e merrnim me mënd, se në murin lindor duhej të dilnin më shumë se një apsidë. Gjithashtu dinim se ambienti i altarit bashkë me arkadat ishte i ri dhe se, gjithashtu, pjesa qëndrore e dyshemesë së tij ishte e re. Në këtë mënyrë, për të sqaruar këtë problem u desh të sondonim si në terrenin përbri murit lindor, ashtu edhe në brëndësi të ambientit të altarit.

Në anën e jashtme, paralel murit lindor, shkonte një mur në nivel më të ulët se sa dyshemeja e kishës (Tab. X, 1). Nga ana e kishës ky mur ishte i kurbëzuar, duke u zgjeruar nën apsidë dhe nën muret anësorë të saj. Duke qënë vazhdimi i kthesave pranë qosheve juglindore dhe jugperëndimore, aty rezulton të jenë themelet e apsidave të dikurshme, fillimet e të cilave i gjetëm në brëndësi të ambientit të altarit. Këto mure, kurbëzimin për apsidat e kryenin nëpërmjet tullave që ishin vetëm në anën e brëndshme të murit. Mbas këtij muri, me një këmbë shkallë, zbritet në një mur të dytë të mbuluar me pllaka guri që shërbenin si shkallë, megjënëse terreni në anën lindore vjen duke u ulur. Muri i ri lindor është ndërtuar me një themel të ri të hedhur më përbrënda apsidës së vjetër, ndërsa apsida e re ngrihet mbi murin e vjetër ku është ngritur një platformë, për pjesën që i takon asaj (Tab. X, 2).

Nga ana e brëndshme, gërmuam në zonën qëndrore, aty ku ndodhej tryeza e altarit; mbi një kolonë të gdhëndur me reliev të ulët që është marrë nga ndonjë ndërtesë tjetër, ose nga pjesët sot të çdukura të monumentit. Menjëherë pas heqjes së pllakave të dyshemesë së re, dolën themelet e apsidave të vjetra (Tab. X, 3), që janë vetëm dy dhe vazhdim i pjesëve që dollën nga pastrimi i terrenit në anën e jashtme. Të dy apsidat takoheshin në mes të ambientit të altarit duke vazhduar mbi një mur që shkon në drejtim lindje–perëndim deri në një vijë me dy pilastrat anësore të arkadës së re naos-ambient i altarit. Duket se dy bemat lidheshin nëpërmjet një boshllëku, dhe na shtyn të mendojnë se një pjesë e ulët e murit, në të cilën duhet të ketë qënë dyshemeja.

Ndërsa konturet e brëndshme të bemave janë mjaft të qarta, konturet e jashtme ne nuk i gjejmë, me përjashtim të kthesës në qoshen juglindore, që ruhet pjesërisht në apsidën jugore dhe të faqes simetrike të saj që ruhet në bemën e re. Muri i apsidës së re e mbulon këtë duke mos na dhënë mundësinë të kuptojmë se ku bën kthesë kjo faqe, nëqoftëse një kthesë e tillë ruhet akoma. Në këtë mënyrë ne e kemi të vështirë të përcaktojmë sa

Bototeq

faqëshe kanë qënë apsidat e dikurshme, dimë vetëm se muri mbi të cilin ngriheshin këto dy apsida të veçanta njëra nga tjëtra, është një dhe i vazhdueshëm, nga jugu në veri.

Në interier, pra, ambienti i vjetër i altarit na paraqitet simetrik dhe me dy bema, duke i dhënë naosit formën me dy nefa. Nëpërmjet këtij sondazhi, mundëm të krijonim një ide dhe për nënshtresat e dyshemesë dhe për thellësinë në të cilën fillon muri me tulla. Dyshemeja me pllaka vendoset mbi dy rreshta tullash me llaç me një trashësi rreth 15 cm. Mbas një shtrese dheu të hedhur 25 cm më thellë gjetëm një shtresë të hollë me mbeturina llaçi, nën të cilën është tabani. Shtresa e llaçit tregon se mbi atë terren është bërë ndërtimi dhe pastaj, nëpërmjet mbushjes, është krijuar dyshemeja.

Në apsidat e vjetra që i gjetëm menjëherë nën dysheme ruhen katër rreshta me tulla, dhe pastaj themeli vazhdon me gurë. Themeli i bazamentit të apsidave është ndërtuar me gur e mbeturina tullash.

Nga sondazhet që paraqitëm deri tashti, mundëm të krijonim një ide, relativisht të plotë, të kishës së Mesopotamit. Për të sqaruar një sërë detajesh sekondare, vazhduam sondazhet që po i paraqesim më poshtë.

Ndër detyrat që deshëm të zgjidhnim ishte edhe përcaktimi i formës së dritareve. Për to dinim se nën thembrat e harqeve kishte kapitele, pjesë të të cilave dilnin jashtë mureve mbushës. Në anën e brëndshme të njërit prej tyre dallonim dhe kolonat, sepse murosja ishte bërë në një rrafsh me ta.

Së pari sonduam dritaren dyshe të fasadës jugore, e cila ishte e suvatuar mbi mbushjen. Mbas heqjes së murit doli dritarja e vjetër (fig. 30), e mbyllur në një kohë më të hershme se të tjerat dhe përpara vitit 1793 (suvatimi hynte dhe nën kundërforcë). Dritarja është me xhama të vëna në një skelet gëlqereje. Ka nga katër xhama rrethorë për secilën anë, xhama jo të rrfashtë, për të difuzuar dritën, dhe me ngjyrë jeshile shumë të hapur në të kaltërt. Në pjesën ndërmjet xhamave rrethorë, kemi xhama më të vegjël me ngjyra kafe dhe jeshile. Dritaret fiksoheshin në mure me gozhda kovaçi dhe me brumë gëlqereje, ndërsa në kolonë lidheshin nëpërmjet brumit të gëlqeres që mbulonte pjesërisht kolonën. Kolona ishte tetëkëndëshe në pjesën më të madhe të lartësisë. Mbi kolonën vendosej kapiteli (fig. 31) me faqen të zbukuruar me një kryq të gdhëndur me katër gjethe anash, të ngjashme, po jo aq të plota, me gjethet e gdhëndura në impostet e mëdha të arkadës naos-narteks.

Në dritaret e tjera ku dukeshin kapitelet, sonduam dhe pamë se në disa prej tyre ruheshin dhe kolonat, që ishin po tetëkëndëshe. Kapitelet ishin në formë trung piramide të përmbysur.

Në fasadën veriore, ku muri i vitit 1845 ndërpret në mes një dritare, sonduam dhe gjetëm të murosur kolonën (Tab. XI, 1) që shpjegon dhe ruajtjen e harqeve mbi të. Në njërën nga dritaret e mëdha, që kanë në pjesën e sipërme një boshllëk për ndriçim, dallojmë se suvaja në anën e brëndshme arrin deri në mes, dhe aty ishte e ngulur një gozhdë (Tab. XI, 2), gozhda e fiksimit të dritares së dikurshme nga ana e brëndshme. Të tilla gozhdë gjetëm dhe pranë mureve të kishës gjatë sondazheve në terren.

Për të përcaktuar lartësinë e apsidave të dikurshme dhe për të sqaruar më mirë formën e anës lindore të vjetër të kishës, sonduam në dy vënde në lartësi të murit të kthesës, që dikur ishte faqe apside. Sondazhi i parë kishte për qëllim të përcaktonte lartësinë e apsidës ndaj murit. Pak nën kornizën e vjetër të murit lindor sonduam dhe dalluam gurët e çmërsit që vazhdonin dhe nën murin e ri (Tab. XI, 3). Prandaj mund të përfundojmë se, për pjesën e sipërme, muri që kthehej me kënd të drejtë në drejtim jug-veri vazhdonte si zakonisht edhe mbi apsidë, duke mbaruar me kornizë, vazhdim i fragmentit të kornizës që ruhet edhe sot. Sondazhi i dytë kishte për qëllim të përcaktonte nëse nikja e prerë në mes ishte e tillë, apo dritare, siç mendon Versaqis [33]). Pamë se brënda harkut në dukje në fasadë muri i vjetër vazhdonte, megjithëse i çrregullt dhe për një distancë të vogël, gjë që na bind se kemi të bëjmë me një nike.

Hyrjen që shërben sot, e kemi përmëndur me emrin nike, por në fakt ajo dallohet nga niket sepse është e mbuluar me një piatabandë guri me një hark me tulla sipër. A kemi të bëjmë me një nike apo me një dritare? Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje ne kishim në dispozicionin vetëm niken e murit jugor. Vetëm murosja na shtyn të mendojmë se s'kemi të bëjmë me një nike, sepse ato nuk janë të murosura, me përjashtim të nikes nga lindja e këtij muri, që do të ketë qënë suvatuar si gjithë ajo anë e kishës, kur është ndërtuar altari brënda portikut. Për këtë hoqëm murosjen, mbrapa së cilës ndodheshin një sërë drush vertikalë, për të mbajtur murin që dikur qe rrëzuar, deri sa të ndërtonin murin si nga ana e jashtme, ashtu edhe nga ana e brëndshme. Shpatullat e kësaj nike apo dritareje ruanin gjurma suvatimi të ngjyrosur, që do të thotë se, së paku për një farë kohe, kjo ka qënë e hapur. Mendojmë se duhet të kenë qënë dritare, dhe

33) F. Versaqis, **vep. cit.,** 34.

DOKTORIK

jo porta, sepse ju është hequr një gur nga fundi, për t'ua shtuar lartësinë ku janë përdorur si porta. Një gjë e tillë do të ketë ndodhur mbas mbylljes së portave të mëdha, kur, sipas traditës, konakët qenë nga ajo anë. Më vonë, rreth vitit 1845, kur konakët u ndërtuan nga ana veriore kjo portë do të jetë mbyllur duke hapur atë të murit verior. Në murin nga jugu i ambientit të altarit, sonduam për të parë nëse kemi ndonjë nike si në murin verior, dhe na rezultoi se ai ishte i ri. Por nuk gjetëm nëse nikja në veri ishte e vjetër apo e re.

Kishim vërejtur se muri i kundërforcës në faqen jugore sikur hynte brënda në murin e kishës dhe se gurët aty ishin në fuga në të njëjtën vertikale. Duke pastruar një pjesë të vogël të suvasë, pamë se kemi të bëjmë me një nike të vendosur në të njëjtën mënyrë si të tjerat, sepse gjetëm harkun që e mbulonte atë (Tab. XI, 4).

Nga sondazhet në tre portat e mëdha, na rezultoi se ato janë me shpatulla të drejta dhe ruajnë gjurmë suvatimi të ngjyrosura.

Teknika e ndërtimit

Vrojtimi direkt i monumentit dhe sondazhet në brëndësi të tij, na dhanë një sërë të dhënash për teknikën e ndërtimit dhe strukturën, si dhe për të gjykuar mbi parimet konstruktive dhe mënyrën e ndërtimit.

Muret, siç kemi thënë dhe më lart, janë me gurë të skuadruar në faqen e jashtme, dhe në faqet e brëndshme janë punuar vetëm me një bordurë për kontaktin me gurët përbri në një fugë thuajse pa llaç në anën e jashtme. Anët e tjera janë lënë të çrregullta për t'u lidhur me pjesën e murit të formuar prej tullash të lidhura me shumë llaç, që për të mos ceduar, për shkak të trashësisë së madhe, ka si mbushës rërë të trashë. Tullat janë të madhësive të ndryshme, të vendosura edhe njëra pranë tjetrës, si në pjesët mbi gurët ashtu dhe në niket, fakt që na shtyn të mendojmë se këto sipërfaqe kanë qënë të suvatuara bashkë me qemeret dhe faqet e brëndshme të pilastrave. Gjurmë suvatimi të ngjyrosura gjënden edhe në murin me tulla dhe niket e anës jugore, por ne s'mund të themi nëse ky është suvatimi i parë.

Ndërsa tullat në pjesët e sipërme janë të cfarëdoshme, kjo nuk ndodh në mbulesat me hark të dritareve, të cilat janë pa përjashtim të niëllojta dhe të madhësive që kërkohen në çdo vënd. Madje në fasadën perëndimore dy harqe janë punuar me tulla të profiluara. Të dy harqet, që janë të ndryshëm njëri nga tjetri, ndodhen njëri në niken e veriut të fasadës perëndimore dhe tjetri në portën e madhe të po kësaj fasade, me tulla më të komplikuara. Të gjitha harqet me tulla janë punuar mjaft mirë dhe me fuga të rregullta.

Brezi i sipërm i punuar me kluasonazhë, që zë një sipërfaqe të madhe të fasadave, me gur çmërsi në ngjyrë gri të errët dhe tulla të kuqe, bënte dikur një efekt mjaft piktoresk, që pjesërisht mund të shohim edhe sot në fasadën jugore. Kontrasti i dy materialeve nënvizohet dhe më tepër nëpërmjet punimit të rregullt të fugave, të mbushura me një pastë ngjyrë kafe të hapët, që rrafshohet e thellohet me një vegël speciale, teknikë kjo e njohur.[34])

Vërejmë se trajtimi pak a shumë i lirë i kluasonazhit, me vija jo shumë të drejta, nuk është shënjë primitiviteti dhe niveli të ulët ndërtimi. Ajo tregon vetëm se në këtë kohë kluasonazhi njihej aq mirë, sa që prej tij mundoheshin të merrnin sa më shumë efekte, gjë që s'mund të bëhej në fillim kur vlera estetike e tij qëndronte në rregullshmërinë e vijave. Këtu, në formën e tij si të pakujdesëshme ai jep një efekt shumë piktoresk.

Meqënëse kluasonazhi arrihej nëpërmjet futjes së tullave të holla në muraturën e anës së mbrapme, për t'u lidhur me të, ishte vështirë të ndërtohej me rreshta që shkonin në tërë fasadën, atje ku tek ajo reflektohen volume me struktura të ndryshme. E tillë është fasada jugore tek e cila kemi naosin, narteksin dhe ambientin e altarit me nivele dhe struktura krejt të ndryshme. Në këtë fasadë, vërehet se muratura është bërë e veçantë në pjesën që i takon naosit, duke filluar nga rreshti me dhëmbë sharre, në nivelin e thembrave të harqeve të dritareve. Një gjë e tillë na duket e kuptueshme, nga që të okupuar në kryerjen e strukturës mjaft të komplikuar të harqeve të dritareve dhe fushës së dekoruar brënda tyre, kluasonazhin e ndërtonin vetëm për pjesën e naosit për t'u lidhur me muret e brëndshme të tij, duke lënë një fugë vertikale në takimet me strukturat e tjera të ndara prej tij, dhe vetëm pas ndërtimit të kësaj pjese ndërtonin dy të tjerat. Fuga me ambientin e altarit është e qartë, ndërsa ajo me narteksin është e fshehur nga një kuadrat me dekor tullash. Edhe korniza me dhëmbë sharre ekziston vetëm në këtë pjesë të fasadës jugore.

34) A. Choisy, **Art de bâtir chez les byzantins** Paris, 1883, 13. G. Millet, **L'école grecque dans l'architecture byzantine**, Paris 1916, 36.
35) F. Versaqis, **vep. cit.,** fig. 2 dhe 8.

DOKTORATURË



PLANIMETRIA mbas sondazheve

Fig. 29

DO NOT COPY



Fig. 30



Fig. 31

Në fasadat dallohen dhe një sërë vrimash. Disa nga to, që janë në një nivel, tregojnë qartë se janë vrima të skelave dhe se më vonë janë mbushur me tulla. Vrima të tjera të mëdha (20 x x 20 cm) janë në nivelet e fillimit të qemereve të portikut dhe nëpër qoshet veriperëndimore dhe jugperëndimore, këto vrima vazhdojnë në gjatësi të murit dhe janë të brezave të murit që kanë qënë në këtë nivel. Një rrjet i dytë brezash dallohet në nivelin e fundit të dritareve të mëdha, bile nga njëra vrimë dallojmë edhe një fragment kolone. Ky brez në këtë nivel ka shërbyer edhe si tirant për harqet e dritareve, që janë edhe harqe mbajtëse të kupolave. Mendojmë se këta breza në këtë nivel duhej të formonin një rrjetë që kalonte dhe në tërë harqet mbajtës, siç ka tirante arkada naos-narteks.

Breza druri ka patur dhe në kupolat. Një brez të tillë prej dy tirantësh pamë në dritaren që lidh dy kupolat jugore, në nivelin e fillimit të tyre, që është dhe niveli i fillimit të tamburit.

Kupolat mbi tambure ngrihen mbi harqet nëpërmjet trekëndëshave sferikë mbi të cilët kalon një kornizë. Trekëndëshat sferikë të kupolës së madhe jugore kanë një veçanti, brënda tyre është një konkavitet i ngjashëm me trombat sferike.

Në kupolat e vjetra ne nuk sonduam për të parë teknikën e ndërtimit të tyre me që pjesët e vjetra janë me afreska. Dimë vetëm se tamburi është me çmërs në anën e jashtme sepse është punuar me kluasonazhë. Zor që çmërsi, material i lehtë dhe i zakonshëm për ndërtimin e kupolave, të mos jetë përdorur dhe këtu. Mund të përmëndim se mbulesa me kupolë të çrregullt, e ambientit të vogël në vëndtakimin e të katër kupolave, është prej çmërsi.

Nga pikëpamja konstruktive, kisha e Mesopotamit, mbulohet me një rrjet kupolash mbi tamburë, kalota dhe qemere cilindrikë (ambienti i vjetër i altarit) të mbështetur në pilastrat dhe muret. Për vetë formën planimetrike dhe volumetrinë e veçantë nga tipat arkitektonikë të përdorur në Bizant, konstruksioni shmanget nga forma e zakonshme. Eliminimi i shtytjeve horizontale nga vetë konstruksioni këtu arrihet në drejtimin lindje-perëndim, ku shtytja e kupolave kalohet në konstruksionin e narteksit dhe të ambientit të altarit, ndërsa në drejtim jug-veri gjithshka u është lënë tiranteve, nëse ka patur, dhe portikut që është ndërtuar në fund, sepse pilastrat nën harqet mbajtëse, të nxjerra pak nga muri, nuk mund të lozin ndonjë rol të madh. Pra, siç shihet, në drejtim jug-veri rezervat e qëndrueshmërisë kanë qënë më të pakta, dhe pikërisht në to kemi dëmtimet më të mëdha. Na habit dëmtimi i anës lindore, që konstruktivisht ishte më e qëndrueshme. Kjo mund të shpjegohet ose me cedimin e tokës, nga tërmeti, ose me transformimin e saj për arësye

DO NOT COPY

funksionale në kohën e riparimit të dëmtimeve.

Megjithatë, ndërtimi i këtij monumenti, me gjithë vështirësitë konstruktive që u dilnin ndërtuesve, ka qënë një ndërmarrje e guximshme. Pjesa më e madhe e tij nuk i ka qëndruar kohës, megjithëse niveli i ekzekutimit është i lartë.

Me kalimin e kohës është bërë forcimi i kolonës së mesit, e cila, edhe pse e hollë, sfidonte ngarkesa të mëdha. Me kohë rrëzohen portikët dhe gjymtohet ana lindore dhe, më vonë, ajo veriore. Humbja e kompaktësisë, një ndër mjetet kryesore të qëndrueshmërisë ndaj ngarkesave, bie pak nga pak edhe dëmtime.

Duke patur parasysh se dritaret e dyert zënë sipërfaqe të mëdha ndër mure, dhe se ato janë vendosur ndërmjet pilastrave, ngarkesat nga lartposhtë kalojnë në tokë pikërisht nëpërmjet këtij rrjeti pilastrash, të cilët janë bërë jo vetëm për mbështetjen e harqeve mbajtëse, por edhe për krijimin e një brinje rigjiditeti dhe të mundësisë që, duke zbritur poshtë, ngarkesat të jenë gjithnjë brënda murit. Nuk është e rastit që pikërisht në pilastrin qëndror në mur është vendosur qemeri i tërthortë i portikut, megjithëse kjo zgjidhje kondicionohet dhe nga pozicioni i portës, që detyrimisht do t'ishte në mes të dy pilastrave. Harqet e këtij qemeri, që nga pilastrat jashtë murit gjer te pilastrat e portikut, lozin një rol të përafërt si harqe shkarkuese, sigurisht po të jetë ndërtuar portiku përpara mbarimit të ndërtimit të kupolave.

Aftësia konstruktive e ndërtuesit dallohet pikërisht në krijimin e një strukture komplekse, të aftë për të mbajtur pesha jo të vogla të ngritur në një lartësi të madhe që nëpër një sërë pilastrash, kalojnë në tokë. Ky çmaterializim i pareteve është një mënyrë e zakonshme ndërtimi bizantin që, në shekujt e vonë, gjen zhvillimin më të madh edhe nëpërmjet përvetësimit të ndërtimit të kupolave të vogla, një sistem ekuilibrimi brënda për brënda strukturave që do të përdoret për një kohë mjaft të gjatë në gjithë vëndet. Duke lehtësuar në maksimum muret, duke holluar elementët mbajtës, duke çuar në kufi të soliditetit tërë konstruksionin sidomos në anët veri dhe jug, ndërtuesit kanë bërë që të ketë sa më pak elementë mbajtës për të përfituar efektet arkitektonike të dëshiruara. Ky antagonizëm ndërmjet nevojës për soliditet dhe dëshirës për çmaterializim, çoi në një zgjidhje që nuk mundi t'i qëndronte kohës.

Rikonstruksioni

Vetëm mbas kryerjes së sondazheve jemi në gjëndje të tentojmë një rikonstruksion hipotetik të kishës Mesopotamit. Në planimetri (fig. 32), kemi një ndarje të naosit në dy nefe, nëpërmjet kolonës të mesit dhe dy bemave. Për shkak të dëmtimit të dyshemesë pranë shkallës naos-ambient i altarit, për ndërtimin e themelit të arkadës së re, më 1793 është çdukur çdo gjurmë e ndonjë ikonostasi të gurtë në dysheme, po të ketë patur një të tillë. I vetmi vënd ku mund të ketë mbetur sot ndonjë gjurmë, është vëndtakimi i pilastrit jugor të arkadës me murin jugor. Fragmentet e pllakave dhe të kolonave të dekoruara nuk na tregojnë gjë, sepse ato mund të jenë prurë bashkë me fragmentet e tjera nga ndonjë vënd tjetër.

Dritaret apo niket në fasadën veriore dhe jugore, për ndryshimin që kanë me niket e tjera, do t'i pranojmë për dritare, dyert janë nga dy në fasadat jugore dhe veriore dhe një në atë perëndimore. Ky rikonstruksion ndryshon nga ai i Versaqis [35]), sepse ky mendonte që brënda pilastrit të madh nuk kishte kolonë por pilastër, ndërsa derën më të vogël nga jugu e ka paraqitur si nike dhe dritaren njëshe mbi derën e madhe e ka rikonstruktuar dyshe. Gjithashtu në formën e re jepet dhe ambienti i vjetër i altarit.

Thamë se gjurmat e apsidave nga ana e jashtme nuk i gjetëm. Por pranë apsidës së re ndodhet një blok i madh muri me tri faqe me kluasonazhë, rreth 90 cm secila. Po ta pranojmë se kjo është pjesë e apsidave të vjetra, numri i faqeve do të jetë më i madh se 5, siç e paraqesim ne në konstruksionin tonë. Sidoqoftë faqet e apsidave, që dalin nga muret jugor, ne mund t'i konstruktojmë duke ripërdorur niken sot të përgjysmuar. Mbas këtyre faqeve të mëdha vinë faqet e tjera, që janë më të vogla. Kupolat e mëdha, sot të çrregullta, mendojmë se duhet të kenë qënë tetëkëndëshe në faqet në dukje.

Rikonstruksioni i portikut paraqitet për ne më i vështirë (Tab. XII, 1). Shtrirjen e tij e dimë por nuk kemi të dhëna, sidomos për formën e tij në anën perëndimore, ku mund të ketë qënë i hapur, si dhe në anët e tjera. Ne, nuk dimë, as numrin dhe vënd-ndodhjen e pilastrave, aq më tepër në se ka qënë i mbyllur ose pjesërisht i mbyllur nuk dimë asgjë. Përveç kësaj duhet pranuar se pjesët me kluasonazh të brezit të sipërm të muraturës janë të pasuvatuara dhe të dukshme, pra të pambuluara nga qemeret e portikut. Na del se qemeret gjatësorë mbuloheshin me çati dyujshe (Tab. XII, 2). Në këtë rast është i vështirë largimi i ujrave të shiut në zonat ndërmjet qemereve të tërthorta që ngrihen mbi ato gjatësorë. Për largimin e ujrave nga pjesët në lindje të qemerit të tërthortë në fasadat jugore dhe veriore kemi një gjurmë mjaft të qartë në qoshen juglindore. Aty, menjëherë në kluasonazh, ruhet një sipërfaqe e vogël me llaç shamot, fundi i së cilës

DO NOT COPY

është i pjerrët dhe i përkulur, siç mund të ishte po të kishte nën të një ulluk për rrjedhje ujrash. Ky ulluk formohej nga muri dhe pjerrësia e çatisë së qemerit. Suvatimi me shamot duhet të jetë bërë në një kohë më të vonë dhe, jo vetëm këtu, por në tërë fasadën jugore, ku akoma edhe sot, ruhen gjurmë të vogla dhe një sipërfaqe e konsiderueshme në anët e dritares së madhe treshe.

Largimi i ujrave nga pjesët e tjera mund të jetë bërë me dy mënyra: Mënyra e parë, është largimi i tyre me ulluk vertikal në një nga qoshet, ose rrëzë pilastrave, që ndodhen anash portave qendrore, variant që nuk na duket shumë i rregullt nga ana estetike. E dyta, largimi me ndonjë tub të vendosur brënda murit, mbi harkun e qemerit të tërthortë, duke dalë në fasadën e arkadës mbi pilastra.

Këtu del një problem tjetër: që dritaret e ngushta që dalin pak mbi kluasonazhë ndërpresin rrjedhjen e ujit, po të mos jenë të mbyllura në pjesët e sipërme (fig. 33).

Në rikonstruksionin planimetrik të portikut jemi nisur nga pilastrat e gjetura në fasadën veriore duke vendosur të tjerët sipas vëndit.

Analiza arkitekturale

Për sa dimë ne, kisha e manastirit të Mesopotamit përbën një tip unikal që për vetë madhësinë dhe nivelin e ekzekutimit është e një forme të kërkuar dhe jo e rastit. Sigurisht që kërkimi i origjinës së një forme të tillë është një detyrë me shumë të panjohura dhe mund të bëhej objekt i një studimi të veçantë.



Planimetria Rikonstruksion

Fig. 32

DO NOT COPY

Arësyet që kanë prurë në një zgjidhje të tillë mund të jenë: kërkesa të veçanta funksionale, kërkesa konstruktive dhe kërkesa estetike. Këto kërkesa së bashku, apo ndonjëra prej tyre veçmas, kanë prurë në zgjidhjen e mësipërme.

Forma dhe madhësia e kishës, për kohën në të cilën është ndërtuar, na shtyn të mendojmë se kemi të bëjmë me një monument të ngritur për t'u dalluar nga madhësia dhe arkitektura. Një gjë e tillë rezulton dhe nga dekori prej skulpturash dhe mozaikësh, elementë që hasen jo shpesh në arkitekturën e vonë bizantine.

Dëshira për një naos të madh dhe me hapësirë të brëndshme, relativisht më të lirë se sa në kishat në formë kryqi, ku ambientet anësorë ishin të shkëputur nga e tëra, kishte në dispozicion tipin me tromb në qoshe, që detyrimisht do të kërkonte një kupolë, e cila për naosin (9.3 x 9.3 m) nuk mund të ballancohej brënda strukturave, nëpërmjet shkarkimeve të njëpasnjëshme, sidomos në drejtim jug-veri, ku muret anësorë nuk do të ishin në gjëndje të mbanin një ngarkesë të tillë. Nga ana tjetër, tipi bazilikal me çati dy ujshe nuk përputhej me kërkesat estetike të kohës. Këto të dhëna fillestare, madhësia dhe aftësia teknike e ndërtuesve, që ishin të zotët për të ndërtuar kupola të vogla si edhe dëshira për një naos të lirë, prunë në këtë formë unikale, në të cilën krijohet ideja e thellësisë, del në pah lartësia dhe krijohet një hapësirë e pafund. Të tri këto parime [36]) këtu janë arritur me rrugë dhe mjete të ndryshme nga ato të formave të zakonshme të arkitekturës bizantine.

Nuk jemi në gjëndje të themi se ç'kërkesa funksionale kanë determinuar një zgjidhje të tillë, po duhet të pranojmë se kërkesat funksionale mund të kenë ekzistuar.

Thamë më lart, se nga madhësia dhe niveli i ekzekutimit, kjo kishë nuk mund të jetë një rastësi, sepse një gjë e tillë mund të ndodhte vetëm brënda një skeme të njohur, në të cilën të varionin dhe të improvizonin gjatë ndërtimit.

Mbasi qe vendosur ndërtimi i një kolone në mes, kjo pruri dhe formën e mbulesës me katër kupola si dhe zgjidhjen e anës lindore me dy bema dhe apsida, sepse në rast të kundërt do të mungonte vazhdimësia e hapësirës në drejtim të aksit gjatësor. Me gjithë këtë, nuk do të donim ta quanim kishën, bazilikë dynefshe me kupola, sepse hapësira e brëndshme nuk ishte tipike bazilikale dhe se ndarja me nefa ishte më tepër një interpretim formal se sa një ndarje faktike.

E menduar për një volumetri dhe funksionalizëm të tillë, kisha paraqitet si një unitet. Megjithë aksin gjatësor, ky nuk mbizotëron, për shkak të zgjerimit të hapësirës në drejtim të nefit tjetër dhe të aksit vertikal. Njëanëshmërinë e zgjerimit hapësinor ndërtuesit janë munduar ta eliminojnë nëpërmjet shpuarjes së murit anësor me një sërë dyersh dhe dritaresh. Se sa ja kanë arritur një gjëje të tillë, ne nuk mund ta provojmë, sepse me imagjinatë mund të krijojmë volumetrinë e dikurshme, por jo ndjenjën e hapësirës së brëndshme, që me rrugë të tilla është e vështirë ta arrish. Të detyruar të vendosin një kolonë në mes ndërtuesit qenë të vetëdijshëm për pasojat estetike të një veprimi të tillë që fragmentonte hapësirën e brëndshme, prandaj, nëpërmjet ngritjes lart të kupolave dhe të harqeve mbajtës, janë munduar jo vetëm të eliminojnë një gjë të tillë, por dhe të zvogëlojnë kolonën e mesit, saqë duket sikur kupolat nuk ngrihen mbi kolonë, por mbështeten në tokë nëpërmjet kolonës.

Për vetë volumetrinë komplekse hapësira e brëndshme nuk është statike. Të qënët endonarteks i narteksit, d.m.th. lidhja e tij direkte me naosin nëpërmjet arkadës, krijon qysh në hyrje një ritëm dinamik që kontribuon në pakësimin e efekteve negative të kolonës së mesit, duke krijuar në të njëjtën kohë një hapësirë jo bazilikale. Sa kalon pragun e portës, edhe pse jo brënda një ambienti të veçantë, nuk mund të perceptosh një gjë të tillë dhe përfshihesh menjëherë brënda hapësirës së naosit të artikulluar me atë të narteksit. Në naos do të jesh i shtyrë patjetër të lëvizësh, të provosh këtë eksperiencë hapësinore, që në çdo pikë është e ndryshme, sepse ndrron pozicionin ndaj kolonës mesit, apsidave dhe kupolave, të dytat më të larta se të parat, që ekzaltojnë vertikalitetin dhe së bashku me dritën që derdhet nga të gjitha nivelet, bëjnë që hapësira e brëndshme të jetë dinamike dhe të duket sikur muret nuk mund ta përmbajnë dot. Në këtë kontribuonte dhe piktura murale që mvishte gjithë muret e brëndshme, duke barazuar gati në një nivel tërë paretet anësore.

Sidoqë kërkimet estetike të epokës së Paleologëve synonin një vlerësim të antikitetit të modeleve më të vjetra, natyrisht në lidhje me nivelin dhe mjetet teknike të kohës, mendojmë se monumenti paraqitet me të tëra karakteristikat e arkitekturës bizantine.

36) P. A. Michelis **L'esthétique d'art byzantine,** Paris 1956, 65.

DOWNLOAD



Rikonstruksion



Mbas rrenimit rreth v1793



Rikonstruksion i v1793



Mbas rrenimit rreth v1845



Gjendja sot

Fig. 33

DO NOT COPY

Jo më pak karakteristike për arkitekturën bizantine është edhe ana e jashtme që, nga volumetria, i ngjan një piramide me një theksim të vertikalitetit edhe nga kupolat. Sot kisha na paraqitet si një kub mjaft kompakt, ide që krijohet dhe nga mungesa e dritareve. Kjo pamje është krejt e kundërtë nga ajo që ka patur kisha në fillim.

Kërkesat për piktoresken këtu arrihen në radhë të parë nga dekori mjaft i pasur keramo-plastik dhe kluasonazhi, megjithëse në dukje i pakujdesshëm, si dhe nga dritaret me harqet e tyre dhe fushat e dekoruara, nga frizat dhe kornizat që nënvizojnë fundin e murit dhe tambureve. Kornizat, edhe pse në vijë të drejtë, nuk krijojnë një pamje të ngurtë, sepse me kornizat e frontoneve në perëndim dhe në lindje si dhe me diferencat e niveleve në veri e jugë kanë një gjallëri, një lëvizje. Në piktoreskun kontribuon dhe vendosja neglizhente e dritareve, harqet rrethuese të të cilave ndërpriten nga frizat dhe i ndërpresin ato.

Në pamjen e dikurshme duhet të lozte një rol jo të vogël dhe portiku që nga tre anët rrethonte kishën me një arkadë të vazhdueshme prej kluasonazhi, që ndërpritet nga tre qemeret e tërthortë në portat qëndrore. Kluasonazhi dilte më tepër në dukje në sfondin e gurtë mbrapa tij, të dekoruar me nike që, duke qënë gjithnjë në hije, loznin rol vetëm si njolla.

Trajtat që tregojnë për një farë influence kryqytetase janë kupolat sferike në narteks të cilat këtu mbulohen me frontone, si dhe apsidat shumëfaqëshe dhe niket në brezin e poshtëm.

Interesant është dhe trajtimi i jashtëm i kupolave, i cili është i thjeshtë dhe kontraston me fasadat. Kjo gjë, mund të ketë ndodhur, nga lartësia relativisht e vogël e tyre, ose nga konceptimi piramidal në të cilin theksimi vertikal vjen nga e tëra, dhe jo vetëm nga kupolat në veçanti, të cilat ndër kishat e vona rriten mjaft në lartësi dhe trajtohen në mënyrë mjaft të pasur.

Datimi

E parë në gjëndjen e sotme, kjo kishë është gjykuar për primitive. Kjo, në një farë mase, ka influencuar në pranimin e gojëdhanës që lidh ndërtimin e saj me kohën e sundimit të Kostandinit IX Monomaku (1042-1054). Po të prononim se në këtë gojëdhanë ka diçka të vërtetë, atëhere në këtë kohë do të jetë ndërtuar Manastiri bashkë me ndonjë kishë tjetër.

Kemi të bëjmë me një kishë jo të zakonshme, që zor se mund të ndërtohej menjëherë në një manastir të porsakrijuar. Një gjë e tillë mund të ndodhte vetëm në një manastir të pasur. Prandaj mendojmë se ka më shumë të ngjarë, që kisha të jetë ndërtuar ca kohë mbas krijimit të manastirit. Ky i fundit është ndërtuar pranë qytetit të vjetër të Mesapotamit, qëndër e dikurshme peshkopate, që duhet të ketë ekzistuar dhe më parë, në anën tjetër të lumit, ku sot është fshati Mesopotam.

Dyselie mendon, se kisha po të jetë e shek. XI, është ndërtim i ndonjë shkolle lokale që s'ka asimiluar akoma elementët e planit në formë kryqi. Në të njëjtën kohë, duke u nisur nga bukuria e fasadave që vështirë të jenë punë e ndonjë shkolle lokale, ai priret për një datim më të hershëm, për shekullin IX. Ai e ka kuptuar se një ndërtim i tillë i shquar në shek. XI nuk mund të ishte rezultat i mosasimilimit të formës së kryqit, tashmë të formuar qartë dhe të njohur në tërë perandorinë Bizantine. Mirëpo, duke mos pranuar se kemi të bëjmë me një formë të kërkuar, ai e shtyn dy shekuj më përpara datimin. Ky datim na duket mjaft i nxituar, sepse dihet mirë që kluasonazhi çfaqet në fillim të shek. XI, pa rregullshmëri dhe si një provë e ndrojtur. [37])

Versaqis, që nuk e njihte gojëdhanën e themelimit të manastirit të Mesopotamit, duke u nisur nga ndërtimi i ulët i kupolave të para, ndërtimi i murit jo i rregullt, shumëngjyrshmëria e kapiteleve, sasia e kupolave dhe kalotave, mendon si datë të mundëshme të ndërtimit gjysmën e dytë të shek. XII ose fillimin e shek. XIII. [38])

Duke patur të bëjmë me një rast unikal, datimi paraqet vështirësi sepse formulimi arkitektonik nuk mund të vërehet si një hallkë brënda një zinxhiri të vazhdueshëm transformimesh dhe variacionesh të një tipi, sigurisht pa e absolutizuar një gjë e tillë.

Që tipi kryq i brëndashkruar në kohën e ndërtimit të kishës ishte i zhvilluar, këtë na e tregon indirekt fakti që këtu u zgjodh një formë tjetër, meqë nga tipi i mësipërm nuk mund të nxirrej në ndonjë variant që të kënaqte dëshirat e ndërtuesve.

Për datimin na ndihmon edhe portiku, që këtu është mjaft i zhvilluar dhe që, më tepër se çdo element tjetër formal, tregon për një influencë të shënuar të modeleve të Konstantinopojës, nga të cilat merr dhe mbështetjen në pilastrat. Këto portike kanë prejardhjen nga ndarja me mur e nefeve qëndrorë dhe anësorë, me të cilët komunikon në-

37) A. Millet, vep. cit., 228.
38) F. Versaqis, vep. cit., 42.

DO NOT COPY

përmjet dyerve, fenomen ky që fillon të ndodhë në shek. XII.[39])

Nga ana tjetër prezenca e një monumenti të tillë në provincë nuk duhet të na habisë. Me rënjen e Perandorit Bizantin më 1204 nga sulmet e kryqtarëve latinë, kemi çvendosjen e qendrave të krijimtarisë artistike nga Metropoli në drejtim të Sërbisë, të Venedikut dhe të Despotatit të Epirit, ndër të cilët ky i fundit, lot një rol mjaft të rëndësishëm edhe si një ndërlidhës i Lindjes Kristiane me Europën Perëndimore, gjë që në këtë periudh mund të shpjegojë ndërtimin e mjaft të godinave me trajta Kostandinopolitane, forma të reja dhe influenca romake në art.

Në fund të shek. XII, në Artë ndërtohet Katedralja me të cilën shihen afrime lidhur me portikun, sot edhe aty të humbur, me shmangie nga tipat dhe me kluasonazhin pak neglizhent, me ndryshimin që tullat janë gjithnjë dy, bile shpesh edhe rreshtat horizontale. Përdorimi i kolonës në mes, dhe jo i një pilastri që nga ana konstruktive do të qe më i sigurtë, duhet të shpjegohet vetëm me kërkesat estetike. Pra, kjo mund të kuptohet jo si një rastësi, por vetëm brënda kuadrit të një zgjidhjeje të zakonshme.

Për datimin duhet të na ndihmojë dhe trajtimi piktoresk i sipërfaqeve të mureve, me qilima të vërtetë dekoracionesh keramo-plastike, karakteristike për shek. XIII-XIV.

Kemi vërejtur më sipër se kapitelet e arkadës naos-narteks janë të shek. XI dhe të ripërdorura. Ky për ne është një fakt tjetër për një datim më të vonë të kishës së Mesopotamit.

Nga sa parashtruam më sipër, mendimi ynë është se shekujt XIII-XIV janë një kohë e mundshme e ndërtimit të këtij monumenti dhe se ai i tëri është i një kohe, pavarësisht nga zgjatja eventuale e ndërtimit.

Datimin në një periudhë kohe më të ngushtë mund ta bëjmë më të lehtë po të pranojmë se tri «fleur de lis» të vendosura në dyshemenë e narteksit janë stema e Anzhuinëve. E themi me rezervë një gjë të tillë, sepse në stemën e Anzhuinëve këto vihen dy sipër dhe një poshtë në mes të tyre. Në këtë rast, koha e ndërtimit të kishës së manastirit të Mesopotamit është ndërmjet viteve 1272-1286, kur Anzhuinët zotëronin pjesën ndërmjet Durrësit dhe Butrintit,[40]) që është afër Mesopotamit. Kjo mund të shpjegojë dhe formën e veçantë të kishës me dy apsida, rrjedhimisht me dy altarë, si pasojë e ekzistencës së dy kishave gjatë këtyre viteve në bregdetin linore të Adriatikut. Sidoqoftë, vërtetimi i kësaj hipoteze do të ishte me interes për zgjidhjen si të problemit të datimit, ashtu dhe të atij të formës planimetrike.

Pasi kemi pranuar vlerat e këtij monumenti, jemi të mendimit se një sërë punimesh të tjera janë të domosdoshme për një vlerësim më të mirë të tij, të cilat nga ana tjetër, do të kontribuonin dhe për një njohje dhe studim më të plotë.

Me ndryshimet e mëdha që ka pësuar monumenti, është e pamundur që t'i jepet atij pamja e dikurshme si brënda ashtu dhe jashtë. Portiku, ambient i vjetër i altarit, pjesë të kupolave, janë për ne elemente të humbur përgjithmonë, kthimi i të cilëve në gjëndjen e parë është i dyshimtë.

Problem tjetër është heqja e shtresave në interier dhe e mbylljeve të dritareve dhe dyerve. Shtresat në interier d.m.th. pilastrat dhe harqet përforcues mbi to, janë shtuar për arësye konstruktive, kështuqë heqja e tyre do të kërkonte elemente të tjerë konstruktivë të aftë për të mbajtur ngarkesat. Të tilla mund të ishin një sistem brezash e tirantesh për të ekuilibruar shtytjet e harqeve, që do të ktheheshin në nivelet e para, si dhe kompaktësimi dhe, në disa raste, edhe përforcimi i strukturave të vjetra. Për sa mund të gjykohet nga barku që ka bërë muri jugor, nga plasjet që kanë marrë muret, harqet dhe kupolat, një punë e tillë është e vështirë, për të mund të merret një vendim vetëm mbas heqjes së tërë suvatimeve të reja, sigurisht në pjesën pa afresk.

Përsa i përket mbushjes së dyerve dhe dritareve, mund të vërehet lehtë se ndërsa disa prej tyre lozin një rol konstruktiv, kur muret pranë apo harku mbi to janë të dëmtuar, të tjerat janë mbushur vetëm për të zënë boshllëkun. Ndërsa të parat mund të çlirohen nga mbushjet vetëm kur të jenë marrë masa përforcuese për tërë godinën, të dytat mund të pastrohen dhe më përpara.

Përpara një gjëndje të tillë si masë të parë konservuese dhe restauruese propozojmë pastrimin e portikut me konsolidimin e mbeturinave të tij, për të dhënë idenë e madhësisë së parë; nxjerrjen në dukje të mureve të vjetra në ambientin e altarit; heqjen e suvasë në muret mbushëse të dyerve; pastrimin e naosit dhe heqjen e pareteve ndarëse prej druri, të cilat s'kanë ndonjë vlerë bile e ngushtojnë edhe më tepër.

Me këto masa të para do të jepet mundësia të shikohet ky monument edhe në pjesët e zhdukura, të imagjinohet madhësia e tij e dikurshme dhe të kuptohet rëndësia e tij jo vetëm për historinë e arkitekturës bizantine tek ne, por edhe për arkitekturën bizantine në përgjithësi, ku ai, për mungesë të këtyre punimeve fillestare, ende nuk ka zënë vëndin që i takon.

39) N Brunov, **Arhitektura Konstantinopolja IX-XIII** v., Viz. Vre Tom II (XXVII), 189. Ch. Diehl, **Vep. cit.,** 774.
40) **Historia e Shqipërisë,** Tiranë 1967, I, 202.

DO NOT COPY

TAB. I





:2

Pamje nga perëndimi

DO NOT COPY





2

Pamje nga jugu

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Pamje nga veriu



Pamje nga lindja


1


2


3


4

DO NOT COPY



Prerje lërthore



Prerje lërthore

DO NOT COPY

Planimetri në nivelin e dritareve të medha.





Planimetria ne nivelin e kupolave

0 1 2 3 4M

DO NOT COPY



1 Prerje tërthore



2 Prerje gjatësore

DO NOT COPY


1


2


3


4

DO NOT COPY

TAB. IX









DO NOT COPY







DO NOT COPY









DO NOT COPY

DO NOT COPY

truite sur sa face extérieure, en pierres calcaires équarries et de dimensions relativement grandes, et, sur sa face intérieure, en briques. Les deux parois se relient grâce à la forme pointue donnée aux pierres vers l'intérieur et au mortier abondant qui les unit aux briques. Se fondant sur l'abondant mortier employé, Ducellier pense erronément qu'il s'agit là d'un mur romain du type «opus cementum». Un sondage effectué dans la face interne a révélé que cette bande ainsi que les bandes supérieures sont identiques par les matériaux employés comme par la technique de construction. On peut donc en conclure que cette bande a été construite en même temps que l'ensemble de l'édifice et avec des pierres employées ici pour la première fois et non point recueillies de constructions antiques, comme Versakis et Ducellier ont tendance à le croire.

La bande supérieure est construite selon l'habituelle technique byzantine tardive du cloisonnage, la face extérieure étant faite de moellons équarris entourés sur les quatre côtés d'une brique mince. Cette bande se termine par une frise surmontée d'une corniche, elle-même constituée par quatre rangées de briques disposées en dents de scie. La frise, que l'on trouve sur les faces sud et nord, où les corniches sont horizontales, est formée d'une ceinture de briques disposées en zig-zags, en dos de poisson ou en forme d'S. Les fenêtres qui s'ouvrent dans cette bande supérieure sont au nombre de trois pour chacun des murs sud et ouest. Le mur du côté nord doit avoir été identique à celui de la face sud, à en juger par la partie ouest, où subsistent deux fragments de fenêtres.

Les fenêtres sont toutes à trois ouvertures, aujourd'hui entièrement murées d'une maçonnerie irrégulière, dans laquelle on distingue des pierres des chapiteaux des deux colonnes intermédiaires. Chaque ouverture est surmontée d'un arc en briques, l'arc central étant plus élevé que les deux latéraux, et chaque fenêtre, dans son ensemble, est surmontée d'un grand arc formé de plusieurs rangées de briques, qui embrasse la largeur des trois ouvertures. L'espace compris entre le grand arc supérieur et les trois arcs de chaque ouverture, est orné de briques disposées horizontalement et verticalement, en zig-zags, en dos de poisson, etc., et taillées dans les formes les plus diverses.

Entre ces deux bandes, se trouve une troisième ceinture construite de pierres et de briques, qui ne présente à première vue aucune homogénéité. Immédiatement au-dessus des pierres cubiques qui marquent le bas de cette ceinture, apparaissent les traces de moellons et de briques formant une voûte à plein cintre, à ligne directrice parallèle au mur, ce qui indique que chacun des trois côtés, nord, sud et ouest, était bordé d'un portique. Sur les murs ouest et sud, auprès des pieds-droits des portes centrales, on distingue les traces de deux piliers sur lesquels reposait un arc à plein cintre, vestige d'une voûte cylindrique à ligne directrice perpendiculaire au mur et qui se distingue plus nettement que la voûte longitudinale. Versakis estime que tant la voûte que la ceinture inférieure de pierres équarries ont été ajoutées postérieurement. Outre ce qu'il a été dit plus haut sur la forme irrégulière des pierres de l'intérieur, une telle opération aurait été fort ardue et, en tout état de cause, aurait provoqué des failles et des déformations, dont on ne relève en l'occurrence aucune trace. Cette interprétation est également réfutée par le fait que le fragment de cette voûte au coin sud-est est lié on ne peut mieux au mur.

Sur le mur est, où saille une abside à quatre faces, on n'a que deux ceintures, un plinthe formé de pierres équarries et un mur ordinaire en pierres. Un examen attentif du plinthe révèle, tant par l'irrégularité des faces que par la présence de petites pierres et de briques, qu'il s'agit là d'une reconstruction. On est amené à conclure que le mur est a été reconstruit et il se joint à l'ancien mur à un mètre environ de l'angle très obtus que forme celui-ci. Si l'on tente de reconstruire l'arc de la niche interrompu en son milieu, on verra que le mur du côté est a été reconstruit plus à l'intérieur que sa position initiale. Sous le fronton central du mur est, se trouve une plaque sur laquelle est gravée une fleur et, au-

DO NOT COPY

dessous, une date, 1793, assurément l'année de la reconstruction du mur est et d'une partie du mur nord, qui va approximativement jusqu'au point où commence le naos. Le mur nord, dans toute sa partie correspondant au naos, appartient à une autre reconstruction postérieure. Sur une inscription empreinte sur une brique et difficilement déchiffrable, on distingue la date 1845, qui doit être celle de la reconstruction concernant l'aile ouest: en bas, jusqu'au montant de la grande porte, et en haut jusqu'à la grande fenêtre partiellement détruite, qui s'ouvre au-dessous de la petite coupole.

Ce n'est qu'après s'être fait, du dehors, une claire idée des reconstructions diverses qu'a connues cette église, que l'on peut examiner les structures de l'intérieur. De dehors, en effet, une telle étude est plus facile, une couche irrégulière de revêtement recouvrant tout à l'intérieur. Outre le grand pilier construit pour renforcer le support d'autrefois sous la partie où se rejoignent les 4 coupoles, ont été ajoutés pour la même raison le pilier sous l'arcade séparant le naos du narthex et tous les piliers existant sur les murs latéraux. Tous ces piliers ont été surmontés de nouveaux arcs de soutien qui renforcent les anciens ou qui les remplacent lorsque les premiers ont été détruits. En examinant l'appui de l'arcade naos-autel sur le pilier qui apparaît sur le mur sud, on voit qu'il consiste en un prolongement de l'ancien pilier, ce qui incite à conclure que cette arcade et le mur lui-même sont de construction postérieure. Pour déterminer la phase de reconstruction à laquelle correspondent les différentes parties de l'édifice, on peut se fonder notamment sur les coupoles, examinées de l'extérieur, ainsi que sur un petit espace laissée entre leurs points de jonction, afin d'alléger la colonne centrale.

De ce qui a été dit plus haut, il ressort que cette église a connu deux reconstructions, la première en 1793 et la seconde en 1845. Elles durent être rendues indispensables à la suite des grands dommages subis par les structures de l'église, bien que la manière dont il a été tenté de remédier à ces dégâts, témoigne de l'incapacité de ceux qui ont mené les réparations. De l'église, dans sont état initial, ont été enlevés en 1793 le portail, le mur est, l'arcade reliant le naos et l'autel, ainsi que les parties des coupoles qui les surmontaient. A cette époque, ont été construits les piliers et les arcs de renforcement qui les surmontent. Il y a lieu de penser que ces derniers ont été aménagés avant que les parties précitées aient été complètement enlevées, car, dans l'absence du grand pilier, la poussée des coupoles ouest aurait été difficilement compensable. A la même époque, a été construit également le contre-fort sur le mur sud.

C'est vers 1845, qu'ont dû être détruits le mur nord ainsi que l'arc de soutien s'appuyant sur ce mur et sur le pilier central, avec les parties des coupoles qui les surmontent, pour être refaits sans sain, mutilant entièrement ce côté du monument.

Le sol de l'église est aujourd'hui endommagé; il est fait de grandes plaques de pierres calcaires disposées selon un dessin régulier que l'on distingue aujourd'hui partiellement. Ce dessin se retrouve dans son intégralité chez Versakis et, indépendamment du fait qu'il est obligé lui aussi de se livrer à certaines interpolations, il concorde avec les parties qui subsistent aujourd'hui et c'est pourquoi il nous semble acceptable. Le motif est dessiné ou moyen des bandes de mosaïque à figures géométriques, disposées entre les pierres. Le pavement du narthex est d'un dessin différent de celui du naos. Il se compose de trois losanges au milieu et de trois carrées sur les côtés, entourés eux aussi de mosaïques. A trois des angles des losanges, sont dessinés de façon régulière trois fleurs de lys.

L'intérieur était décoré de fresques, de chapiteaux et de corniches en pierres, qui longeaient l'appui des fenêtres dans le naos comme dans le narthex, et qui sont aujourd'hui détruits ou revêtus de crépi.

Les quatre chapiteaux de l'arcade naos-narthex sont du même type: imposte-chapiteau, formés par le chapiteau et l'imposte, joints l'un à l'autre. Le chapiteau est moins haut que l'imposte et constitue le passage de la forme circulaire de la

colonne à la forme rectangulaire de l'imposte. Il est orné de motifs végétaux travaillés en partie au trépan et en partie en champlevé. L'imposte, dont les faces sont ornées de motifs végétaux, est appliquée immédiatement sur le chapiteau. L'espace compris entre les décorations est rempli de stuc coloré en rouge, en marron et en noir, ce qui confère un aspect assez pittoresque au chapiteau. Les trois chapiteaux s'alignant sur le côté sud sont similaires par les dimensions, la forme et le mode de travail, cependant que le chapiteau sur le côté nord est plus petit, et lui-même, ainsi que l'imposte, présente quelques différences avec les trois autres. A en juger par le mode de travail, ces chapiteaux doivent dater du XIe siècle. Les impostes étant de surface plus réduite que les pieds des arcs qui y reposent, il en a été aménagé d'autres, décorées de feuilles, sur les côtés les plus étroits. Le besoin qui s'en est manifesté, la manière du travail effectué sans trépan, la forme et le motif décoratif révèlent qu'elles ne datent pas de la même époque que les chapiteaux et que ces derniers ont dû être recueillis ailleurs pour être utilisés dans cet édifice.

Sur les murs cubiques des façades est, ouest et nord, sont sculptés des motifs représentant une série d'animaux dans des scènes d'ensemble ou isolés. Sur le mur nord, on distingue, sur l'architrave de la niche servant aujourd'hui de porte, la représentation dégradée d'un chien et d'un sanglier. Entre eux, se dresse un arbre, et l'attitude des deux bêtes laisse entendre qu'il s'agit d'une scène de chasse. Sur la face ouest, est représentée une autre scène avec un arbre au milieu et un chien qui semble poursuivre un lion à visage d'homme. Sur le côté est, assurément pas à leur emplacement initial, on voit un aigle, deux dragons et un lion, une des plus expressives de ces sculptures. En ce qui concerne leur datation, divers avis ont été exprimés. Selon Ugolini, la scène de la façade nord daterait de la période romaine tandis que les autres appartiendraient à l'art byzantin de la même époque que celle de la construction de l'église. Versakis juge qu'elles sont grecques ou romaines, enlevées de quelque autel de sacrifices d'animaux à Phoinike. Puzanova et Dhamo estiment, pour leur part, qu'elles sont d'inspiration paléo-chrétienne. A notre sens, toutes ces sculptures datent de l'époque de la construction de l'église, quand une troisième vague d'influences orientales traversait l'art byzantin en sculpture, et qu'un grand nombre d'animaux et de monstres étaient sculptés sur les façades des églises. La manière du travail et la forme de parallélépipède droit des pierres, identique à toutes les autres, militent en faveur de cette thèse.

L'examen de ce monument nous donne un tableau assez clair des transformations qu'il a subies dans le temps. Néanmoins, nous ne sommes pas en mesure de déterminer sa forme initiale et, sous cet aspect, demeurent à définir la forme du côté est de l'église, la forme et la grandeur du portail, ainsi qu'un assez grand nombre d'autres détails. Etant donné qu'une intervention à des fins de restauration porterait sans nul doute atteinte au monument et afin de ne pas endommager les parties qui en sont ensevelies, soit sous terre soit sous le nouveau pavement, ou encore recouvertes par les murages successifs, nous avons jugé opportun d'entreprendre une série de sondages dans les murs et sur le terrain environnant.

Afin de découvrir le support qui devait se trouver autrefois au milieu du naos, nous avons effectué des sondages sur le côté sud du pilier central. A quelque 50 cm de profondeur nous avons découvert un mur de briques bien travaillé, alors qu'à 86 cm. nous avons dégagé la colonne en marbre sur laquelle devaient s'appuyer autrefois les arcs des coupoles. Il semble que, par la suite, par crainte que la colonne ne suffise pas pour soutenir une si forte charge, on ait construit le pilier en briques puis, en 1793 le grand pilier, comme il apparait de l'inscription empreinte sur une brique.

Afin de certifier la présence du portail et sa forme, nous avons déblayé une partie du terrain près des murs. Le sol du portique qui entourait l'église sur trois côtés, était dallé de pierres tout comme celui du naos. On descendait à celui-ci par une marche formée d'une dalle de pierre qui saille sous les murs. Il était bordé par

DO NOT COPY

DOWNLOAD

des arcades reposant sur des piliers. Les fragments de 5 de ceux-ci ont été retrouvés sur le côté nord. Les piliers étaient de forme diverse, construits en briques et en moellons selon une technique identique à celles des murs latéraux. Deux d'entre eux sont plus grands, à la base en forme de croix et ils englobent sur leurs côtés les colonnes à base rectangulaire qui s'élèvent du sol de ce côté. Il semble que, entre eux, s'ouvrait l'entrée principale du portique, qui fait face à la porte principale de la façade nord. Sur ces deux piliers et sur deux autres qui flanquent la porte et dont on a retrouvé la partie inférieure intacte, s'élevait la voûte perpendiculaire au mur.

Au coin sud-est du portique nous avons retrouvé les vestiges d'une abside qui a dû servir d'autel secondaire. A en juger par les matériaux employés et la technique de construction, elle dut être construite postérieurement, mais en tout état de cause avant l'occupation turque.

Sur le sol de l'aile nord du portique subsistait un pan de mosaïque légèrement dégradé, figurant 4 coqs et une espèce de récipient dont on ne distingue pas bien la nature. Leur motif nous parait similaire à celui qui, selon Versakis, devait se trouver autrefois dans le naos. Comme on le voit, leur dessin est schématique, mais non dépourvu d'élégance.

Ce qui était plus important pour nous, c'était de découvrir la forme initiale de l'espace réservé à l'autel. Des sondages effectués dans le nouvel espace qui lui était réservé et hors du mur est, il ressort que celui-ci se terminait autrefois par deux absides, qu'il comportait donc deux choeurs. Nous avons dégagé les fondations des anciens murs de sous le nouveau pavement et en dehors du nouveau mur est, qui fut construit en donnant au nouvel espace destiné à l'autel le volume du narthex. Les deux anciens choeurs étaient séparés par un mur qui aboutissait, à l'ouest, à une rangée de piliers latéraux de la nouvelle arcade conduisant du naos à l'autel, et elles communiquaient entre elles par une ouverture aménagée dans ce mur de séparation. Ainsi l'ancien choeur apparaît symétrique, terminé par deux absides, ce qui donne au naos la forme d'une double nef. De dehors, les absides aboutissaient à un mur dont subsistent aujourd'hui les vestiges sous le niveau du sol mais dans un état qui ne permet pas de déterminer le nombre de faces des anciennes absides.

Des résultats des autres sondages, citons seulement la découverte dans le mur sud d'une fenêtre double séparée par une colonne de marbre et surmontée d'un chapiteau. Les vitres en sont rondes et fixées dans une mince armature faite essentiellement de chaux.

Les autres fenêtres semblent avoir été du même type.

Ce n'est qu'à la suite de ces sondages que nous avons été en mesure de tenter une reconstruction hypothétique de l'église de Mesopotame. L'église se compose du narthex, surmonté de trois calottes sphériques, du naos séparé par les colonnes du milieu en deux nefs couvertes de quatre coupoles et de l'endroit réservé à l'autel formé de deux choeurs et de deux espaces surmontés de voûtes cylindriques. Sur les trois côtés, l'église est entourée par un portique ouvert dout les arcades reposent sur des piliers.

Le monument en question constitue un type particulier, à notre connaissance, qui, par ses dimensions et la qualité de son exécution, répond à une conception déterminée. Il n'est pas le fait du haspard, ni, comme le pense Ducellier, le résultat de l'assimilation incomplète du type de la croix inscrite. Les exigences qui ont conduit à une telle conception architecturale sont de trois ordres: fonctionnel, constructif et enfin esthétique. Ces exigences conjuguées, ou celles d'un certain ordre en particulier, ont conduit à cette solution. L'objectif étant apparemment de réaliser un grand naos carré et un espace intérieur relativiment plus dégagé que dans les églises en forme de croix, la seule solution pouvant satisfaire à ces exigences était le type à coupole sur trompes d'angle, laquelle aurait obligatoirement nécessité une coupole qui, du fait des dimensions du naos (9, 30 x 9,30), ne pouvait être supportée par la structure même. Les petites coupoles, par contre, ayant toujours été facilement

DO NOT COPY

réalisables par les bâtisseurs byzantins, c'est cette dernière solution qui fut adoptée, avec l'établissement d'un pilier central.

Conçu avec un tel propos fonctionnel et des volumes, le monument présente une certaine unité et son espace intérieur est un trait propre à l'architecture byzantine. En dépit de la présence d'un axe longitudinal, qui ne prédomine cependant pas, du fait de l'extension de l'espace dans le sens de l'autre nef et de l'axe vertical, les constructeurs se sont employés à compenser l'extension unilatérale dans la direction de l'autre nef, en étendant l'espace intérieur par le percement d'une série de portes et de fenêtres. D'autre part, on s'est efforcé d'amoindrir la masse de la colonne intérieure en élevant assez haut les arcs qui supportent les coupoles.

Par la complexité même des volumes, l'espace intérieur n'est pas statique. Dès le narthex, qui, pour être précis est un endonarthex, à travers l'arcade naos-narthex, on est pris dans l'espace du naos, qui s'articule avec celui du narthex. Dans le naos, on est poussé au mouvement, incité à éprouver une expérience d'ordre spatial, qui, à chaque point du naos, est diverse (la position des colonnes, du pilier central et des coupoles varie, ces dernières, plus élevées que les premières, accentuant l'impression de hauteur). Assurément, l'impression de l'espace intérieur était-elle accentuée par les peintures murales qui couvraient les murs et portaient presque sur le même plan les différents parois latérales, ainsi que par la lumière diffuse qui se déversait d'en haut à travers les coupoles et les fenêtres latérales, à tous les niveaux.

Nous pensons que, même s'il n'est pas le résultat des exigences esthétiques propres à l'époque des Paléologues, qui visaient à revaloriser l'Antiquité, et les modèles plus anciens, exigences conditionnées ici par le niveau et les moyens techniques de l'époque, le monument offre toutes les caractéristiques de l'architecture byzantine.

L'église, par son volume en forme de pyramide, se dressant surtout en hauteur, et même par ses coupoles, les postérieures étant plus élevées que les antérieures, n'était pas moins réussie sous son apect extérieur, qui était tout à fait différent de sa physionomie actuelle.

Les traits caractéristiques de ce monument sont la symétrie, les corniches rectilignes tant des portiques que, plus haut, des murs latéraux et des coupoles, et les calottes sphériques qui surmontent le narthex, formes relativement rares dans les provinces. D'autre part, les provinces avaient pour trait la tendance au pittoresque, réalisé ici par les façades en briques et en pierres, le contraste entre le gris et le rouge, les ornements en briques des corniches, des frises des fenêtres et la disposition désinvolte de celles-ci dont les arcs sont interrompus par les frises. Le cloisonnage également, qui peut sembler irrégulier et primitif, mais qui, par le mode d'exécution – il suffit de mentionner les joints, – nous convainc du contraire, contribue au pittoresque. Dans l'ensemble, tous les travaux, la maçonnerie, fût-elle de pierres ou décorée de motifs de briques, les sculptures, les mosaïques, le sol et les autres détails, témoignent d'un bon niveau de construction.

Considéré dans son état actuel, ce monument a été jugé primitif et dans une certaine mesure cela a concouru à accréditer la légende selon laquelle il aurait été construit à l'époque de Constantin IX Monomaque (1042-1054). Mais une série de données que nous avons énoncées au cours de cet exposé, nous font considérer cette thèse avec réserve et rattacher la légende à la fondation du monastère auprès de l'ancienne ville de Mesopotame et éventuellement à la construction d'une église plus ancienne à l'intérieur de ce monastère. Le plan lui-même de l'édifice, et en particulier le portique qui se présente ainsi comme la phase finale des diverses formes que l'on rencontre à Constantinople et à Salonique, principalement aux XIIe et XIIIe siècles semblent appuyer cette thèse. De même les chapiteaux caractéristiques du XIe siècle, reproduits ici, ainsi que la manière pittoresque dont sont traitées les surfaces extérieures à travers une riche décoration céramique et plastique, carastéristiques des XIIIe et XIVe siècles.

A notre sens, les XIIIe et XIVe siècles sont une époque possible de construction

de ce monument et, indépendamment de la longue durée probable des travaux le monument date tout entier d'une même époque. Nous pourrions nous permettre une datation plus précise si nous admettons que trois fleurs de lys figurant sur l sol du narthex sont les armes des Anjou. Ce n'est là qu'une simple hypothèse les fleur de lys des armes des Anjou étant diposées différemment. Dans ce cas, l'époque de l construction de cette église se situerait entre 1272 et 1286, lorsque les Anjou détenaien le territoire compris entre Durrës et Buthrint, proche de Mesopotame. Cela pourrai expliquer aussi la forme particulière de l'église avec ses deux absides, et, en consé quence, les deux autels, ce qui serait justifié par la présence à l'époque de deu églises sur la côte orientale de l'Adriatique. Quoi qu'il en soit, la confirmation de cette hypothèse serait intéressante et résoudrait tant le problème de la datation de l'église que celui de son plan, unique en son genre.

Appréciant la valeur de ce monument, nous pensons qu'une série de travaux y sont nécessaires. Toutefois, en raison des importantes modifications qu'il a subies, il est impossible de faire recouvrer au monument son aspect d'antan, à l'intérieur comme à l'extérieur. Le portique, le choeur, certaines parties des coupoles sont pour nous des éléments perdus à jamais, dont le retour à l'état antérieur semble douteux.

Aussi, comme premières mesures de conservation et de restauration, proposons-nous de déblayer le portique, pour avoir une idée de ses dimensions premières; de dégager les anciens murs dans le choeur, de débarrasser les fenêtres murées de leur nouveau revêtement pour en relever les formes et les éléments anciens, de décaper le nouveau revêtement des portes murées et de débarrasser le naos des cloisons en bois sans aucune valeur et qui ne font que le rapetisser.

Ces mesures permettraient de rediscerner les parties dissimulées du monument pour pouvoir le refigurer dans ses dimensions antérieurs et être ainsi à même d'en bien apprécier la valeur et l'importance, non seulement pour l'histoire de l'architecture byzantine dans notre pays, mais aussi pour l'architecture byzantine en général, dans laquelle, à défaut de ces premiers travaux, il n'a pas encore pris la place qui lui revient.

DO NOT COPY

Stilian ADHAMI

DO NOT COPY

TË DHËNA RRETH FIZIONOMISË URBANISTIKE DHE ARKITEKTONIKE TË QYTETIT MESJETAR TË VOSKOPOJËS

Studimi i zhvillimit ekonomik, shoqëror e kulturor të qytetit mesjetar të Voskopojës, i fizionomisë urbanistike dhe arkitektonike të tij, si qendër administrative, prodhimi e tregëtie, paraqet interes si për rëndësinë dhe peshën specifike që Voskopoja pati në të kaluarën, ashtu edhe për trashëgiminë e pasur në lëmin e kulturës materiale, që ruhet ende në ditët tona në këtë qendër historike.

Si pasojë e një sërë faktorësh me karakter ekonomiko-natyror dhe politiko-shoqëror, Voskopoja njohu një zhvillim relativisht të shpejtë të forcave prodhonjëse, duke arritur kulmin e zhvillimit të saj të gjithanshëm në shekullin XVIII. Jehona e këtij qyteti, me kolegjin «Akademia e re» dhe me shtypshkronjën e vet, me zhvillimin e zejtarisë e të tregëtisë dhe me marrëdhëniet edhe me botën e jashtme, me figurat e shquara në shkencë, letërsi e art dhe me kulturën materiale mjaft të rëndësishme, i kapërceu kufijt e vëndit tone; prandaj, me të drejtë, Voskopoja ka tërhequr me kohë vemendjen e studjozeve dhe të udhetareve te ndryshëm, të huaj dhe vendas, që i kanë kushtuar asaj një literature të pasur.

Ndër autorët e parë, prej të cilëve kemi disa shënime rreth Voskopojës, vlen të përmënden Pukëvili [1]) dhe Liku [2]), që e kanë vizituar këtë qytet, pasi kishin kaluar rreth tri dekada nga koha e shkatërrimit të parë të tij. Shënime të dobishme na kanë lënë gjithashtu në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar edhe Hahni, Meyeri, Vaigandi, etj. Kontribut me vlerë historike për Voskopojën kanë dhënë një sërë autorësh shqiptarë me botimet e tyre të veçanta apo artikuj e dorëshkrime, që prej vitit 1888 e këtej, si H. Karmici, I. Dasareti, K. Skënderi, E. Kurila, J. Martiniani, I. M. Qafëzezi, V. Puzanova, Th. Popa, [3]) etj. Me aspekte e probleme të ndryshme të Voskopojës janë

1) F. C. Pouqueville, **Voyage dans la Grèce,** Paris 1826, II, lib. 6, 329, 330

2) W. Leake, **Travels in Northein Greece,** London 1835, f. 343.

3) H. Karmitsi, **Geografia tis Koritsas kai tis perioihidos,** Selanik 1888; I Dassaritou, **Peri tis Koritsas.** Në Deltio tis istorikis kai ethnografikis etaireias tis Ellados», V. 1896, 123 e vij. K. Skënderi, **Istoria tis arhaias kai syghronou Moshopoleos,** Athinë 1960, 1928; E. Kourila Labriotou, *I. Moshopolis kai i nea Akadimeia autis...*, Athinë 1935, **Grigorias o Argirokastritis.... Epimetron i istoria tis Moshopoleos kai i politismos autis,** Athinë 1935; I. Martinianou, **Symbolai eis tin istoria tis Moshopoleos....** Athinë 1939, **I. Moshopolis 1339-1930.** Botuës Stilpon Kiriakidhi, Selanik 1957; I. M. Qafëzezi për herë të parë me historin e Voskopojës është marrur me një artikull të botuar në dy numra të revistës «Minerva» në Dhjetor 1933 me titull «Voskopoja e vjetërë». Për punimet e tjera të mëvonëshme shih: **Bul. Shk. Shoq.** n. 3 — 1954, 141-142; V. Puzanova, **Shënime mbi artin shqiptar të shek. XVIII** në B.U.SH.T. Seria Shk. Shoq. n. 1(3) 1957, 44-61: **Prapë mbi artin shqiptar të shek. XVIII në B.U.SH.T.** Seria Shk. Shoq. n. 2, 1958, 152-158; **Voskopoja, Onufri nga Neokastra, Shpati dhe Berati,** drsh. në Inst. H.GJ. G. 1. 10; Th. Popa, **Piktorët Korçarë Kostandin dhe Athanas Zografi dhe freskat e tyre në skenat e Apokalinsit** në B.U.SH.T. Seria Shk. Shoq. n. 1, 1959, 23-48; **Mbishkrime dhe piktura në Katedralen «Fjetja e Shën-Mërisë» në Voskopojë,** në B.U.S.H.T. Seria Shk. Shoq. n. 3, 1962, 76-106 etj.

marrë edhe disa autorë ballkanas, siç janë rumunët Gj. Roza, Gj. Alexisi, P. e V. Papahagi, Th. Capidan, V. Papacostea, grekët Dh. e G. «Dhimitrienjtë», K. M. Kumas, K. Saqellariu, N. A. Guda, F. Mihallopullo [4]) etj.

Por, megjithë këtë varg të gjatë botimesh, studimesh e përshkrimesh, që i janë kushtuar këtij qyteti mesjetar, apo që e cekin atë kalimthi, të dhënat përsa i përket fizionomisë urbanistike, shtrirjes dhe zhvillimit të tij, si edhe arkitekturës së ndërtimeve qytetare në procesin e evolucionit të tyre, janë të pakta. Me përjashtim të Martinianit, Mihallopullos dhe Qafëzezit, që këto aspekte i kanë trajtuar pjesërisht, nga autorët e tjerë probleme të tilla nuk janë trajtuar fare ose janë prekur cektas e në mënyrë krejt fragmentare. Në këtë punim do të orvatemi të trajtojmë pikërisht disa aspekte që kanë të bëjnë me fizionominë urbanistike dhe arkitektonike të këtij qyteti, veçanërisht atë të shekullit XVIII, të kulmit të lulëzimit të tij, natyrisht për aq sa na lejojnë kushtet e sotme, kur qyteti i dikurshëm prej kohe është kthyer në gërmadha.



Fig. 1

DO NOT COPY

4) G. K. Rosa, **Untersuchungen uber die Romanien...,** Buda-Pesta, 1808; G. Alxici, **Macedoromanii,** në «Converbiri literare» V. XXXVII, 950 e vij., P. Papahagi, **Scritorii Aromani in sec. XVIII,** Bucuresti 1909; V. Papahagi, **Aromanii moscopoleni si comertul venetian in secolele al XVII — leasi al XVII — lea,** Bucuresti 1935; Th. Capidan, **Farserotii, Studiu linguistic asupra Romanilor din Albania,** Bucuresti 1931; V. Papacostea, **Theodor Anastasie Cavalioti, Trei manuscrisse,** Bucuresti 1931; D. Ieromonaku — G. Ieremonaku, **Geografia.....** Tom I, Wien, 1791; K. M. Koumas, **Istoria ton anthropinon prakseon apo ton arhaiotaton hronon eos ton imeron mas,** Wien XII, 1832; K. Sakellaridou, **Peri Moshopoleos.** «Pandora», IX, Athinë 1859, 44, N. A. Gouda, **Bioi paralliloi,** IV, Athinë 1871; F. Mihallopoullou, **Moshopolis. Ai Athinai tis tourkokratias 1500-1769,** Athinë 1941.

5) Me këtë rast falnderoj pleqtë më të moçëm të fshatit, Sandri Bano dhe Dhimitri Baba, si dhe arsimtarin e vjetër të Voskopojës Dhori Fallo, që m'u vunë disa herë në dispozicion dhe më ndihmuan me të dhëna informative të dobishme.

Si rezultat i gjurmimeve tona të herëpasherëshme në vënd, i grumbullimit të të dhënave informative [5]) dhe i shfrytëzimit në mënyrë kritike të burimeve bibliografike ekzistuese, midis të tjerash, do të japim një planimetri të përafërt të shtrirjes së dikurshme të qytetit me lagjet e vjetra të tij, duke korektuar e saktësuar të dhënat e deritanishme lidhur me popullatën e tij maksimale dhe do të synojmë në lokalizimin e monumenteve të shumtë të qytetit, prej të cilëve na janë ruajtur vetëm një pjesë e vogël. Qëllimi ynë është që të hedhim sadopak dritë mbi fizionominë dhe karakterin e këtij qyteti të rëndësishëm mesjetar, sot fshat i vogël, për të kontribuar në studimin e mëtejshëm të kësaj qendre historike.

* * *

Voskopoja (fig. 1) ngrihet në një pllajë të lartë të Malësisë së Oparit, rreth 1200 m. mbi nivelin e detit, 24 km. në P. të Korçës, mbi rrugën Korçë-Berat. Ajo shtrihet në një luginë të vogël, me drejtim jugë-veri, me gjatësi rreth 3 km dhe gjerësi 2 km, në trajtë katërkëndëshi, e rrethuar nga të tri anët me kodra [6]). Ambienti rrethues, kodrinor e malor, ka gërshetime të shumta; diku kodrat janë të larta shkëmbore e diku zbuten në kodrina deri në fushën e Korçës. Nga ana veriore Voskopoja kufizohet me një varg të gjatë pyjesh tërë pisha, nga VP me Çukën e Belloit, nga P me një sërë kodrash me emrat Kostamanda, [7]) Pasha Tepe ose Luadhi i Bellos, Peltek, bregu i Miho Nastos, nga J me malin e Çukës dhe Luadhet e Gjergjevicës, nga JL me Shkëmbin e Mustafallarit, kurse nga ana lindore me një varg kodrinash të buta e pllaja të degëzuara, midis të cilave kalon xhadeja e Korçës. Pikërisht lugina që hapet në drejtimin lindor përbën dhe të vetmen hyrje natyrore për Voskopojën. Që nga pozita e lartë e kodrave të Shën-Prodhromit duken majat e maleve të Lenies, të pasura me lëndë druri, majat e Ostrovicës ku verojnë bagëtitë dhe, më tutje, ato të Tomorit.

Luginën e Voskopojës e përshkojnë tre përrenj, që kanë ujë vazhdimisht dhe që e ndajnë këtë rrafshnaltë në tri pjesë: përroi i Zhombrit ose i Gjergjevicës apo i Shën-Harallambit, që duke rrjedhur nga kullat e Gjergjevicës kalon nga J në V, përroi i Strugut [8]), që përshkon Voskopojën nga P në V, dhe përroi i Peltekut ose i Poshtenikës apo i Shëndëllisë, i cili rrjedh nga një pjesë e Kostamandës dhe drejtohet po ashtu nga P në V. Që të tre këta përrenj derdhen në lumin Azo të Voskopojës, i cili, duke i kaluar anash Voskopojës në pjesën e poshtëme nga L në VP, pasi bashkohet me përruan e Shipckës dhe, më tej, në Pulahë, me lumin e Oparit, derdhet në Devoll në P të Gjinikasit pranë fshatit Nikollarë.

Pozita natyrore e favorshme në thellësi të maleve, jo larg artereve të mëdha të komunikacionit, e kësaj rrafshnalte të mbrojtur nga korrentet e ftohta, e përshtatshme për t'u mbrojtur edhe nga sulmet e kundërshtarëve, me ujra të bollshme dhe lugina disi pjellore e livadhe të gjelbëruara, ka ndikuar për ta bërë Voskopojën një vendbanim me mundësi zhvillimi pak a shumë të qetë dhe pa ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të pushtuesve turq. Në sajë të këtyre kushteve Voskopoja ka qënë përherë një nga vendet më klimaterike e turistike të Shqipërisë jugore. Voskopoja ka qënë kryevend i malësisë së Oparit. Prodhimet bujqësore të saj kanë qënë të pakta, por, falë kullotave të shumta, ka pasur mjaft prodhime blegtorale.

Një ndër çështjet e pakthjelluara ende mirë për Voskopojën është ajo e fillimeve të saj. Legjendat dhe mendimet mbi themelimin e vendbanimit janë të ndryshme dhe të dhëna të dokumentuara plotësisht nuk ka. Sidoqoftë, sot për sot, me që nuk i kemi vënë vetes për detyrë zgjidhjen e këtij problemi, të cilin do ta trajtojmë në një studim të

6) Në një shënim të tij të v. 1931 prof. Andon Qeramopullo thotë se pllaja e vogël mbi të cilën ka qënë ngrehur qyteti-gërmadhë paraqet pamjen madhështore të një «castrum-i» romak. (Martiniani — **Moshopolis 1330-1930,** Selanik 1957, 36-37; I. M. Qafëzezi — **Historia e qytetit Voskopoje....** (drsh).

7) Martiniani **(vep e cit.** 7) e shënon emrin e kësai kodre të lartë me trajtën «Koestu al Manduka» (Koastë — vllahisht: brinjë mali; Manduka — mbiemri i dijetarit voskopojar Dhionis Manduka, mitropolit i Kosturit (1648-1714) Prof. Th. Capidan e shënon po këtë trajtë si emër njeriu «Cesti al Manduca», ndërsa nga goja e vetë voskopojarëve kemi dëgjuar të quhet Kostamanda.

8) Quhet kështu nga që ujët e Strugut vjen rrëmbyer.

9) P. Aravantinou, **Monografia peri koutsovlahon, Ed. Tip. katastimaton Ipirid. Koysylinou,** Athinë 1905, 43-45; I. assaritou, **vep e cit.** V (1900), 153, sh. 56; N. D. N., **Korça dhe fshatrat përqark,** Sofie 1901, 50; T. Selenica, **Shqipëria më 1927,** 316; K. Skënderi, **vep. e cit.,** Athinë 1928, 8-9; I. Martinianou. **Symbolai...,** 31; I Moshopolis..., 35, **«Drithi»** n. 4-14, 1940, 34-35; I. M. Qafëzezi **Historia e qytetit Voskopojë apo Vockëpojë** (drsh), 17-20.

veçantë, ne bashkohemi me rezervë me mendimin mbizotërues se fillimet e para të ndërtimit të Voskopojës të paktën duhen kërkuar aty nga shek. XIV [9]), në mos më parë. Historia e saj para shekullit XIV është krejt e errët, për deri sa asnjë nga autorët e vjetër nuk e përmënd atë dhe, për më tepër, të dhënat arkeologjike heshtin në këtë drejtim.

Vetëm nëpërmjet vëzhgimit të rrënojave të shumta të këtij qyteti-gërmadhë, të burimeve të shkruara si dhe të analizës së kulturës materiale ne mund të vihemi në gjëndje të përfytyrojmë atë ç'ka qënë ajo në fillim, të shohim rrugën që ka ndjekur shtrirja urbanistike e qytetit, cilat kanë qënë lagjet e para, ç'arkitekturë është përdorur për ndërtimet e ndryshme, etj.

Ka shumë të ngjarë që bërthama fillestare e fshatit ta ketë pasur zanafillën me kasollet e para aty nga ana veriore e rrafshnaltës së Voskopojës, afërsisht në vendin ku është ndërtuar kisha e Shënapremtes dhe përreth saj, e cila konsiderohet më e vjetra e kësaj qendre dhe bashkëmoshatare me të. Një tezë e tillë është hedhur dhe mbrojtur nga autorë të ndryshëm, [10]) por gjen mbështetje edhe në traditën gojore. Në të mirë të saj flasin edhe varrezat e vjetra, apo ndonjë mbeturinë gërmadhash që vërehet aty-këtu që nga gropa e pllajës pranë Gurit të Babës, nga ana VP e Shënapremtes, e deri në zonën VL të kësaj kishe. Është fjala për ngulimet e banorëve të parë në këtë truall, qofshin këta barinj endacakë, që sipas traditës [11]) u vendosën aty dhe ndoshta i dhanë emrin Voskopojës (nga profesioni i tyre = fusha e barinjve), qofshin këta të shpërngulur nga vendbanimi më i afërt, Voskopi i braktisur. [12]).

Në shek. XV ka mundësi që Voskopoja të ketë qënë një farë qendre urbane deri diku e populluar dhe e dëgjuar për deri sa, siç na kumton Hahni dhe ndonjë autor tjetër, me zaptimin e Stambollit nga Turqit më 1453, mjaft intelektualë refugjatë shkuan e u vendosën në Voskopojë. [13])

Gjithashtu siç pranojnë dhe Kostandai, Aravantinoi, Saqellaridhi, Vutirai etj. e së fundi Mihallopullo, një rritje e dukëshme e popullatës së Voskopojës duhet të jetë bërë gjatë shek. XVI mbas nënshtrimit të Shqipërisë nga turqit, atëhere kur, me ndalimin e lëvizjes së popullsisë në ato vise, siç shprehet dhe Hekarti [14]), shumë fise endacake të kucovllehëve dhe të sarakaçanëve u detyruan të nguliteshin diku dhe të krijonin vendbanime të vogla, zakonisht nëpër vise malore ku veronin me bagëtitë e tyre. Popullsia e saj rritej vazhdimisht me banorë që vinin aty për të shpëtuar nga ndjekjet e pushtuesve turq dhe, më pas, për t'i shpëtuar islamizimit, mbasi pozita e Voskopojës midis maleve ishte më e fshehur. Duke qënë ajo në brendësi të vendit, në një zonë malore, për një kohë nuk u ndie drejtpërdrejtë pesha e rëndë e feudalizmit ushtarak shkatërrimtar turk.

Si rezultat i rritjes së popullatës nga shtesat natyrore dhe ngulimet e reja të të ardhurve, me kalimin e kohës, fshati u shtri në drejtim jug-perëndim nga vëndi i origjinës, duke u bërë dalngadalë një fshat i madh, që merrej kryesisht me blegtori dhe pak me bujqësi. Kështu filluan të lindin lagjet e para, si ajo e Sarzës (ose Shën-Mërisë apo Mitropolisë), lagja Rue (ose e Shën-Kollit) dhe e Skamnelit (ose e Shën-Thanasit), emrat e të cilave figurojnë gjatë shek. XVII në kodikun e Shën-Prodhromit, kodik që është botuar nga I. Martiniani më 1939 (d.m.th. para djegjes së vitit 1943 që pësoi manastiri, kur u zhduk edhe kodiku) dhe që është parë edhe nga G. Vaigandi në v. 1889. Sipas këtij

10) C. N. Burileanu, **I romeni di Albania,** Bologna 1912, v. I, 128; J. Martiniani, **I. Moskopolis....,** 73. V. Puzanova thotë se prej kishës së Shënepremtes vetëm muri jugor i saj, ku ruhet sot e dëmtuar freska me vlerë artistike e shek. XIV, i përket ndërtimit fillestar të kësaj kishe, që është rindërtuar disa herë. **(«Voskopoja, Onufri nga Neokastra, Shpati dhe Berati»,** drsh. në Inst. H.GJ. G. 1, 10, 27-29; **«Shënime mbi artin shqiptar në shek. XVIII»,** në BUSHT, seria Shk. Shoq. n. (1) 3-1957).

11) Nga Grigos Kostandai kemi këtë shënim: **«Më parë nuk ekzistonte qyteti. Voskopojarët e kanë si traditë se kanë pas ekzistuar në fillim 16 kasolle barinjsh dhe nga kjo u quajt Voskopojë».** Edhe sot ndër të moshuarit voskopojarë ndihet e trashëguar brez pas brezi një gojëdhanë e tillë: **«Vendi ka qënë tërë ferra e gropa. Barinjtë vinin në verë këtu me kopetë e tyre dhe në dimër ktheheshin në Myzeqe; disa barinj qëndruan me bagëtitë e tyre dhe pasi prenë ferrat e kullumbritë, ngritën kasolle pranë Shënapremtes».**

12) W. M. Leake, **Travels in Northern Greece,** — Ed. J. Rodsvelt — London 1835, vol. I, 343. I. M. Qafëzezi, **Voskopoja e vjetër dhe rrebeshi i parë 1338-1769,** art. në rev. «Minerva n. 16/1933-17/1934. K. Skënderi, **vep e cit.,** botim i 1928, 4; J. Martiniani, **vep. e cit.,** 10; V. Puzanova, **vep. e cit.,** Po aty.

13) G. Hahn, **Albanesische Studien,** Jena 1854, 296, krh. edhe: I. Dassaritou, **vep e cit.,** 123-158. E. Kurila, **Grigorios o Argirokastritis.....** 77-78; **«Ylli i Mëngjezit»,** art. «Fuqia e ndërgejgjes kombëtare e popullit shqiptar», 167.

14) Hecquard, Histoire et description de la Haute Albanie ou Guegarie, Paris 1858, 429.

FOTOCOPY

TAB. I

DO NOT COPY

QYTETI I VOSKOPOJES NE SHEK. XVIII



kodiku, në kohën e igumenëve Theodhos dhe Gavril (1660-1687) kanë marrë borxh prej tyre këto tri lagje të Voskopojës: Sarza, Rue dhe e Skamnelit [15]). Fakti që në këtë shekull ende nuk ishin ndërtuar këto kisha tregon se emrat fillestare të këtyre lagjeve me prejardhje nga emrat ose mbiemrat e kryetarëve të fiseve kanë qënë Sarza, Rue dhe Skamnelit (kjo e fundit nga emri i vendit të shpërnguljes) që, me kalimin e kohës, u harruan për t'u lënë vend emrave të kishave të ngritura nga secila lagje, sikundër shohim të emërtohen lagjet e ndërtuara më vonë me emrat e Shën-Mëhillit, Shën-Janit, Shëndëllisë, Shën-Pjetrit, Shën-Gjergjit, etj. Tri lagjet e para (Sarza, Rue, Skamnelit) përbënin pjesët qëndrore të qytezës dhe u bënë pikënisje për shtrirjen rreth tyre edhe të lagjeve të tjera dhe për zhvillimin e mëtejshëm të qytetit që nga bregu i Shënapremtes e deri në rrëzat e malit Kostamanda. Disa lagje e kanë marrë emrin nga përrenjtë me të njëjtin emër, si ajo e Strugut dhe e Zhombrit. Kjo e fundit është thirrur edhe lagje e Mecovës, sepse banorët e saj, si rrjedhim i grabitjeve, persekutimeve dhe presioneve për islamizim, dhe të tërhequr nga zhvillimi i artizanatit dhe tregëtisë, apo për arësye lidhjesh gjinie, qenë shpërngulur kryesisht nga Mecova e Epirit, ashtu siç ishin vendosur nga mesi i shek. XVII, të tërhequr nga të njëjtat arësye ose shkaqe të përafërta, edhe mjaft banorë nga Skamneli i Zagorit, duke krijuar kundrejt lagjeve fillestare nga ana veriperëndimore lagjen e Skamnelit (e Shën-Thanasit), që përmëndëm më sipër, apo aty më vonë, nga fillimi i shek. XVIII, prej Postenanit të Përmetit lagjen Postenika ose Postenanika në P të Skamnelit, matanë përroit me të njejtin emër [16]). Të tjera lagje më vonë kanë marrë emrat e familjeve të dëgjuara dhe të shtresave të pasura, si lagja e Xegës dhe ajo e Pasanikëve, teksa ajo e banorëve më të varfër, buzë lumit të Voskopojës, thirrej lagja Pezhu. Pas shek. XVIII, kur ngulime të reja populluan deridiku qytetin e shkatërruar gjatë periudhës 1769-1789, lagje të reja u krijuan me emrat e vendeve të prejardhjes, si lagja e Grabovarëve, Oparakëve etj.

Në literaturë [17]) përmëndet edhe një lagje me emrin Nalza, emërtuar kështu nga kryetari i fisit, por këtë nuk kemi mundur ta lokalizojmë.

Duke u mbështetur në argumentat që do të sjellim më poshtë, jemi të prirur të besojmë, se Voskopoja në shek. XVII, e sidomos gjatë gjysmës së dytë, arriti të merrte fizionominë e një qyteti dhe jo të një fshati të zakonshëm. [18])

a) Vetë zhvillimi urbanistik i këtij vëndbanimi, që në këtë kohë kishte arritur të ketë disa lagje duke thithur edhe banorë të ardhur nga anë të ndryshme, siç përmëndëm më lart rastin e lagjes së Skamnelit, flet në të mirë të kësaj teze. Përveç tri lagjeve që figurojnë në kodikun e Shën-Prodhro-



Fig. 2

15) G. Weigand, **Die Aromenen** — «Ethnogr. — Philolog. Hist. Untersuchungen», Ed. J. A., Barth. Leipzig, 1894-95, vol. I, 102-104; J. Martiniani, **Symbolai...**, 31-44; **I. Moshopolis...**, 76.

16) P. Aravantinos, **Hronografia tis Epeirou,** Athinë 1856, 35-36; J. Martiniani, **Symbolai...**, 76-77; K. Sakellaridhi, **vep e cit.;** F. Mihallopullo, **vep. e cit.;** K. Skënderi, **Vep. e cit.** Athinë 1906, 15. Në Mbishkrimin e kishës së Shën Thanasit, ku jepen emrat e pesë mjeshtërve që e ndërtuan atë, lokalizohet edhe rajoni ku u ndërtua kjo kishë, lagja e Skamnelit.

17) J. Martiniani, **vep. e cit.,** 73.

18) Krh: **Historia e Shqipërisë, I,** Tiranë 1959, 404-407.

19) V. Papahagi, **Aromanii moscopoleni.....,** 62; F. Mihallopullo, **vep. e cit.,** 10-11; J. Adami, **Historia e rrugëve të Shqipërisë** — Bulet. Inst. Shk. — Seria Shk. Shoq., V. VII, n. 3, 1958, Rrugët gjatë mesjetës, 33, I. M. Qafëzezi, **Historia e qytetit Korçë dhe e qarkut,** Drsh. në Muzeumin e Korçës, D. 47, 1851/115; **Historia e Shqipërisë,** I, Tiranë 1959 404-5; **Historia e letërsisë shqipe,** I, Tiranë 1959, 302; S. Naçi, **Çështje të çifligut feudal në Shqipëri në shekujt XVII-XVIII,** BUSHT, Seria Shk. Shoq. n. 3, 1960; C. Serban, **Le rôle économique des villes roumaines aux XVII et XVIII siècles dans le contexte de leurs relations avec l'Europe du sud-est,** në «Studia Balcanica», n. 3, 1970.

DO NOT COPY

mit, në burimet historiografike haset edhe lagja e Ilut (Shën-Mëhillit), pra është fjala për ekzistencën e të paktën 4 lagjeve në shek. XVII.

b) Voskopoja në shek. XVII kishte marrë pamjen e një qendre jo të papërfillëshme zejtare e tregëtare. Këtë e vërteton jo vetëm fakti që banorëve të shpërngulur nga vënde të tjera u ofroheshin kushte pune e jetese më të mirë, por edhe nga vetë marrëdhëniet tregëtare të kësaj qendre me qytete të tjerë të Shqipërisë, e për më tepër edhe me vënde të huaja, ku tregëtarët voskopojarë shisnin prodhime bujqësore, blegtorale e zejtare dhe blinin prodhime të industrisë evropiane. Këto marrëdhënie, megjithëse i shohim të dokumentuara vetëm nga fundi i shek. XVII (v. 1696 e këtej) nëpërmjet korespondencës tregëtare, sidomos me Venedikun, kishin marrë zhvillim gjatë shek. XVII [19]).

c) Fakti që përveç kishës së Shënepremtes, që ishte ngritur prej kohe, në gjysmën e parë të shek. XVII u ndërtua edhe manastiri i Shën-Prodhromit (v. 1632-34) dhe nga fundi i këtij shekulli hidhen themelet edhe të një kishe të madhe në trajtë bazilike (Kisha e Shën-Mërisë) dëshmon për karakter jo më të një fshati, por të një qendre urbane me popullatë pak a shumë të konsiderueshme. Tjetër burim, që hedh dritë *ex silentio* në përforcim të tezës sonë, përbëjnë tri kishat e tjera të mëdha të ndërtuara në Voskopojë nga fillimi i shek. XVIII e deri në v. 1724 (Kisha e Shën-Kollit, e Shën-Mëhillit dhe e Shën-Thanasit). Pavarësisht nga rritja e vrullëshme e qytetit në gjysmën e parë të shek. XVIII, do t'ishte jashtë llogjikës të pranohej, që urbanizimi i kësaj qendre është bërë i menjëhershëm.

Gjatë shek. XVIII, ose më mirë gjatë viteve 1700--1760, Voskopojën e shohim në kulmin e lulëzimit të saj. Ajo arriti të gëzonte, lidhur me administrimin e saj, një farë autonomie relative, ku rol të dorës së parë loznin esnafët dhe kryesitë e tyre. Sipas Hahnit në këtë kohë ajo ishte «*qyteti më i civilizuar në tërë Shqipërinë*».

As K. Skënderi dhe as J. Martiniani, që të dy Voskopojarë-oparakë dhe që i kanë kushtuar studime të veçanta Voskopojës, nuk na kanë dhënë një varg të plotë të lagjeve të vjetra që përfshinte qyteti në shek. XVIII dhe as që i kanë lokalizuar ato plotësisht. Kemi parasysh edhe botimin e fundit të Martinianit të vitit 1957. E. Kurila thotë se qyteti ishte ndarë në 6 lagje, kurse Velianiti i ngre këto në 12, por pa i emërtuar fare. Nga gjurmimet tona të zhvilluara jo vetëm mbi burimet bibliografike, por edhe në terren, duke shfrytëzuar edhe traditën gojore, për atë sa është e mundur, doli se Voskopoja në kohën e lulëzimit dhe të shtrirjes së saj maksimale përfshinte 14 lagje të mëdha e të vogla. Duke u mbështetur në traditën gojore, që ende ruan emrat e lagjeve sipas përrenjve që i ndajnë ato, në dokumentacionin e shkruar si edhe në vëzhgimet në vend të të gjitha rrënojave të qytetit gërmadhë, mundëm të hartonim një skemë thuajse të saktë të shtrirjes urbanistike të qytetit të Voskopojës në shek. XVIII me kufitë e përafërta të lagjeve të vjetra. (Tab. 1). Nga të 14 lagjet e dikurshme na rezulton se 6 ishin lagjet krye-



Fig. 3



Fig. 4

DO NOT COPY

sore dhe më të organizuarat, në 4 zona të mëdha të ndara nga të tre përrenjtë që përshkojnë qytetin. Voskopoja në kulmin e zgjerimit të saj arriti të shtrihej në një sipërfaqe rreth 180 ha, me një perimetër të përafërt me 6 km. Nuk na rezulton të kemi të bëjmë me një qytet të fortifikuar; për këtë dëshmon edhe mungesa e gjurmëve të mureve rrethuese.

Duke trajtuar zhvillimin urbanistik të qytetit, nuk mund të mos ndalemi për të bërë një periodizim të shkurtër të rrugës së përshkuar prej tij gjatë shekujve:

Periudha e parë, që nga themelimi (shek. 14--16), i përket kohës kur nga një fshat i vogël me pak kasolle, dalëngadalë, Voskopoja rritet për të marrë në të ardhmen fizionominë e një qyteti, pra i takon periudhës kur ajo ende ka ruajtur karakterin e saj blegtoral të një fshati të madh. Si i tillë, edhe zhvilimi urbanistik, i njejtë si kudo në qendrat e ngulimeve të barinjve, pa dyshim i është përshtatur nevojave krejt baritore e blegtorale [20]).

Periudha e dytë, që ne po trajtojmë, është ajo e zhvillimit dhe e lulëzimit të Voskopojës si qytet (nga shek. XVII deri në dekadën e shtatë të shek. XVIII), kur me zhvillimin e artizanatit dhe të tregëtisë dhe me përparimin e madh arësimor, kulturor dhe artistik, edhe urbanistika e qytetit konceptohet në një mënyrë më të avancuar për kohën. Voskopoja rradhitet ndër qytetet e mëdhenj të vëndit tonë, me lagje të shumta, me tregje jo vetëm me krahinat fqinjë të Shqipërisë së jugut dhe asaj të mesme, si dhe me vise të tjerë të Perandorisë Turke, por edhe me vise të Evropës jugore, qendrore e lindore.

Periudha e tretë, do të ishte koha që shkon nga viti 1769 deri në vitin 1916, kur Voskopoja pëson tri shkatërrime me rradhë dhe, me gjithë periudhat e shkurtëra të disa rimëkëmbjeve të përkohshme, më 1916 mori fund si qytet.

Nga pikëpamja urbanistike, siç pasqyrohet nëpër disa gravura të shek. XVIII (fig. 2) dhe ndonjë fotografi të fundit të shekullit të kaluar, siç tregojnë rrënojat dhe relievi, qyteti i dikurshëm i periudhës së lulëzimit të vet ka qënë ndërtuar në taraca me tri shkallëzime të njëpasnjëshme, të ndërprera si zona nga përrenjtë që i përshkojnë.



Fig. 5

Nga burimet historike del se lidhjet midis zonave kryesore të qytetit bëheshin nëpërmjet një sërë urash të mëdha e të vogëla. Duke filluar nga hyrja e qytetit, lagja e Zhombrit lidhej me lagjet Sarza e Rue nëpërmjet 4 urave mbi përruan e Zhombrit. Kjo pjesë e qytetit, që ishte dhe qendra e tij, lidhej me pjesën e tretë, d.m.th. me lagjet e Skamnelit dhe të Shën-Janit, me anën e 7 urave mbi përruan e Strugut, dhe kjo përsëri lidhej nëpërmjet 4 urave me lagjen e fundit, atë të Postenikës. Prej të gjitha këtyre urave, përveç urës së madhe mbi lumin e Voskopojës (fig. 3), që është rindërtuar nga fundi i shekullit të kaluar, gjënden vetëm dy ura të vogëla të asaj kohe mbi përruan e Strugut, njera më e madhe gjatë rrugës për Shëndëlli, e ashtuquajtura rruga e Beratit (fig. 4), dhe tjetra më e vogël që lidh lagjen Sarza me atë të Shën-Janit, ku shtrihet dhe zona e ndërtimeve kulturalo-arësimore. Të dy urat e vjetra kanë hapësirë drite, njera 4 m dhe tjetra 3 m, janë me shpatulla anësore të ndërtuara me muraturë guri të skuadruar, të palidhur me llaç. Që të dyja kanë të njëjtën zgjidhje konstruktive. Pjesa e kalimit, e ndërtuar me konstruksion druri me gje-

20) Krh. F. Mihallopullo, **vep e cit.,** 7-11.

21) **«Qyteti i ndërtuar në pllajë mali, mbi shtatë kodra, për mungesë vëndi ishte populluar dëndur, kishte rrugë të ngushta, siç shihet nga ndërtesat e mbetura dhe gërmadhat që i ndajnë rrugët e ngushta, kështu që rrallë, për të mos thënë kurrë, shihnin dritën e diellit, sepse strehët e gjera të dala shumë jashtë asnjë herë nuk lejonin kalimin e rrezeve të diellit** (K. Skënderi, **vep. e cit.,** 11).

22) Gojëdhana thotë se **«strehët e shtëpive kanë qënë të ngjitura me njera-tjetrën, sa që thuhet se një kec i humbur ka qëndruar dy javë në çati».** Gojëdhana analoge qarkullojnë edhe nëpër qytete të tjerë, për të treguar dëndësinë e ndërtesave dhe madhësinë e dikurshme të këtyre qyteteve.

BOTIMI

rësi rreth 2,5-3,5 m pa qemer, është kushtëzuar nga konditat e terrenit dhe ngushtica e përroit. Tek ura më e madhe me lartësi të pjesës së kalimit mbi nivelin e ujit rreth 3 m, vihet nëpërmjet një rruge të shtruar mirë me kalldrëm dhe të përkufizuar anash me gurë të mëdhenj.

Një rrjet i gjerë rrugësh e rrugicash me kalldrëm përshkonte tërë qytetin. Këto në përgjithësi kanë qënë të ngushta dhe luhateshin nga 1.5 m deri në 2.5 m. Të tilla ndeshen pjesërisht nëpër disa lagje, sidomos në lagjet e Shën-Pjetrit, të Shëndëllisë dhe të Shën-Janit, ku gërmadhat e ndërtesave kanë ngelur deri diku të paprekura, gjë që s'ndodh nëpër lagje të tjera, ku janë hapur toka buke ose janë tërhequr gurë apo janë bërë ndërtime të ndryshme mbi to, dhe sot pas 200 vjetësh prej shkretimit të parë të qytetit, ne i shohim rrënojat vetëm në pirgje të mëdhenj gurësh. Gjurmë kalldrëmesh të rrugëve të vjetra të qytetit ndeshen të ruajtura më mirë edhe brenda lagjes Sarza, nga ana lindore e hyrjes së qytetit (fig. 5), ashtu edhe gjatë rrugës që shkon nga Shën-Kolli drejt Shën-Mëhillit. Ngushtësia e këtyre rrugicave na bën të besojmë pohimet e ndonjë autori [21]) mbi dëndësinë e banesave të ndërtuara afër midis tyre, gjë që përkon në një farë mase edhe me një gojëdhanë popullore. [22])

Qyteti lidhej me krahinat dhe qytetet përreth me një sërë rrugë karvanesh, siç janë rruga me dy degë e karvaneve për Berat, rrugë që pastaj e lidhte me Durrësin e Vlorën, rruga që e lidhte me Korçën, rruga e Shipckës dhe rruga e Gjergjevicës, që të çonte në Vithkuq e Skrapar. Në të hyrë të qytetit, nga ana e majtë e xhades së sotme të Korçës, vërehet edhe sot një trakt rreth 60 m i gjatë dhe 2.5 m i gjerë i rrugës së karvaneve të Korçës. Nga kodiku i Shën-Prodhromit [23]) marrim vesh se edhe rruga me kalldrëm nga kisha e Shënapremtes e deri tek lëmi i manastirit të Shën-Prodhromit është ndërtuar gjatë periudhës 1762-1764; gjurmët e kësaj rruge ekzistojnë edhe sot. Është rasti të përmëndim këtu, se nëpërmjet rrugës së Voskopojës kalonte edhe posta e rregullt diplomatike midis Stambollit dhe Venedikut. Për mjaft kohë këtë postë e çonin voskopojarët.

Sipas të dhënave, ndërtimet kryesore publike me karakter shoqëror dhe kulturalo-arësimor ishin bërë në një zonë të përbashkët që formonte bërthamën qëndrore të lagjes së Shën-Janit, pikërisht në vëndin ku edhe sot tradita gojore e emërton «Luadhi i Skolivet». Së pari, ndoshta më 1720 (datë jo e dokumentuar), është ndërtuar shtypshkronja, një ndërtesë kjo që bashkohej me kishën e Shën-Jan-Theollogut. Aty pranë, rreth viteve 1741-1750, ishte ngritur godina e madhe e Akademisë dhe më pas jetimoret, që sipas disave kanë patur pranë edhe spital.

Tregu i qytetit zinte vëndin qëndror, pak a shumë në truallin ku sot është qendra e fshatit në lagjen e Shën-Mërisë (Sarzës), dhe i shtrinte arteret e veta në të gjitha lagjet. Madje çdo shtëpi kishte edhe një punishte të vogël ku qepej, endej, ngjyrosej ahe pregatiteshin sende me vlerë për cilësinë e tyre, ndoshta në bashkëpunim me vetë esnafët ose për llogari të tyre. Ilo Mitkë Qafëzezi është i mendimit që lagja Sarza duhet thënë, mbase më drejt, lagja Çarçi, duke e marrë emrin kjo pikërisht nga çarçia, tregu që ndodhej këtu. Nga më të moshuarit mbahet mend se, edhe para vitit 1900, zejtarët e qytetit dyqanet i kanë pasur në qendrën e sotme. Sipas përshkrimeve që kemi, është fjala për një treg të rëndësishëm, me sheshin e tij të gjerë të mbjellur me pemë dhe me kroje të shumtë, me dyqanet e punishtet rreth e rrotull [24]) dhe sidomos me jetën aktive dhe lëvizjen e gjallë, që të jepte përshtypjen e tregut të një qyteti të math. Atje shkonin për të tregëtuar fshatarët dhe qytetarët e rajoneve të afërta të Shqipërisë jugore dhe të Maqedonisë, si dhe barinjtë e zonave malore, veçanërisht gjatë panaireve të shpeshta që bëheshin shumë herë në vit. [25])

Megjithëse në burimet e shkruara nuk kemi hasur gjë dhe as nga tradita gojore nuk flitet për ekzistencë hanesh në qytet, ne këtë nuk e vemë aspak në dyshim, duke marrë parasysh veprimtarinë e gjerë ekonomike të qytetit, panairet tregëtare që organizoheshin dëndur këtu, karvanet e pazarakëve që jepnin e merrnin me Voskopojën nga anë të ndryshme. Mendimi ynë përkon në këtë rast edhe

23) Në këtë kodik lexojmë: **«Për të ndërtuar kalldrëmin nga Shënapremtja deri te lëmi i manastirit të Shën-Prodhromi,t gjatë periudhës 1762-1764, Mihal Theodhor Bitra dha ndihmë 1000 asllanë dhe, për mirëmbajtjen e manastirit, caktoi që të merreshin çdo vit nga qiraja e punishtes së vet 10 grosh».** (J. Martiniani, **Symbolai....**, 65).

24) Dyqanet e punishtet kanë qënë të grumbulluara sipas zejeve dhe esnafëve në të cilët kanë qënë organizuar, si p.sh. bakenjtë, terezinjtë, gëzofpunuesit, fllokataxhitë, sixhadepunuesit, armëpunuesit, bakërpunuesit, argjendarët, mëndafshpunuesit etj.

25) F. Mihallopullo, **vep. e cit.,** 15. Pazari i vjetër ishte ndën lagjen fillestare të Shënapremtes, pranë urës së madhe mbi lumin e Voskopojës, tek zona e quajtur «Luadhi i dhespotit», ku më vonë, me zhvillimin e qytetit bëhej vetëm pazari i gjësë së gjallë.

Botim

me shprehjet lavdëruese që hasen në literaturën historiografike lidhur me sistemin e goditur komunal të këtij qyteti.

Furnizimi i qytetit me ujë të pijshëm sigurohej nëpërmjet disa ujësjellsave, njeri prej të cilit fillonte nga vëndi i quajtur Tas-Veriga, që ndodhet në një nga lartësitë peréndimore të qytetit. Në lagjen e Strugut, që ndodhet nën të, fshatarët shpesh kanë gjetur fragmente keramike të tubacioneve të këtij ujësjellësi. Vaigandi [26]), që e ka vizituar Voskopojën më 1889, (fig. 6) thotë se vetëm në luginën jugperëndimore kishte gjetur 4 ujësjellës me qyngje gres, nga të cilët edhe atëhere dy vazhdonin të ishin në përdorim. Ai përmend edhe ekzistencën e puseve të shumta, duke shtuar se «*uji nuk ka munguar as për 60.000 banorë*». Për shumicën e krojeve dhe të çezmave që ka edhe sot Voskopoja, qarkullon gojëdhana, e veshur jo pa hiperbolë, se çdo rrugë kishte çezma dhe se gjithësej paskish pasur 262 të tilla.

Nga të dhënat gojore dhe vrojtimet e bëra na rezulton se me ujrat e përrenjve dhe, për më tepër me ato të lumit të Voskopojës, janë ushqyer mbi 25 mullinj, shumica e madhe e të cilëve nuk ekzistojnë më. Nga këta, 7 kanë qënë gjatë rrjedhjës së Strugut, 1 në Zhombër, dhe të tjerët gjatë lumit të Voskopojës e deri tek ura e Shipckës dhe kalivet e Krushovës. Për të krijuar një ide rreth ndërtimit të këtyre mullinjve po japim disa të dhëna të shkurtëra përshkrimore të një mulliri në breg të përroit të Strugut, afër urës së vogël, prej të cilit qëndrojnë ende pjesërisht vetëm muret anësore. Ky është ndërtuar me muraturë guri 60 cm, me gurë të punuar disi së jashtëmi, të lidhur me llaç balte; çdo 70 cm lartësi ka breza druri. Ka një sipërfaqe relativisht të madhe 6 x 12 m, dhe furnizohet me ujë nga mbrapa me anën e një tubacioni druri me diametër 0.50 m. Përveç mullinjve, të dhënat flasin edhe për ekzistencën e një derstile dhe të një banje për të argasur shajakun aty nga ana veriore, në vëndin Bënjë, buzë lumit të Voskopojës, që i shërbente dikur qytetit. Mendimi ynë është që të tilla duhet të ketë pasur më shumë, po të marrim parasysh, nga një anë, popullatën e madhe të Voskopojës dhe, nga ana tjetër, faktin që përpunimi i rrobeve të leshta ishte një ndër mjeshtëritë më të njohura të voskopojarëve.

S'ka dyshim se elementi arkitektonik me më shumë interes i qytetit do të ishte banesa, por fatkeqësisht, me djegien e vitit 1916 dhe me atë më të fundit gjatë luftës nacional-çlirimtare nga pushtue-



Fig. 6

DO NOT COPY

TAB. II







DO NOT COPY

sit fashistë më 1943, nuk ka mbetur asnjë banesë në këmbë nga të vjetrat, kështu që, dhe në trajtimin arkitektural të banesave, duhet t'u referohemi burimeve grafike e fotografike dhe të dhënave gojore të dëshmitarëve okularë.

Arkitektura e banesave voskopojare pa dyshim i është nënshtruar ndikimit, së pari, të kushteve ekonomike e shoqërore të vetë klasave apo të shtresave shoqërore që i ndërtonin, mandej dhe të faktorëve të tjerë, siç janë klima, relievi, materialet ekzistuese të ndërtimit, etj. Dimri i fortë i këtij rajoni ka përcaktuar edhe një strukturë e tip të përshtatshëm të banesave, pak a shumë të trajtuara me të njëjtën gjuhë arkitektonike. Që nga kasollet primitive të blegtorëve, të cilat formuan bërthamën e parë, e deri në banesat e mëdha qytetare të pasanikëve të shek. XVIII, banesa voskopojare ka pasur evolucionin e vet gjatë shekujve, stadet e ndryshme të së cilit ne mund t'i ndjekim nëpërmjet të dhënave direkte dhe indirekte.

Kasollet fillestare për kohë të gjatë qëndruan si të tilla, për t'u shërbyer krejtësisht nevojave blegtorale. Më vonë ato, duke u ndryshuar e përmirësuar vazhdimisht me shtojca të reja, arritën në banesa të vogëla të ndërtuara me gurë e të mbuluar me plloça. Me zhvillimin e mëtejshëm të veprimtarisë ekonomike dhe me shndrimin e fizionomisë së Voskopojës në qendër zejtare e, më pas, edhe tregëtare, edhe arkitektura e banesës ka pësuar ndryshime në përshtatje me nivelin ekonomik e kulturor të vetë qytetarëve, për t'u ofruar këtyre një komoditet më të madh dhe një banesë më estetike.

Jemi të prirur të besojmë, se shumica e madhe e banesave të Voskopojës kanë qënë ndërtuar dykatëshe të mbyllura. Themi se të tilla banesa përbënin banesën tipike mbizotëruese të këtij qyteti me fizionomi zejtaro-tregëtare. Këtë e vërejmë jo vetëm nëpër gravurat e fotografitë e Voskopojës, respektivisht të shek. XVIII dhe të fundit të shek. XIX, por e nxjerrim edhe nga përshkrime të autorëve të ndryshëm. Nga ana tjetër, mendimin tonë e përforcon edhe analogjia me qytetet e tjerë të kësaj kategorije, përreth Voskopojës e që kishin marrëdhënie me të, si Berati, Janina, Shiatista, Mecova etj. Një argument tjetër jo pa rëndësi përbën edhe fakti që voskopojarët e shpërngulur në Korçë, ku krijuan lagje më vehte pas shkretimit të Voskopojës, ndërtuan atje banesat e tyre, në masë dykatëshe, duke ndjekur traditën e tyre vëndase. Prandaj duke u mbështetur kurdoherë në të dhëna indirekte, në përshkrimin tonë të skemës së kompozimit funksjonal dhe teknikës së ndërtimit kemi parasysh një banesë të tillë më të zakonshme.

Banesa dykatëshe voskopojare ka qënë ndërtuar krejtësisht me gurë, me qoshe të latuara mirë. Në fasadën kryesore të katit të parë ka pasur dy ose katër frengji, siç duket, më tepër për dritë se sa për mbrojtje. Një portë e mbuluar me hark çonte në pjesën përdhese të banesës, që përfshinte ambientet ndihmëse të shtëpisë: kuzhinën, qilarin, depon e druve dhe ambiente të tjera të nevojshme. Një shkallë e drunjtë e brendshme çonte në katin e dytë. Në ato banesa të rralla që kishin avlli e kopësht përdorej shkallë e gurtë e jashtëme. Kati i dytë përfshinte dhoma për fjetje, dhoma shërbimi, banjë dhe dhomën e pritjes, dhomë kjo e madhe me oxhak dhe me divan rreth e rrotull, e shtruar me qilima ose me rroba të tjera të vyera të dala nga punishtet e qytetit dhe të vëndeve të tjera të Lindjes, duke pasur nga ana e rrugës tri ose katër e më shumë dritare të mbuluara me harqe. Nga sa shkruan Mihallopullo, në Voskopojë nuk kanë mungar as banesat me çardak, që e kishin me kolona të drunjta në katin e dytë, nga ana jugore e banesës. Edhe Vaigandi, aty nga fundi i shekullit të kaluar, ka vërejtur shumë banesa dykatëshe, shpesh disa shtëpi nën një çati të përbashkët me dyer e porta kryesisht me harqe, me çardaqe etj.[27]

26) G. Weigand, **vep. e cit.,** 100.

27) G. Weigand, **vep e cit.,** 100. Një vizitor tjetër i Voskopojës, i vitit 1905, rumuni Burileanu thekson: **«Caratteristiche sono le colonne insieme agli archi che li uniscono che non mancano quasi da nessuna casa. Caratteristiche anche sono le porte dei cortile» (I. Burileanu, I romeni di Albania,** I, 129)

28) Villarai ka bërë një përshkrim të mirë ndërtimeve të kaluara të Janinës, sipas të cilit si shtëpitë qytetare dykatëshe ashtu edhe ato trekatëshe të pasanikëve në pamjen e tyre të jashtëme kanë qënë shumë të thjeshta (I. Billara, **Periodiko «Dodoni»,** etos A. Athinai 1896, 42-44).

29) Një autor grek, Vakallopullo, jep disa të dhëna rreth arkitekturës së thuajse 30 shtëpive të pasanikëve, që ruhen edhe sot nga shekujt XVII e XVIII si modele të teknikës popullore në një qytet të afërt të Maqedhonisë perëndimore, Shiatistës. Me këtë qytet Voskopoja ka pasur mjaft marrëdhënie e, natyrisht, edhe huazime e analogji në ndërtime, aqë më tepër që nuk kanë edhe distancë të largët. Nga burime të shkruara dimë se tregëtarë të të dy qyteteve kanë bashkëpunuar ngushtë midis tyre.

30) Mbi shtresa prej dërrase shpesh pikturoheshin skena mitologjike, sikurse kanë treguar shumë gërmadha të godinave të qytetit. Dekoret nuk mungonin edhe nëpër dollape e hajate (shih: F. Mihallopullo, **vep e cit.,** 49).

DOZIOTOK

TAB. III

MONUMENTE TE VOSKOPOJES NE SHEK XVIII

DO NOT COPY



KISHA RENOJE OSE TE ZHDUKURA

1	SHEN	THIMIU
2	SHEN	SPIRIDHONI
3	SHEN	VARVARA
4	SHEN	SOTIRI
5	SHEN	MITRI
6	SHEN	GJERGJI
7	SHEN	KOSTANDINI
8	SHEN	PJETRI
9	SHEN	PANDELEJMONI
10	SHEN	TRIARKONDEI
11	SHEN	TRIADHA
12	SHEN	NAUMI
13	SHEN	JAN THEOLLOGU

KISHA EKZISTUESE

I	SHEN	MARIA
II	SHEN	MARINA
III	SHEN	THANASI
IV	SHEN	ILIA
V	SHEN	KOLLI
VI	SHEN	MËHILLI
VII	SHEN	HARALLAMBI
VIII	SHEN	DHIONISI
IX	SHEN	E PREMTE

Legjenda

- KISHE EKZISTUESE Bazilike
- KISHE EKZISTUESE E VOGEL
- KISHE RRENOJE E VOGEL
- MANASTIR
- NDERTIME Kult-Arsimore
- BANESA TE SOTME

Ne nuk mund të formojmë një ide të plotë për anën e jashtme të banesave voskopojare, ashtu siç kanë qënë në periudhën e lulëzimit të qytetit. Turqit, siç dihet, e shikonin me cmir e antipati epërsinë ekonomike të të nënshtruarve të tyre, prandaj voskopojarët, për t'ju shmangur rrezikut që mund t'u vinte prej tyre, nuk ngulnin këmbë, sikurse edhe në qytete të tjerë, në dekorimin e jashtëm të godinave. Në këtë vështrim ato kanë qënë të thjeshta.[28]

Banesave të shtresave të pasura u shtohet edhe kati i tretë, kryesisht i destinuar për pritjen e miqve, i cili përbëhej nga çardaku, dhoma të mëdha në të dy krahët e tij dhe dhoma të tjera nga pas, duke marrë emërtimin «shtëpi arkondësh» (pasanikësh) [29]) (Tab. II, 1). Tavani i dhomës së miqve ka qënë ndërtuar me mjeshtri dhe stolisur me gravura dekorative. Edhe muret e tyre të brëndëshme shpesh kanë qënë pjesërisht të veshur me dru dhe të pasur me dekoracione. [30]) Oxhaku i dhomës së miqve përbënte gjithashtu një stoli më vehte. Martiniani, që siç duket kqyri në vënd mbeturinat e fundit të qytetit shumë vjet para djegjes së 1916-tës, midis të tjerave flet për pamjen madhështore të këtyre godinave, që paraqiteshin si kështjella të fushës.

Oborret e shtruara me pllaka dhe të rrethuara me kopshte me kroje në mes e me avllira, me qoshqet e ndërtesat më të vogla si ambiente ndihmëse, i jepnin kësaj banese në tërësi një pamje të gëzueshme. [31])

Krahas ndërtimeve të tjera të qytetit shkonte edhe ndërtimi ose rindërtimi i kishave. Periudha e ndërtimeve fetare më të rëndësishme ishte koha e zhvillimit më të madh ekonomik, vitet 1700-1760. Burime të ndryshme japin numura të ndryshme të kishave të ndërtuara në Voskopojën e vjetër. Kështu, p.sh., ndër autorët e fundit, Mihallopullo flet për ekzistencën e 22 kishave, kurse Kurilla thotë se brënda një shekulli (1650-1740) në Voskopojë u ndërtuan 24 kisha, dhe secila prej tyre kishte në vartësi 1-2 kishëza (paraklisa), me tempuj të bukur, me amvona e throna të peshkopëve të gdhëndura në dru arre, etj. Ne arritëm të gjurmonim gjithësej 22 kisha dhe një manastir dhe të hartojmë një planimetri (Tab. III), ku japim emërtimet dhe lokalizimin edhe të atyre monumenteve që nuk ekzistojnë më, ose që pjesërisht



Fig. 7



Fig. 8

31) Sipas Martinianit, gati të gjitha banesat kanë qënë ndërtuar me themele të forta e të lidhura mirë, me qoshe të latuara në mënyrë të mrekullueshme, me dritare gati përgjithësisht me harqe të lidhura në formë kornize me kangjella të Ankonës, Venedikut ose Hungarisë, që kishin trajtën e dantellës.

32) Gurët e zez që i përdornin lagjet e sipërme, nxirreshin nga malet e Kostamandës dhe të Peltekut, gurët e bardhë, që i përdornin kryesisht lagjet e poshtme dhe ajo e pasanikëve, merreshin nga ana lindore e Shën-Prodhromit, kurse pllоçat më tepër siguroheshin nga Shipcka dhe Lirasi (afër Gjonomadhit).

DO NOT COPY

gjënden vetëm si rrënoja. Nga 23 faltoret e mësipërme sot janë më këmbë vetëm 7 kisha bazilikale, 1 manastir dhe 2 kishëza (paraklise). Në literaturë përmënden dy kisha të tjera, ajo e 12 apostujve dhe e Anargjirëve, të cilat janë djegur e shëmbur, por ne nuk arritëm t'i lokalizojmë.

Përsa i përket stilit arkitektural të kishave të Voskopojës, që thuajse ruheshin integralisht deri më 1916, duke u mbështetur në ato ekzistueset, mund të themi shkurtimisht (sepse ky problem kërkon trajtim më vete), se në shumicën prej tyre është përdorur stili i bazilikës së vjetër, pa kube, mbuluar me qemere e kalota sferike, me portike në pjesën e përparme (Tab. V). Pra, nuk janë të sakta pohimet e Veliantit dhe të autorëve të tjerë, se kishat e Voskopojës janë të stilit bizantin. As në kalkografitë e shek. XVIII nuk vrojtohet ndonjë kishë me kube, me përjashtim të asaj të Shën-Prodhromit (fig. 7). Ato që thamë për anën e jashtëme të banesave vlejnë edhe për ndërtimin e dekorimin e këtyre kishave.

Nga ana e jashtëme në përgjithësi kishat e Voskopojës nuk duken ndonjë gjë e jashtëzakonshme, por me të hyrë brënda të pushton një ndjenjë admirimi për madhështinë e ndërtimit të brëndshëm dhe për punimet artistike të shquara. Si punimet e gdhëndura në dru dhe, aq më tepër, pikturat murale janë vepra të shquara të artistëve më të mirë të kohës, si David Selenica, Kostandin e Athanas Korçari, etj. (fig. 8). Voskopojarët nuk kufizoheshin vetëm me mjeshtrit e artistët e tyre, por sillnin edhe të tjerë nga më të aftët e më të famëshmit në Shqipëri, Maqedoni e gjetkë. Me shumë të drejtë kishat e Voskopojës u quajtën nga bashkëkohësit si më të bukurat e Turqisë evropiane. Në fakt, në vëndin tonë nuk gjejmë kisha të këtij niveli dhe me përpjestime aq të mëdha, (Tab. IV, 1), prandaj si të tilla meritojnë dhe kërkojnë studime të gjithanëshme.

Zhvillimin e ndërtimeve në Voskopojë e favorizonte edhe sigurimi në vënd i materialeve të ndërtimit, i gurëve [32]) dhe i lëndës së drurit [33]). Çatitë me strehët të gjera shpesh mbuloheshin me pllaka guri të latuara, që siguroheshin nga mademet e pasura aty afër. Një nga autorët më të vjetër që ka përshkruar qytetin thotë se Voskopoja «*ka qënë e famëshme për madhësinë e shumicën e shtëpive, që ishin të ndërtuara me material të fortë*», [34]) kurse Kuzineri, duke trajtuar paraqitjen tërheqëse të shtëpive voskopojare, përmënd sa vijon: «*Në ditët tona Voskopoja u pasurua nga tregëtia me Gjermaninë, banorët ndërtuan atje banesa shumë të bukura*» [35]). Për godinat e mëdha të qytetit që të imponoin me volumet, përpjestimet dhe monumentalitetin e tyre flet edhe një autor tjetër. Është fjala jo vetëm për banesat e shquara të pasanikëve, por edhe për godinat publike të ndërtuara për qëllime social-kulturale. Tregohet se ka qënë e hijëshme godina trikatëshe e Akademisë me konviktin e jetimoren e saj prej 40 dhomash, fjetore e salla mësimore, godina e mitropolisë pranë kishës së Shën-Mërisë, ndërtesë e madhe kjo me 30 dhoma, jetimorja e arësimit të ulët gjithashtu ka qënë godinë e madhe, banesa e kryepeshkopit të Ohrit, Joosaf Voskopojarit, etj. [36])

Pra, Voskopojës nuk i mungonte asgjë për të marrë zhvillim të vrullshëm ndërtimi, sikundër nuk i mungonin specialistët me tradita të zonës së Oparit, të rretheve të Korçës e të Kolonjës, të cilët kanë ndërtuar në tërë Shqipërinë jugore deri në bregdet. Pa dyshim ndërtimet masive duhet të jenë bërë nga mjeshtrit vëndas. Këtë konkluzion e nxjerrim edhe nga fakti që esnafi i muratorëve në Voskopojë ka qënë një ndër më të pasurit dhe që përfshinte në gjininë e vet më shumë anëtarë [37]). Por ritmi i shpejtë i ndërtimeve në këtë qytet, që arriti në disa mijra banesa brënda një periudhe relativisht të shkurtër, ishte i tillë, që pa tjetër diktoi nevojën edhe të sjelljes së një numuri mjeshtrash ndër më të mirët e Shqipërisë jugore, të Maqedonisë apo të Thesalisë etj. Për këtë flasin edhe dokumentat epigrafike. Kështu

33) Le të sjellim ndërmënd se tërë rrafshnalta, ku është ndërtuar Voskopoja, dikur ka qënë e mbuluar nga një pyll i madh e i dëndur, prej nga u muar lënda. Tërë boriga ka qënë pyllzuar edhe mali i Kostamandës, të cilin ca nga ca banorët e çveshën qoftë për t'i marrë lëndën, qoftë edhe për faktin që të ishte më në mbrojtje vetë ayteti, për të shikuar armiqtë në rast se u suleshin nga sipër. Jo shumë larg ngrihen madhështore edhe pyjet e Lenies, të përmëndura për lëndën e parë të drurit.

34) P. Papahagi., Scritori, Aromani, Bucuresti 109, 20.

35) E. Cousinery, **Voyage dans la Macédonie,** vol. I, Paris 1829, 17.

36) Ka të dhëna që fasadat e këtyre pallateve dikur ishin të veshura edhe me lloje të ndryshme mermeri, që gjithashtu nuk mungonte në trevën përreth Voskopojës. Sipas Kostandait, në kohë të tij, nga mali në L të saj, në një distancë rreth një ore, nxirreshin tre lloje mermeri të bukura me llustër me ngjyra të kuqe, të bardhë dhe të kaltër. Këto të fundit ai i përmënd shumë të mira (Krh. K. Skënderi, **Vep. e cit.,** 55).

37) F. Mihallopullo, **Vep. e cit.,** 31.

POWTCOPY

p.sh. në mbishkrimin e kishës së Shën-Thanasit, për të cilin patëm rastin të bëjmë fjalë më lart, lexohen emrat e pesë mjeshtrave të ardhur nga fshati Krimi i Kosturit. Në të vërtetë elemente arkitekturale të përbashkëta vërehen ndërmjet hajateve të kishave të Voskopojës dhe të manastirit të Rilit në Bullgari, të ndërtuar në shek. XIX nga mjeshtrit prej Krimit të Kosturit, siç janë zbukurimi me tulla etj. (Tab. IV, 2) [38]). Gjithashtu, në një mbishkrim tjetër të kishës së Shën-Kollit në thronin e dhespotit, përmendet emri i një specialisti të gdhëndjes në dru me origjinë nga Korfuzi. (Tab. VI, 3). Megjithatë, pavarësisht nga ndikimet e parëndësishme dhe huazimet reciproke të mundshme që duhet të ketë pasur në mes të vendeve fqinjë, veçanërisht si rrjedhim i kontakteve dhe marrëdhënieve të dëndura tregëtare me to, arkitektura e ndërtimeve të Voskopojës, që arrin trajta të larta në shekullin e lulëzimit të saj, nuk shkëputet aspak nga tradita vëndase dhe, rrjedhimisht, nuk ka si të mos mbajë vulën e tabanit ku u mbrujt. Bindja e jonë është se ndikimet e huaja, duhet të kenë qënë pothuaj të parëndësishme; ato kanë pasur të bëjnë më tepër me ndonjë hollësi apo do të mund të jenë praktikuar aty-këtu në godina të veçanta. [39])

Një mjeshtëri tjetër që u zhvillua mjaft në këtë pellg, e që duke u ngritur në art, na ka lënë në këtë kohë monumente të pavdekëshme në Voskopojë e qëndra të tjera të vëndit, si dhe në Maqedoni e Greqi, ka qënë edhe ajo e të gdhëndurit në dru, ksilogravura, një degë kjo e arteve të aplikuara, që për funksionin dhe destinacionin e saj ka në themel lidhjen dhe bashkëpunimin e ngushtë me arkitekturën. Motivet e përdorura në këtë gjini arti dhe ekzekutimi i hollë i tyre në dru, si për dekoracionet e ndryshme të brëndshme të kishave dhe të banesave, ashtu dhe gravurat e botimeve të shtypshkronjave në Voskopojë, dëshmojnë qartë për nivelin e lartë artistik të këtyre punimeve të artit popullor që meritojnë studime të veçanta.

*
* *

Pasi dhamë një sërë elementesh mbi urbanistikën dhe mbi artitekturën e qytetit, që hedhin sadopak dritë mbi fizionominë e Voskopojës në shek. XVIII, mendojmë se është e nevojshme të rishqyrtojmë me këtë rast edhe një herë problemin e popullatës maksimale që ka pasur qyteti në atë kohë, me që mendime nga më të ndryshmet janë çfaqur në lidhje me këtë. Disa autorë si Pukëvili, Kostandai, Hahni, Saqellaridhi, Kuconika, Karmici, Kurilla dhe së fundi, Martiniani etj. e shpien popullatën e saj deri në 60.000. Aravantinoi shprehet se kanë qënë 50.000 banorë, Vakallopullo e kalon këtë shifër, të cilën Llambrua, duke e tepëruar fare, e ngre në 200.000 ose të paktën 85.000, ashtu si Bërçiu në 100.000. Lista e autorëve, që kanë dhënë shifra të tepëruara, mund të zgjaste edhe më. Është me interes fakti që shumica e tyre, edhe pa e vizituar fare Voskopojën, janë mbështetur në bujën e bërë nga dokumenti latinisht i botuar prej Aleksicit në Bukuresht më 1909. Është fjala për një kërkesë të tregëtarëve voskopojarë të vendosur në Budapest pas prishjes së qytetit të lindjes, të cilët duke përmëndur origjinën e tyre prej Voskopoje, theksojnë me një farë mburrje dhe për oportunitet, pra jo edhe pa hiperbolë, se mëmëdheu i tyre përbëhej prej 12.000 shtëpi. [40]) Po një dokument tjetër analog na është kumtuar kohët e fundit edhe nga Shuteriqi. [41]) Është përsëri një lutje e një voskopojari bashkëkohës i shpërngulur në Hungari, prej së cilës del se Voskopoja ka pasur atëhere mbi 10.000 shtëpi, d.m.th. të paktën 50.000 banorë.

38) V. Puzanova, **Shënime.....,** 50.

39) Na duket i pa argumentuar dhe aspak bindës pohimi i Kalimakut për mundësinë e një stili të arkitekturës në formë të vjetër vieneze apo veneto-maqedonase me influencë turke, siç thonë, pa të drejtë, edhe Mihallopullo e Martiniani. Llogjika e do që kontaktet e tregëtarëve të mëdhenj voskopojarë me Evropën e sidomos me Venedikun e Austrinë, të kenë ndikuar disi në huajtjen e modeleve të huaja në formën e jashtëme të banesave, e veçanërisht të interierevet. (Khs.: J. Martiniani, **Symbolai... 14, 25, I Moshopolis...,** 36, 37; Kalimahos, **Periodiko «Panathinaia»,** v. XXVI, 1913, 5, cituar nga: F. Mihallopullo, **vep e cit.,** 48.

40) Në këtë dokument të shek. XVIII, midis të tjerave thuhet: **«Moscopolis.... urbs amplissima, non modo in tota Gracia, sed etiam fere per totum turcarum imperium; numero domorum ex solida materia constructarum qui ad doudecim millia facile excurrit....»** (Shih G. Alexici, **Macedoromanii, in Converbiri Literare,** vol. XXXVII, 951, riprodhuar nga: P. Papahagi, **Scriitori Aromani....,** Bucurest 1909, 20 dhe cituar nga: Const. Noe, **Les Romains Koutzo-Valaques,** Bucurest, 1913, 19; ie uca Benedetto, **Gli aromani del nuovo assetto balcanico.** Estratta dal «Kuvendi», Tip. Soc. Pilizzi,, Roma 1920 10).

41) Dh. S. Shuteriqi, **Shqiptarët në Hungari,** Bul. shk. shoq. n. 2, 1957, 236.

Ukoton

Një dëshmitar okular me prejardhje nga Maqedonia, që ka bërë një botim gjeografik më 1826, thotë se Voskopoja më 1726 ka pasur 40.000 banorë. Edhe Kumasi, ndonse në historinë e vet pranon 60.000, në gjeografinë që botoi më vonë, zbret në 40.000. Ndofta këtë informatë Kumasi mund ta ketë marrë nga vetë voskopojarët, që pas braktisjes së qytetit shkuan në Vjenë, me të cilët kishte lidhur marrëdhënie të ngushta. Po këtë numur banorësh jep edhe gjeografi Llorenti, me të cilin bashkohet edhe Vaigandi e Mihallopullo. Probabilisht, sipas burimeve të shkruara, pra, ky duket numuri më i përafërt i banorëve të saj, i pranueshëm për një shumicë autorësh.

Ne i vumë vetes për detyrë që ta vëzhgojmë mirë në vënd edhe këtë problem, për t'iu afruar sa të jetë e mundur më tepër realitetit. Në vlerësimin tonë kemi marrë parasysh një sërë faktorësh, siç janë gjurmët e gërmadhave që flasin për sipërfaqen e banueshme, ngushtësinë e rrugëve që dëshmon për dëndësinë e ndërtimeve, gjë që përkon edhe me burimet historike, numurin e madh të kishave dhe hapësirat e mëdha të bazilikave me kapacitet secila deri në 1000 vetë, numurin e madh të mullinjve, ujësjellësve dhe çezmave. Të gjitha këto si edhe madhësia e shtëpive, numuri mesatar i përbërjes familjare etj. na bindin, pas disa krahasimeve të bëra me parcela e lagje me dëndësi e reliev analog të disa qyteteve tona dhe pas një sërë përllogaritjesh, se popullata maksimale e Voskopojës në shek. XVIII duhet të ketë qënë rreth 25-30.000 banorë, në një kohë kur edhe qytete të tillë si Sofia, Athina, Belgradi nuk arrinin të 20.000 banorët. [42])

Duke pranuar këtë version nuk mund të pajtohemi as me Likun (dhe as me Ilo Mitkë Qafëzezin që përqafon tezën e tij), i cili, megjithëse nuk mundi ta vëzhgojë në vënd Voskopojën, nuk pranon që të ketë pasur më shumë se 1.000 shtëpi, pra një popullatë shumë më të vogël nga ajo e pranuar prej të gjithëve. Në të njëjtën kohë detyrohemi të mos pajtohemi edhe me tekstin e Historisë së Shqipërisë, i cili thotë se Voskopoja nuk kishte më tepër se 15-20.000 banorë. [43])

DO NOT COPY

42) C. Serban, **Po aty.**
43) **Historia e Shqipërisë,** I, 407.



DO NOT COPY





TAB. V







DO NOT COPY

Stilian Adhami

ASPECTS URBANISTES ET ARCHITECTURAUX DE LA VILLE MEDIEVALE DE VOSKOPOJE

RÉSUME

L'étude de la ville médiévale de Voskopoje, qui atteignit l'apogée de son essor économique et culturel au XVIIIe siècle, présente un intérêt particulier non seulement par son importance passée, mais aussi par le riche héritage de culture matérielle qui en subsiste encore aujourd'hui.

Sous l'effet d'une série de facteurs d'ordre naturel et aussi économique, politique et social, Voskopoje a connu un impétueux développement des forces productives. Le renom de cette ville, avec son collège de la «Nouvelle Académie» et son imprimerie, avec le vigoureux essor de l'artisanat et du commerce et ses rapports étendus avec l'étranger, avec ses figures éminentes de la science, des lettres et des arts et son importante culture matérielle, a franchi les limites du pays. De longue date, la ville a attiré l'attention des chercheurs et voyageurs, étrangers et locaux, et leurs témoignages à son sujet ont constitué un riche fonds de documentation.

Dans cette étude, l'auteur traite uniquement de l'aspect urbaniste et architectural de cette ville, surtout au XVIIIe siècle, époque de son épanouissement. Dans les recherches sur cette cité ou les descriptions qui nous en ont été faites par une série d'auteurs, notamment par Pouqueville et Leak, Hahn et Weygand, Karmic, Skënderi, Kurilla, Kapidani, Papahadjiu, Puzanova et d'autres, ces aspects ne sont pas traités du tout ou sont abordés superficiellement et de façon fragmentaire. Seules exceptions peut-être, les études partielles de Martiniani, Mihalopoulo et Qafëzezi.

Se fondant sur les résultats des recherches successives menées sur les lieux, du rassemblement de données et de l'utilisation des sources bibliographiques existantes, vérifiées sur place, cette étude présente un plan approximatif de la ville, telle qu'elle devait s'étendre jadis avec ses anciens quartiers, ainsi qu'une carte situant les nombreux monuments qui embellissaient autrefois la ville, mais dont il ne subsiste plus qu'un petit nombre. Ces documents sont les premiers du genre qui aient été jamais conçus. Le but de cette étude est d'éclairer, fût-ce faiblement, la physionomie et le caractère de cette importante ville médiévale – aujourd'hui réduite à la condition de petit village – dans l'espoir de guider les études qui seront conduites ultérieurement sur ce centre historique et d'y contribuer. A cette occasion, il est procédé à une correction des estimations faites jusqu'ici quant à la population maximale de la ville, et adopté une attitude critique à l'égard des observations inexactes des auteurs étrangers.

Voskopoja se dresse, à 1.200 m au-dessus du niveau de la mer sur un plateau montagneux situé à 24 km au sud de Korçë. Elle est entourée sur trois de ses côtés par des collines partiellement dénudées. Ses environs sont constitués par un enchevêtrement de collines, tantôt élevées et rocheuses, tantôt molles et descendant vers la plaine de Korçë.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

La vallée de Voskopoje est sillonnée par trois torrents qui se jettent dans la rivière du même nom, affluent du Devolli.

La position naturelle favorable de ce haut-plateau au climat sain, profondément encaissé entre les monts à proximité de grandes voies de communication, protégé contre les courants froids et se prêtant à une bonne défense contre toute attaque de l'extérieur, pourvu d'eaux abondantes et de riches pacages, a fait de Voskopoje un lieu de séjour très recherché et un des centres climatiques et touristiques les plus agréables de l'Albanie du Sud.

Un des points non parfaitement éclaircis concernant la ville est celui de l'époque de sa fondation. Les légendes et les jugements à ce sujet sont des plus divers et il n'existe pas, en fait, de données pleinement documentées en ce domaine. Quoi qu'il en soit, l'auteur ne s'étant pas fixé ici pour tâche de résoudre ce problème, il se rallie, dans l'état actuel des connaissances, à l'opinion prédominante selon laquelle les débuts de la construction de Voskopoje sont à rechercher au XIVe siècle, si ce n'est plus en arrière dans le temps.

Il est fort possible que le noyau initial du village ait été établi vers l'extrémité nord du haut plateau de Voskopoje, non loin du lieu où s'élève l'église de Shënepremte et autour de celle-ci, considérée comme la plus vieille de la ville. Une pareille thèse trouve également un appui dans la tradition orale. Des tombes anciennes ou des ruines éparses que l'on observe çà et là, semblent témoigner en faveur de cette explication. Il s'agirait là du premier établissement sur ce territoire, de pasteurs nomades ou d'habitants de l'agglomération la plus proche, Voskop, qui fut effectivement abandonnée par la population locale.

Il est intéressant de noter que Voskopoja, de petit village qu'il était au début, se peuple par la suite, progressivement, pour devenir rapidement une ville renommée de dizaines de milliers d'habitants, fort développée sur le plan économique, urbaniste et culturel.

Ainsi que l'admettent entre autres, Kostanda, Aravantino, Saqelaridhi, Vutira, et dernièrement Mihalopoulo, il est probable que Voskopoje se soit peuplée durant le XVIe siècle après la soumission de l'Albanie par la Turquie, lorsque, avec l'arrêt des déplacements de populations dans ces zones, de nombreuses tribus de Koutso-valaques et de Sarakacane furent contraintes de s'établir en quelque lieu, créant ainsi de petites agglomérations. Sa population ne cessait de croître d'éléments albanais et koutso-valaques, qui y accouraient pour échapper aux persécutions de l'occupant turc, puis pour se soustraire à l'islamisation, la position de Voskopoje encaissée dans les montagnes la mettant mieux à l'abri. Du fait de sa situation dans de hautes régions, la ville, pour un temps ne ressentit pas trop directement le lourd fardeau du féodalisme militaire turc et ses effets destructeurs.

Avec le temps, le village s'étendit vers le sud-ouest, pour devenir peu à peu un important hameau dont la population s'adonnait principalement à l'élevage et dans une moindre mesure à l'agriculture. C'est ainsi que virent le jour les premiers quartiers, et notamment ceux de Sarze (ou de Sainte-Marie), de Skammel (ou de Saint-Athanase) et de Rrua (ou de Saint-Nicolas), dont les noms figurent au XVIIe siècle dans le code de Saint-Prodrome. Par la suite, se construisent des quartiers entiers qui portent le nom de léglise qui s'y dresse, tels le quartier de Saint-Jean, de Shëndëlli, de Saint-Pierre, de Saint-Georges, de Saint-Michel, etc. Certains quartiers ont reçu le nom des torrents du même nom, comme ceux de Strug et de Zhombër. Ce dernier quartier est aussi appelé quartier de Mecove, car ses habitants, pour la plupart, à la suite du développement de l'artisanat et du commerce, y étaient venus principalement de Mecova, une localité d'Epire, de même que s'y établirent aussi beaucoup d'originaires de Skamnel de Zagori (quartier de Skamnel) ou de Postenan (quartier de Poshtenika ou Postenika). D'autres quartiers ont pris le nom de familles en vue des couches riches, comme le quartier des Xega et celui des riches, cependant que le quartier des habitants de condition inférieure, situé le long de la rivière de Voskopoja, s'appelait

DO NOT COPY

le quartier de Pezhu. Après le XVIIIe siècle, lorsque de nouveaux établissements de populations repeuplèrent la ville partiellement détruite de 1769 à 1789, de nouveaux quartiers prirent le nom des lieux dont ces collectivités étaient originaires, tels les quartiers des Grabovars (originaires de Grabove), des Oparaks (originaires d'Opar), etc.

Au XVIIe siècle, Voskopoja prit peu à peu l'aspect d'une ville. Elle avait cessé d'être un village ordinaire, comme de nombreux auteurs et même le texte de l'histoire d'Albanie estiment qu'elle l'était encore. Cela apparaît de l'essor même économique et urbaniste qu'elle connaissait à l'époque, de l'expansion de son marché et des relations commerciales qu'elle avait établies avec l'étranger, avec Venise en particulier, au XVIIe siècle.

Durant le XVIIIe siècle, ou plus précisément de 1700 à 1760, Voskopoja nous apparaît à l'apogée de son épanouissement. Elle réussit à jouir d'une autonomie relative où les esnafs (corporations) et leurs organismes dirigeants jouaient le rôle primordial. Selon Hahn, elle était, à l'époque, «la ville la plus civilisée de l'Albanie entière».

Les recherches menées sur place, et fondées sur la tradition orale, sur les limites naturelles de certains quartiers et sur les sources bibliographiques, font apparaître que Voskopoja comprenait 14 quartiers de plus ou moins grande extension. Dans la mesure où l'on a pu en retracer les vestiges, la ville, à l'apogée de son expansion, s'est étendue sur une superficie de quelque 1 800 ha avec un périmètre d'une longueur approximative de 6 km.

Traitant du développement urbaniste de la ville, il est possible de définir, dans les grandes lignes, les périodes qu'elle a traversées. La première période, allant de sa fondation (XIVe siècle) au XVIe siècle, a pour trait sa lente et progressive croissance de petit hameau en ville, la population, durant la majeure partie de cette phase, continuait à s'adonner essentiellement à des activités pastorales. De ce fait, le développement de la ville sous l'aspect urbaniste, comme dans tous les centres d'établissement de collectivités pastorales a tendu à se conformer à ces exigences. La deuxième période est celle de son essor et de sa floraison en tant que ville proprement dite (XVIIe-XVIIIe siècles), quand l'expansion de l'artisanat et du commerce, ainsi que l'essor culturel et artistique, s'accompagnent, sur le plan de l'urbanisme, d'une conception plus avancée, qui est celle de la cité médiévale, aux rues étroites et tortueuses. C'est l'époque où Voskopoja est considérée comme «une très grande ville (urbs amplissima) de l'empire turc», aux nombreux quartiers, et aux riches marchés, dotée déjà d'une industrie locale et qui entretient des relations commerciales non seulement avec les régions voisines de l'Albanie du Sud et Centrale, ainsi qu'avec d'autres contrées de l'empire, mais aussi avec des pays de l'Europe méridionale, centrale et orientale. La troisième période s'étendrait de 1769 à 1916, ce serait l'époque où Voskopoja est ravagée successivement, à trois reprises et, malgré de brèves périodes de redressement, finit, en 1916, par disparaître totalement en tant que ville.

Du point de vue urbaniste, la ville, dans la période de son épanouissement, était construite comme en terrasses avec trois étages successifs d'habitations, divisées entre elles par les torrents qui decendent des montagnes. La liaison entre les principales zones de la ville s'effectuaient par plusieurs ponts, grands et petits, dont il ne subsiste aujourd'hui, à part le grand pont sur la rivière de Voskopoje reconstruit vers la fin du siècle passé, que deux ponts sur le torrent de Strug.

Un réseau étendu de rues et de ruelles pavées sillonne toute la ville. La largeur de ces rues généralement étroites varie entre 1,5 m et 2 m. Cette étroitesse semble témoigner de la densité des habitations, ce qui est confirmé par les sources bibliographiques et dans une certaine mesure par une légende populaire.

La ville était reliée aux régions et aux villes environnantes par un certain nombre de routes de caravanes dont on discerne les traces encore aujourd'hui. Il convient de rappeler que c'est par la route de Voskopoje que passait aussi le courrier diplomatique habituel entre Constantinople et Venise. Pendant un long temps, ce courrier fut porté par les habitants de Voskopoje.

DO NOT COPY

Apparemment, les principaux édifices publics à destination culturelle et éducative se dressaient dans une zone commune, qui constituait le noyau central du quartier de Saint-Jean, au lieu précis que la tradition orale qualifie encore aujourd'hui de «Plaine des écoles». Le premier édifice construit probablement en 1720, fut l'imprimerie, en partie souterraine, reliée à l'église de Saint-Jean Théologue. Vers 1741-1750, fut édifié le bâtiment grandiose de l'Académie puis les orphelinats, auprès desquels, selon certains, devait se dresser aussi un hôpital.

Le marché, qui occupait le centre de la ville, se situait approximativement sur le territoire qui constitue aujourd'hui le centre du village, dans le quartier de Saint-Marie, et il étendait ses ramifications dans tous les quartiers. Presque chaque maison était devenue aussi un petit atelier où l'on cousait, tissait, teignait et fabriquait des objets de prix. Il s'agissait d'un vaste marché, avec une grande place plantée d'arbres et de nombreuses fontaines, entourée d'échoppes et d'ateliers groupés selon les métiers et qui, par son animation et l'activité qui s'y déployait, donnait l'impression du marché d'une grande ville.

L'approvisionnement en eau potable était assuré par plusieurs aqueducs. Souvent les paysans de la région sont tombés sur des tragments de céramique des conduites de ces aqueducs. Weigand, qui a visité Voskopoje en 1889, affirme que rien que dans la vallée s'étendant au sud-ouest, il existait 4 aqueducs aux conduites en grès. Les eaux des torrents et en particulier celles de la rivière de Voskopoje alimentaient plus de 25 moulins, dont l'immense majorité n'existent plus.

Malheureusement, l'incendie de 1916 et le dernier qui fut, en 1943, durant la Lutte de libération nationale, le fait des envahisseurs fascistes, n'ont laissé debout aucune des ancienne habitations, à l'exception de 7 églises basilicales, d'un monastère et de 3 paraklise en sorte que dans l'étude architecturale de l'habitation de Voskopoje à ses stades successifs, nous ne pouvons nous référer qu'aux sources graphiques et photographiques et aux indications orales de témoins oculaires. L'immense majorité des habitations de cette ville, d'aspect essentiellement artisanal et marchand, étaient des maisons d'un étage au-dessus du rez-de-chaussée, de type fermé. Cette étude donne le schéma de leur composition fonctionnelle et la technique de leur construction, ainsi que de celles à deux étages, généralement habitées par les couches les plus riches. La construction ou la reconstruction d'églises allait de pair avec les autres constructions de la ville. La période d'érection des plus importants édifices du culte coïncide avec celle de la plus grande floraison économique (1700-1750). Le nombre des églises qui auraient été construites dans l'ancienne Voskopoja varie selon les différentes sources. Nous avons réussi à relever les vestiges de 24 églises, dont il ne subsiste que celles citées ci-dessus.

En ce qui concerne le style architectural de ces églises, qui étaient toutes presque intactes en 1916, nous ne nous rallions pas à l'opinion de certains auteurs, qui les considèrent comme de style byzantin. Se fondant sur le type des églises existantes ainsi que sur des calcographies du XVIIIe siècle, nous sommes d'avis que la plupart d'entre elles était du type de la basilique ancienne sans coupole.

De l'extérieur, les églises de Voskopoje n'ont pas un aspect particulièrement frappant, mais dès qu'on y pénètre on ne peut retenir son admiration pour la majesté de l'architecture intérieure et la qualité artistique des travaux qui la décorent. Les sculptures sur bois et les peintures murales sont l'oeuvre des plus éminents artistes de l'époque, notamment de David Selenicasi, de Kostandin et Athanas Korçari, etc. Voskopoja ne se contentait pas du travail des maîtres et des artistes locaux, elle en faisait venir aussi d'autres, des plus habiles et des plus renommés en Albanie, en Macédoine ou ailleurs; c'est pourquoi ses églises furent tenues par les contemporains pour les plus belles de la Turquie d'Europe.

A Voskopoje, la possibilité de se procurer sur place les matériaux de construction favorisait aussi le développement des activités du bâtiment. Aucun facteur n'y faisait donc défaut pour que le bâtiment connût un vigoureux essor.

DO NOT COPY

On y disposait, entre autres, des maîtres d'ancienne tradition des régions d'Opari, de Korçë et de Kolonjë, qui ont construit de leurs mains une infinité d'ouvrages et de maisons dans toute l'Albanie du Sud jusqu'au littoral. Assurément, le rythme rapide des constructions dans cette ville, qui atteignit rapidement le chiffre de plusieurs milliers d'habitants, nécessita le concours des meilleurs bâtisseurs de l'Albanie du Sud, de la Macédoine, de la Thessalie, etc., comme cela apparaît notamment de certaines inscriptions. Néanmoins, sans égard aux influences négligeables et aux emprunts possibles qui durent probablement être faits chez les pays voisins, en particulier par suite des fréquents contacts et des relations commerciales que Voskopoja entretenait avec eux, l'architecture, qui y atteignit une haute qualité durant le siècle de son épanouissement, ne rompt nullement avec la tradition locale et, partant, porte nécessairement la marque du terrain sur lequel elle a été élaborée.

A ce propos, nous réfutons l'affirmation de Kalimak, non fondée et nullement convaincante, selon laquelle l'architecture de la ville serait d'inspiration viennoise ou encore l'interprétation de Mihalopoulo et Martiniani, qui, bien à tort, croient y voir des traits vénitiens ou macédoniens avec une certaine influence turque. Si les contacts des grands marchands de Voskopoja avec l'Europe, et en particulier avec Venise et l'Autriche, doivent, assurément, avoir entraîné l'emprunt de modèles étrangers dans la forme extérieure des habitations et particulièrement des intérieurs, cette influence n'en a pas moins été d'importance négligeable. Elle devait se traduire tout au plus dans l'emprunt de quelque détail ou, de façon plus marquée, dans quelques rares bâtiments isolés.

Finalement, cette étude élucide le problème de la population maximale qui dut être celle de Voskopojë au XVIIIe siècle, et à propos de laquelle subsistent encore de la part de certains auteurs des estimations outrées. La plupart d'entre eux, sans même avoir visité Voskopoje, ont été influencés par le grand bruit qui entoura la publication à Bucarest, en 1909, par Aleksiq, d'un document en latin à ce sujet. Nous nous sommes fixé pour tâche de bien étudier sur place ce problème également. Les nombreux vestiges de maisons et des superficies habitées, les traces des rues étroites qui séparaient autrefois les maisons, (ce qui atteste une forte densité de construction et coïncide par ailleurs avec les sources historiques), le nombre élevé d'églises et leur grande capacité, qui permettait à chacune d'entre elles de contenir près de 1.000 personnes, le grand nombre de moulins, d'aqueducs et de fontaines, ainsi que plusieurs autres facteurs, tels que les dimensions des maisons, le nombre moyen des membres de chaque famille, et d'autres éléments encore, nous ont convaincu, à la suite de certaines confrontations faites avec des parcelles et des quartiers de certaines de nos villes à densité et relief analogue, et de calculs appropriés, que Voskopoje, au XVIIIe siècle, devait compter de 25 à 30.000 habitants, en un temps où d'autres villes telles que Sofia, Athènes, Belgrade, en atteignaient à peine 20.000

Emin RIZA — Burhan STRAZIMIRI

DO NOT COPY

VËSHTRIM MBI ARKITEKTURËN E QYTETIT TË KORÇËS

Qyteti i Korçës është relativisht i ri po të krahasohet me qytete të tilla me histori mijëvjeçare si Durrësi, Shkodra, Berati etj. Burimet historike në lidhje me Korçën nuk janë aq të plota për të krijuar një kuadër të qartë të zhvillimit të qytetit në kohë, aq më tepër për të vendosur një kufi kalimi nga Korça-fshat në Korçën-qytet. Sidoqoftë, burimet që ekzistojnë janë vjelur duke hedhur dhe mendime mbi zhvillimin e Korçës.

Deri më sot teza më e drejtë duket ajo, simbas së cilës, Korça gjatë shek. XVII qe një fshat i madh që një shekull më vonë fitoi tiparet e një qyteti të vogël. [1]) Kjo qendër fillon të marrë një zhvillim më të madh mbas shkatërrimit të Voskopojës në vitet 1769-1779, dhe në gjysmën e parë të shek. XIX zhvillohet me shpejtësi, aq sa rreth vitit 1850 duhet konsideruar si një konkurente e rrezikshme e Janinës, përsa i përket tregëtisë me viset e Veriut. Kjo tezë na duket e drejtë, aty të çon dhe studimi i arkitekturës së qytetit dhe, veçanërisht, shtrirja e lagjeve të qytetit, formulimi i tyre urbanistik dhe pazari i Korçës.

Qyteti i Korçës shtrihet në rrafshin e fushës me të njejtin emër; lugina e Devollit e lidh me Maqedoninë, ndërsa rrugë të tjera e lidhin këtë qendër me trevat e Epirit dhe të Shqipërisë së Mesme e të Veriut.

Qyteti në gjëndjen e sotme, me përjashtim të xhamisë së Mirahorit e ndërtuar më 1496, nuk ruan monumente të lashta; kishat janë ndërtime relativisht të reja. Siç dihet, në mesjetë ndërtimet e kultit ishin në shumë raste embrioni dhe epiqendra rreth të cilave ndërtoheshin lagjet e para të qendrave të banuara. I tillë duhet të ketë qënë dhe zhvillimi i Korçës, lagjet e para të së cilës ka shumë mundësi të kenë rrethuar xhaminë e Mirahorit, duke u shtrirë më tepër në pjesën J-P të saj. Dhe zona e shtrirjes së Pazarit, pranë xhamisë, duhet të ketë qënë që në krye aty ku ndodhet tashti. Sot nuk ka asnjë gjurmë që të dokumentojë për këto mendime, mbasi ndërtimet si në lagjen që shtrihet pranë xhamisë ashtu dhe në Pazar nuk shkojnë më tutje mesit të shek. XVIII.

Në gjëndjen e sotme, zona e vjetër e banuar e qytetit është pa dyshim ajo mbi monumentin e luftëtarit kombëtar. Në këtë lagje të bie në sy qartë urbanistika tipike e qyteteve tona mesjetare, e përgjithësisht ballkanike: rrugica të ngushta plot dredha, pa ndonjë kriter urbanistik, madje dhe shumë banesa të kësaj lagje janë të tipeve që dallojnë nga banesa korçare si tip, e cila siç do shohim, fillon të predominojë që prej fundit të shek. XVIII. Zona që shtrihet në mes të shetitoreve «Republika» dhe asaj «Luftëtari Kombëtar» si dhe zona mbi shetitoren «Republika», është relativisht e re. Duke pranuar si më të sakta të dhënat e Feliks de Bozhurit dhe të Likut, të cilët kaluan në Korçë në fillim të shek. XIX, mësojmë se Korça në këtë kohë kishte rreth 3000 banorë e 450 banesa. Ndërsa në vitin 1859 kishte 10.000 banorë, pra brënda një gjysmë shekulli kemi një rritje tepër të madhe të qytetit. [2]) Kësaj periudhe i përket

1) Z. Shkodra, **«Të dhëna mbi Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut sipas një dokumenti të shek. XVII»,** B.U.SH.T., Seria Shkencat shoqërore, Nr. 4, 1958.
2) Të dhënat e mësipërme janë marrë nga Z. Shkodra, Vep. cit.

sigurisht dhe zgjerimi i qytetit në lagjet e përmëndura më sipër, si dhe një pjesë e mirë e pazarit.

Në të dy qëndrat e banuara që përmëndëm më sipër, të cilat nuk janë më të hershme se fundi i shek. të XVIII, spikat qartë një koncept urbanistik shumë më i përparuar se ai i lagjeve të vjetra të qytetit. Rrugët janë të drejta, duke formuar parcela



Fig. 1

ndërtimi me forma të rregullta gjeometrike. Anash këtyre parcelave, buzë rrugëve, ndërtohen banesat prane njera tjetres. Me qarte spikat ky koncept urbanistik i avancuar për konen ne lagjen Barç të ndertuar në një terren me pjerresi te lehtë. Dhe pazari i Korçës në pjesën qëndrore të tij, e cila ruhet edhe tani, është i ndërtuar jo pa një koncept urbanistik, rrugët gjatësore dhe tërthore të drejta kalojnë përmes grumbujve të dyqaneve të vendosur varg në dy rreshta, shpinë me shpinë me njëri tjetrin.

Korça dhe pazari me arkitekturën e tyre shprehin qartë natyrën zejtaro-tregëtare të zhvilluar për kohën e këtij qyteti. Pazari shtrihet në pjesën veriperëndimore të qytetit në afërsi të xhamisë së Mirahorit. Dyqanet kanë qënë grupuar sipas zejeve, duke formuar tregje të veçanta si tregu i drithit, i peshkut, i bylmetit, i saraçëve, i kallajxhinjëve, i kovaçëve, etj. Dyqanet në përgjithësi janë dykatëshe, e pothuaj, gjithmonë me podrum (fig. 1). Kur dyqani i përkiste zejtarit, zakonisht në katin e dytë ishte punishte, ndërsa në katin e parë bëhej tregëtimi i prodhimeve; kur ai i përkiste tregëtarit, kati i sipërm ishte depo malli. Podrumet në të dy rastet shërbenin gjithashtu për depo.

Dyqanet janë të ndërtuar në përgjithësi me gurë, tulla ose me të dy materialet së bashku. Në ndërtimet më të hershme të pazarit ka gjetur një përdorim të gjërë mbulesa me qemer cilindrik, i cili mbulonte podrumin dhe, në disa raste, edhe katin e tij të parë. Në gjëndjen e sotme qepenet i gjejmë pothuaj të gjithë metalikë me palosje (fig. 2),



Fig. 2

vonë kanë hyrë në përdorim dhe qepenet në formë ruloni. Simbas një të dhëne i gjithë tregu i Korçës u dogj më 1879. Nga ky zjarr sigurisht që janë djegur strukturat e drurit, kështu që rikonstruksioni i pazarit nuk duhet të ketë sjellë ndryshime në vendosjen e vetë dyqaneve, por vetëm janë rindërtuar çatitë dhe përpunuar fasadat, të cilat në shumë raste kanë pësuar ndryshime dhe për nevoja thjesht estetike. Për analogji me pazaret e qyteteve të tjerë si të Shkodrës, Elbasanit, Krujës etj. mendojmë se përpara qepeneve metalikë dhe në Korçë duhet të kenë qënë përdorur qepenët dhe, ndofta, edhe tarabat e drurit.

Në krahasim me pazaret e qyteteve të lartpërmendur pazari i Korçës dallohet për ndërtime më solide, më higjenike e gjithësesi më të përpunuara (fig. 3).

Në zonën e pazarit kanë qënë ndërtuar në të kaluarën një numër i madh hanesh, prej të cilëve sot në gjëndje të dëmtuar ruhen vetëm tetë. Numri i madh i tyre në të kaluarën (rreth 15), hedh dritë mbi veprimtarinë e gjerë ekonomike të qytetit. Hanet janë kompozuar zakonisht në formë katërkëndëshe rreth një oborri të gjerë. Ambientet e fjetjes ndërtohen në katin e dytë. Para tyre, në tërë vargun e

DO NOT COPY

thyer të këtyre elementeve, kalon një galeri e ngushtë e hapur me funksion ndërlidhës. Kati i parë disa herë i mbuluar me qemer cilindrik, shërben për depo. Ngjitur me hanin janë stallat e kafshëve të ngarkesës. Hanet kishin një klientelë deridiku të përcaktuar simbas qendrave nga vinin bujtësit, kështu ata qenë emërtuar: Hani i Elbasanit, i Manastirit, i Shuleve, etj.

Kategoria arkitektonike interesante e qytetit është banesa. Dhe në Korçë ashtu si në qytetet e tjerë të vëndit gjejmë, në periudha të caktuara historike, disa tipe ose variante të preferuara banesash, duke qënë këto zgjidhje të kushtëzuara: a) nga faktorët ekonomikë e, më saktë, nga klasat dhe shtresat shoqërore që i ndërtonin, si dhe b) nga klima, terreni, materialet dhe traditat e ndërtimit.

Në banesat e qytetit të Korçës, vetëm një numër i vogël është i datuar. Mendimi ynë është se ato më të vjetrat nuk janë më të hershme se fundi i shek. të XVIII. Në dallim nga qytete të tillë si Gjirokastra, Berati dhe Shkodra, ku kishte një shtresë të rëndësishme feudalësh të mesëm e të vegjël edhe një shtresë tregëtarësh me tradita, të cilët që në shek. XVIII dhe më parë filluan të ndërtonin banesa të mëdha e solide, disa prej të cilave, ruhen dhe në ditët tona. Në Korçë gjatë shek. të XVIII nuk dimë të ketë pasur një shtresë të rëndësishme pronarësh e tregëtarësh, gjë që shpjegon dhe mungesën e banesave të vjetra në ditët tona. Duke pranuar si cakun e përafërt për zgjerimin e qytetit të Korçës, fillimin e shek. të XIX, në zonat e reja gjejmë një banesë me tipare të qarta qytetare, të ndërtuar në variante të ndryshme me të njejtën ide kompozicionale. Por krahas këtij tipi, në zonën e vjetër të qytetit mbi monumentin e Luftëtarit të Lirisë ruhen akoma disa banesa, që tregojnë se përpara se të zinte vënd tipi i ri i banesës, kanë qënë ndërtuar banesa të tipeve dhe llojeve të ndryshme. Gjurmët e këtyre banesave, që duhet të jenë ndërtuar gjatë shek. XVIII dhe, së bashku me tipin e ri të banesës, deri nga mezi i shek. XIX, janë të pakta, por sidoqoftë, ato japin një kuadër të përafërt të karakterit të banesës korçare, kur Korça ishte në fazën e kalimit nga një qendër e vogël me karakter më tepër fshatar në një qendër qytetare, d.m.th. kur elementi zejtar e tregëtar përbënte shumicën e banorëve dhe ishte forca prodhuese e qytetit. Po t'i klasifikojmë banesat në dy grupe: të hapura, ku përfshihen banesat me hajat dhe çardak, dhe të mbyllura, do të vëmë re gjithashtu, qenjen e të dy grupeve përpara se tipi i ri i banesës korçare të bëhej mbizotëruese.

Me interes është banesa në rrugën Shpresë Palla Nr. 12 (Tab. I). Kjo është një banesë tipike me çardak, me kat me përmasa të vogla. Banesa përbëhet nga dy ambiente, nga një në secilën kat, nga çardaku si dhe nga dy parahyrje, respektivisht në të dy ambientet. Dhoma e ndërtuar në çardak dhe ambienti nën të në hajat, duken qartë se janë shtesa të vona. Ambienti i katit përdhe është shtëpia e zjarrit; një çatma e ndan atë nga parahyrja dhe depoja. Shtëpia e zjarrit është e pajisur me oxhak dhe me një dollap në murin fundor. Tri dritare sigurojnë një ndriçim të mjaftueshëm të ambientit. Çardaku ngrihet mbi hajatin e katit përdhesë. Dyshemeja e çardakut dhe çatia mbi çardak mbahen nga shtylla druri. Shkallë të thjeshta druri të ndërtuara në qendër të çardakut lidhin të dy katet. Shkallët në nivelin e dyshemesë së çardakut mbyllen me kapakë druri. Ambienti i katit të dytë është dhoma e mirë, ajo është e pajisur me oxhak, një mafil të thjeshtë dhe, dy dollapë muri. Në çardak sheh një dritare me rrjetë druri. Tavani i drurit ka në qendër një rozetë me një punim të thjeshtë. Banesa deri në lartësinë 1.6 m nga toka është e ndërtuar me mur guri të lidhur me breza druri, ndërsa mbi këtë lartësi janë përdorur qerpiçë të lidhur gjithashtu me breza druri. Në katin e dytë është përdorur gjerësisht çatmaja. Nyja sanitare është në fundin e oborrit të vogël, para banesës. Banesa nuk është e datuar. Simbas nesh, ajo duhet të jetë ndërtuar nga një pronar i vogël toke rreth fundit të shek. XVIII. Banesë me çardak është edhe ajo në rrugën Spiro Velko, Nr. 9.



Fig. 3

Banesë e mbyllur interesante, është ajo në rrugën «Shpresë Palla» Nr. 12. Është një banesë dy-

katëshe me podrum (Tab. I, fig. 4). Mbi derën e hyrjes të mbuluar me qemer gjysëm rrethor, është murosur një pllakë guri që mban datën e ndërtimit 1850. Në gjëndjen e sotme, banesa ka pësuar ndryshime: shkallët nuk janë në vëndin e parë, ato janë shtyrë duke dalë jashtë konturit katërkëndësh këndrejtë të planimetrisë. Në fillim ato kanë qënë vendosur në krahun e djathtë të hyrjes, këto shkallë njërampëshe të çonin në një koridor të ngushtë të katit të dytë, i cili mbas çvendosjes së shkallëve u zgjerua dhe hapi vënd për krijimin e një ambienti të vogël. Një ndryshim të vogël ka pësuar dhe ambienti i dhomës së dimërit, i cili ka qënë më i madh në kohën e ndërtimit. Pra, banesa përbëhej në fillim prej podrumit dhe nga një ambient në të dy katet; i poshtmi është ambienti i gatimit dhe i qëndrimit,



Fig. 4

ndërsa i sipërmi është dhoma e mirë. Podrumi shërbente për depozitimin e ushqimeve. Banesa nuk ka asnjë zbukurim për t'u shënuar. Ajo është e ndërtuar me mur guri në të dy katet. Muratura përshkohet nga breza druri dhe lidhet me llaç balte me fugaturë llaç gëlqereje nga jashtë. Dora e parë e suvasë është me llaç balte, dora e dytë vetëm me gëlqere.

Banesa në rrugën «Mihal Grameno» Nr. 19 (Tab. II), e ndërtuar më 1841, është një ekzemplar origjinal në kompozimin e vet. Ajo përbëhet nga dy kate, në katin e parë janë ndërtuar katër ambiente, vetëm njëri prej të cilëve është i pajisur me oxhak, ndërsa tre të tjerët do të kenë shërbyer për depo. Në katin e dytë, janë vendosur katër ambiente dhe një qoshk i mbyllur. Në krahun e djathtë, më vonë, janë bërë disa transformime të vogla. Unikale është zgjidhja e shkallëve, ato fillojnë nga një parahyrje e katit të parë në të cilën të çojnë 3 harqe gjysmë rrethorë. Shkallët janë dyrampëshe, të ngushta e jo të volitshme. Mbi hyrjen (kafazin e shkallëve) është ndërtuar një qoshk i mbyllur, por i ndriçuar nga shumë dritare. Kompozimi dallohet për kompaktësinë dhe çfrytëzimin racional të sipërfaqes së banueshme. Banesa është e ndërtuar me mur guri në të dy katet. Strehët janë shumë të gjëra, dyfishe e të çveshura. Ka një përpjekje të ndijshme për t'i dhënë pamjes kryesore një trajtim të goditur.

Banesa në rrugën «Fan Noli» Nr. 2 (Tab. II) për nga kompozimi është e thjeshtë. Ajo të kujton një variant të banesës me çardak. Në planimetri, banesa ka formën e gërmës «L». Krahu i djathtë i saj ka podrume, njëri prej të cilëve përfshin edhe lartësinë e katit të parë, në gjysmën e kësaj lartësije përshkohet nga një dysheme. Kati i parë përfshin hajatin dhe dy ambiente banimi. Në katin e dytë, përveç çardakut të mbyllur, ka tre dhoma banimi. Banesa është ndërtuar me mur guri në të dy katet. Muratura është lidhur me llaç balte. Në katin e dytë balli i çardakut dhe dy faqet e dhomës në vazhdim të tij janë ndërtuar me skelet druri.

Në zonën e banuar mbi monumentin e Luftëtarit të Lirisë, ndodhen akoma në këmbë disa banesa ose pjesë të tyre, në të cilat në katin e dytë ka gjetur përdorim të gjerë muri i hollë me skelet druri të veshur me çatma; në disa raste krejt kati i dytë është ndërtuar me këtë teknikë. Strehët e tyre janë të mbyllura, të veshura me dërrasa ose pjesërisht me suva e pjesërisht me dërrasa. Erkeri gjen një përdorim të gjerë në to. Nga sa kemi vërejtur është vështirë të dallosh ndonjë koncept të caktuar në kompozimin e tyre; ato më tepër janë improvizime. Ndërtimi i tyre duhet konsideruar si një sprovë që nuk gjeti terren në Korçën me klimë të ftohtë, ku materiali tradicional guri e, më vonë edhe tulla kanë prioritet. Në Korçë gjenden dhe disa banesa që duhet t'i përkasin fillimit të shek. XIX, të cilat janë ndërtuar ose në të dy katet me qerpiç të lidhur me breza druri, ose deri në një farë lartësie me mur guri e pastaj me qerpiç, gjë që tregon se ky material ka qënë i përdorshëm. Si përfundim, në lidhje me arkitekturën e banesës së përhapur në Korçë

Do not copy

gjatë gjysmës së dytë të shek. të XVIII dhe më parë, kur banesa e re korçare, siç duket nuk kishte zënë vënd, mund të themi se në këtë qytet nuk gjen ndonjë tip të preferuar që të ketë pasur ndonjë përhapje të gjerë. Gjatë kësaj periudhe janë ngritur më shumë banesa të mbyllura të ndërtuara më tepër me gur, por të njohur dhe të përdorur janë dhe qerpiçi e skeleti i drurit. Banesat me kat, duket se kanë pasur përhapje mjaft të gjerë, mbasi shumë rrallë gjënden banesa të vjetra përdhese. Tipet e ndryshme të banesave të përmëndura më sipër vazhduan në një masë më të vogël të ndërtohen në Korçë dhe gjatë gjysmës së parë të shek. XIX krahas banesës së re korçare. Ndryshe nga banesa e vjetër, për banesën e re, të cilën duke mos munduar ta emërtojmë duke u bazuar në ndonjë karakteristikë funksionale, do ta quajmë thjeshtë «banesë korçare». Gjëndet një material i mjaftueshëm për të dhënë një kuadër të plotë të saj. Po e themi që në krye, banesa korçare, e ndërtuar në një numur jo të vogël variantesh por me një koncept të njëjtë, është banesë e shtresave të borgjezisë qytetare, duke filluar që prej zanatçiut të vogël e deri tek tregëtarët e pasur. Variantet e ndryshme shprehin qartë shtresëzimin shoqëror brënda klasës së borgjezisë qytetare të Korçës. Ne do t'i paraqesim këto variante, duke pasur për bazë në renditjen e tyre shkallën e ndërlikimit të tyre, i cili vërehet në shtimin e numurit të ambienteve duke ruajtur qartësinë dhe thjeshtësinë e skemës kompozicionale. Kjo renditje nuk është e karakterit kronologjik, as nuk duhet konsideruar si një zhvillim hap mbas hapi nga e thjeshta në të ndërlikuarën. Shumë prej këtyre varianteve do të jenë përdorur njëkohësisht.

Duke gjurmuar mbarë qytetin kemi arritur të dallojmë shtatë variante të ndryshme të banesës korçare, tre prej të cilave janë banesa njëkatëshe, ndërsa katër të tjera banesa dykatëshe.

Varianti më i thjeshtë i banesës korçare është një banesë e vogël katërkëndrejtë në planimetri. Përveç katit ajo ka dhe podrumin. Si podrumi ashtu dhe kati kanë të njëjtën zgjidhje planimetrike, dy ambiente në podrum, dhoma e dimrit, qilari, si dhe një ambient i vogël ndërlidhës, në fund të të cilit shkallë druri të cojnë në kat, të përbërë gjithashtu prej një salloni të vogël ndërlidhës dhe dy ambienteve anësh tij. Hyrjet për në podrum dhe në kat janë të veçanta. Shkallë guri të çojnë në një çardak të vogël para hyrjes në kat. Banesa e ka nyjen sanitare jashtë saj. Ambientet janë të vegjël dhe pa asnjë zbukurim. Vendosja e dhomës së dimrit në podrum, i cili është në fakt një gjysmë kati, se është i thelluar në tokë rreth 1 m, është një praktikë që përdoret gjerë në Korçën me dimër të ftohtë. Ky variant ndeshet sot mjaft rrallë. Banesa në rrugën «Sotir Meha», Nr. 13 është shëmbulli tipik i këtij varianti (Tab. III); ajo duhet të jetë ngritur rreth mesit të shekullit të kaluar dhe i përkiste një zanatçiu të vogël. Banesa është ndërtuar me mur guri.

Varianti i dytë ka të shtuar në njërin krah edhe një ambient të tretë në katin mbi podrum, duke marrë kështu banesa formën e gërmës «L» në planimetri. Banesa në rrugën «Jovan Vreto», Nr. 22 (Tab. III) është një shëmbull i këtij varianti. Duke qënë se asnjëri nga të dy ambientet e podrumit nuk përdoret për banim, komunikimi me të nga salloni është i panevojshëm. Si në variantin e parë, edhe këtu podrumi dhe kati kanë hyrje të veçanta. Ky variant është mjaft i përhapur në Korçë, madje edhe në ditët tona, sidomos duke përdorur ambientet e podrumit që thellohen pak në tokë, si guzhinë dhe dhoma qëndrimi gjatë dimrit.

Varianti më i zhvilluar i banesës korçare me një kat është ai që kompozohet duke vendosur nga të dy anët e një salloni nga dy ambiente; podrumi ndërtohet nën gjithë sipërfaqen e katit ose pjesërisht. Podrumi vazhdon të ketë hyrje të veçantë nga kati dhe, në shumicën e rasteve, komunikon me të dhe nëpër sallon. Ky variant ka pamje kryesore tërheqëse, në qendër shkallë guri, zakonisht dy krahëshe, të çojnë në një portik të vogël që mbahet nga dy kollona, më shpesh guri e disa herë edhe druri; mbi të ndërtohet një çati e zakonshme ose fronton. Dy ballet anësore janë simetrike kundrejt kësaj qendre të spikatur qartë. Ky variant është i përdorur gjerë në Korçë. Banesa në rrugën «Andon Zako Çajupi» Nr. 17 (Tab. IV, fig. 5) është shëmbull tipik i këtij varianti.

Të katër variantet e tjerë të banesës korçare, janë dykatëshe dhe kanë podrume sa sipërfaqja e kateve ose më të vogël. Në të gjithë këta variante, me përjashtime të rralla, gjejmë erkerin si një element karakteristik të përhapur mjaft gjerë në banesën korçare. Erkeri si element arkitektonik, njihet që prej kohësh shumë të vjetra. Në arkitekturën e banesës qytetare shqiptare, ai duhet të jetë një çfaqje relativisht e vonë, ndërsa në banesën fshatare të mjaft zonave gjejmë një përdorim të gjerë të një elementi arkitektonik, i cili në fakt ka funksionin e erkerit.

Në banesat me kat të Gjirokastrës, të Beratit, të Shkodrës dhe të Elbasanit të ndërtuara gjer në fillim të shek. të XIX, erkeri nuk është përdorur. Nga fillimi i shekullit të kaluar, ai gjen përdorim të gjerë veçanërisht në Berat e, ndofta dhe më parë, në Krujë. Në banesën korçare të ndërtuar në teren të rrafshët, erkeri i dalë në formë konsoli ose i mbështetur në kollona nuk bëhet i nevojshëm si në Berat, për të fituar sipërfaqe të banueshme në teren të thyer. Erkeri në Korçë është padyshim në radhë të

Botim Copy

parë një element funksional, një qoshk i mbyllur, por dhe vlera e tij dekorative ngrë mjaft peshë në përdorimin e gjerë të tij. Erkeri (fig. 6), i ndërtuar gjithmonë mbi hyrjen e banesës në variantet e pazhvilluara të banesës dykatëshe është zakonisht pjesë e sallonit, i cili pa këtë zvogëlohet shumë për shkak të shkallëve; erkeri në këto raste është një kënd intim për pushim. Në shumë raste ai është i ngritur një deri dy këmbë shkallë nga pjesa tjetër e



Fig. 5

sallonit dhe mer funksione banimi gjatë verës. Në variantet më të zhvilluara, në disa raste ai kthehet në një ambient më vete. Erkeri rrallë mbështetet mbi pajanta që shkarkojnë në muraturë, në shumicën e rasteve ai mbështetet mbi kollona. Kollonat ndërtohen edhe prej druri (fig. 7), por zakonisht ato janë prej guri dhe përfundojnë me kapitel. Numuri i kollonave është dy, ose katër. Erkeri ndriçohet nga një numur i madh dritaresh, që vendosen në ballë dhe anash. Në ballë, simbas madhësisë së erkerit, vendosen një deri më tri dritare, ndërsa anash, nga një në secilën faqe. Sipërfaqja e erkerit ndryshon sipas madhësisë së vetë banesës. Më të vegjëlit luhaten rreth përmasave 1 x 2 m, ndërsa ka edhe të tillë me përmasa 5.5 x 2 m.

Varianti më i thjeshtë dhe më i përhapur i banesës korçare me dy kate është kompozuar thjesht, duke pasur në katin e parë dy ambiente anash një salloni. Në fund të këtij, përballë hyrjes, ndërtohen shkallët për në katin e dytë, i cili ka të njëjtin kompozim, me ndryshimin se sallonit i shtohet dhe erkeri. Ashtu si dhe katet, podrumi zë dy ambiente, por ka dhe raste që ai përbëhet vetëm nga një ambient. Hyrja në podrum sigurohet me shkallë të vendosura nën ato që të çojnë në katin e dytë; disa herë në dyshemenë e ambienteve të katit të parë ndërtohet një kapak, nën të cilin vendosen shkallë të thjeshta që të çojnë në podrum. Qilari merr disa herë dhe zgjidhje interesante dhe praktike, si në banesën e rrugës së «Veteranëve» Nr. 36 të ndërtuar rreth vitit 1875. Ekzemplar tipik i këtij varianti është banesa në rrugën «Stefan Luarasi» Nr. 24 (Tab. IV) e ndërtuar në të dy katet me mur guri.

Varianti i pestë i banesës korçare e ka njërin krah më të dalë përpara; në të ndërtohen zakonisht dy ambiente, por ka dhe raste që ndërtohet një ambient i vetëm me një aneks të vogël pranë tij. Banesa në rrugën «Neim Nexhipi» Nr. 32 (Tab. V), është e këtij varianti. Një variant më i zhvilluar i



Fig. 6

banesës korçare është kompozuar duke vendosur nga dy ambiente anash sallonit në secilin kat. Ekzemplar tipik i këtij varianti është banesa në rrugën «Dodona», Nr. 13 (Tab. V), e ndërtuar në vitin 1871

DO NOT COPY



Fig. 7

Ajo ka një skemë të thjeshtë planimetrike dhe podrum në gjithë sipërfaqen e banesës; hyrja në të është e veçantë, por ajo komunikon dhe nga brënda me katet. Erkeri mbahet nga dy kollona druri. Pamja kryesore është mjaft e goditur. Të këtij varianti janë dhe disa banesa që kanë nga tre ambiente në çdo krah të salloneve në të dy katet, ndonjë herë vëndi i shkallëve del jashtë konturit të planimetrisë duke e lënë të pastër sipërfaqen e salloneve. Në këtë variant të banesës korçare mund të përfshihen edhe disa banesa shkallët e të cilave janë në njërin krah të sallonit, anash të cilave janë vendosur dy ambiente.

Varianti më i zhvilluar i banesës korçare me kat është banesa në rrugën «Evanthi Dvorani» Nr. 1 (Tab. VI), e ndërtuar më 1873. Ajo ka podrum dhe dy kate, shkallët janë anash sallonit. Në dallim nga variantet e tjerë, kjo banesë ka dy hyrje të trajtuara me të njëjtën gjuhë arkitektonike, por të punuara me materiale të ndryshme; njëra hyrje kryesore ka shkallë me gurë të punuar e parmak hekuri, ndërsa mbi shkallë, katër kollona guri mbajnë erkerin; hyrja sekondare ka kollona druri. Podrumi gjithashtu ka dy hyrje nën shkallët e jashtme. Sallonet e dy kateve janë me përmasa të mëdha. Banesa nuk ka ndonjë zbukurim dyert, tavanet, janë të thjeshtë. Banesa ka dy pamje kryesore, por dhe ato anësoret janë trajtuar me kujdes.

Banesa korçare është e vendosur në shumicën e rasteve me njerin ose dy ballet e saj nga rruga. Ajo rrethohet me mure të plotë guri, por një përdorim të gjerë kanë kangjellat e hekurta të punuara me shumë mjeshtëri. Porta e hyrjes për në oborr është gjithmonë dy flegërshe. Kur muri rrethues është prej guri, porta është prej druri, anash saj me gurë të latuar ndërtohen dy qoshet mbi të cilat vendoset një arkitra guri. Porta mbrohet nga një çati e vogël. Kur rrethimi bëhet me kangjella, edhe porta është metalike. Përpara derës ndërtohen dy sofa guri. Oborri i banesës korçare është zakonisht i vogël, në të gjejmë nyjen sanitare, që ndërtohet jashtë për arësye higjenike, si dhe një ambient që përdoret kryesisht në stinët e ngrohta për gatim e larje rrobash; në këtë guzhinë verore hasen shpesh, oxhaku dhe furra. Oborri shpesh shtrohet me pllaka guri; kur e lejon hapësira në të mbillen pemë frutore, kurse oborret e vegjël mbillen zakonisht me lule e mbahen mjaft mirë.

Zakonisht banesa korçare ndërtohet me mur gurī i cili lidhet me breza druri çdo 80-120 cm. Brezat e drurit duken ose janë të maskuar me muraturë. Muri i gurit, në shumicën e rasteve, lidhet me llaç balte, ndërsa nga jashtë fugatohet rëndë me llaç gëlqereje. Përdorim të madh kanë dhe tullat, që janë përdorur më vonë se guri. Skeleti i drurit përdoret më shpesh në konstruksionin e erkerit, por ai përdoret edhe disa herë në ballët e ambienteve anash erkerit dhe në ndarjet e brëndshme. Skeleti i drurit vishet me listela në dy faqet ose mbushet me tulla. Çatia ndërtohet me lëndë e mbulohet gjithmonë me tjegulla të lugéta. Strehët janë të shumta e të mbyllura; ato vishen me dërrasa, me listela e suva ose me kornizë guri. Dyshemet ndërtohen me trarë e mbulohen me dërrasa të afruara; podrumet ose janë përdhes ose shtrohen me pllaka guri. Tavanet janë prej dërrase, shumë rrallë me ndonjë zbukurim të thjeshtë ose me çatma të suvatuar. Dyert e dritaret janë punuar thjesht, pa zbukurime; dritaret zakonisht kanë sipër një lloj kornize druri. Shkallët e brëndshme janë gjithmonë prej druri. Me kujdes e shije punohen shkallët e jashtme të gurit, e sidomos kollonat dhe kapitelet prej guri që mbajnë erkerin. Në shumë raste kemi hasur suvatime të brëndshme të bëra në dorën e parë me llaç balte, ndërsa në të dytën me gëlqere, por përdoret dhe suvatimi i banesës me llaç gëlqereje. Nga jashtë banesa zakonisht nuk suvatohet, por nga çereku i tretë i shekullit të kaluar fillon të përhapet dhe suvatimi nga jashtë i banesës, duke sajuar në shumë raste dekoracione të ndryshme, më tepër neoklasike, rreth dritareve, dyerve dhe në kornizë.

Banesa korçare përbën një tip më vete në kua-

DO NOT COPY

drin e banesës qytetare shqiptare, tip i cili në variantet më të zhvilluara është shkalla më e lartë që arriti banesa e borgjezisë qytetare, deri në fundin e shekullit të kaluar. Në Shkodër kjo klasë, deri rreth mesit të shekullit të kaluar, ndërtoi banesa të hapura me çardak, ndërsa në Berat, ku ishte më e dobët, ndërtoi banesa të vogëla të tipit me gjysmë kat. Duke filluar nga çereku i parë i shekullit të kaluar, një përhapje të gjerë morën banesat e mbyllura me katin e dytë të ndërtuar me çatma e, shpesh herë, të dalë në formë erkeri, por këto nuk qenë ndonjë tip i kristalizuar, por më tepër adaptime dhe rikonstruksione të vjetra me mur guri në të dy katet. Në Elbasan e Kavajë nga borgjezia qytetare u ndërtuan kryesisht banesa përdhese (dollmallije), ndërsa në Tiranë krahas saj dhe tipi i banesës tiranase, tipe këto me shumë tipare të banesës fshatare. Në dallim nga këto, në Korçë kemi një banesë që në të gjithë variantet e saj shpreh qartë natyrën e vet qytetare.

Të gjitha variantet e banesës korçare kanë një skemë të qartë e të thjeshtë kompozicionale, në qendër salloni dhe anash tij ambientet e banimit. Shkallët vendosen pothuaj gjithmonë në fund të sallonit dhe rrallë, anash tij. Salloni ka zakonisht përmasa të vogla në banesa njëkatëshe ku kryen vetëm funksione ndërlidhëse, ndërsa në ato dykatëshe salloni i katit të dytë trajtohet më me kujdes duke qënë se erkeri, i cili është nga ana hapësinore pjesë e tij, merr gjatë verës funksione banimi. Në banesën korçare nuk gjejmë ndonjë dallim të qartë funksional sipas kateve, por gjithmonë ambjenti i qëndrimit dhe i gatimit është në katin e parë, ndërsa ai i pritjes në të dytin dhe, në përgjithësi, kati i parë banohet në dimër, ndërsa i dyti në verë. Simbas funksionit, në banesën korçare dallojmë tri lloje ambientesh; ambientet e depozitimit të rezervave ushqimore dhe të lëndëve djegëse, ambientet e banimit dhe ambientin e pritjes. Ambientet e depozitimit të rezervave ushqimore e të druve ose qilaret janë një element i përhershëm në banesën korçare; kjo shpjegohet kryesisht me klimën e ftohtë. Numuri i këtyre ambienteve është i ndryshëm, po së paku një ambient i tillë ndërtohet gjithmonë. Qilaret ndërtohen përherë në podrum i cili rreth dy të tretat e lartësisë së tij i ka nën tokë. Në banesat e mëdha ambientet e podrumit shërbenin edhe për depozitim mallrash (në familjet tregëtare). Shpesh, sidomos në variantet e banesës njëkatëshe, një ose më shumë ambiente të podrumit shërbejnë edhe për banim; në këto raste, pothuaj gjysma e lartësisë së podrumit është mbi tokë. Dhoma e dimrit ndërtohet në podrum mbasi ai është ambienti më i ngrohtë. Qilaret ndriçohen dobët nëpërmjet dritaresh të vogla. Ambientet e banimit përbëhen zakonisht nga dhoma e dimrit ku gjatë kësaj periudhe dhe gatuhet. Ajo i përgjigjet shtëpisë së zjarrit dhe pajiset me oxhak, dollap muri e, shpesh, me musandër. Gjatë verës zakonisht qëndrohet në një ambient të katit të dytë si dhe në qoshkun e erkerit. Tipet e zhvilluara të banesës korçare kanë një numër ambientesh banimi që shërbejnë për funksione të ndryshme. Ambienti i pritjes është i thjeshtë, pa ndonjë trajtim të veçantë që ta dallojë nga ambientet e tjera. Banesa korçare zakonisht i ka jashtë ambientet sanitare.

Banesa korçare, në krahasim me banesat me çardak të Shkodrës dhe të Beratit, me banesat Gjirokastrite, madje dhe me banesat e shtresave zejtaro-tregëtare të Beratit, dallohet për një qartësi e thjeshtësi të theksuar, jo vetëm përsa i përket kompozimit, por dhe trajtimit të interierëve dhe elementëve të tillë arkitektonikë si tavane, dyer, dollape muri, etj. Në banesën korçare nuk ka asnjë zbukurim për t'u vënë re; gdhëndjet në dru, në tavanet, dollapet, apo dhe në ndonjë musandër mungojnë; oxhaqet janë fare të thjeshtë. Në dallim nga banesa gjirokastrite dhe ajo me çardak, dhomat janë me dimensione jo të mëdha, plot dritë e të pangarkuara me zbukurime. Në banesën korçare mungon krejtësisht harku dhe qemeri, elementa konstruktivë aq të përhapur në Gjirokastër, Berat dhe Shkodër. Banesa korçare është një banesë ekonomike, e cila i përgjigjej shumë mirë borgjezisë së re në rritje, për të cilën ishin të panevojshme dhe jo racionale, qoftë skema kompozicionale e banesave me çardak dhe e asaj gjirokastrite, qoftë dhe ornamentika e tyre shumë e pasur dhe jo utilitare. Dhe trajtimi i pamjeve të jashtëme të banesës korçare tregon qartë për karakterin thjesht qytetar të saj. Pamja kryesore theksohet në qendër, ku vendoset gjithmonë erkeri i mbajtur zakonisht nga kollona të punuara në gur me shije, që i jep një gjallëri të madhe kësaj pamje. (fig. 8). Dritaret e mëdha, strehët e mbyllura dhe të vogla, përdorimi i gjerë i

3) J. Bourcart. **Les confins albanais administrés par la France,** Paris 1922 dhe **L'Albanie et les Albanais,** Paris 1921.
4) M. Urban. **Die Siedlungen Sudalbanies.**
5) **Historia e Shqipërisë,** I 1959, 410.
6) Histori e Shqipërisë, **po aty.**
7) G. Kozhuharov — **Bëllgarskata kësha prez pet stoletiia,** Sofija 1967.
8) B Kojiç — **Stara gradska i seoska arhitektura u Srbiji,** Beograd 1949.

elementëve neoklasikë, janë tipare të pamjes kryesore të banesës korçare. As pamjet e tjera nuk lihen pas dore; në rastet kur janë buzë rrugëve ato trajtohen me kujdes.

Banesa korçare gjatë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar dhe deri nga vitet 30 të këtij shekulli gjeti një përhapje të gjerë në shumë qytete, qendra



Fig. 8

të vogla, madje edhe në disa fshatra të rrethit të Korçës. Të tilla banesa, sidomos të variantit dykatësh me dy ambiente në secilin kat, si dhe nga katër ambiente në çdo kat, i gjejmë të ndërtuara dhe në Tiranë, Fier, Pogradec, etj. Te këto banesa, skema kompozicionale e të cilave është e njejtë me atë të banesës korçare, në shumë raste erkeri mungon ose, në vend të tij, ndërtohet ballkoni. Përhapja e gjerë e këtij tipi sidomos në qytetet e rinj ose me zhvillim të shpejtë si Tirana, tregon se kjo banesë ishte ajo që plotësonte më mirë kërkesat e borgjezisë së re në rritje, e cila kërkon një banesë ekonomike dhe të thjeshtë.

Banesa korçare është bërë e njohur deri më sot nga Zhak Burkari, [3] duke u emërtuar prej këtij banesë e tipit maqedon, madje ky autor dhe vetë qytetin e Korçës e quan të tipit maqedon. Po të ishte ky emërtim aspak karakterizues vetëm i këtij autori, i cili ishte specialist i një fushe tepër të largët nga ajo e arkitekturës, ndoshta ky pagëzim mund të kalohej pa u ndalur më gjatë. Por ky emërtim u pranua pa u peshuar mirë dhe nga M. Urbani [4]) i cili njihte shumë më mirë problemet e urbanizimit në përgjithësi dhe banesës në veçanti. Madje atë e gjejmë dhe në botimin e parë të Historisë së Shqipërisë. [5] Burkardi në këtë emërtim të banesës korçare është nisur kryesisht nga një element arkitektonik, nga erkeri ose «ballkoni i mbyllur», siç e quan ai. Ky autor ka bërë një punë me vlerë duke bërë tipizimin e banesës fshatare në shumë zona të Shqipërisë së Jugut. Njëri prej këtyre tipeve është dhe: «banesa me gur e tipit maqedon». (Burkardi pranë termit maqedon ka vënë në kllapa «me ballkon të mbyllur»). Kuptohet qartë se ballkoni i mbyllur, simbas këtij autori, është tipari kryesor që e ka çuar atë në cilësimin e banesës së tipit maqedon. Në një botim tjetër, në një karakterizim pak më të gjerë të tipeve të banesës shqiptare, gjejmë këtë formulim: «Banesat e tipit maqedon të përhapura kryesisht në Shqipërinë lindore dhe jugore janë me dritare të mëdha dhe të shumta. Dritaret e mesit të katit janë me konsol, duke formuar një lloj ballkoni të mbyllur. Mbulesa është shumë e rrafshët...». Dhe në këtë karakterizim, erkerit i jepet në fakt vëndi kryesor, meqë cilësimi i parë dhe i tretë janë tepër të përgjithshëm. Dhe në vëll. I të Historisë së Shqipërisë [6]) i jepet vendi kryesor erkerit me karakterizimin e të ashtuquajturit «tip maqedon». Dihet mirëfillit se erkeri është një element i lashtë i përdorur gjerësisht në banesat ballkanase, sidomos gjatë shek. XVIII-XIX, ai është përhapur dhe në shumë qytete të Maqedonisë. Në Berat në formë erkeri del shpesh i gjithë kati i dytë. Siç duket Burkardi këndej është nisur për të emërtuar banesën korçare të tipit maqedon. Po të kish vizituar Burkardi Beratin, ka shumë të ngjarë ti kishte dhënë një emërtim tjetër banesës korçare ose, duke e ruajtur po atë emërtim, ti gruponte gabimisht, siç bëhet në Historinë e Shqipërisë, banesat e Beratit (ato që janë me erker në katin e dytë) si të të njëjtit tip me ato të Korçës. Nga ana metodologjike shihet sheshit se një emërtim i tillë nuk është aspak i bazuar. Ai është krejt formal; kompozimi planimetriko-volumor e mjaft faktorë të tjerë vendimtarë për të karakterizuar një tip banese, nuk merren fare parasysh. Pra, emërtimi i Burkardit nuk është i drejtë. Emërtimi «banesa korçare» për tipin e banesës së përshkruar në këtë artikull, na duket se shpreh vendin e veçantë që zë ky tip banese në arkitekturën e banesës qytetare shqiptare.

Në anë tjetër nga sa njohim në Maqedoni nuk gjejmë të përhapur gjërësisht një tip banese që të jetë i njëjtë me banesën korçare. Më afër përsa i përket kompozimit qëndrojnë disa banesa në Koprivshica të Bullgarisë, të ndërtuara rreth mesit të shek. të XIX. [7]) Tek B. Kojici [8]) gjejmë kompozime shumë të ngjashme me banesën korçare në disa qytete të Serbisë, të Kosovës, etj. dhe në përgjithësi në banesën që ay autor e quan të tipit simetrik. Por jemi të me-

DO NOT COPY

ndimit se këto paralele nuk duhet të na çojnë në ndonjë përfundim të tillë, se diku duhet kërkuar një qendër rrezatimi nga ku të jenë përhapur këto ndikime. Nga fundi i shek. të XVIII dhe sidomos gjatë gjysmës së parë të shek. të XIX, në arkitekturën e banesës ballkanike gjejmë shumë elemente të përbashkët, si në kompozimin e tyre, ashtu edhe në përdorimin e gjerë të disa elementeve të veçantë arkitektonikë më tepër në trajtimin e pamjeve kryesore. Dhe kjo shpjegohet me gjallërimin për herë e më të madh të shtresave të borgjezisë qytetare, që po fitonin peshë në saje të rolit të rëndësishëm që luanin në jetën e këtyre qyteteve që, kohë më parë, kish filluar të marrë tiparet e një ekonomie kapitaliste. Lidhjet tregëtare ishin një faktor që sillte pasoja edhe në arkitekturë. Por pa nënvleftësuar këtë faktor ne jemi të mendimit se lindja e një tipi të ri ose, më saktë, preferenca e një forme të caktuar të një kategorie arkitektonike kur atë e kërkojnë kushtet, siç është rasti ynë, kur borgjezia qytetare e Korçës pa tradita po rritej shpejt dhe kërkonte si një klasë e formuar të materializonte specifikën e vet në mënyrën e jetës në një tip banese të përshtatëshme, ky tip u formua brënda një kohe relativisht të shkurtër. Duke pasur parasysh faktin se banesa qytetare shqiptare që në mesin e shek. të XVIII kishte arritur një zhvillim të madh, se mjeshtrit shqiptarë gëzonin një përvojë të çmuar teknike, duhet ta konsiderojmë kristalizimin relativisht të shpejtë të këtij tipi si një fenomen të shpjegueshëm. Si përfundim mund të themi se banesa korçare është një banesë tipike e borgjezisë së re shqiptare, e cila gjatë shek. të XIX po afirmohej si fuqi ekonomike.

Banesa korçare u formua si tip në një vënd me traditat në fushën e banesës, ajo mori gjithshka që i duhej nga kjo traditë, sidomos në lëmin teknik dhe në elementë të veçantë arkitektonikë dhe, në përputhje me nevojat e jetës borgjeze, mori zgjidhje racionale për kohën. Paralelet me arkitekturën qytetare ballkanike të së njëjtës periudhë shpjegohen me faktin se, borgjezia shqiptare kishte filluar të zgjeronte fushën e veprimtarisë së vet dhe të kishte marrëdhënie tregëtare me shumë qëndra, duke krijuar kushte për influenca dhe huazime reciproke. Borgjezia e re ballkanike, pavarësisht nga kombësia, kishte një bazë të fortë afrimi që përbënte shkakun kryesor të çfaqjeve paralele në shumë fenomene të veprimtarisë së saj, duke përfshirë këtu dhe banesën. Me zgjerimin e tregjeve, me krijimin e lidhjeve të gjera në mes të rajoneve të ndryshme, kjo klasë po thyente atë izolim dhe autarki ekonomike të shekujve të mëparshëm, e cila ishte një nga faktorët kryesor që kushtëzoi atë larmi tipesh e formash arkitektonike të banesës popullore shqiptare.

DO NOT COPY

Banesa në rrugën Shpresa Palla Nr12



Pamje kryesore



Kati I-rë



Kati II-të

BANESA në rrugën Shpresa Palla Nr10



Pamje kryesore



Kati I-rë

Kati II-të



Kati III-të



DO NOT COPY

TAB. II

Banesa në rr. Mihal Grameno Nr. 19



Pamje kryesore

Banesa në rr. Fan Noli Nr. 2



Pamje kryesore

Kati i I-rë



Kati i I-rë



Kati i II-te



Kati i II-te



Tab II

DO NOT COPY

Banesë në rr. Jovan Vreto Nr 22





Podrumi

Kati I-re



Banese në rr Sotir Meha Nr 13





Podrumi



Kati I-re

DO NOT COPY

TAB. IV

Banesë në rr Stefan Luarasi Nr 24



Banese në rr Andon Zako Çajupi Nr 17



Kati i I-re



Podrumi



Kati i II-të



Kati i I-re



DO NOT COPY

Banese ne rr. Dodona Nr. 13



Banesë ne rr. Neim Nexhipi Nr. 32





Podrumi



Kati I-re



Kati I-re

Kati II-të





Kati I-re

DO NOT COPY

Banese në rr. Evanthi Dvorani Nr.1



Pamje krysore



Pamje e mbrapme



Podrumi



Kati I I-rë



Kati I II-të

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Emin Riza — Burhan Strazimiri

APERCU DE L'ARCHITECTURE DE LA VILLE DE KORÇË

RESUME

La ville de Korçë est relativement récente si on la compare à des cités à l'histoire séculaire comme Durrës, Shkodra et Berat. Les sources historiques relatives à Korçë ne sont pas assez complètes pour offrir un tableau bien défini du développement de la ville au cours des temps. Quoi qu'il en soit, les sources à ce sujet ne font pas entièrement défaut.

En nous fondant sur l'héritage architectonique que l'on observe encore aujourd'hui dans la ville, il nous semble judicieux de penser que Korçë a connu, du XVIIe au XVIIIe siècle, un processus de développement qui l'a fait passer de l'état de bourg à celui de ville, c'est-à-dire d'agglomération dotée d'une économie dominée par la production artisanale et marchande. La ruine de Voskopoje, de 1768 à 1779, donna une vigoureuse impulsion à l'essor de Korçe, qui devint, au milieu du XIXe siècle, un important centre de production et d'échanges pour l'Albanie du sud-est. La ville, dans son etat actuel, à l'exception de la mosquée de Mirshor, construite en 1496, ne conserve pas de monuments très anciens, les églises étant de construction relativement récente.

La plus ancienne zone habitée est, dans l'état actuel de la ville, celle qui domine le monument du Combattant National. Dans ce quartier, on est frappé par la conception urbaniste propre à nos villes du bas moyen âge, et plus généralement aux cités balkaniques: rues étroites très tortueuses, sans aucun critère d'urbanisme. L'autre partie de la ville, la zone située sur la droite du boulevard de la République, et celle comprise entre ce boulevard et celui du Combattant National est relativement récente. Si l'on en croit les données que nous fournissent F. de Beaujour et Leake, qui ont séjourné à Korçë au début du XIXe siècle, Korçë aurait compté à l'époque 3.000 habitants et 450 maisons. En 1859, le nombre de ses habitants s'était élevé à 10.000, ce qui atteste d'une nette augmentation de la population en un demi-siècle. C'est de cette période que doit dater sûrement aussi l'extension de la ville aux quartiers précités, extension qui a dû commencer par la zone comprise entre les deux boulevards. Le Marché de Korçë a dû connaitre à la même époque un sensible développement. Dans les deux nouvelles zones habitées, qui ne sont pas antérieures à la fin du XVIIIIe siècle, apparaît clairement une conception urbaniste beaucoup plus avancée que celle des anciens quartiers. Les rues sont rectilignes, et forment par leurs intersections des lots de construction de formes géométriques régulières.

Le marché s'étend au nord-est de la ville à proximité de la mosquée de Mirshor. Les magasins sont groupés selon les métiers; les espaces découverts réservés à l'échange de produits agricoles, du poisson, etc., étaient nettement délimités. De façon générale, les magasins sont à un étage et presque tous pourvus d'un sous-sol. Quand la boutique était propriété de l'artisan, le premier étage était généralement réservé

DO NOT COPY

à l'atelier cependant que la vente des marchandises se faisait au rez-de-chaussée; quand la boutique appartenait à un commerçant, l'étage supérieur servait de dépôt de marchandises. Dans les deux cas, les sous-sols étaient également utilisés comme dépôts. Les magasins sont généralement construits en pierres, en briques, ou avec ces deux matériaux combinés. Dans les anciennes boutiques on trouve un fréquent usage de la voûte cylindrique, qui recouvre généralement les sous-sols, et, dans certains cas, le rez-de-chaussée. Les façades sont traitées en des langues architecturales diverses qui reflètent les diverss époques de construction. Un grand nombre des boutiques ont été reconstruites pour pouvoir s'adapter aux exigences de l'époque, mais surtout après tes fréquents incendies, et notamment après celui de 1879, qui endommagea gravement le Marché.

Dans la zone du Marché, s'élevaient autrefois un certain nombre d'auberges, une quinzaine environ. Elles étaient généralement de forme rectangulaire ou polygonale, les bâtiments entourant une large cour. Le rez-de-chaussée servait de dépôt, le premier étage de dortoir. Les chambrées étaient longées d'une galerie étroite qui les faisait communiquer entre elles.

L'élément architectural le plus intéresant de la ville est représenté sans conteste par les maisons d'habitation. A Korçë comme dans les autres villes du pays l'on observe, suivant les diverses périodes historiques, plusieurs types de maison, dont le choix semble avoir été principalement conditionné par des facteurs économiques, ou plus précisément par la nature des classes et des couches sociales qui les faisaient construire.

Etant approximativement établi que l'extension de la ville de Korçë s'amorce au début du XIXe siècle, l'on trouve, principalement dans les zones nouvelles, une habitation aux traits nettement urbains, construite selon diverses variantes auxquelles préside la même idée compositionnelle. Aux côtés de cette habitation, se rencontrent aussi certains exemplaires, qui jettent la lumière sur le type d'habitation existant dans la ville avant que le type précité ne devînt prépondérant, dans le premier quart du siècle dernier.

En ce qui concerne l'architecture du type d'habitation qui prévalait dans la seconde moitié du XVIIIe siècle et antérieurement, lorsque, apparemment, le nouveau type de maison ne s'était pas imposé, l'on peut dire que l'on n'observe pas dans la ville un type préféré, prépondérant. On construisait alors en même temps des maisons aux murs clos et des maisons à «tchardak», cependant que les maisons de plus d'un étage devaient également être répandues.

A la différence de ce qu'il en est pour l'ancien type, sur le nouveau type que, faute de pouvoir la caractériser par quelque trait compositionnel, nous appellerons simplement maison de Korçë, on dispose de matériaux suffisants pour pouvoir en former un tableau complet. Une étude minutieuse et fouillée de toute la ville nous a permis d'en dégager sept variantes diverses, dont trois sont à simple rez-de-chaussée, et les quatre autres à un étage. Ces variantes s'inspirent de la même idée compositionnelle, mais elles se distinguent par le nombre des pièces, leur disposition et leur mode de construction.

Les diverses variantes de la maison de Korçë obéissent dans leur conception à un schéma clair et simple: un vestibule central entouré des pièces d'habitation. L'escalier est presque toujours situé au fond du vestibule et, rarement, sur son côté. Le vestibule est généralement de petites dimensions. Dans les maisons à simple rez-de-chaussée il n'a qu'une fonction de liaison; dans celles à un étage, le vestibule du premier est plus soigneusement aménagé, la véranda couverte en encorbellement qui s'y intègre étant habitée en été. Les différents étages de la maison de Korçë ne présentent pas de nette distinction fonctionnelle. Le rez-de-chaussée est généralement habité dans la saison froide, le premier dans la saison chaude.

La maison de Korçë constitue, dans l'ensemble des habitations urbaines albanaises, un type distinct qui, dans ses variantes les plus évoluées, représente le plus haut degré atteint par la maison de la bourgeoisie citadine jusqu'à la fin du siècle passé.

DO NOT COPY

Elle se distingue de la maison à «tchardak» de Shkodra et de Berat, et de la maison type de Gjirokastër, voire de la maison des couches artisanales et marchandes de Berat, non seulement par la netteté et la simplicité de la composition, mais aussi par la manière dont sont traités les intérieurs et les éléments architectoniques tels que plafonds, portes, placards, etc. Ceux-ci, en effet ne comportent aucun ornement; les plafonds, armoires ou placards, sont nus de toute sculpture sur bois, les cheminées sont des plus simples. Les pièces, à la différence de celles des maisons de Gjirokastër et des maisons à «tchardak», sont de grandes dimensions, très éclairées et sobres d'ornements. Dans l'habitation de Korçë, l'arc et le voûte, éléments de construction si répandus à Gjirokastër, Berat et Shkodër, sont totalement absents. La maison de Korça est une habitation économique, qui répond parfaitement aux besoins de la bourgeoisie nouvelle en croissance, pour laquelle le type des maisons à «tchardak» et celui des maisons de Gjirokastër, à trop riche conception ornementale, et peu utilitaires, sont inutiles et irrationnnels. De même, l'aspect extérieur de la maison de Korçë témoigne clairement de son caractère esssentiellement urbain. La partie médiane de la construction est la plus marquante. C'est là que se situe toujours le balcon fermé, soutenu généralement par des colonnes en pierre travaillées avec goût, et qui relève l'aspect de la façade. Les grandes fenêtres, les avant-toits fermés, le large usage des éléments néo-classiques, sont les traits caractéristiques de la façade de la maison de Korça. Les autres faces non plus ne sont pas négligées surtout lorsqu'elles bordent la rue.

Durant la seconde moitié du siècle passé jusqu'aux années 30 de ce siècle, le type de maison de Korçë s'est largement répandu dans de nombreuses villes et localités et même dans certains villages du district de Korçë. On trouve aussi de ces maisons, en particulier de celles à un étage sur rez-de-chaussée, avec deux ou quatre pièces à chaque étage, dans les villes de Tirana, Fier, Pogradec, etc. Dans ces maisons dont la conception s'apparente à celle des maisons de Korça, frequemment la véranda en encorbellement fait défaut ou bien l'on trouve à sa place un balcon.

La vaste diffusion de ce type d'habitation, surtout dans les villes nouvelles, ou en rapide croissance comme Tirana, témoigne que c'était celui qui satisfaisait le mieux aux exigences de l'époque.

La maison de Korçë a notamment fait l'objet de l'intérêt de Jacques Bourcart, qui la qualifie de maison de type macédonien. Cette appellation a été admise sans examen attentif par M. Urban lui-même, qui connaissait pourtant beaucoup mieux les problèmes d'urbanisme de notre pays et ceux de l'habitation en particulier. On retrouve même cette dénomination dans la première édition de l'Histoire d'Albanie. Pour donner cette appelation à la maison de Korçë, Bourcart a considéré la véranda, qu'il appelle «balcon fermé», comme le principal élément architectonique de la construction. On sait bien que c'est là un élément d'ancienne date, utilisé largement dans les habitations balkaniques surtout aux XVIIIe et XIXe siècles. Il est également courant dans nombre de villes de Macédoine, où, comme à Berat notamment, tout le premier étage est parfois en surplomb. Apparemment, c'est sur cet élément que Bourcart s'est fondé pour lui donner cette dénomination. Du point de vue méthodologique, il est évident qu'une telle dénomination est très mal fondée et, dirions-nous, purement formelle. La disposition planimétrique et la répartition des volumes ainsi que maints autres facteurs déterminants dans la caractérisation d'un type d'habitation ne sont pas du tout considérés. Aussi la qualification de Bourcart est-elle inexacte. Celle de maison-type de Korçë pour le genre d'habitation qui prédomina à Korçë à partir du premier quart du XIXe siècle, nous paraît rendre beaucoup mieux la place particulière que ce type d'habitation occupe dans l'ensemble de l'architecture urbaine albanaise.

Des maisons assez semblables, quant à leur composition, à l'habitation-type de Korçë se retrouvent dans un bon nombre de villes des Balkans. Ces similitudes ne doivent pas, à notre sens, nous induire à conclure qu'il convient de rechercher un foyer d'où se seraient répandues ces influences. Vers la fin du XVIIIe siècle, et surtout dans la première moitié du XIXe siècle, on relève, dans l'architecture de l'habitation balkani-

DO NOT COPY

que, de nombreux éléments communs, en ce qui concerne tant la composition que la large utilisation de certains éléments architectoniques, et particulièrement dans la conception des faces principales. Cela s'explique par l'essor croissant des couches de la bourgeoisie citadine dont le rôle ne cesse de grandir dans l'économie de ces villes, qui avaient revêtu des traits capitalistes. Les rapports commerciaux influaient en effet aussi sur l'architecture. Toutefois, sans négliger ce facteur, nous estimons que l'apparition d'un type nouveau peut se réaliser en un temps relativement bref quand il est requis par les circonstances. La bourgeoisie citadine de Korçë, dépourvue de traditions, croissait rapidement et cherchait, en tant que classe désormais constituée, à adapter son mode de vie et son habitation à ses traits propres. Vu que l'habitation urbaine albanaise avait, dès le milieu du XVIIIe siècle, atteint un haut degré de développement et que les maîtres albanais possédaient une précieuse expérience technique, la cristallisation relativement rapide de ce type est parfaitement explicable. D'autre part, il faut également avoir en vue que l'habitation de Korçë se distingue par une composition d'une netteté et d'une simplicité facilement réalisables.

L'habitation-type de Korçë s'est cristallisée dans une agglomération dotée de traditions en matière d'habitation. Elle a puisé dans cette tradition tout ce qui lui était nécessaire, particulièrement en matière technique et quant à certains éléments architectoniques. D'autre part, répondant aux exigences de la vie bourgeoise, les solutions qu'elle apporte sont rationnelles pour l'époque. Les similitudes avec l'architecture urbaine balkanique de la même période s'expliquent par le fait que la bourgeoisie albanaise avait commencé à étendre son champ d'activité et à entretenir des relations commerciales avec de nombreux centres, créant ainsi les conditions favorables à des influences et des emprunts réciproques. La bourgeoisie balkanique avait une puissante base commune, et c'était le motif essentiel des nombreuses analogies qui apparaissent dans maints phénomènes de son activité, y compris le bâtiment. Avec l'extension des marchés et des rapports entre les diverses régions, cette classe sortit de l'isolement et de l'autarcie économique dans lesquels elle avait été plongée durant les siècles antérieurs. Il faut voir là un des principaux facteurs qui déterminèrent la variété de types et de formes architecturales de l'habitation populaire albanaise.

Miltiadh PAPA

DO NOT COPY

MBROJTJA LIGJORE E PASURIVE KULTURALE NË VËNDIN TONË

Aktet normative që dualën para çlirimit të vëndit në fushën e pasurive kulturale

Nga fundi i shek. XIX edhe në Perandorinë Turke mbrojtja e pasurive kulturale u sanksionua me ligj. Me sa dimë ne, akti i parë normativ në këtë fushë, që pati fuqi edhe për vendin tonë është rregullorja e brëndëshme e datës 1/V/1305 (1889).[1]) për rregullimin e muzeumit mbretëror, prej 43 nenesh. Muzeumi, siç del nga rregullorja ishte dhe institucioni që merrej me mbrojtjen dhe studimin e pasurive kulturale. Simbas nenit 1 të kësaj rregulloreje, «muzeumi mbretëror ka për qëllim të zbulojë dhe të mbrojë të gjitha ndërtesat e vjetra dhe monumentet që do të dalin në dritë nga gërmimet, t'i vendosë ato në muzeum, t'i publikojë me anë botimesh, t'i rregullojë ato për ekspozim», etj.

Në pragun e Shpalljes së Pavarësisë së vëndit hyri në fuqi ligji i datës 8/7/1328 (1912)[2]) i përbërë nga 6 artikuj, «mbi mbrojtjen e monumenteve (abidat)». Simbas artikullit 5 të këtij ligji, «përgjithësisht fortesat (kështjellat) e vjetra, burgjet, muret (ledhet) e çdo ndërtesë (monumenti) quhen antikitete». Ky ligj mbeti në fuqi deri në vitin 1929. Të dy këto ligje, megjithëse duhet të zbatoheshin edhe në tokat shqiptare, mbetën vetëm formale në kushtet e sundimit feudal turk.

Pas Shpalljes së Pavarësisë, akti i parë zyrtar, për pasuritë e kulturës materiale, është qarkorja e Ministrisë së Arësimit Nr. 923 datë 19/6/1922,[3]) drejtuar gjithë kryeinspektorive dhe inspektorive të arësimit, me anën e së cilës ato porositeshin të kujdeseshin për gjetjen dhe ruajtjen e vjetërsirave. Në qarkore thuhet se, me fjalën «vjetërsira», duhet të kuptohen «jo vetëm gurë rrase të mbishkruara apo jo, shtatore ose koka njerëzish prej guri apo metali, pare, enë balte ose metali, gjëra të gjetura nëpër varre, vegla të vjetra, petrofacta (gurë të punuara), etj., si dhe ndonjë shtyllë guri e dergjur diku, ndonjë kishë apo xhami e vjetër, një qytet ose një katund, ndonjë mur fortese të vjetër, për të cilin ka ndonjë gojëdhanë, libra apo dorëshkrime të vjetra, varreza ose tyrbe, etj.». Pra, siç shihet, përkufizimi i pasurive kulturale i dhënë me këtë akt është i kufizuar.

Akti më i plotë juridik, se ata që u përmendën, është ligji Nr. 129, datë 28/Maj/1929 «Mbi monumentet kombëtare».[4]) Ky ligj, me sa duket, është marrë nga shtetet e tjera dhe karakteri i tij del qartë në artikullin 17, i cili le në fuqi të gjitha traktatet e përfunduara ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve të huaja lidhur me gërmimet arkeologjike, për të cilat do të flitet më poshtë.

Megjithëse për shumë çështje në ligj flitet me hollësi, probleme të rëndësishme për fatin e pasurive kulturale, siç është restaurimi dhe përballimi i fondeve që nevojiteshin për mbrojtjen e tyre, as që parashikoheshin fare. Artikulli 5 flet për ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre, por mënyra se si do të realizoheshin ato

1) Qarkore e Ministrisë së Brëndëshme, viti 1922.
2) Kodi, Seria II, 599.
3) Qarkore e Ministrisë së Brëndëshme, viti 1922.
4) Fletore Zyrtare, Nr. 34, datë 12/Qershor/1929.

as që përmëndet. Pra, del e qartë se as formalisht nuk parashikohej caktimi i fondeve për mbrojtjen e pasurive kulturale.

Gjithashtu çështje të tjera me shumë rëndësi për fatin e pasurive kulturale, siç është prishja ose ndryshimi i formës së tyre simbas artikullit 8 të ligjit, ishin të lejueshme dhe për këtë duhej vetëm aprovimi i Ministrisë së Arësimit e cila nuk ka pasur asnjë organ të specializuar në këtë drejtim (megjithëse krijimin e tyre e parashikonte art. 3). Çdo objekt me vlerë, po të jepej leje formale mund të prishej, por në shumicën e rasteve, simbas informatave që kemi marrë, kjo leje as që është kërkuar fare.

Një problem tjetër me rëndësi, që nuk trajtohet në këtë ligj, është çështja e studimit dhe e proçedurës së shpalljes së pasurive kulturale. Në fakt deri më 1945 asnjë listë e pasurive kulturale nuk ishte shpallur dhe as që dihej se cila prej tyre mbrohej nga shteti.

Artikulli e ngarkonte Ministrinë e Arësimit të pregatiste një ligj më të plotë për monumentet kombëtare, por ky ligj para çlirimit të vëndit as që u aprovua, përderisa nuk është botuar në asnjë organ zyrtar.

Shtetet kapitaliste, menjëherë pas luftës së parë botërore, filluan t'i shtrinin kthetrat e tyre në vëndin tonë dhe shumë shpejt ja vunë syrin pasurive tona kulturale. E para, Qeveria Franceze në 1923 lidhi marrëveshje me Qeverinë Shqiptare për mbi rrënimet arkeologjike në Shqipëri, që u aprovua nga parlamenti shqiptar më 29/9/1923[5]). Me ardhjen e Zogut në fuqi, shëmbullin e Francës e ndoqi Italia fashiste e cila lidhi një marrëveshje analoge, bile me kushte më të rënda për vëndin tonë, që u aprovua me ligjin e datës 30/12/1927[6]).

Të dy këto marrëveshje arësyen e lidhjes së tyre e gjejnë në të ashtuquajtura «marrëdhëniet e mira miqësore» që ekzistonin respektivisht midis qeverive të Francës dhe të Italisë me qeverinë Shqiptare, si dhe në eksperiencën e specialistëve të këtyre shteteve në këtë fushë. Në bazë të marrëveshjeve qeverisë Franceze i jepej privilegji eksklusiv për të bërë gërmime arkeologjike në prefekturën e Shkodrës (nënprefekturat e Malsisë së Madhe, të Dukagjinit dhe të Pukës), në prefekturën e Durrësit (në qytetin dhe katundet për rreth si dhe në nënprefekturën e Krujës), në prefekturën e Beratit (në nënprefekturën e Fierit dhe të Mallakastrës); kurse qeverisë Italiane, në prefekturat e Dibrës dhe të Kosovës, të Vlorës, të Gjirokastrës, të Korçës, si dhe në nënprefekturën e Tiranës. Misioni arkeologjik italian, duke marrë leje, mund të bënte kërkime arkeologjike dhe studime edhe në vëndet me karakter sekret ushtarak.

Në bazë të artikullit 4 të marrëveshjes me Francën dhe të artikullit 6 të marrëveshjes me Italinë, Shteti Shqiptar kishte të drejtë të kontrollonte studimet dhe gërmimet që do të bënin misionet arkeologjike. Pranë tyre duhej të viheshin aqë delegatë (specialistë) shqiptarë sa specialistë të huaj do të punonin, të cilët kishin të drejtë të jipnin leje për gërmime, të bënin inventarin e sendeve të gjetura, etj. Kuptohet se kjo e drejtë ishte vetëm formale, mbasi në atë kohë (1923 dhe 1927) si edhe më vonë specialistë shqiptarë për këtë fushë mungonin. Në zonat e dhëna në koncesion Italisë, ishte krejtësisht e ndaluar të bëheshin gërmime dhe studime nga specialistë jo italianë. Pra, edhe sikur të kishte specialistë ose studjues shqiptarë në këtë fushë, ata nuk mund të bënin asnjë gërmim ose studim në këto zona (art. 7 i marrëveshjes).

Materialet që zbuloheshin në bazë të marrëveshies ishin pronë e Shtetit Shqiptar, por kjo nuk e ndalonte, sidomos misionin arkeologjik italian, të grabiste dhe të dërgonte fshehurazi jashtë shtetit edhe objekte me vlerë të madhe. Shitja e pasurive kulturale shteteve të huaja ishte e sanksionuar me ligj, përderisa në art. 6 të marrëveshjes me Francën dhe në art. 9 të marrëveshjes me Italinë, të dy këto shtete ruanin të drejtën e parablerjes për objektet me vlerë që zbuloheshin në zonat që kishin marrë në koncesion, po të shiteshin.

Në marrëveshjen me Italinë flitet për «mirënjohjen» e qeverisë Shqiptare ndaj qëllimeve të Italisë që do të ndihmonte me studimet e misionit arkeologjik në ndriçimin e historisë së Shqipërisë, në shënjë të së cilës mirënjohje, misionit arkeologjik italian i jepeshin të gjithë dyfishimet e sendeve që do të zbuloheshin.

Të drejtën eksklusive për studimin dhe hetimin e materialeve të zbuluara e ruanin plotësisht Franca dhe Italia për një kohë prej 5 vjetësh pas zbulimit, me kalimin e këtij afati Shteti Shqiptar mund t'i botonte për studime shkencore. Kuptohet se edhe kjo e drejtë mbetej krejt formale sepse, siç u përmënd, në Shqipëri atëhere jo vetëm që nuk kishte specialistë, por as që investoheshin fonde për këto qëllime.

Megjithëse në të dy marrëveshjet parashikohej se, përveç gërmimeve arkeologjike, misionet e huaja do të bënin studime në monumentet e gjinive të tjera dhe do të paraqitnin projekte për meremetimin e tyre, gjatë gjithë kohës që ato kanë qënë në

5) Fletore Zyrtare, Nr. 55, datë 11/10/1923.
6) Fletore Zyrtare, Nr. 2, datë 3/I/1928.

Botuar

fuqi nuk u bë gjë, përderisa asnjë monument nuk është restauruar.

Në vitin 1937 u lidh marrëveshja dhe me Qeverinë Rumune, në bazë të së cilës asaj i jepeshin në koncesion për të bërë gërmime arkeologjike disa zona në Sarandë, por misioni arkeologjik rumun nuk filloi fare punimet.

Megjithëse formalisht pasuritë tona të kulturës materiale edhe në të kaluarën mbroheshin me ligj, për to nuk kujdesej asnjë organ shtetëror dhe ato janë shkatërruar ose dëmtuar vazhdimisht. Po përmendim vetëm disa shëmbuj, të cilat na lejojnë të formojmë një ide se si trajtoheshin këto pasuri me vlerë të madhe në të kaluarën. Pothuajse të gjitha kishat e Myzeqesë deri në Berat janë ndërtuar me materiale që janë marrë nga qyteti antik i Apollonisë, bile dhe për sarajet e pashës së Beratit janë marrë 70 qerre me gurë. [7]) Pushtuesit turq, përveç se kanë grabitur nga Durrësi dhe çuar në Stamboll një sarkofag me vlerë, më 1870 lejuan francezët të mirrnin andej objekte me vlerë të madhe. Gjatë luftës së parë botërore dhe pas saj ushtritë pushtuese shkatërruan dhe grabitën shumë objekte me vlerë të pasurive tona kulturale.[8]) Më 1929 u prish ujësjellësi i kalasë së Gjirokastrës, gurët e të cilit u përdorën për shtruarjen e kalldrëmeve të rrugëve [9]) etj.

Mbrojtja e pasurive kulturale pas çlirimit të vëndit

Kongresi i Përmetit anulloi të gjitha traktatet skllavëronjëse me shtetet kapitaliste, bashkë me të cilët edhe ato që jipnin në koncesion pasuritë tona kulturale. Ligjet e shtetit të vjetër nuk mund t'i shërbenin më shtetit tonë të Demokracisë Popullore, prandaj dhe për mbrojtjen e pasurive kulturale ishte e nevojëshme të dilnin ligje të rinj.

Në vitin 1948 dolli akti i parë normativ pas çlirimit për mbrojtjen e pasurive kulturale, ligji Nr. 609, datë 24/5/1948, «Mbi mbrojtjen e monumenteve të kulturës dhe të sendeve natyrale të rralla», ku hidhen parimet kryesore për shpalljen, studimin, restaurimin dhe mbrojtjen e pasurive kulturale. Në vitin 1955, me vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 130, datë 5/4/1955, u aprovua rregullorja «Mbi ruajtjen e monumenteve të kulturës». Këto dy akte normative kanë dhënë një kontribut të shënuar në çështjen e mbrojtjes së pasurive kulturale, megjithëse dualën në një kohë kur eksperienca jonë në këtë drejtim pothuajse mungonte fare. Periudha që ka kaluar qysh nga koha e daljes së tyre nxori probleme të reja që kërkonin zgjidhje juridike, prandaj u aprovua dekreti Nr. 4874, datë 23/9/1971 «Mbi mbrojtjen e monumenteve kulturale dhe të pasurive natyrale të rralla», i cili abrogon dekretin Nr. 586, datë 17/3/1948.

Shpallja dhe grupimi i pasurive kulturale. Pasuri kulturale janë gjithë objektet e luajtëshme dhe të paluajtëshme me vlerë historike, kulturalo-artistike, ambientale dhe natyrale të rralla. Për që të vihen në mbrojtje të shtetit këto, ne radhe te pare, duhet të njihen, të studjohen dhe të aprovohen nga një organ i caktuar me ligj. Në bazë të nenit 3 të ligjit Nr. 609, datë 24/5/1948, pasuritë kulturale shpallen me vendim të një organi të caktuar nga qeveria, kurse rregullorja e aprovuar me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 130, datë 9/4/1955, përcakton se ato shpallen në listat të posaçme me vendim të rektoratit të U.SH.T. (pika 3), kurse ato me rëndesi të veçantë, me vendim të Këshillit të Ministrave (pika 4 dhe 5). Simbas dekretit Nr. 4874, datë 23/9/1971, pasuritë kulturale duhet të vihen në mbrojtje të shtetit me propozimin e institucioneve përkatëse dhe me aprovimin e Ministrisë së Arësimit dhe të Kulturës. Institucionet caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Por në raste kur pasuritë kulturale kanë rëndësi të veçantë, ose karakter kompleks si p.sh. një qytet-muze, një ansambël arkitektural etj., është e domosdoshme që këto të shpallen me vendim të Këshillit të Ministrave. Me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 172, datë 2/6/1961, janë shpallur qytete muze Berati, Gjirokastra, Pazari i vjetër i Krujës dhe pjesa e vjetër dhe nëntoka e qytetit të Durrësit. Shpallja e qyteteve muze është një problem i rëndësishëm që lidhet shumë me zhvillimin urbanistik, konditat e banimit, etj. të tyre, prandaj janë aprovuar dhe rregullore të veçanta për to.

Shpallja e pasurive kulturale në lista, siç parashikohet deri tani, sjell disa vështirësi sepse ato mund të dalin në periudha kohe relativisht të gjata, gjatë të cilave mund të mbeten pa mbrojtje pasuri kulturale të zbuluara rishtazi, prandaj sipas dekretit të ri, shpallja mund të bëhet kurdoherë pa u kushtëzuar me mbledhjen e tyre në lista. Mbrojtja e pasurive kulturale fillon qysh nga koha e shpalljes së vendimit, kurse për ato që janë pronë vetiake, qysh nga data që pronarët ose posedues it e tyre njoftohen për këtë.

7) Leake W. M., **«Trovels in Northern Greece,** Ed J. Rodwelt, London 1865», Vëllimi I, 273.
8) H. Ceka – Informata gojore.
9) Th. Kamberi – **Si furnizohej me ujë qyteti i Gjirokastrës?** Gazeta Bashkimi datë 27/I/1972.

Document

Lista e parë e monumenteve të kulturës u shpall me vendimin e presidiumit të Institutit të Shkencave dhe u botua në Gazetën Zyrtare Nr. 95, datë 6/10/1948. Ajo përfshinte vetëm 95 objekte, por duhet thënë se nuk përfshihej asnjë monument historik, banesë popullore, etj. Ky fakt është i shpjegueshëm se vetëm 4 vjet pas çlirimit nuk ishte bërë dhe as që mund të bëhej studim më i plotë i pasurive kulturale. Kjo listë ka qënë në fuqi gjer sa u shpall tjetra me vendimin Nr. 6, datë 15/I/1963, të rektoratit të U.SH.T. e cila, me disa ndryshime është edhe sot në fuqi.

Kur konstatohet se një objekt me rëndësi nuk është shpallur pasuri kulturale, duhet të vihet në mbrojtje shtetërore paraprake deri sa ai të studjohet përfundimisht dhe të vendoset për të.

Në bazë të pikës 2 të rregullores së aprovuar me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 130, datë 9/4/1955, pasuritë kulturale ndahen në këto kategori: të arkitekturës, të artit, të arkeologjisë dhe historike. Rregullorja e aprovuar nga Ministria e Arësimit dhe Kulturës datë 1/6/1972 këtyre kategorive u shton edhe pasuritë kulturale etnografike dhe ambientale, sepse ato kanë karakteristika të veçanta dhe përbëjnë kategori më vete.

Studimi, konservimi dhe restaurimi i pasurive kulturale. Studimi, konservimi dhe restaurimi i pasurive kulturale kërkojnë njohuri shkencore, prandaj ato mund t'i kryejë vetëm një institucion i specializuar në këtë drejtim. Në fillim këto detyra i kryente Instituti i Shkencave, më vonë U.SH.T., dhe sot Instituti i Monumenteve të Kulturës për pasuritë kulturale të paluajtëshme. Neni 2 i ligjit Nr. 609, datë 24/5/1948, thotë se «caktohet një organ i posaçëm për mbrojtjen dhe studimin shkencor të monumenteve», por nuk përcaktonte shprehimisht se kush mirret me restaurimin dhe konservimin e tyre. Këtë mungesë deri diku e plotësonte neni 9 ku autorizohet organi kompetent që me shpenzimet e shtetit «të bëjë të gjitha punimet e nevojëshme për mirëmbajtjen e monumentit të mbrojtur». Pika 10 e rregullores së Këshillit të Ministrave në mënyrë indirekte përcakton se U.SH.T. (në atë kohë) kryente riparimin dhe restaurimin e pasurive kulturale, por fjala «riparim» që përmëndet në këtë pikë nuk është e saktë.

Studimet shkencore në pasuritë kulturale, simbas dekretit të ri, mund të bëhen nga institucionet e krijuara për këtë qëllim, por nuk duhet të kuptohet se është e ndaluar krejtësisht që institucionet ose studjues të tjerë të merren me këtë, duhet vetëm që drejtimin ta ketë institucioni i ngarkuar dhe ai të lejojë të tjerët, kur plotësojnë kushtet e nevojshme, të mirren me studime të tilla.

Lidhur me restaurimin dhe konservimin e pasurive kulturale të paluajtëshme lind dhe problemi përballimit të shpenzimeve që nevojiten për këtë qëllim, kur ato janë në pronësi vetiake. Neni 9 i ligji Nr. 609, datë 24/5/1948, thotë se organi kompeten është i autorizuar që të kryejë të gjitha punime me shpenzimet e shtetit. Rregullorja e aprovua me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 130, datë 9/4/1955, këtë problem nuk e trajton në mënyrë direkte, por pika 9 e saj thotë: «drejtuesit e ndërmarrjeve, të institucioneve shtetërore, të jenë përgjegjës për ruajtjen dhe riparimet e nevojëshme simbas udhëzimeve të U.SH.T.». Këto dy dispozita nuk janë të plota dhe kanë shkaktuar keqkuptime përsa u përket shpenzimeve që bëheshin për restaurimin e banesave pronë vetiake. Udhëzimi Nr. 9, datë 14/12/1965, i ish Ministrisë së Kulturës dhe Arteve dhe i Ministrisë së Financave deri diku e trajtoi këtë problem. Në bazë të dekretit të ri, që në fakt është zbatuar në praktikë edhe para daljes së tij, të gjitha shpenzimet për restaurimin e pasurive kulturale pronë vetiake financohen nga shteti. Në këto raste shteti përballon vetëm ato shpenzime që bëhen për ruajtjen e vlerave historike dhe kulturale të tyre, kurse shpenzimet e tjera, që bëhen zakonisht për mbajtjen e objektit në gjëndje të përdorueshme paguhen nga pronari. Kur pronari nuk shlyen rregullisht detyrimin brënda një viti, pasuria kulturale, me vendim të komiteti ekzekutiv të K.P. të rrethit kalon në pronësi të shtetit.

Përdorimi i pasurive kulturale. Ligjet tona nuk përjashtojnë mundësinë e përdorimit të pasurive kulturale për nevoja praktike, por kjo bëhet gjithmonë me lejen e institucioneve kompetente. Në bazë të pikës 13 të rregullores së lartpërmëndur pasuritë kulturale, në lidhje me mundësinë e përdorimit të tyre, ndahen në këto kategori:

a) Ato që mund të përdoren për qëllime praktike, si mure të vjetra, godina të rrënuara etj.;

b) Ato që mund të përdoren, por ekskluzivisht për institucione shkencore dhe muzetë, duke ruajtur fizionominë e tyre artistike dhe estetike, mobilimin e brëndshëm dhe gjëndjen e jashtme, si p.sh. ndërtime kulti etj.;

c) Ato që mund të përdoren për shfrytëzim nga organizata, institucione dhe shtetas të ndryshëm, po pa cënuar vlerat e tyre.

Çështja e përdorimit të pasurive kulturale për qëllime të ndryshme ka rëndësi dhe lidhet drejtpërsëdrejti me mbrojtjen e tyre. Për çdo qëllim përdorimi, siç u përmënd më lart, bëhet vetëm me autorizimin e institucionit kompetent dhe vetëm për qëllime që i përshtaten natyrës së tyre dhe nuk i dëmtojnë.

Në bazë të pikës 14 të rregullores së lartpër-

Do not copy

mendur, ndërmjet institucioneve kompetente dhe institucioneve, organizatave dhe shtetasve, që do të përdorin pasuritë kulturale, lidhet kontrata përkatëse ku caktohen kushtet e përdorimit. Kontrata për përdorimin e pasurive kulturale nuk duhet të kontondohet me kontratën e qirasë, mbasi institucioni i ngarkuar me mbrojtjen nuk është pronar, por mirret vetëm me studimin, mbrojtjen dhe restaurimin e tyre. Kontratat e përdorimit duhet të lidhen dhe me personat që janë pronarë të pasurive kulturale. Mosrespektimi i kushteve të kontratës, përveç përgjegjësisë penale, sjell si pasojë dhe zgjidhjen e saj duke ua hequr të drejtën përdorimit atyre që i dëmtojnë.

Mbrojtja e pasurive kulturale. Neni 1 i ligjit Nr. 609, datë 24/5/1948, vinte në mbrojtje të shtetit pasuritë kulturale duke përmëndur gjithë kategoritë e tyre, kurse neni 1 i dekretligjit të ri në mënyrë më konçize përcakton se «monumentet e kulturës të luajtëshme dhe të paluajtëshme me vlerë historike, kulturalo-artistike, ambientale dhe natyrale të rrallë, vihen në mbrojtje të shtetit. Vlera shkencore historike, kulturale dhe estetike e tyre është pasuri e përbashkët e popullit». Vënja e këtyre pasurive në mbrojtje të shtetit lind detyrime ligjore në këtë drejtim për çdo institucion, organizatë ose shtetas dhe nuk mbetet vetëm detyrë shoqërore.

Detyrën e ruajtjes së pasurive kulturale ligji ua ngarkon këshillave populiore dhe komiteteve të tyre ekzekutive, të cilat duhet të vënë në dijeni institucionin kompetent për rastet e dëmtimit të tyre, duke propozuar masat që duhen marrë për t'i mbrojtur ose restauruar.

Për të evituar çdo rast dëmtimi të pasurive kulturale, në to nuk lejohet të bëhen gërmime, restaurime, të përdoren ose të preken në çdo mënyrë tjetër pa autorizimin e institucionit kompetent.

Në bazë të rregullores së qyteteve-muze, pasuritë kulturale, për efekt të mbrojtjes dhe të përcaktimit të shkallës dhe mënyrës së ndërhyrjes në to, ndahen në dy kategori. Të kategorisë së parë janë gjithë ato objekte që ruhen në tërësinë e tyre si nga brënda ashtu dhe nga jashtë dhe në to, nuk lejohet të bëhet asnjë punim ose ndërtim; kurse të kategorisë së dytë, janë ato që ruhen vetëm përsa i përket pamjes së jashtme, kurse nga brënda, mund të adaptohen dhe t'u përshtaten kushteve të banimit.

Mund të ketë raste që, për arësye të rëndësishme, është i pashmangshëm cënimi ose prishja e një objekti të paluajtshëm që është shpallur pasuri kulturale. Në këto raste, që janë të jashtëzakonshme, autorizimin e jep vetëm organi që ka të drejtën e shpalljes së tij pasuri kulturale. Para se të cënohet ose të prishet objekti është e domosdoshme që institucioni kompetent të kryejë të gjitha punimet shkencore në të (sondazhe, rilevime, fotografime, etj.).

Shpesh ndodh që me rastin e punimeve të ndryshme (hapje kanalesh, rrugësh, punimesh bujqësore, etj.) të zbulohen pasuri kulturale, prandaj punimet e filluara duhet të ndërpriten dhe, nëpërmjet komiteteve ekzekutive të K.P. të rretheve, të njoftohen institucionet kompetente. Brënda 5 ditëve nga koha e lajmërimit këto institucione duhet të dërgojnë përfaqësuesit e tyre për të verifikuar rëndësinë e pasurive kulturale të zbuluara. Nëqoftëse ato kanë vlerë, me vendim të institucionit kompetent punimet e filluara duhet të ndërpriten dhe të pësojnë ndryshime për të mos i dëmtuar. Kur vendimi i institucionit gjen kundërshtim, çështja vendoset përfundimisht nga organet më të larta. Në këto raste, nevojiten shpenzime suplimentare për ndryshimin e planeve të punimeve, të cilat projektit të pregatitur duhet të përballohen nga institucioni që i financon.

Ligjet tona në mënyrë kategorike ndalojnë nxjerrjen e pasurive kulturale jashtë shtetit dhe, në këtë drejtim asnjë organ i pushtetit apo i administratës shtetërore nuk ka të drejtë të vendosi të kundërtën. Vetëm në bazë të dekretit të ri, duhet të lejohet dërgimi jashtë shtetit i ekspozitave ose koleksioneve shkencore për shkëmbim, por gjithmonë me aprovimin e Ministrisë së Arësimit dhe të Kulturës.

Përsia e ligjeve tona mbi ato të paraçlirimit dhe në fushën e pasurive kulturale, është e padiskutueshme. Krahasimi, patjetër, as që duhet menduar se do të bëhet me ligjet e kohës së okupacionit otoman; por me atë të vitit 1929:

a) Në legjislacionin e vjetër as që përmendet fare organi që shpall pasuritë kulturale dhe procedura që ndiqet për këtë qëllim:

b) Çështja e restaurimit të pasurive kulturale dhe përballimi i shpenzimeve që nevojiten, në këtë rast, janë sanksionuar me ligj vetëm pas çlirimit;

c) Mënyrën e përballimit të shpenzimeve për restaurimin e pasurive kulturale, pronë vetiake, as që mendohet se mund të parashikonin dhe ligjet e paraçlirimit;

ç) Shitja e pasurive kulturale jashtë shtetit, ndalohet krejtësisht nga ligjet tona, kurse me ligjet e paraçlirimit lejohej.

Këto masa që përcaktohen nga dekret-ligji i ri, janë padyshim një kontribut i madh në drejtim të mbrojtjes, konservimit dhe restaurimit të këtij thesari shumë të çmuar të kulturës materiale që trashëgon populli jonë. S'ka dyshim se në t'ardhmen numuri i objekteve që do të vihen në mbrojtjen e shtetit do të shtohen dhe kjo e bën më të mprehtë nevojën e një zbatimi më rigoroz të legjislacionit në fuqi.

Miltiadh PAPA

LA PROTECTION LEGALE DU PATRIMOINE CULTUREL DANS NOTRE PAYS

Les actes législatifs et réglementaires relatifs à la protection du patrimoine culturel promulgués dans notre pays avant la Libération.

RESUME

Le premier acte réglementaire relatif à la protection du patrimoine culturel, mis en vigueur dans notre pays fut le règlement intérieur du musée impérial, comportant 43 articles. A la veille de la proclamation de l'Indépendance, le 8.7.1912, fut promulguée la loi «sur la protection des monuments», composée de 6 articles.

Après la proclamation de l'indépendance, le ministère de l'Instruction publique publia la circulaire N° 923, en date du 19.6.1922, recommandant aux inspections de l'Instruction Publique d'organiser la recherche et la conservation des objets anciens ou antiques: dalles portant des inscriptions ou non, statues humaines en pierre ou métal, monnaies, vases en terre cuite ou en métal, vieilles églises, vieilles villes ou vieux villages, anciennes forteresses, anciens livres ou manuscrits, tombeaux ou mausolées, etc. Par la suite, fut adoptée la loi n° 129, en date du 28 mai 1929 «Sur les monuments nationaux», qui maintenait en vigueur tous les traités conclus entre l'Albanie et les pays étrangers relatifs aux fouilles archéologiques. Cette loi ne fait pas mention de la restauration des richesses culturelles ni des moyens financiers nécessaires pour leur conservation. Rien, non plus, n'est envisagé quant à la procédure de détermination des richesses culturelles, ni quant aux critères de cette définition. Aussi, aucune liste de ces monuments ne parut jusqu'en 1945. Aussitôt après la Première Guerre mondiale, les pays capitalistes conclurent avec l'Albanie des traités qui asservissaient l'Albanie dans le domaine des richesses culturelles également. Ainsi, en 1923, le gouvernement français conclut avec le gouvernement albanais un accord «sur les ruines archéologiques» qui fut suivi, en 1927, d'un accord analogue avec le gouvernement italien, voire même à des conditions plus onéreuses. Aux termes de ces conventions, la France et l'Italie se voyaient reconnaître le droit exclusif de mener des fouilles archéologiques sur certains territoires albanais. Ce droit s'étendait également à l'étude des matériaux découverts et à leur publication pour une durée de 5 ans. En dépit des stipulations dans ce sens contenues dans les conventions, aucun travail de restauration ne fut entrepris sur les monuments d'autres genres.

En 1937, fut conclue avec le gouvernement roumain une convention lui accordant le droit d'entreprendre des fouilles archéologiques à Sarande, mais elle ne fut pas mise en application.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Bien que, de façon purement formelle, notre patrimoine culturel fût protégé par la loi même avant la libération, il n'était, en fait, l'objet d'aucun soin et les étrangers l'ont pillé, détruit, ou endommagé. Les exemples dans ce sens pullulent.

La protection du patrimoine culturel après la libération du pays

En 1948, fut promulguée la loi Nº 609 datée du 24.5.1948 «Sur la protection des monuments de la culture et les choses précieuses de la nature». En application de cette loi, l'arrêté Nº 130 du Conseil des Ministres, en date du 5.4.1955, approuvait le règlement «Sur la protection des monuments culturels». Ces deux actes réglementaires virent le jour en un temps où notre expérience dans le domaine des richesses culturelles était encore réduite, aussi certaines questions n'y étaient pas traitées. Néanmoins, Ils ont été d'un précieux concours pour la protection et la restauration des monuments. Le décret Nº 4874 en date du 23.9.71 «Sur la protection des monuments culturels et historiques et des choses précieuses de la nature» qui règle les problèmes ayant surgi dans la pratique et qui ne trouvaient pas de solution dans les actes antérieurs réglementaires, a été d'une grande aide pour la protection, l'étude et la restauration des richesses culturelles.

Les sites, les constructions ou objets divers sont définis richesses culturelles sur proposition des institutions intéressées et avec l'approbation du ministre de l'Instruction et de la Culture, cependant que les richesses culturelles de nature complexe ou d'une importance particulière sont définies telles par décision du Conseil des Ministres. La première liste des richesses culturelles a été proclamée par décision du Présidium du l'ancien Institut des Sciences et a été publiée dans le Journal Officiel Nº 95, daté du 6.10.1948, cependant que celle qui est en vigueur aujourd'hui encore a été approuvée par une décision du Rectorat de l'Université d'Etat de Tirana en date du 15.1.1963. L'étude, la conservation et la restauration des richesses culturelles sont sujettes à une autorisation préalable des institutions concernées. Aux termes de nos lois en vigueur, les frais entraînés par ces travaux sont couverts par l'Etat, alors que lorsqu'il s'agit de propriété personnelle les travaux sont également exécutés aux frais de l'Etat, les propriétaires ne remboursant, et ce par versements échelonnés, que les frais engagés pour le maintien en état de la construction.

L'utilisation des richesses culturelles est assujettie à l'autorisation des institutions intéressées, et pour des fins qui ne risquent pas d'altérer la valeur de ces richesses.

La protection des richesses culturelles commence dès le jour de l'entrée en vigueur de la décision qui les qualifie de telles, et, pour les propriétés privées, à partir du jour de la notification de la décision à leur propriétaire ou possesseur. La charge de leur protection est confiée aux conseils populaires et à leurs comités exécutifs. Dans les villes-musées, les richesses culturelles immobilières se divisent en deux catégories: celles qui sont protégées dans leur totalité et celle qui ne le sont que dans leur aspect extérieur.

Aux termes de nos lois en vigueur, la ruine ou la dégradation d'une richesse culturelle immobilière n'est autorisée que dans ces cas exceptionnels et toujours avec l'autorisation de l'organe comptétent. L'exportation des richesses culturelles est interdite, à l'exception des cas où des expositions sont organisées à l'étranger au titre des échanges avec l'étranger, et ce avec l'approbation du ministère de l'Instruction et de la Culture.

La supériorité de nos lois sur celles antérieures à la Libération dans le domaine des richesses culturelles est indiscutable. Il n'est que de rappeler que les anciennes lois ne faisaient même pas mention des organes qui définissaient ces richesses comme telles, ni ne prévoyaient des fonds à des fins de restauration. De plus, et c'est là l'essentiel, ces lois n'ont jamais été mises en application.

DO NOT COPY

Gjerak KARAISKAJ

MATERIALE DHE KUMTESA

TË DHËNA TË REJA PËR DATIMIN E KALASË SË ELBASANIT

DO NOT COPY

Në një punim të mëparshëm [1]) kemi bërë përshkrimin e kalasë së Elbasanit dhe jemi përpjekur ta datojmë atë, duke u mbështetur në analizën e teknikës së ndërtimit dhe në planimetrinë e monumentit. Me qënë se të dhënat burimore janë fare të pakta dhe asnjëra nuk bën fjalë, qoftë edhe tërthortë, për ndërtimin e kalasë, ishte e vështirë të përcaktohej koha e ndërtimit të saj brënda një diapazoni më të ngushtë se sa periudha që përfshin gjithë shekullin IV të erës sonë, përderisa ky datim nuk ishte i mbështetur në një sondazh arkeologjik. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për rindërtimet e bëra para pushtimit turk.

Gjatë punimeve restauruese, të kryera në vitin 1970, u gërmua Kulla Nr. 1, për të restauruar disa pjesë arkitektonike të mbuluara pjesërisht nga dheu. Gjatë tremujorit I të vitit 1971, u gërmua hyrja lindore e kalasë. Nga sondazhi i kryer në Kullën Nr. 1, si dhe në portën lindore, u përfituan disa të dhëna të reja, që na vlejnë për të bërë një datim më të saktë të kalasë, të cilat do të përpiqemi t'i paraqesim në këtë punim.

Sondazhi në Kullën Nr. 1 arriti deri në taban, në një thellësi prej 4.5 m. dhe na dha një stratigrafi të qartë horizontale (fig. 1). Në këtë mënyrë mundëm të dallonim tri shtresa kulturale kryesore, që lidhen me tri periudhat e ndërtimit të kalasë. Shtresa e parë (fig. 1), kishte një trashësi prej rreth 0.5 m., ngjyra e dheut ishte kafe e errët në të zezë. Aty u zbuluan me shumicë fragmente keramike të shek. IV-VI, kryesisht enësh guzhine me parete të holla, vegje, etj., si dhe tjegullash mbi të cilat dalloheshin shënja gishtash që kishin krijuar vizatime në formë vijash paralele, të valëzuara apo rrethore.

Shtresa e dytë, me trashësi 1.25 m., përbëhej prej dheu argjilor në ngjyrë okër. Ajo përmbante kryesisht keramikë ndërtimi, në të cilën kishte edhe fragmente tjegullash me shënja gishtash të gjetura në shtresën e parë. Nga materialet më të rëndësishme të kësaj shtrese janë disa fragmente tullash me anë të rumbullakosura nga njëra faqe, me stampën e një delfini me degë ulliri në gojë, të ngjashme me tullat e traktit bizantin pranë muzeut. Fragmente të tjerë tullash kanë të stampuar kryqe (fig. 2) si dhe një monogram të tipit me dy shtaga vertikale me gërma të vendosura brënda tyre (fig. 2). Pranë shtagës së majtë është kapur një germë me përmasa të vogla. Këto tipe monogramesh janë datuar nga Vajgandi prej fundit të shek. IV deri nga fundi i shek. VI. [2])

Shtresa e tretë, 2.4 m e trashë, ndahej në tre horizonte të paraqitura në fig. 1 me gërmat A, B dhe C. Kjo shtresë përmbante objekte që datohen pas shek. XV, deri në ditët tona. Horizonti A përbëhej prej mbeturinash druri të kalbur. Kishte një trashësi

1) Gj. Karaiskaj, *Kalaja e Elbasanit*, Monumentet Nr. 1, 1971, f. 61.
2) K. Weigand, **Ein bisher verkanntes Diptychon symmachorum,** Jahrb. des Deutschen Archeologischen Inst. Band 52, 1937, f. 121-138 shih dhe C. H. Вобчев; два монограмни печата върху тухли от креп осните стени на серика, «Археология» книга 2, 1970, f. 64-69.

prej 6 cm dhe shtrirje gati horizontale. Ai ndante rigorozisht shtresat II dhe III, të cilat u përkasin periudhave krejtësisht të diferencuara dhe të largëta. Nuk ka dyshim që horizonti A përfaqëson nivelin e tabanit të kullës në periudhën e rindërtimit të kalasë nga turqit më 1466 dhe është krijuar nga rënia e dyshemesë apo e konstruksioneve të tjera prej druri.

Nga sondazhi u zbulua krejtësisht porta e kullës (fig. 3), e cila është 3.75 m e lartë, 1.8 m [3]) e gjerë nga ana e brëndshme dhe 1.5 m nga ana e jashtme e kullës. Ajo, si dhe portat e kullave ndërmjetëse, është e mbuluar me një qemer tullash prej dy rreshtash. Pragun dhe pjesën e poshtëme të shpatullave nga ana e jashtme i ka prej guri të punuar. Qemeri i kullës është cilindrik, me gjatësi baze 1.5 m, kështuqë skajet e tij nga ana e mbrendshme e kullës përputhen me shpatullat e portës, ndërsa nga jashtë, duke qënë se porta është më e ngushtë se baza e qemerit, krijohen në të dy anët dhëmbëzime. Qemeri është ndërtuar krejtësisht prej tullash, ashtu si edhe qemeret e portave në kullat ndërmjetëse.

Lartësia e murit të vjetër në këtë kullë arrin 5 m. Nga sondazhi u zbuluan dy dritare të periudhës së parë të ndërtimit (TAB IV – a, dhe b), të vendosura 2.75 m. mbi nivelin e tabanit, të cilat shërbenin për ndriçimin e shkallëve. Njëra nga këto dritare ruan gjurmët e vjetra vetëm në pjesën e poshtme të shpatullës së djathtë (b), ndërsa tjetra është ruajtur e plotë. Kjo e fundit është mbuluar me një hark tullash prej një rreshti. Është 85 cm e gjerë nga ana e mbrendshme e kullës dhe ngushtohet deri në rreth 20 cm, nga ana e jashtme. Dritarja ka një lartësi prej 1.60 m dhe është e mbyllur në pjesën e sipërme nga një mur i mëvonshëm.

Në një nivel me fundin e dritareve dallohen gjurmët e disa vrimave, për vendosjen e trarëve të skelave. Ato janë katërkëndëshe me përmasa 20 x x 18 cm dhe qëndrojnë 1.5 m larg njëra tjetrës. Nga gërmimi u zbulua një mur masiv me gjerësi 2 m dhe i lartë 1.5 (TAB IV). Përmbi këtë mur vazhdonte shtresa II kulturale, e përbërë nga keramika e ndërtimit. Muri, me sa duket, nga ndryshimet në teknikën e ndërtimit, i përket periudhës së dytë të ndërtimit, por nuk mund të përcaktojmë se çfarë destinimi ka patur.

Dritaret e periudhës së parë të ndërtimit, të zbuluara në kullën Nr. 1, kanë një disnivel prej 168 cm me dritaret e periudhës turke, të konstatuara në kullën Nr. 20. Ky disnivel është pothuajse i njëjtë me atë të tabaneve në këto dy periudha ndërtimi. Dritaret e periudhës turke ndryshojnë nga të parat edhe pse në pjesën e sipërme nuk kanë qemer, por një mbulesë të rrafshtë murature guri, ndërsa pragjet vinë me pjerrësi nga ana e brëndshme.

Përshkrimi i gjetjeve kryesore të kullës Nr. 1

Nga gjetjet që i përkasin shtresës së parë, predominon keramika e enëve me parete të holla të përdorimit të përditshëm. Karakteristikë e kësaj keramike është pikturimi i saj me vernik ngjyrë kafe ose të bardhë në formë shiritash të valëzuar ose inçizimi me kanelyra horizontale. Në belat e fundit u gjetën fragmente enësh guzhine (Tab. II), kandila (fig. 4) dhe keramikë e pikturuar (TAB. III), ndërsa fragmentet me inçizime u gjetën në belat e sipërm të kësaj shtrese.

Enët e guzhinës të tipit vorbë u gjetën shumë



Fig. 1

DO NOT COPY

të fragmentuara. Balta e tyre ishte poroze e përzier me kokrriza silici dhe kishte marrë nga pjekja një ngjyrë kafe të errët. Prej tyre mundëm të dallonim katër forma kryesore, të cilat i kemi paraqitur në Tab. I. Vorba me shpatulla konike dhe buzë të profiluara për vendosjen e kapakut (TAB. II, 1); me shpatulla konike dhe buzë të shtrira në drejtim horizontal (TAB, I, 2); me trup sferik dhe buzë të shkurtër të anuar pak nga jashtë me vegje të ngjitur në buzë (TAB. II, 3); si dhe vorba me trup sferik dhe buzë të drejta të trashura nga jashtë (TAB. I, 4).

Në enët me grykë të ngushtë, predominonin amforat. Tipat kryesore të grykave i kemi paraqitur në (TAB. II.) Nga këto kemi gryka cilindrike amforash me buzë të mprefët dhe vegje të ngjitura në qafë dhe shpatull (TAB. II, 5), të cilat përbëhen prej një balte të pastër me disa grimca shumë të vogla dhe të rralla silici. Nga pjekja kanë marrë një ngjyrë të kuqe të çelët (ngjyrë tjegullash), ndërsa në pjesën e jashtme janë lyer me një shtresë shumë të hollë balte që nga pjekja ka marrë një ngjyrë okër të çelët. U gjetën gjithashtu gryka qypi konike me buzë të trasha (TAB. II, 6), enë balte me grykë të shkurtër cilindrike, me buzë pak të hapura me seksion trekëndësh (TAB. II, 7) dhe një fragment gryke oinoheje.

Nga vegjet (TAB. I) predominojnë ato me seksion petullicë, me njërën anë të përveshur nga mbrenda dhe me kanelyra vertikale nga ana e jashtme. U gjet vetëm një vegje kornute (TAB. I, 2) me seksion të rrumbullakët, me një baltë mjaft të pastërt në ngjyrë okër të çelët.

Sipas zbukurimeve, paretet e enëve ndahen në dy grupe, me pikturim dhe inçizime (TAB. III). Keramika e pikturuar ndahet gjithashtu në dy pjesë: njëra pjesë përbëhet prej një balte më të ngjeshur me kokrriza të vogla silici, ndërsa balta e tjetrës ka të njëjtën përbërje, por është më poroze.

Të parat, janë zbukuruar me disa shirita të valëzuar me ngjyrë kafe në të kuqe (TAB. III, 1-2), ndërsa të tjerat me shirita në ngjyrë të bardhë (TAB. III, 3-5). Keramika e pikturuar me shirita ngjyrë kafe zbukurohet edhe me disa breza horizontalë me kanelyra dhe ka nga një herë vegje horizontale. Nga keramika e pikturuar me shirita të bardhë patëm më pak fragmente, dhe këto ishin të vogla, kështu që nuk mundëm të vërenim zbukurime të tjera.



Fig. 2

Në fragmentet e enëve të zbukuruara me inçizime balta është më e pastër. Nga ngjyra që kanë marrë këto enë mbas pjekjes, mund t'i ndajmë në dy grupe: disa kanë një ngjyrë të kuqe (tulle) dhe të tjerat, okër të hapur në të verdhë.

Zbukurimet janë dy llojesh: 1) me kanelyra horizontale të ngushta (TAB. III, 7-9), dhe 2) kanelyra horizontale të gjëra të cilat vinë duke u ngushtuar në drejtim të fundit të enës (TAB. III, 6); këto të fundit, i përkasin më tepër grupit të keramikës me ngjyrë okër të çelët në të verdhë.

Keramika e pikturuar dhe ajo me inçizime e gjetur në Elbasan, është datuar nga N. Ceka dhe Ll. Papajani nga gërmimet e bëra në Bradashesh dhe Belsh, respektivisht si e shek. IV dhe VI.[4] Keramika me inçizime është e tipit të zakonshëm edhe në Dobruxha në shek. VI të e. sonë.[5] Por nga objektet më të rëndësishme, që mund të datohen më me saktësi në këtë shtresë, janë dy kandila vaji, nga

3) Porta e Kullës Nr. 20, e cila rezultoi 2,6 m e gjerë, është matur në bazën e harkut, mbasi pjesa e poshtme është e mbushur. Me sa duket, në të ka rënë rreshti i poshtëm i tullave të harkut, kështu që gjerësia reale e saj është sa edhe e portës së kullës Nr. 1 — Shih Kalaja e Elbasanit, **vep. e cit.,** 61.

4) N. Ceka, Ll. Papajani, **Raport mbi gërmimet në Bradashesh dhe Belsh.** Arkivi i Institutit të Monumenteve të Kulturës.

5) R. Floresku, **Limesul Dunarean in perioda tirzie a imperaliul roman** f. 38, fig. 5 (1, 2, 3, 5) në «Buletinul monumentelor istorice». Anul XLI nr. 3, 1972.

BOTIMET



Fig. 3

të cilët njëri është ruajtur pothuajse i plotë (fig. 4), ndërsa tjetri shumë i fragmentuar. Kandilat janë prej keramike të lyer nga jashtë me një shtresë të hollë verniku të kuq. Kandili i paraqitur në fig. 4 ka një gjatësi prej 12 cm., gjërësi 6.2 cm. dhe trashësi 3.5 cm. Në pjesën e sipërme ky kandil është zbukuruar me disa ornamente gjeometrike, të cilat paraqesin rrathë dhe rombe që alterojnë me njëri tjetrin. Këto ornamente rrethojnë monogramin e Krishtit i cili na paraqitet pa germat α dhe Ω në anët. Ky lloj monogrami i përket epokës konstantiniane dhe fillon të përdoret në monedha prej vitit 320, ndërsa në vitet 365-385 shtimi i germave α dhe Ω gjeti përhapjen më të madhe. [6])

Si element datimi për shtresën e dytë kulturale na shërbejnë tullat me vula, prej të cilave, ato me monogram shkojnë nga fundi i shek. IV deri në fundin e shek. VI.

Porta lindore e kalasë

Nga porta lindore e kalasë ruheshin vetëm disa gjurmë të vogla të pragut dhe të shpatullës prej guri, si dhe disa shënja fare të pakta të kullës Nr. 10, që e mbronte këtë portë nga ana jugore. Konstruksioni i plotë i saj nuk njihej. Gjatë gërmimit të kullës Nr. 10 doli në dritë trajta e planimetrisë së saj, nga mund të gjykohet edhe për konstruksionin e portës në përgjithësi. Kulla ishte gjysmë rrethore nga ana e përparme dhe këndrejtë në pjesën e mbrapme. Ajo ka një gjatësi të përgjithëshme prej 13.06 m. nga ana e brëndshme, duke dalë prej mureve të rrethimit në pjesën e përparme 8,21 m, që është një masë pothuajse e njëllojtë me daljen e kullave të tjera të kalasë (8-9 m). Muret e saj janë 2,15 m të gjerë, ndërsa gjerësia e brëndshme e kullës është 4.87 m. Në mesin e murit të mbrapëm ndodhet porta e kullës 1.62 m e gjerë. Në murin e kullës që bie nga ana e portës lindore të kalasë, 1.16 m mbi nivelin e dyshemesë, ndodhet një vrimë katërkëndëshe 32 x x 28 cm., e cila përshkon gjithë trashësinë e murit dhe është e shtruar në pjesën e poshtme me tulla, ndërsa nga sipër mbulohet me rrasa guri. Kjo vrimë, me sa duket, shërbente për të lëvizur trarin që siguronte portën nga ana e brëndshme e saj. Muret e kullës ruhen deri në lartësinë prej 2.8 m. Teknika e ndërtimit është e njëllojtë me pjesën tjetër të kalasë. Në lartësi 70 cm nga tabani, dallohet brezi prej katër rreshta tullash. Tullat janë përdorur gjithashtu në qoshet e mureve, në shpatullat e portës, si dhe në vëndet ku fillon rrumbullaksinë harku i pjesës së përparme të kullës. Në këto të fundit, pjesa me tulla ka një gjërësi prej 1 m. Mbushja e kullës nga hedhurinat dhe rrënimet është krijuar në një kohë të vonë. Kjo ka ndodhur sepse ajo gjëndet krejtësisht mbi nivelin e rrugicës që i kalon pranë, në të cilën dallohen edhe gjurmët e pragut dhe shpatullës prej guri të portës. Një mur mbajtës, i cili shërbente njëkohësisht dhe si mur i oborrit të shkollës, e ndante kullën prej rrugicës. Ky ka ndihmuar së tepërmi në depozitimin e materialit. Gjatë gërmimit u konstatuan disa shtresa kulturale. Shtresa e parë, me një trashësi prej 1.2 m, përbëhej nga një dhe i zi me shumë pak fragmente keramike. Keramika ishte e periudhave të ndryshme, e përzierë. Aty u gjetën çibukë balte dhe fragmente të tjera enësh të periudhës turke, disa fragmente vorbash të kohës së vonë antike të tipit të paraqitur në TAB. II, 1-4, si dhe një fragment pareti pitosi me ornament të valëzuar. Përmbi shtresën e përmëndur ndodhej një shtresë tjetër 48 cm e trashë, që përshkonte gjithë sipërfaqen e kullës dhe përbëhej nga bloqe tullash të lidhura me llaç të qemereve të rrëzuara të kullës. Ekzistenca e kësaj shtrese,

6) G. Marachini – Mazel, **Les monuments paléochrétiens de la Corse,** Paris, 1967, 98.

DO NOT COPY

përmbi shtresën me fragmente keramike turke, vërteton se qemeret e kullës janë rrëzuar pas pushtimit turk. Tullat e qemereve ishin të madhësive 31 x 29 x 5 cm; 33 x 27 x 4 cm; 31 x 27 x 5 cm e të tjera me përmasa të përafërta me to. Shumica e tullave të qemereve ishin me stampa. Nga këto kishte 27 tulla me kryq (fig. 2 (5)), një tullë me delfin katër tulla kanë të stampuar figurën e një pëllumbi të punuar në mënyrë shumë primitive (fig. 5) (fig. 2, (4)) dhe njëra prej tyre përmbante një monogram (fig. 6), (fig. 2 (4)). Të gjitha shënjat janë të ngritura në reliev. Tek tullat me kryq, ky i fundit është vendosur në mes, është i tipit latin, me përmasa të krahëve 7 dhe 14.5 cm. Tullat janë të pjekura mirë, në mjaft raste, anët i kanë të rrumbullakosura nga faqja në të cilën është vendosur stampa. Monogrami i përmëndur më sipër është shkruar në alfabetin grek dhe është i tipit me dy shtaga vertikale. Trashësia e llaçit ndërmjet tullave të qemerit është 5 cm në pjesën e poshtëme dhe 8-9 cm në pjesën e sipërme të harkut, ndryshe nga qemeret e tjerë të kalasë, fuga e llaçit e të cilëve nuk i kalon 3-5 cm. Llaçi është i përzierë me copëra tullash, që kanë një diametër nga 1-2.5 cm. E njëjta teknikë vërehet edhe në traktin bizantin pranë muzeut. Nga teknika e ndërtimit e përdorur në këto qemere, tulla me delfin dhe monogrami, mund të gjykojmë se këto i përkasin periudhës së rindërtimit të kalasë, e cila, me sa shihet, edhe në këtë rast ka patur një karakter të përgjithshëm. Nga gjurmët që kemi në dispozicion tani pas gërmimit të kullës, mund të arrijmë në një rikonstruksion thuajse të plotë të planimetrisë së portës lindore dhe, si rrjedhim, edhe të asaj perëndimore, që duhet të ketë qënë identike me të. Porta ka qënë me një hapësirë të vetme rreth 4 m të gjerë, e mbuluar me qemer tullash dhe e mbrojtur anash prej dy kullash. Kullat e portës janë më të gjata se kullat e tjera të kalasë dhe, ndryshe prej tyre, nuk dalin krejtësisht prej mureve, por ndërpriten nga këta të fundit. Muri fundor i kullës vazhdon edhe jashtë saj, në drejtim të portës duke krijuar një oborr katërkëndësh nga ana e brendshme midis dy kullave. Karakteri thjesht mbrojtës i kësaj porte të bie menjëherë në sy. Ajo i përngjan më tepër një hyrje kampi të fortifikuar, se sa një porte qyteti. Gjerësia frontale e gjithë konstruksionit është e vogël (28-29 m). Asnjë zbukurim arkitektonik. Një hyrje e thjeshtë, e mbuluar me hark dhe e mbrojtur nga dy kulla anësore, të cilat tërhiqen mbrapa si me frikë. Karakteri i ndërtimit është në përshtatje të plotë me epokën e tij. Luftrat fitimtare të perandorisë romake kishin marrë fund me kohë. Të shtërnguar nga presioni i sulmeve të vazhdueshme të popujve shtegtarë dhe nga çthurrja e rendit skllavopronar, mbrojtësit hoqën dorë shpejt nga



Fig. 4



Fig. 5



Fig. 6

trajtimi arkitektonik monumental i portave dhe, duke ju përshtatur nevojave të reja, u dhanë atyre një karakter thjesht mbrojtës.

Përfundime

Duke u mbështetur në të dhënat arkeologjike, mund të përfundojmë, se kalaja nuk u përdor më për qëllime mbrojtëse pas shek. VI, gjë që vërteton një degradim, në mos braktisje të qytetit, që konfirmohet

FOTO COPY

TAB. I



DO NOT COPY

në një shkallë të madhe edhe nga mospërmëndja e Skampinit në burimet historike pas vitit 519.

Materialet më të hershme arkeologjike ishin ato të shek. IV, nga të cilat, kandilat i përkasin periudhës së sundimit të perandorit Kostandin (324-337). Gjithashtu dimë që gjatë epokës së këtij perandori, kështjellat apo kampet përforcoheshin më shpesh me kulla në formë freskoreje në qoshet dhe në formë patkoi gjatë mureve. [7])

Vlen të theksojmë gjithashtu faktin, që porta kështjellash me oborr të brendshëm [8]) të tipit të Elbasanit fillojnë të zhduken në vazhdim të shek. IV. Megjithatë, nuk mund të thuhet me siguri, se kalaja e Elbasanit është vepër e Kostandinit, për faktin që rrethanat e depozitimit të materialeve arkeologjike mund të jenë nga më të ndryshmet. Por mund të pranohet si periudha më e mundshme e ndërtimit të saj gjysma e parë e shek. IV të erës sonë. Nga sondazhet u përfituan të dhëna të rëndësishme edhe rreth rindërtimeve të kalasë të bëra para pushtimit turk. Traktet e hershme bizantine, me breza tullash në murin jugor dhe perëndimor, të shikuara nga cilësitë e tyre teknike, nuk mund t'i datonim mbrenda një diapazoni të ngushtë kohe. Tani që kemi në dorë edhe rezultatet e sondazheve, sidomos faktin që pas shek. VI deri në shek. XV kemi një ndërprerje të jetës në kala, për të gjitha rindërtimet me breza tullash mund të themi se i përkasin periudhës prej mezit të shek. V, deri në vitet e para të sundimit të Justinianit I (527-565), ndërsa për rindërtimet para turke pa breza tullash, jemi të mendimit se nuk janë më të vona se kjo kohë.

7) S. Soppronі — **Der Spätrömische Limes zwischen Visearad und Esztergom** — Limes romanus konferenz Nitra, Bratislava 1959, 131-135.
8) R. Schultzs, **Die römische Stadttore,** Bonner Jahb. Heft, 118. Bonn 1909, 280-352.



DO NOT COPY



DO NOT COPY

DO NOT COPY

KULLA NR 1





PLANIMETRIA E KALASE ELBASANIT

Periudha e I e ndërtimit

Periudha e II e ndërtimit



Rikonstruksioni Planimetrisë së Portes Lindore

DO NOT COPY

Gjerak KARAISKAJ

NEW DATA FOR THE DATING OF THE CASTLE OF ELBASAN

A SUMMARY

Proceeding from the remnants of the castle still existing above the ground and on the historical circumstances an attempt has been made at making a description of the monument and at fixing its date of construction.

After a series of archaeological probes carried out in 1970 and 1971 there were brought into light some parts of the fortification enabling us to make a more complete reconstruction of its lay-out as well as to obtain some fresh data which aid to fix a more precise date for the construction of the castle. In 1970 digging went down to the foundations of the Nº 1 tower through a sedimentary layer of 4,5 m. and the result was a clear horizontal stratigraphy (fig. 1). Thus were defined three principal cultural layers following upon one another and connected with the three periods of the construction of the castle. The first layer 0,5 m. thick preserved a considerable amount of ceramic fragments pertaining to the IV-V centuries of our era. The ceramic of thin vessels of everyday use is prevailing. Characteristic of the sort of ceramic is its painting with varnish waving bands in brown or white color (see TAB. III), whereas some other fragments represent incisions with narrow horizontal grooves. In the lower part of this layer there were unearthed fragments of utensils (TAB I), two lamps (fig. 4) and fragments of ceramics painted with varnish bands and strips (TAB III), whereas in the upper part of this same layer there were found fragments with incisions. Of these finds, the most easily to be dated are the lamps of this layer, one of which is preserved almost complete. On the upper side of this lamp there is the monogram of Christ without the α and Ω letters just on the side characteristic of the Constantinian period. The painted ceramic and that with incisions is dated by N. Ceka and Ll. Papajani during the excavations carried out in Belesh and Bradashesh respectively as appertaining the IV and VI centuries of our era. The second cultural layer 1,25 m. thick harbored chiefly building materials of ceramics. The most important finds of this layer are somme fragments of stamped brick. One of the bricks bares the stamps of a delphin carrying a branch in its mouth, on the other brick there are some crosses (fig. 2) as well as a monogram of the type with two vertical axes with the letters inscribed within them (fig. 2 and 3). Of these materials the most easibly datable are the bricks with monograms. Weigand fixes them at a period by the end the IV century to the end of the VI century of our era.

The third layer 2,4 m. thick is divided into three horizons represented in fig. 1 with the A, B, C signs respectively. This layer contained objects dated after the XV century up to our days.

The A horizon of 0,06 m. thickness, with an almost horizontal position consist of remnants of rotten wood. It divided strictly the II and III layers, which belong to

DOKUMENT

entirely differentiated and distant periodes and represented the level of the foundation of the tower in the period of the reconstruction of the castle by the Turks in 1466.

From the eastern entrance of the castle there are still existant a few traces of the doorstep as well as some slightly perceptible signs of the tower which use to defend this entrance from the southern side. The excavations made in the first trimester of the year 1971 at the tower south of the entrance shed light upon the form of its design which enables us to judge on the construction of the entrance in general (TAB IV). With the discovery of the eastern gate, the reconstruction of the lay-out of the whole monument will be more complete. During the excavation there were observed some cultural layers. The first layer 1,2 m. thick contained very few ceramic fragments of mixed periods dating from the late antiquity period and the Turkish period. On these layers there was superposed another layer 0,48 m. thick running all along the surface of the tower and made up of bricks connected with mortar belonging to the vaults of the fallen tower. The existence of this layer above the lower one containing Turkish ceramic fragments proves that the vaults of the tower must have been ruined after the Turkish invasion, because the majority of the bricks of the vaults were stamped with crosses (fig. 2 and 5), a single brick bore the stamp of a delphin, whereas some others had a dove stamped in a most primitive manner (fig. 5, fig. 2 and 4) and one of them had a monogram (fig. 6, fig. 2 and 4) written in the greek language of the same type as that with two vertical axes. The thickness of the mortar ranging from 8-9 cm., its bits of brick identical with that of the Byzantine track in the vicinity of the muzeum, the bricks with dophin and the monogram induce us to think that the vault oi the tower belongs to the period of the reconstruction in the early Byzantine epoch. This reconstruction, as this case shows, has been of a general character.

From the data obtained by the two abovementioned probes two conclusions can be arrived at: the castle ceased to be used for defensive purposes after the VI century of our era, which goes to show that the town had declined if it was not entirely abandoned. This suggestion is confirmed by the fact that Skampini is not mentioned in the historical sources after the year 519. Proceeding from the archaeological finds, the design of the eastern gate with an inner yard, from the shapes of the towers at the corners and of those in intermediary positions, we must accept the first half of the IV century of our era as the most probable time of the construction of the castle.

These probes yielded important data also for the dating of the reconstructions prior to the Turkish invasion. As for the reconstructions with brick layers, we hold that they belong to the period ranging from the middle of the V century to the first years of the reign of Justinian, whereas the reconstructions prior to the Turks without brick layers should not be of a later date.

DO NOT COPY

Kasem BIÇOKU

DO NOT COPY

KËSHTJELLA E RE (Jenixhekalaja) DHE ELBASANI

Në defterin e regjistrimit të kohës e të popullsisë të v. 835 h. (1431-1432) të sanxhakut të Shqipërisë [1]), kur jepen tiparet e vilajetit ët Pavlo Kurtikut, që gjëndeshin ndërmjet lumenjve Shkumbin dhe Erzen, Jenixhekalaja (Kështjella e Re) [2]) përmëndet si e vetmja kështjellë që ishte në funksionim në këtë vilajet. Nga të dhënat e këtij dokumenti del kjartë se në një gjëndje të tillë ajo ishte që në pushtimin e tokave shqiptare më 1415-1417 prej trupave osmane.

Botuesi i defterit të regjistrimit të v. 835 h., H. Inalçik, Jenixhekalanë e ka lokalizuar në Bradashesh. [3]) Një përfundim i tillë, me një vështrim të parë, duket i pranueshëm për shkak të dy shënimeve që ndodhen në defter. Në krye të faqes 110 a të origjinalit të defterit, [4]) me një shkrim të theksuar, është vënë shënimi «mustahfazanë të kalasë Jenixhe, Bratusheshi me famë»; dhe, nën të e në faqet që pasojnë, janë regjistruar timari i «dizdarit të kalasë Jenixhe» si dhe timaret e ushtarakëve të tjerët të saj. Po kështu, në faqen 118 a, nën fshatin Godolesh, është shënuar se ai fshat «ju hoq Ballabanit që ishte nga ushtarakët mustahfazanë të kalasë Bratushesh» dhe ju dha, në v. 841 h., të birit të Pavlo Kurtikut, Mustafait [5]).

Kështjella «Jenixhe», nga të dhënat e defterit, del si qëndra administrative e ushtarake e pushtonjësve osmanë në vilajetin e Pavlo Kurtikut. [6]) Kadiu i atij vilajeti cilësohej «kadiu i Jenixhekalasë», po kështu edhe dizdari, «dizdar i kalasë Jenixhe» [7]) dhe, siç e vumë në dukje pak më lart, për ruajtjen e saj ishin caktuar një numur ushtarakësh, të cilët qenë kryesisht të huaj. Por, si rezultat i luftimeve që u zhvilluan gjatë viteve 1432-1435 ndërmjet shqiptarëve e forcave osmane, elementi i huaj pushtonjës, që në kohën e regjistrimit të v. 835 h. (1431-2) gjëndej si timarli në vilajetin e Pavlo Kurtikut dhe ishte ngarkuar me detyrën e kadiut, të dizdarit e të mbrojtësve të Jenixhekalasë, nuk do të ndodhej më në ato vise. Timaret e tyre kaluan në duart e elementit vendas, siç e tregon, ndër të tjera, shënimi i bërë në v. 841 h. në timarin e kadiut: «në kohën e tanishme timaret që u përkasin dizdarit dhe ushtarakëve të kësaj kalaje (Jenixhekalasë) ju dhanë Mustafait, të birit të Pavlo Kurtikut» [8]).

Një ndryshim i tillë në përbërjen etnike të timarliinjve në vilajetin e Pavlo Kurtikut dhe likuidimi i funksionit të kadiut e të dizdarit, në fakt tregonte se në ato krahina nuk kishte më administratë të rregullt osmane.

---

1) H. Inalcik, Hicri 835, *Suret-i defter-i Sancak-i Arvanid*, Ankara 1954.
2) Po aty tim. 240, 241, 253, 254, 259.
3) Po aty, tim. 241, shën. 1.
4) Po aty, f. 90.
5) Po aty, tim. 259.
6) *Po aty.* tim. 241.
7) *Po aty.* tim. 241, 244.
8) *Po aty.* tim. 241.
9) Halkokondili, në *Lufta shqiptaro-turke në shekullin XV — Burime Bizantine*, Tiranë 1967, 45-47.

Në këtë kuadër dhe në kushtet e pasigurisë së përgjithëshme politike të asaj periudhe duhet parë edhe jeta e kështjellave, të cilat kishin një rëndësi të veçantë, të dorës së parë, për zotërimin e viseve rreth tyre.

Nga materialet e defterit të lartpërmëndura mbi jetën e Jenixhekalasë, nuk mund të nxirret ndonjë e dhënë tjetër me rëndësi. Por, duke marrë për bazë jetën politike të kohës, emrin e kështjellës si dhe pozicionin e saj (e vendosur në një zonë të hapur dhe në buzë të rrugës shumë të rëndësishme që lidhte Shqipërinë me viset e brendshme të Ballkanit, duke ndihmuar qarkullimin e sigurtë nëpër atë rrugë) mund të arrihet në përfundim se jeta e saj, koha kur ajo hyri në funksionim, duhen lidhur me periudhën e vendosjes së pushtimit turk në ato vise; pra, që nga pushtimet që Mehmeti I kreu në tokat shqiptare, gjatë viteve 1415-1417. Që nga viti 1432, me fillimin e kryengritjeve të shqiptarëve, viset pranë Jenixhekalasë përbënin zonën më të rëndësishme të kryengritjeve dhe të veprimeve luftarake të shqiptarëve. Me shfarosjen e timarlinjve osmanë prej këtyre viseve [9]), kuptohet që edhe Jenixhekalaja ndodhej në duart e shqiptarëve. Pozicioni gjeografik bënte që kjo kështjellë, e vendosur në vënd të hapur, të lehtësonte qarkullimin e trupave osmane që vinin nga Lindja. Pra ajo nuk vlente aq si pikë mbrojtëse e favorshme për shqiptarët, se sa mund të ishte për turqit një bazë e fuqishme për nënshtrimin e krahinave rreth saj. Në këto rrethana, nxjerrja e saj jashtë përdorimit ishte një nga masat e para më të nevojshme që duhej të mernin shqiptarët për t'u mbrojtur nga forcat pushtuese osmane. Natyrisht si e tillë, në gjëndje të papërdorshme e të shkatërruar, ajo do të qëndronte edhe gjatë periudhës së Skënderbeut. Kurse, për të penguar depërtimin e forcave osmane, në rrugët kryesore që kalonte nëpër ato vise, ishin të destinuara kështjella të tilla si, «Sofra e Skënderbeut» në Prrenjas dhe, «Guri i Skënderbeut» në Dardhë të Librazhit.

Edhe gjatë kohës së Skënderbeut dhe në shekujt që do të pasonin nëpër burime të ndryshme do të haset po në atë zonë i njejti emër *(Kështjella e Re)* apo forma e ngjashme me të, *Qyteti i Ri*. Është fjala për Elbasanin. [10])

Lidhur me të rëndësi të veçantë merr fakti që shumë kohë pas rindërtimit të kështjellës më 1466 të vënies së emrit Elbasan prej Mehmetit II, popullsia vëndase do ta njohë atë si qytet edhe me emrin *Kështjellë e Re*, siç dëshmojnë dokumentat kishtare vendase të shkruara në gjuhën greke.

Në dy mbishkrime të Onufrit, të bëra më 1554 në kishën Shëna Premtes të Valshit, qyteti në fjalë është shënuar me emrin Neokastër. [11]) Po kështu quhet në botimin e parë të Akoluthisë së shën-Gjon Vladimirit, të bërë më 1690, siç është shënuar në frontespic, «me shpenzimet e të shumë nderuarit zotit Joan Papa, nga qyteti i Neokastrës. . . .» si dhe në kodikët e kishës së kalasë.

Në një mbishkrim të v. 1729, të gdhendur rreth bazamentit të thimiatonit të madh prej argjendi të kishës, lindja e shën-Mërisë në kështjellën e Elbasanit, qyteti përmëndet me dy emra: «Ky thimiaton është i së mbishejtës Hyjlindëse në Neokastër — Elbasan.» [12]) Mbishkrimi na jep një element me shumë rëndësi, duke treguar se përdorimi i emrit Kështjella e re (Neokastra) nuk lidhej me sferën kishtare, për të mos përdorur emrin turko-arab, Elbasan, por tregonte se qyteti njihej me të dy emrat nga banorët vëndas. Për këtë bindesh nga dy mbishkrime më të hershme të kishës së shën-Kollit të Shelcanit (Shpat i Elbasanit), në të cilat qyteti në fjalë përmëndet vetëm me emrin që i vuri Mehmeti II në 1466: «u pikturua me shpenzimet e të shumë nderuarit dhe shumë fisnikut zotit Gjika sekretar nga qyteti Elbasan. . . në vitin 1625». [13])

Emri *Kështjella e Re* (Jenixhekala) që gjëndet në defterin e v. 835 h. (1431-1432) dhe përdorimi i të njëjtit emër nga banorët vendas për kështjellën e Elbasanit, të bën të mendosh se kemi të bëjmë me të njejtën kështjellë. Është e pamundur që, për dy kështjella pranë njëra tjetrës, banorët vendas të përdornin të njejtin emër.

10) Hil Ruvarac. **Kleinigkeiten zur Geshichte der Balkanhalbinsel** në **«Arch. fur Slav. Phil. XVII»,** 567-571; F. Babinger. **Die Gründung von Elbasan** në **«Mitteilungen des Seminars fur Orientalische Sprachen,** XXXIV, Jahrg. II, Abtelig. Westasiatische Studien (Berlin 1931) 94-105.
11) Th. Papa, **Mbishkrimet e kishave të Shqipërisë** (drsh) Nr. 13-14.
12) **Po aty.** Nr. 26.
13) **Po aty.** nr. 17; 18.
14) H. Inalçik, **vep. e cit.,** 241.
15) J. Radoniç, **Gjuragj Kastriotic Skanderbeg I Arbanija u XV vjek,** Beograd, 1942. nr. 334.
16) M. Barleti, **Historia e Skënderbeut,** Tiranë 1964; 481.
17) Gj. Karaiskaj, **Kalaja e Elbasanit** në «Monumentet», Nr. 1, 1971. Idem, **Të dhëna të reja për datimin e kalasë së Elbasanit,** «Monumentet» **Nr. 3.**

DOKTORATY

Në fakt, gjurmë të ekzistencës së një kështjelle mesjetare në Bradashesh nuk njihen. Por në atë kohë, në fillim të shek. XV, me pushtimin e atyre vendeve prej turqve, jo larg këtij fshati, ishin rrënojat e kështjellës së qytetit antik Skampin ato të Valmit mesjetar (në defterin e regjistrimit të v. 835 h. përmëndet një djerrinë a vënd i braktisur nga banorët, *mezra, me emrin Divalm*, [14]) që të kujton Valmin që përmëndet në dokumentat e shek. XV [15]) dhe te Barleti [16]); i cili ishte në një gjëndje të tillë sa që më 1466 forcat osmane të Mehmetit II arritën për një kohë shumë të shkurtër, brënda një muaji, të bënin adaptimin e saj: veshjen e lartësimin e mureve ekzistuese dhe, vënien në funksionim të kanalit rreth tyre. [17]) Duke qënë në një gjëndje të tillë një kështjellë në afërsi të Bradasheshit, nuk mund të justifikohet ngritja në këtë fshat në kohën e pushtimeve të para turke, apo edhe më parë prej të tjerëve, e një kështjelle të re për të cilën nevojiten mundësi materiale e shpenzime të shumta, përderisa me më pak mundësi e shpenzime më të pakta mund të vihej në funksionim, tërësisht apo pjesërisht, kështjella e vjetër, ashtu siç veproi më 1466 Mehmeti II. Pra e njejta gjë që u bë nga sulltan Mehmeti II, ndoshta në mënyrë të pjesëshme, duhet të jetë bërë edhe më 1415-1417 apo edhe më parë, si p.sh. në kohën e principatave shqiptare.

Dhënia apo barazimi i Jenixhekalasë me Bradasheshin në dy shënimet e defterit të regjistrimit të vitit 835 h. (1431-32) nuk përbën në vetëvete ndonjë problem të pashpjegueshëm. Nuk mund të përjashtohet mundësia e ndonjë gabimi e personave të ngarkuar me regjistrimin ose e sekretarit që ka shkruar kopjen e defterit të botuar. Por, pavarësisht nga kjo, shënimi i f. 110/a të origjinalit të defterit («mustahfazanë të kalasë Jenixhe, Bratusheshi me famë») tregon se Bradasheshi, që pas fshatit Manës [18]) del në gjysmën e parë të shek. XV qëndra më e madhe e banimit në ato vise [19]), kishte një pozitë të veçantë, duke gëzuar famë. Ai duhet të ketë shërbyer si një farë qendre e jetës ekonomiko-shoqërore e krahinave për rreth, mbasi qyteti i Valmit ishte i shkatërruar e i braktisur [20]), dhe një e tillë qendër tjetër nuk del në atë zonë. «Fama», pra pozita e veçantë që kishte Bradasheshi, bënte që Kështjella e re të ishte, të thuash në një kuptim të ngushtë, në funksion e vartësi të Bradasheshit. Kjo gjë duhet të ketë bërë që në dy shënimet e mësipërme të defterit Kështjella e re dhe Bradasheshi të shprehen si i njejti vend.

BOOK COPY

18) H. Inalcik, **vep e cit.** 243, 252.
19) **Po aty, vep. e cit.** 240.
20) M. Barleti, **vep e cit.,** 481.

Kasem BIÇOKU

LA NOUVELLE CITADELLE (JENIDJEKALA) ET ELBASAN

RESUME

Le registre de recensement des terres et de la population de l'an 835 (1431-1432) du sandjak d'Albanie, fait état de Yenidjékala (la nouvelle Citadelle), comme de la seule citadelle en fonction dans le vilayet de Pavlo Kurtik, formé des régions qui s'étendaient entre les cours des fleuves Shkumbin et Erzen. Les données contenues dans ce document font apparaître que cette forteresse existait en tant que telle dès l'invasion des territoires albanais par les troupes ottomanes, en 1415-1417.

Le professeur H. Inalçik qui a publié le registre de recensement de l'an 835, a localisé Yenidjékala à Bradashesh, se fondant en cela sur la note contenue dans le registre de la «Citadelle Jenidjé, à Bradashesh, d'illustre renom».

A partir de 1432, avec le début des insurrections albanaises, les régions environnant Yenidjékala constituaient la zone la plus importante des révoltes albanaises et des opérations de combat en général. Avec l'expulsion de ces régions des bénéficiaires ottomans de timars, la Yenidjékala dut de toute évidence se trouver aux mains des Albanais. De par sa situation géographique, cette citadelle, située en un lieu découvert où les troupes ottomanes venant d'Orient pouvaient facilement évoluer, n'était pas tant une position de défense favorable pour les Albanais qu'une puissante base pour les Turcs en vue de la soumission des contrées qui l'environnaient. Dans ces circonstances, les Albanais se devaient, comme une des premières mesures nécessaires pour assurer leur défense contre l'invasion ottomane, de mettre cette forteresse hors d'usage. Bien entendu, elle devait demeurer inutilisable et partiellement en ruine durant la période de Skanderbeg. Mais depuis la reconstruction de la citadelle d'Elbasan par Mehmet II en 1466 et bien après cette date, dans les documents occidentaux ainsi que dans les sources écclésiastiques locales telles qu'inscriptions diverses, codex et livres ecclésiastiques, on retrouve, en ce qui concerne cette zone, le même nom (Nouvelle Citadelle) ou une forme similaire, Cité nouvelle. Il s'agit là d'Elbasan. La dénomination de Nouvelle Citadelle (Yenidjékala) que l'on retrouve dans le registre des années 1431-1432 et l'utilisation du même nom par les habitants de ces lieux pour la citadelle d'Elbasan, donne à penser que l'on a affaire au même ouvrage. Il est impossible que les habitants aient utilisé la même appellation pour deux citadelles proches l'une de l'autre. D'autre part, l'existence d'une citadelle, encore que partiellement en ruine, à proximité de Bradashesh, comme l'était celle d'Elbasan, ne pouvait justifier la construction, dans cette localité, à l'époque des premières invasions turques, ou même d'invasions antérieures, d'une nouvelle forteresse, travail qui aurait nécessité du temps et de gros moyens, alors qu'il était possible de remettre en état l'ancienne forteresse plus rapidement et à moins de frais, comme devait effectivement le faire Mehmet II en 1466. On a donc lieu de penser que c'est de cette manière, peut-être même partiellement, qu'il a été procédé également en 1415-1417, ou même auparavant. La position particulière qu'occupait Bradashesh dans la région concernée, en tant que centre économique, doit être à l'origine du fait que dans le registre précité, la Nouvelle Citadelle et Bradashesh figurent comme qualifiant le même lieu.

DO NOT COPY

bëra nga turqit [9]). Është për t'u vënë në dukje se kati i sipërm i barbakanes nuk e mbulon plotësisht katin e poshtëm. Nga muri i vjetër i kështjellës barbakana ka një largësi rreth 2,30 m. duke lënë të zbuluar qemeret e pjesës fundore 1, 2, 3, 4. Mungesa e mbulesës mbi krejt barbakanen, ka bërë që, në tavanin e tunelit të formohen stalagtite nga kullimi i ujit të shiut dhe nga përbërja gëlqerore e gurit.

Në oborr (fig. 2) ka një shkallë që shërben për ngjitje në vendecjen e rojes. Kjo ka një lartësi prej 2,90 m., ndërsa muri mbrojtës mbi të, arrinte nga shenjat e dukshme, në 2,50 . Krejt vendecja mbështetet mbi dy harqe gjysmërrethore. Nën secilin hark, në murin fundor, shihet nga një kanal kuadratik që e përshkon krejt murin dhe që, në pjesën e jashtme, bëhet më i pjerrët. Mendojmë se kanalet shërbenin për hedhje lëngjesh dëmtuese kundër armikut.

Për të hyrë në pjesën ku gjenden dy këndet e dalura duhet të kalohet një portë, (fig. 2) me qenë se ato janë plotësisht të veçuara nga barbakaneja dhe oborri, pasi as vendecja, që gjëndet në oborr, nuk komunikon me atë pjesë.

Këndet e dalura shërbenin për mbrojtjen e tërë sistemit të fortifikimit. Këndi i dalur më afër portës ka një vendqitje për top me shikim nga rruga e kështjellës, ndërsa këndi i dytë ishte i pajisur me vendecje për roje dhe frengji të ndryshme. Nën këndin e dytë, me shikim nga hendeku dhe Buna, hapet një portë sekrete. [10]) (TAB. I, 3) që, mendojmë se nuk del në thellësi të kështjellës, por komunikon vetëm me këtë sistem fortifikimi. Mund të jetë ajo «llogore e nëndheshme e hapur në shkëmb të gjallë» pranë portës së madhe, që përmënd M. Barleci dhe që shërbente për të mbajtur armë e municione për të mbrojtur «gropat». [11]) Është për t'u vënë në dukje se Barleci gjithashtu vëren se kjo llogore kishte «të dala të ndryshme» [12]). Sot porta sekrete, ashtu siç është, ka vetëm një dalje, por, posa të hyhet në të, ndahet në dy koridore të hapura në shkëmb, me gjërësi sa për të kaluar një njeri, koridore të hapura deri në njëfarë vendi, por, më sipër, të mbushura dhe të penguara nga materiale të ndryshme.

Ledhi i pjesës së fundit të fortifikimit ka vendecje për roje, të pajisura me frëngji. Nga brenda është i forcuar me kundërmure. Në pjesën e fundit shihen gërmadhat e një ndërtese dhe, në truallin e saj, fare pranë kullës së rrumbullakët, dy dhoma të vogla me qemer. Në këtë vënd thuhet se gjendeshin shtëpitë e Jonimëve, të cilat, siç kemi thënë më sipër, qenë shpronësuar në kohën e ndërtimit të këtij fortifikimi [13]).

Nga kthesa e fundit e rrugës që çon në kështjellë, deri te porta e barbakanes, kemi vepra plotësuese fortifikimi e mbrojtjeje, që mbulojnë këtë pjesë rruge. Në një largësi afro 38,50 m. shihen mbeturinat e mureve (me gjerësi 60 cm) të dy ndërtesave (me hapësirë të brëndshme 6,33 x 6,20 m. dhe 4,50 x x 4,75 m), që shërbenin për pararojet e portës. Këto vepra të fortifikuara do të shërbenin njëkohësisht edhe si vendroje edhe si pika për të penguar sulmin armik për pushitmin e hyrjes së kështjellës.

Prej portës së barbakanes, në drejtim të vendrojeve, kemi një vepër fortifikuese të gjatë 17,50 m. dhe të gjerë 2,90-3,25 m. me një mur mbrojtës, nga ana e jashtme, të lartë 2,20 m. (gjërësi 0,75-0,80 m), me siguri dikur i pajisur me frëngji e bedena dhe që shërbente si vendecje për rojen, me një lartësi, që sot luhatet nga 0 në 65 cm. Kjo vepër fortifikuese dhe dy ndërtesat e mësipërme lidheshin me një perdëz (kurtinë) të gjatë 9,66 m, lartësia e plotë e së cilës sot nuk dallohet në vend, por që besojmë të mos i ketë kaluar 2,20 m siç e shohim nga gjurmët në murin e ballit të barbakanes. Këtu është për t'u vërejtur, se këtej e tutje, porta e barbakanes nuk duhet quajtur më portë kryesore e kështjellës, sepse kryesore është e ashtuquajtura portë e dytë, e mbrojtur me kryekullë (donjon) dhe një kompleks të tërë. Ky gabim rrjedh nga se barbakaneja gjendet shumë afër saj, ndryshe nga ç'ndodh në kështjellat e tjera mesjetare.

Ndërtimi i barbakanes ka mbuluar, pjesërisht, në anën perëndimore të oborrit, mure të ndërtimit ilir. [14]) Përbëhen nga bloqe të mëdhej, me forma poligonale të punuara mirë, të puthisur në mes të tyre në formë të rregullt dhe të lidhur pa llaç. Këto bloqe veshin në gjatësi krejt faqen e brendshme të oborrit të vogël deri në një lartësi rreth 2 m. dhe vazhdojnë në faqen fundore të strehimit 4 e 3, ndërsa nuk duken më në strehimet 2 e 1. Gjurmë të tjera bloqesh, me përmasa edhe më të mëdha, shihen te kthesa mbas portës së kështjellës, në anën e majtë të tunelit të dytë të hyrjes.

Para këtij sistemi mbrojtës muri i jashtëm, i cili ruan nga kështjella një largësi që luhat nga 6.50-

9) M. Barleci, Rrethimi i Shkodrës. Bot i dytë. Tiranë, 1967, 63, 65-67.
10) Pjesa e sipërme e saj është restauruar tashti vonë.
11) M. Barleci, **vep. e cit.**, 73. Mendojmë se me këtë fjalë Barleci quan hendekun mbrojtës.
12) **Po aty**, 73.
13) V. Kamsi, **Kalaja e Shkodrës**, «Shkodra», Shkodër, 1961, 82-83.

-9 m, krijon një hendek. Këtë mur (TAB. I, 4) deri në provë të kundërt nga gërmime të rregullta do ta quajmë pseudoilir. Muri vazhdon deri te porta sekrete, duke u nisur nga skaji i kodrës në drejtim të Bunës, ndërsa gjurmë të tija kemi deri te rruga që çon në kështjellë, aty ku në fund të viteve 20, qe ndërtuar një shkallë dhe ku disa punime për të zgjeruar rrugën e kanë prerë në skajin që lidhej me të (te kthesa e vjetër).

Mbas një studimi të mëtejshëm në vend, edhe një element i ri i shtohet hipotezës sonë, se kemi të bëjmë me një mur të ndërtuar në mesjetë: [15]) lartësia e sotme maksimale e murit në fjalë arrin në 3,30 m, ndërsa ajo e shkëmbit, mbi të cilin mbështeten veprat e fortifikimit që po studjojmë e kalon thuajse edhe një herë më tepër këtë lartësi duke arritur të 5-6 m. Pra, përsëri nuk justifikohet hipoteza e murit ilir, sepse në një rast të tillë ndërtuesit e tij do ta vinin veten në një kurth, pa mundësi shpëtimi. Gjithashtu na ka tërhequr vëmëndjen një teknikë e ngjajshme ndërtimi, me blloqe të njëllojta, të parregullta, në një kështjellë mesjetare të ndërtuar gjatë sundimit venedikas në ishullin e Kretës [16]).

Ndër elementët zbukurues të barbakanes dallohet ballëzina e portës së hyrjes me një hark të ulur, mbi të cilin është vendosur një hark i dytë, me dy breza gurësh të latuar dhe, në sqetullën e harkut, një element i përbërë nga një hark kllapë me një zbukurim mbi të. Sipër harkut të portës, rreth 2 m. më sipër, ku fillon muri i ndërtimit turk, vërehen mbeturina të luanit të shën-Markut, bishti dhe një këmbë e pasme të drejtuara nga lindja. Ky luan, simbol i Republikës së Venedikut, në vitin 1858 shihej ende në vend, i plotë [17]). Prishja e tij ka ndodhur në gjysmën e dytë të shek. XIX, kur, simbas dëshmisë së A. Degrand-it ushtarët turq e thyen [18]). Më 1913, një pjesë e tij që marrë prej ushtarëve malazezë [19]).

Në gjithë sistemin e fortifikimeve të hyrjes kryesore të kështjellës shihet qartë dallimi në mes të punimeve të bëra nga venedikasit dhe të punimeve



Fig. 2

të meremetimit e ndërtimit të bëra nga turqit. Punimet turke, më të dobëta se ato të ndërtimit të parë, shihen në anën e djathtë të portës. Për to dëshmon një sipërfaqe mjaft e gjërë, e veshur me gurë të latuar, gjithfarë masash, të vendosur pa puthitje të rregullt, shpesh me zgavra në mes tyre e, disa herë, të mbushura me copa tullash e tjegullash. Po ashtu e ndërtimit turk paraqitet edhe shtesa e katit përmbi portën. Kjo dallohet nga punimi i murit prej guri, nga forma e kamareve dhe e frëngjive (me hark të thyer), të ngjajshme me ato që shihen në shtëpitë e vjetra të qytetit. Po ashtu edhe llaçi i përdorur në këto punime nuk është me cilësi të mirë, derisa aty shihen copa gëlqereje, të cilat na tregojnë një punë

14) Më gjërë shih C. Praschniker — A. Schober. **Archäologische Forschungen in Albanien und Montenegro** Wien 1919, f. 9.
15) V. Kamsi, Vështrim mbi kështjellën e Shkodrës lexuar në Sesionin I shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, 5-6 Dhjetor 1969.
16) G. Gerola, **Monumenti veneti nell'isola di Creta.** Vol. I. Venezia, 1905. Në kështjellën e Melisës «faqja e rrëpinjtë e përbërë nga shkëmbinjtë është vazhduar dhe rritur me anën e një muri të thatë (d.m.th. pa llaç — V.K.) me blloqe të parregullt» (f. 278-279). Po aty Fot. 169, që jep planimetrinë e vendit, dhe sidomos në Fot. 170 ku duket qartë muri për të cilin bëhet fjalë.
17) H. Hecquard, **Histoire et description de la Haute Albanie ou Guegarie** Paris, 1858, 18. Për këtë si dhe për shënimet e mëposhtme 15 e 16 shih edhe V. Kamsi, **Kalaja e Shkodrës,** 85 shën. 26.
18) A. Degrand, **Souvenirs de la Haute Albanie.** Paris, 1901, 78.
19) **Shqypnija e ilustrueme.** Kalendar i vjetës perishtupe 1928. Shkodër, 13.

DOKTORI

jo të kujdesshme si në shuarjen e saj dhe në përgatitjen e llaçit. Pjesë të tjera nga dora e turqve vërehen edhe në pjesën e fundit të rrethuar me ledhe, ku mbi murin e mëparshëm, në një lartësi 1,70 m. fillon një brez i lartë 1 m., i cili është i punuar me teknikën e katit të sipërm të barbakanes.

Edhe kalldrëmi ekzistues i rrugës, nga shkalla e re deri brenda në kështjellë, është punim i vonë turk, i bërë mbi shtresën më të vjetër, gjë që ka prurë ngritjen e nivelit të rrugës. Gjurmë të rrugës së lashtë, që ruajnë ende kalldrëmin e vjetër, shihen poshtë shkallës së re, dhe na tregojnë njëkohësisht se kjo rrugë kishte një ecje zig-zage, ishte më e ngushtë dhe më e vështirë në ngjitje, sidomos në pjesën e poshtme.

Nga sa kemi thënë më sipër, mund të arrijmë në këto përfundime kryesore:

1) Barbakaneja u ndërtua për të siguruar kështjellën nga sulme të befasishme, duke e detyruar armikun të kalonte disa breza fortifikimi të mbrojtura mirë.

2) Punimet e barbakanes u filluan në vitet 1407--1408.

3) Përveç venedikasve, në këtë sistem vunë dorë edhe turqit, duke bërë punime vetëm ruajtëse, të kufizuara dhe të dobëta teknikisht.

DO NOT COPY

TAB. I









DO NOT COPY

Vili KAMSI

LA FORTIFICATION DE L'ENTREE PRINCIPALE DE LA CITADELLE DE SHKODËR

RESUME

Le cadastre de Venise fait état pour la première fois en 1416-1417 de la fortification de la porte principale de la citadelle de Shkodër.

Bien que n'étant pas en mesure de déterminer avec précision l'année de la construction, nous pouvons fixer cette date dans une certaine fourchette. En 1403, Venise décide de faire fortifier la citadelle de Shkodër. La même année, a lieu une révolte contre la domination vénitienne, à la suite de laquelle un bon nombre de participants au mouvement verront leurs biens confisqués. La période de la fortification de la porte doit, semble-t-il, se situer entre les années 1403 et 1406, et, si l'on tient compte de l'intervalle qui a séparé généralement dans d'autres cas analogues la prise de la décision de sa mise à exécution, il est permis de penser que ces travaux ont dû être effectués dans les années 1407 ou 1408. Les constructions menées par les Vénitiens en ces années, avaient pour but d'assurer l'entrée principale de la citadelle, créant une cour fortifiée par une barbacane devant l'ancienne entrée.

La barbacane (A) est constituée par une tour à base rectangulaire des dimensions, 10,20 x 20,20. Le rez-de-chaussée est parcouru d'une longue galerie au plafond assez haut, flanquée de 4 abris de chaque côté. Ils étaient utilisés pour abriter les troupes qui défendaient la porte, ainsi que l'infanterie, dans les cas de passage de la cavalerie. Les abris sont surmontés d'arcs et surélevés de 30 à 40 cm par rapport au niveau du couloir. On y distingue des niches qui devaient servir aux moyens d'éclairage. La barbacane devait avoir un étage au-dessus du rez-de-chaussée, et être couverte d'un toit, comme nous la représente Barletius, lorsqu'il décrit les bombardements à l'aide de matières incendiaires, auxquels la soumettaient les Turcs. Mais le premier étage ne recouvrait pas entièrement le rez-de-chaussée et il laissait découverts les voûtes de la partie terminale des abris 1, 2, 3 et 4.

Dans la cour, on remarque un escalier qui servait à l'ascension du corps de garde au chemin de ronde. L'escalier a une hauteur de 2 m. L'ensemble de ce passage s'appuie sur deux arcades en plein cintre. Sous chaque arcade, dans la muraille s'ouvre une meurtrière s'évasant vers l'extérieur, et qui a dû servir au jet de matières incendiaires sur les assaillants.

L'ensemble de ce système de fortifications était défendu par deux places d'armes saillantes (D, D). La place d'armes C commande la route qui conduit à la citadelle, cependant que l'angle saillant D est pourvu de plates-formes pour les sentinelles et de meurtrières de diverses formes. Sous l'angle D, s'ouvre une porte secrète donnant sur une galerie, qui se divise, presque aussitôt qu'on s'y engage, en deux couloirs creusés dans le roc, de largeur juste suffisante pour permettre le passage d'un

DO NOT COPY

homme. Il se peut qu'il s'agisse là de ce «fossé souterrain ouvert dans le roc près de la grande porte», dont parle Barletius. A partir du dernier tournant de la route menant à la citadelle jusqu'à la porte de la barbacane, se dresse des ouvrages complémentaires de fortifications. L'ensemble de ce système est également entouré d'un fossé.

Dans toutes ces fortifications de la porte principale de la citadelle aparaît la distinction entre les travaux effectués par les Vénitiens et les réparations exécutées par les Turcs. Ces derniers aménagements, techniquement inférieurs, s'observent sur la droite de la porte. La construction ajoutée au premier étage sur la porte ainsi que le pavage existant de la rue menant de l'escalier à l'intérieur de la citadelle, pavage qui a eu pour effet de rehausser le niveau de la rue, portent également la marque des bâtisseurs turcs.

DO NOT COPY

Hasan NALLBANI

DO NOT COPY

SHËNIME MBI MASAT RESTAURUESE NË PIKTURËN E XHAMISË SË BEQARËVE NË BERAT

Xhamia e Beqarëve është quajtur kështu nga që ndërtimi i saj është financuar nga shoqata e zejtarëve beqarë, për ekzistencën e të cilave në vendin tonë gjejmë të dhëna që në shek. XVII [1].

Xhamija është ndërtuar në gjysmën e parë të shek. XIX [2]). Gjendet në rrëzë të lagjes Mangalem, paesazhi i së cilës kurorëzohet me siluetin dinamik të kalasë së qytetit të Beratit.

Zgjidhja arkitektonike e godinës është konceptuar thjeshtë, pjesa kryesore, që përfshin ambientin ku kryheshin ritet ka formën e një kubi të mbajtur nëpërmjet një harkade me kolona prej gurësh të latuar në formë disku, e cila krijon poshtë fasadës jugore tre ambiente me qemer me shtrirje gjatësore që shërbejnë si element konstruktiv për dyshemen, njikohësisht edhe si ambient të çfrytëzueshme për qëllime tregëtie. Volumi masiv i ambientit kryesor që sheh nga jugu përveç katër dritareve për çdo fasadë të vendosura në dy rreshta është dekoruar nga jashtë nën strehë me një brez dekorativ të pikturuar me gjërësi deri 1.5 m. si dhe me një brez tjetër mbi të cilin është vizatuar me ngjyrë të bardhë një muraturë e rregullt.

Në pjesën që sheh nga veriu është ndërtuar hajati i cili në të tre krahët kufizohet me harkadë me kolona prej guri.

Gjatë Luftës së parë botërore, sipas thënieve të pleqve, xhamia është përdorur për një kohë nga forcat pushtuese të Austro-Hungarisë si kazermë. Në këtë kohë janë vendosur mjaft gozhdë në brezin e drunjtë për të varur armët dhe është ndezur zjarr brënda godinës, gjurmët e të cilit ruhen edhe sot.

Për meremetimin dhe konservimin e arkitekturës së xhamisë, grupi i kulturës materiale, gjatë viteve 1960-1963, ndërmori një ekspeditë e cila kreu një seri punimesh që konsistuan në rimbulimin e çatisë dhe konsolidimin e harkut të mesit të fasadës jugore, e cila si rezultat i trafikut të shtuar vitet e fundit kish ceduar, duke krijuar çarje në krejt fasadën. Si rezultat i këtyre punimeve lindi nevoja për të marrë disa masa mbrojtëse dhe konservuese edhe në pikturën e faqes nga jugu, brënda dhe kryesisht në zonën e mihrabit ku u vendosën napa mbrojtëse.

Gjendja e pikturës murale

Përveç brezit dekorativ, nën strehë që rrethon nga jashtë të tre faqet e godinës, krejt interieri i xhamisë në lartësinë mbi 2 m. nga dyshemeja, është dekoruar me motive floreale, paesazhe të arkitekturës myslimane si dhe me elemente të tjerë dekorativ si fruta, lule, etj. të trajtuara këto në kriteret e pikturës orientale në mënyrë kaligrafike pa evidentime volumesh dhe trajtim prespektiv.

Në pikturën e brezit nga jashtë skenat me motive të arkitekturës janë shpërndarë në mënyrë simetrike të përcaktuara nga bordura me ngjyrë të

1-2) Zija Shkodra. **Problemi i kallfës në sistemin e esnafëve shqiptarë** B.U.SH.T. Nr. 1, 1963.



Fig. 1

kuqe të cilat e ndajn frizin e pikturës në disa kuadrate.

Brezi i jashtëm si një dantellë e lehtë lidhet në mënyrë mjaft organike me arkitekturën duke e pasuruar dhe ndihmuar perceptimin e saj.

Gjithashtu piktura e interierit ka shfrytëzuar po ato motive si dhe brezi i jashtëm. Dekori është ndërtuar brënda kuadrateve që përcaktojnë bordurat me ngjyrë të kuqe të ndërtuara horizontalisht dhe të ndërprera në mënyrë vertikale.

Krejt piktura është vepër e një mjeshtri anonim me eksperiencë dhe shije mjaft të hollë. Për elegancën e vizatimit dhe ndërtimin koloristik, piktura e Xhamisë së Beqarëve në Berat mendojmë se është një nga më të bukurat ndër monumentet e arkitekturës së kultit mysliman në vendin tonë.

Për pregatitjen e shtresës së llaçit ku është ekzekutuar piktura kanë shërbyer dy shtresa, e para e pregatitur me gëlqere dhe kashtë gruri të grirë, ndërsa shtresa mbi të cilën është pikturuar është përzier me lesh dhije dhe ka një trashësi deri 0.5 cm.

Motivet dekorative janë ekzekutuar kryesisht mbi llaçin e njomë të shtresës së sipërme, duke siguruar lidhjen e nevojshme për ngjyrat. Disa nga ngjyrat si ultramarini, jeshilja dhe veçanërisht e zeza nuk kanë siguruar lidhjen e nevojshme.

Krejt piktura e brendisë ka qenë e lyer me disa shtresa shërbet gëlqereje të vendosura kryesisht mbas vitit 1940.

Si rezultat i tymit të druve dhe të qirinjve të djegur brenda godinës, mbi sipërfaqen e pikturuar është depozituar një velo e zezë me bazë karboni, e cila ka dëmtuar aspektin teknik dhe estetik të pikturës.

Nga ngricat dhe veprimi indirekt i reshjeve atmosferike, si dhe nga ndryshimet e temperaturës dhe veprimi i dritës së diellit gjatë verës, është dëmtuar mjaft brezi i piktuaruar në fasadën jugore dhe perëndimore, duke sjellë si rezultat shkatërrimin e ngjyrave dhe dekompozimin e suvasë. Trafiku urban dhe lëkundjet e tërmeteve të viteve të fundit kanë shkaktuar çarje në muraturë dhe në suvanë e pikturuar, duke krijuar një rrjetë të tillë mbi gjithë pikturën e godinës. Piktura e interierit ka pësuar edhe nga keqpërdorime të karakterit të ndryshëm, duke krijuar në mjaft zona shkëputje të suvasë nga muri dhe gropa të shumta, që i gjejmë kryesisht në zonën e ambientit të dekoruar.

Masat restauruese

Gjatë muajve maj – gusht të vitit 1968 u ndërmuarën masa të pjesshme restaurimi në pikturën murale të interierit. Këto masa kishin për qëllim të çvishnin pikturën nga shtresat e gëlqeres si dhe ta shoqëronin këtë proçes me masa të tjera restauruese, që konsistonin në konsolidimin e gjëndjes së pikturës, në mbushjen e gropëzave të hapura, si dhe në pastrimin e gropëzave të tjera që ishin mbushur më parë pa kushtet teknike të nevojshme.

a) Faza e parë e punës kishte të bënte me heqjen e shtresave gëlqerore dhe me zbulimin e pikturës murale. Kjo masë u krye në fillim thjesht mekanikisht, me anë të thikave dhe të spatulave të madhësive të ndryshme të pregatitura për këtë qëllim. Proçesi i çveshjes së pikturës nga shtresa e gëlqeres nuk shkonte gjithnjë mirë, me që në shumë zona shtresa pikturale ishte e dekompozuar, ndërsa në zona të tjera, lidhja e pamjaftueshme e suvasë së pikturuar me murin krijonte mjaft xhepa të zbrazët. Shkalla e qëndrueshmërisë së suvasë ishte e ndryshme, për pasojë, në shumë vende sherbeti i gëlqeres ishte kalçifikuar dhe përbënte një lidhje shumë kompakte me shtresën e ngjyrave të dekorit. Këtij problemi ju gjet zgjidhja me anë të veprimit fizik të një pllake metalike të nxehur në zjarr dhe të vënë pastaj mbi shtresën e trashë të gëlqeres. Në

DO NOT COPY

këtë mënyrë u bë e mundur nxehja, bymimi dhe plasaritja e shtresës së gëlqeres, duke krijuar kështu mundësinë e shkëputjes së saj nga piktura. Proçesi i çvendosjes u krye në mënyrë mekanike, me anë bisturishë kirurgjikale të madhësive të ndryshme.

Puna ndoqi një radhë të tillë: duke filluar me heqjen e shtresave gëlqerore të sipërme deri te shtresa e sherbetit të gëlqeres. Kjo radhë pune jepte mundësi që shkëputja e sherbetit të bëhej më lehtë dhe të kontrollohej vazhdimisht shtresa e pikturës nën sherbet, në mënyrë që shkalla e nxehjes të ishte e tillë, që mos të dëmtonte shtresën e pikturës. Për këtë qëllim u përdor lagia e sherbetit me ujë, gjë që ndihmoi në shkëputjen e gëlqeres gjatë proçesit të nxehjes. Uji, duke hyrë në plasaritjet dhe pastaj duke u avulluar, ndihmonte që veprimi fizik i bymimit të ishte më i plotë.

Për shpejtimin e punës u pa i nevojshëm përdorimi i një mjeti nxehës më të fuqishëm. U praktikua nxehja me furnelë elektrike dhe pastaj, me hekur korenti. Ky proçes kërkonte mbikqyrje të kujdesshme dhe mund të praktikohej direkt vetëm mbi shtresën e trashë të gëlqeres. Në këtë mënyrë u arrit që brënda një kohe të shkurtër të çvisheshin sipërfaqe të mëdha. Por pastrimi nuk ishte i plotë. Mbeturina të veçanta të gëlqeres, që ishin lidhur fort me shtresën e pikturës, mbeteshin për një fazë tjetër pastrimi.

Gjatë fazës parë u zbuluan mjaft gropa të vogla dhe të mëdha, që ishin mbuluar nga gëlqerja ose ishin mbushur me llaç. Të gjitha këto u pastruan dhe u hapën deri në thellësinë e murit. U eksperimentuan dhe metoda të tjera pastrimi, si përdorimi i tretësve për shkatërrimin e shtresës gëlqerore. Në fillim u përdor acidi açetik i holluar në ujë dhe, më vonë, ai kloridrik në dozën 5%, në vende ku nuk kish pikturë. Eksperimenti me acidin kloridrik nuk dha rezultate, për arësye se veprimi i tij mbi gëlqeren nuk linte pa prekur sadopak shtresën e pikturës, ndërsa ai acetik, në rastet kur shtresa e gëlqeres ishte e fortë, nuk jepte asnjë rezultat.

b) Faza e dytë e punimit kishte të bënte me pastrimin e mbeturinave të gëlqeres, të tymrave, të pluhurit dhe të mbeturinave të tjera organike, ose të njollave të ndryshme që kishte piktura në sipërfaqe. Gropat e hapura duheshin mbushur në mënyrë që të shërbenin si bazë për tonimin në një fazë tjetër dhe, njëkohësisht, si pika fiksuese të shtresës së llaçit me murin. Ky problem paraqitej i vështirë sidomos në zonën që kapte brezin e drunjtë të mura-



Fig. 2

NO NOT COPY

turës, ku dhjetra gozhdë kishin hapur një numur të konsiderueshëm gropash në gjithë shtrirjen gjatësore të brezit të drunjtë.

Ky qëllim u arrit, duke bërë mbushje me një llaç të përbërë nga gëlqere e shuar mirë me stazh disa vjeçar, kazeinë dhe pluhur mermeri. Raporti i gëlqeres ishte 15 me 1 kazein, ndërsa pluhuri i mermerit u përdor në sasinë e kërkuar për suvatim. [3]) Ky proçes në fillim nuk eci mirë, pati plasje të mbushjeve dhe shkëputje të suvasë së re. Mbas disa provash, konstatuam se një faktor i rëndësishëm ishte sasija e ujit që duhej për lagien e gropës, si dhe sigurimi i lagështirës së nevojshme gjatë proçesit të tharjes së llaçit mbushës, pa përjashtuar këtu përpunimin e llaçit dhe shtrirjen e vazhdueshme me spatul.

Përdorimi si lidhës i kashtës së shtypur, ose i leshit të dhisë, u pa me vënd në shtresën e parë mbasi ishte bërë spërkatja me ujë dhe sherbet çimentoje. Llaçi i vendosur në dorën e parë duhej të ishte i fortë dhe me fakturë të ashpër, për të formuar lidhje me shtresën tjetër, por jo aq sa të krijonte disnivelime të theksuara, të cilat lindnin kushte të pabarabarta në tharjen dhe konsolidimin e shtresave. Gjatë vendosjes së shtresës së parë u siguruan dhe copat e gropave, ndërsa sigurimi i një lidhësi të qëndrueshëm gjatë brezit të drunjtë qe një problem që u zgjidh me anën e gozhdëve të ngulura në dru, për të shërbyer si lidhës për llaçin. Mbushjet e bëra në këtë mënyrë krijuan mundësinë e marrjes së masave të tjera restauruese.

Problem paraqiste dhe fiksimi i xhepave në zonat ku shtresa e pikturës kishte bërë shkëputje me murin. Në këtë rast, u përdor një lloj llaçi lidhës i përbërë nga gëlqere, kazein dhe açetat polyvinil, duke i shtuar dhe pluhur mermeri. Ky lloj lidhësi fiksoi këto zona duke krijuar mundësinë e pastrimit të tymrave dhe të mbeturinave të tjera sipërfaqësore.

c) Faza e tretë e punës konsistoi në pastrimin me gomë, gjë e cila dha rezultat të kënaqshëm. U përdor njëkohësisht dhe larja me furçë, sapun dhe ujë, në zonën ku nuk kishte pikturë. Rezultatet e pastrimit me gomë qenë veçanërisht pozitive sidomos kur fërkimi me gomë shoqërohej me një rrymë uji të vazhdueshme që aplikohej me një tullum të zakonshëm, kryesisht për sipërfaqet e papikturuara. Gjatë proçesit të pastrimit jo të gjitha ngjyrat kishin një shkallë të njëjtë rezistence ndaj fërkimit: p.sh. e zeza dhe jeshilja ishin ngjyra të dobëta që nuk duronin fërkime me gomë. Për pastrimin e pikturës u përdorën edhe tretës si terpentina dhe alkooli. Përdorimi i tyre kishte pasoja në lënien e mbeturinave dhe nuk na u duk gjithnjë praktik.

Në radhën e masave restauruese u kryen dhe çvendosje pjesësh të pikturuara, rregullime dhe përforcime të llaçit ekzistues. Heqja dhe rivënja në mur e pjesëve të pikturës së dëmtuar qenë masa të pjeshme, që u kryen me sukses dhe evituan pjesërisht rrezikun e prishjes së pikturës.

Për fiksimin e shtresës së pikturuar në faqen e lindjes në këndin juglindor u provua pjesërisht vendosja e një shtrese të açetatit të polyvinilit në alkool, mbi një zonë të pikturës së pastruar.

Punimet e pjesëshme restauruese bënë të mundur të pastrohet nga shërbeti i gëlqeres mbi 60% e pikturës së mbuluar, duke shërbyer njëkohësisht në pasurimin e përvojës për punime të këtij karakteri. Shtrirja e tyre edhe në zona të tjera si dhe thellimi i mëtejshëm i proçesit restaurues në drejtim të pikturës dhe arkitekturës do të ndihmojnë për vlerësimin e plotë të monumentit.

DO NOT COPY

3) P. Philippot et P. Mora; **La conservation des peintures murales.** Musées et monuments, XI. **La préservation des biens culturels,** Unesco 1969.





DO NOT COPY

TAB. II





DO NOT COPY

Hasan NALLBANI

NOTES SUR LA RESTAURATION DES PEINTURES DE LA MOSQUEE DE «BEQARS» A BERAT

RESUME

La mosquée des «Beqars» à Berat est un monument qui date du XVIIIe siècle.

Du point de vue architectural, il s'apparente, dans la répartition des volumes aux habitations typiques de cette ville, ce qui a été dicté par l'inclinaison du terrain sur lequel il est construit.

En 1963, une série de travaux de réparation et de restauration y ont été entrepris et certaines mesures ont été adoptées en vue de préserver les peintures murales dans certaines parties de l'édifice.

Les peintures murales couvrent entièrement à l'intérieur, la partie supérieure de trois des murs, sous la forme d'une frise décorative. Entre autres motifs, on y relève des éléments architecturaux traités sous l'aspect calligraphique sans mise en évidence de volumes ni utilisation de la perspective. De façon générale, ces peintures se fondent en une unité avec l'ensemble et contribuent à la perception des éléments architecturaux.

Quant à leur état, elles ont souffert des fumées à base de carbone et sont recouvertes de plusieurs couches de lait de chaux. Elles sont endommagées en maints endroits et la couche de revêtement est détachée du support de soutien. De même, sous l'effet du soleil, des pluies et des variations continuelles de température, les peintures qui décorent la façade ouest et sud sont considérablement dégradées.

Du mois de mai au mois d'août 1968 certaines mesures de restauration ont été mises en oeuvres sur la surface qui décore l'intérieur de la construction. Ces mesures avaient pour but de nettoyer les peintures des couches de chaux qui les recouvrent et de consolider leur état après l'émimination de ces couches, ainsi que de niveler les parties nettoyées, grâce à des remplissages appropriés.

Pour le nettoyage de la chaux on a employé diverses spatules du type de celles utilisées en chirurgie. Dans les cas où la couche de chaux créait une croûte épaisse, on a procédé au chauffage de ces parties de façon à en provoquer la dilatation et le détachement. La couche de lait de chaux qui subsistait après l'élimination des autres couches a été nettoyée mécaniquement à plusieurs reprises par aspersion d'eau, ce qui a entraîné la formation de cassures et permis d'ôter plus facilement cette couche.

D'autres méthodes ont également été expérimentées, notamment par frottement à l'aide de solution d'acide acétique à 10-20%, mais l'action de cet acide s'est révélée limitée, cependant que l'emploi d'acide chlorhydrique dilué risquait d'endommager la couche de peinture.

Les creux créés à la suite de l'élimination de la couche de chaux ainsi que ceux

DO NOT COPY

qui existaient déjà ont été remplis de mortier constitué de chaux éteinte, de caséine et de poudre de marbre.

Dans les parties où la couche de peinture était séparée de son support, elle a été enlevée puis solidement replacée sur son nouveau support à l'aide de chaux aspergée d'alcool à 10% d'acétate de polyvinyle.

Afin de fixer la surface des peintures il y a été oppliqué une mince couche d'acétate de polyvinyle.

A l'issue des mesures de restauration adoptées pour ces peintures on est en droit de conclure que pour le nettoyage du lait de chaux le moyen le plus sûr est le nettoyage mécanique à l'aide de spatules de dimensions diverses. Le mouillage de la couche de chaux, entraînant la pénétration de l'eau dans les fissures, a aidé au détachement de cette couche. Le nettoyage des fumées et des impuretés se fait au moyen d'un léger lavage à une solution d'ammoniaque à 5%, ou d'acide acétique. Pour le nettoyage de la poussière demeurée sur les peintures on peut employer, avec de bons résultats, la mie de pain. L'emploi de la poudre de marbre comme matériau de remplissage crée une facture similaire à celle de la peinture et est d'un heureux effet quant au ton.

Les mesures de restauration ont contribué à revaloriser une vaste zone qui était couverte d'une couche de chaux. L'extension de ces travaux à d'autres parties et l'élaboration plus poussée de ces méthodes sur le plan de l'architecture proprement dite, permettra une parfaite revalorisation de ce monument.

DO NOT COPY

Emin RIZA – Thanas KAMBERI

DO NOT COPY

KULLAT NË FSHATIN GORANXI

Në fshatin Goranxi, që gjëndet rreth 10 km. në jug lindje të qytetit të Gjirokastrës, që ndrojnë ende më këmbë disa ekzemplarë ndërtimesh të vjetëra mbrojtëse, që fshatarët i quajnë «kulla», madje dhe vetë fshati në të kaluarën thirrej me emrin «Kulla Goranxi».

Goranxia, e ndërtuar në rrëzë të Malit të Gjerë, ashtu si shumë fshatra të tjerë të kësaj zone, ka përpara fushën pjellore të Dropullit. Koha e ndërtimit të fshatit nuk dihet, në regjistrin e Sanxhakut të Shqipërisë të vitit 1432, [1]) përmenden dy Goranxi: Ashagi Koranxhi (Goranxia e Sipërme) dhe Jukari Koranxhi (Goranxia e Poshtme). Ne mendojmë se fshati Goranxi, kullat e të cilit janë objekt i kësaj kumtese, duhen identifikuar me Goranxinë e Sipërme të Defterit turk.

Në këtë fshat sot numërohen rreth 25 kulla, prej të cilave vetëm 3 janë në gjëndjen e tyre origjinale, ndërsa të tjerat janë adaptuar pjesërisht ose tërësisht. Në fshatrat Haskovë dhe Sofratikë ka nga një ekzemplar të adaptuar, ndërsa në fshatin Derviçian ka dy të tillë gjithashtu të adaptuar për banim.

Në këtë kumtesë jemi mbështetur kryesisht në tre ekzemplarë që ruhen në gjëndje të mirë në Goranxi, duke pasur parasysh dhe kullat e adaptuara më vonë.

Kullat (fig. 1), me planimetri katërkëndëshi këndrejtë, janë vendosur të gjitha me ballin e gjerë nga fusha, ato janë ndërtuar krejtësisht me gurë e mbuluar me rrasa guri. Volumi i tyre prizmatik lidhet natyrshëm me ambjentin e çveshur shkëmbor. Nuk ka gjurmë që të tregojë në se ka pasur mure rrethuese ose ndërtime ndihmëse. Banesat e fshatit janë të tipit me gjysmë kat, të ndërtuara me gurë. Ato janë më të vona se kullat dhe duhet të kenë filluar të zëvëndësojnë banesën shumë të thjeshtë të çifçinjve aty nga mesi i shekullit të kaluar.

Kullat janë zakonisht trekatëshe (sipas njehsimit popullor), por gjënden dhe kulla katërkatëshe, ku ndërlidhja në mes kateve sigurohet me anë shkallësh të brendshme; ato që lidhin katin e parë me të dytin janë ndërtuar prej guri, ndërsa ato që të çojnë në katin e tretë janë zakonisht prej druri. Hyrja e vetme për në kullë, në shumicën e rasteve ndërtohet në ballin e gjerë të saj, por disa herë ajo ndërtohet në ba-



Fig. 1

1) **Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë,** Vol. II, Tiranë 1962, f. 157.

Ilin e ngushtë. Hyrja mbulohet nga një hark gjysmërrethor pak më të thelluar se faqja e muraturës. Dera njëkanatëshe ndërtohet me dru të fortë dhe sigurohet me katarah. Pranë derës nuk duken frengji. Por në shumë kulla mbi hyrjen, në katin e tretë, ndërtohet një dritare e vogël e cila, siç duket, ka shërbyer për të vrojtuar dhe mbrojtur hyrjen për në kullë (fig. 2).

Kati i parë ndahet në dy pjesë nga një mur i tërthortë. Në pjesën e parë janë ndërtuar shkallët e gurta, pjesa tjetër është ambienti i vetëm i katit të parë, i cili shërbente si depo prodhimesh bujqësore dhe, me shumë gjasë, edhe për strehimin e kafshëve të ngarkesës. Ky ambient, ashtu si dhe pjesa e parahyrjes, ndriçohet nga dritare në formë frengjie që shohin nga fusha. Muri i tërthortë vazhdon dhe në katin e dytë, i cili ka të njëjtën vendosje ambientesh si të katit të parë. Ambienti i vetëm i katit të dytë ka shërbyer gjithashtu për depo prodhimesh bujqësore. Ai ndriçohet nga dritare në formë frengjie, të cilat ndonjë herë janë ndërtuar dhe në ballin e ngushtë, por përveç tyre, gjejmë dhe dritare të zakonshme me përmasa shumë të vogla. Kati i tretë ka qënë i banueshëm, ai formohet nga dy ambiente. Nuk jemi të sigurtë nëse këto ndaheshin me ndonjë ndarje të lehtë, siç është gjëndja sot në kullën Nr. 1 (tab. I), por jemi të prirur të mendojmë se kjo ndarje ka qenë ndërtuar së bashku me kullën për shkak se funksionet e ndryshme të këtyre dy ambienteve, njëri për qëndrim e tjetri për gatim, e kërkojnë një zgjidhje të tillë. Kati i tretë është me lartësi rreth 2,80 m, pra rreth 1 metër më i lartë se dy të parët. Ai ndriçohet nga dritare jo të mëdha që mbulohen zakonisht me hark. Ambienti i banimit nuk ka oxhak; në muret e tij gjen të ndërtuara kamare. Afër ballit, nga faqja që sheh në fushë, duken qartë gjurmët e një lloj çardaku të vogël, i cili dilte jashtë kontureve të planimetrisë (fig. 3). Sipas pohimeve të banorëve, ai ishte i veshur me dërrasa dhe mbulohej nga zgjatimi i flegrës së çatisë. Pranë derës së ngushtë që lidh çardakun me kullën ndërtohen gjithmonë dy kamare pranë njëra tjetrës. Ky çardak i mbyllur duhet të ketë pasë funksionin e qoshkut. Ambienti tjetër ka shërbyer për gatim. Në të gjejmë një lloj oxhaku i cili, për mendimin tonë, është një fazë kalimtare drejt ndërtimit të oxhakut me tymar. Ky vend zjarri pa tymar është vendosur në mesin e faqes ballore të ambientit të gatimit. Ai formohet nga dy kamare të vendosura njëra mbi tjetrën në thellësi të muraturës nga të cilat e poshtmja është vëndi i zjarrit. Në kullën Nr. 1 (tab. I), vëndi i zjarrit formohet nga tri pllaka guri të vendosura dy anash dhe e treta sipër tyre jashtë muraturës. Në faqen përbri vëndit të zjarrit janë të ndërtuar një ose dy policë (sergjen) guri, si dhe kamare. Në kullën Nr. 2, në dy qoshet e faqes ballore, në lartësi rreth 1.6 m, gjejmë dy gropëza që mund të kenë qenë përdorur për vendosjen e pishtarëve të ndriçimit. Ambienti ndriçohet zakonisht nga një dritare e vogël që sheh nga fusha. Në faqen që sheh nga mali ndërtohet një sqoll për derdhjen e ujrave. Gjithashtu në këtë faqe janë ndërtuar dhe kamare. Ndërsa shtresa e ambientit të banimit është me dërrasa të vendosura mbi trarë, ambienti i gatimit është i shtruar me



Fig. 2



Fig. 3

PROTOTY

pllaka guri të cilat janë vendosur mbi shtresën e dërrasave; në pjesën ku ndizet zjarri mbi pllakat është hedhur një shtresë me baltë të punuar. Të dy ambientet e katit të tretë janë pa tavan.

Në kullat e Goranxisë të bie në sy çardaku i vogël i mbyllur, i cili ka shumë paralele me të njejtin element arkitektonik në kullën e Moglicës, [2]) me tipin e vjetër të banesës së Matit dhe me banesën e Çermenikës, Dibrës dhe Malësisë së Tiranës. [3]) Kulla e Moglicës (fig. 4), ruante një fragment të çardakut origjinal të ndërtuar me dru mbi zgjatimin e trarëve të dyshemesë, pjesa tjetër, e mbyllur më vonë sipas shënjash të qarta, tregon se ka qenë gjithashtu pjesë e çardakut të mbyllur. M. Urbani vëren me të drejtë «se ballkoni prej druri», siç shprehet ai, «tregon se kulla është tepër e vjetër», por ne mendojmë se është i ekzagjeruar mendimi se ajo ka një lashtësi rreth 400 vjeçare. Çardaku i kullave të Goranxisë në formën dhe teknikën e ndërtimit është i njëjtë me ata të përmëndur më sipër, por ai ka dhe një ndryshim me rëndësi nga këta çardakë, se ambienti i katit të tretë në kullat e Goranxisë nuk është i bashkuar me çardakun, por vetëm lidhet me të me anë të një dere të ngushtë.

Kullat e Goranxisë janë ndërtuar krejtësisht me muraturë të thatë guri të papunuar dhe pa breza druri, teknikë mjaft primitive që, me sa dimë, nuk është hasur në asnjë kullë të vëndit tonë.

Guri i shtrezuar në formë pllakash i nxjerrë në vënd, ka bërë të mundur që rreshtat të jenë horizontalë dhe muratura të lidhet mjaft mirë dhe në drejtimin tërthor, mbasi pllakat gjithmonë kalojnë gjysmën e trashësisë së muraturës. Terreni shkëmbor, mbi të cilin ngrihet direkt muratura dhe punimi i mirë i saj, megjithëse pa përdorur asnjë lidhës, ka bërë që muratura të jetë shumë solide. Në gjëndjen e sotme nuk shohim as plasje as ndonjë deformim tjetër të saj. Themeli i kullave është i cekët për shkak të terrenit shkëmbor dhe shpesh muratura ngrihet mbi shkëmbin e sheshuar. Muratura, që zakonisht fillon në katin e parë me trashësi 90-100 cm, ngushtohet mbas çdo kati 10-12 cm, duke arritur në katin e fundit rreth 70 cm. trashësi. Në muraturë duken shënja të trarëve të skelave të vendosur mesatarisht çdo 80 cm për shkak të peshës së rëndë të gurëve. Kjo teknikë e thatë dhe pa breza druri e muraturës ndryshon nga ajo e banesave gjirokastrite të ndërtuara me të njejtin gur shtresor, se në Gjirokastër përdoret lidhësi në faqen anësore të muraturës dhe muratura lidhet me breza druri.



Fig. 4

Çatia e kullave është gjithmonë dy ujshe, me kallkan guri, i cili është vazhdimi i muraturës në dy faqet e ngushta. Konstruksioni i çatisë është ndërtuar me lëndë, në formë stropili, ajo mbulohet me rrasa guri. Strehët shumë të vogla formohen nga zgjatimi i dy pllakave të mbulesës. Dyshemetë, me përjashtim të katit të parë, janë të ndërtuara me dërrasa të vendosura mbi trarë, ndërsa vetëm ambienti i gatimit ka dhe një shtresë me pllaka mbi të. Ambientet janë suvatuar me një shtresë llaç balte të lidhur me kashtë. Për mbulimin e hapësirave të dyerve të jashtme dhe të dritareve janë përdorur gjerësisht qemeret e punuara me gurë, të cilët, duke u trajtuar më thellë se muratura, janë të vetmit elementë arkitektonikë të punuar me përkujdesje estetike te këto godina, ku utilitarizmi shprehet në format e veta më të qarta.

Tre janë materialet ndërtimore të këtyre kullave: guri, druri dhe balta, dhe që të tre këta ndodhen në vëndin e ndërtimit, mbasi në të kaluarën zona mbi fshat ishte e pyllëzuar.

Siç përmëndëm më sipër, në fshatin Goranxi ruhen në gjendje relativisht të mirë tri kulla, të cilat dhe i kemi paraqitur grafikisht, kulla Nr. 1 (tab. I), Nr. 2 (tab. II), dhe Nr. 3 (tab. III).

Kulla Nr. 1 (tab. I), së cilës i kemi bërë dhe një rikonstruksion, ruhet në gjëndje të mirë, ajo ka pësuar vetëm një meremetim të vogël të çatisë, gjatë së cilës njeri kallkan është rrëzuar dhe në vënd të

2) M. Urban **«Die Siedlungen Südalbaniens»**
3) P. Thomo – **Banesa popullore e tipit kullë në Mat dhe në Mirditë, «Studime historike»,** Nr. 1, 1970.

tij është ndërtuar një flegër. Çardaku i mbyllur është shkatërruar krejtësisht duke lënë qartë gjurmët e trarëve të dyshemesë dhe vendet e mbështetjes së pajantave që përforconin dyshemenë. Në dallim nga dy kullat e tjera, hyrja kryesore nuk mbulohet me hark por me një arkitra druri. Kulla Nr. 2 (tab. II) me hyrje kryesore nga balli i gjerë, ruhet në gjëndjen origjinale; asaj i është shkaktërruar vetëm çardaku i cili, duke qënë ndërtuar krejtësisht prej druri, nuk i ka qëndruar kohës. Në këtë kullë ruhet mirë ambienti i gatimit në katin e tretë. Kulla Nr. 3 është më e dëmtuara, asaj i mungojnë dyshemetë dhe shkallët, të cilat mendojmë të kenë qënë ashtu siç i paraqesim në tab. III (fig. 5).

Kullat e Goranxisë janë ndërtime ku spikat qartë kompozimi vertikal, planimetria e tyre në formë katërkëndëshi këndrejtë, në dallim nga planimetria tradicionale afër katrorit e kullës, duhet shpjeguar me nevojën për rritjen e sipërfaqes, nevojë që diktohej nga fakti se këto ndërtime ishin dhe depo të prodhimeve bujqësore. I njëjti funksion ka influencuar në vendosjen e kullave paralel me vijat rrushkulluese, në dallim nga banesat e ndërtuara në Goranxi dhe në shumë fshatra e qytete të Shqipërisë të ndërtuar në terren të pjerrët, ku banesa vendoset me ballin e ngushtë në kontakt me terrenin.

Kullat nuk janë të pajisura me frëngji, dritaret në formë frengjije të katit të parë dhe të dytë kanë vetëm funksione ndriçimi, ashtu si në shumicën e banesave të malësisë të Shqipërisë së jugut. Por ngritja në lartësi, shkallët e mbrendshme, mungesa e dritareve në të dy katet e parë flasin qartë për tiparet mbrojtëse të kullës, e cila është një ndërtim ku mund t'a ndjesh veten të sigurtë nga çdo sulm. Mungesa e frengjive të luftimit, të cilat, siç dihet, në kullat ndërtohen zakonisht anës hyrjes dhe në katet e sipërme, ndofta duhet shpjeguar me përhapjen e pakët të armëve të zjarrit në kohën e ndërtimit të tyre. Në kullat e Goranxisë të bie në sy një primitivizëm i theksuar i cili shprehet si në zgjidhjen funksionale, ashtu dhe në teknikën e ndërtimit dhe në varfërinë e madhe të ambienteve, madje dhe ato të banimit janë pa tavan dhe pa asnjë element dekorativ, sado të thjeshtë qofshin. Pamjet e jashtme të kullave janë tepër të ashpra dhe të thata, dritaret e vogla të katit të tretë thyejnë shumë lehtë ftohtësinë dhe lakonizmin e theksuar të këtyre ndërtimeve të rënda e të zymta.



Fig. 5

Kullat e Goranxisë tregojnë qartë se nuk kanë shërbyer si banesa, mungesa e komoditetit minimal në katin e tretë e sidomos, mungesa e vendit të zjarrit në ambientin e banueshëm tregon se këto ndërtime nuk kanë shërbyer për qëndrim gjatë dimrit. Kullat e Goranxisë kanë shërbyer jo si banesa, por si depo dhe vëndqëndrim provizor për çifligarët, pronarë të tokave të fushës së Dropullit, të cilët gjatë verës dhe, posaçërisht gjatë kohës së mbledhjes së prodhimeve bujqësore qëndronin aty për të përvetësuar sa më shumë nga shfrytëzimi i punës së fshatarëve çifçinj.

Siç thamë më sipër, në Goranxi ekzistojnë gjurmët e rreth 25 kullave, numur ky shumë i madh, por siç pohojnë dhe vëndasit, Goranxia është «kërthiza e fushës së Dropullit», prandaj këtu ishte grumbulluar dhe shumica e kullave. Megjithatë ky grumbullim pret një shpjegim në të ardhmen. Siç dihet, sistemi i çifligut filloi të çfaqej që në shek. XVII, por në shek. e XVIII ai përhapet gjerësisht në Shqipëri.[4] Me këtë sistem të ri të shfrytëzimit feudal të fshatarësisë janë të lidhura dhe kullat në shqyrtim. Feudali kishte nevojë për një strehim të bollshëm për grumbullimin e prodhimit bujqësor, nga ana tjetër ky strehim duhej të ish i sigurtë jo vetëm për të ruajtur prodhimet bujqësore, por edhe jetën e vetë çifligarit në një ambient thellësisht armiqësor siç ishte ai i çifçinjve të shfrytëzuar. Pra, këto ndërtime, që me të drejtë quhen «kulla» për shkak të karakterit mbrojtës të tyre dhe të zhvillimit në lartësi, formojnë një klasë më vete në radhën e ndërtimeve mbrojtëse që thirren me të njëjtin emër.

Kullat e Goranxisë i kanë ndërtuar çifligarët që banonin në Gjirokastër, të cilëve, siç shkruan Hani[5],

4) S. Naçe «Çështje të çifligut feudal, në Shqipëri në sh. XVII e XVIII. «Buletini U.SH.T»., Seria Shkencore Shoqërore, Nr. 3, 1960.
5) J. G. Hahn – Albanesische Studien, Jena 1854 f. 41.

DOWNSCOPY

u përkasin të gjithë fshatrat e fushës. Për kullat e çifligarëve në fshatrat çifliqe, Hani na jep të dhëna me interes. Ai shkruan se «të tilla ndërtime gjënden në të gjithë gadishullin në fshatrat që janë çifliqe bejlerësh». [6]) Duke bërë një përshkrim të shkurtër të tyre, ky autor na thotë se hyrja në këto kulla ndërtohej në katin e dytë, te kjo hyrje mund të afrohesh me anën e një ure të lëvizëshme që mbështetej mbi një shkallë 5-6 këmbë larg kullës. Në Goranxi ne nuk gjetëm ndonjë hyrje të tillë.

Në disa fshatra të Metohisë kullat e para i ndërtuan bejlerët në çifliqet e tyre për të kontrolluar punën e çifqinjve si dhe për pushim në verë. Sasia e këtyre kullave ka qënë e madhe, dhe shumë prej tyre gjënden dhe sot në Grobovac, Gllavinicë, Leshan, Jabllanicë, Dugojevë, etj. [7]) Këto kulla për nga funksioni janë të njëjta me kullat tona.

Ne nuk kemi ndonjë element datues të sigurtë për të dhënë një mendim të saktë mbi kohën e ndërtimit të këtyre kullave, por disa rrethana të tërthorta, si përhapja e gjerë e sistemit të çifliqeve në zonën e Dropullit dhe teknika e tyre tepër e thjeshtë, na shtyn të mendojmë se këto ndërtime ka të ngjarë, të jenë të paktën aty nga mesi i shek. XVIII, e ndoshta aty nga fundi i shek. XVII.

Kompozimi pothuaj identik i këtyre kullave, elementet e njëjtë funksionalë, teknikë dhe arkitektonikë na shtyjnë të mendojmë se ndërtimi i tyre duhet të jetë bërë brënda një kohe relativisht jo të gjatë.

Në këtë fshat gjëndet dhe një ekzemplar kulle disi më i komplikuar i cili duhet parë si rast i veçantë. Kullat e Goranxisë duken qartë se janë ndërtuar nga mjeshtra profesionistë, të cilët sigurisht kanë qënë ata të krahinës së Kolonjës dhe të Dangëllisë që tradicionalisht ndërtonin në këto zona. Ne deri më sot nuk dimë të kenë mbetur në vendin tonë ekzemplare kullash me funksionet e atyre të Goranxisë. Por, sigurisht ndërtime të tilla duhet të kenë ekzistuar dhe në rajone të tjera të vendit tonë. Kështu kullat e familjes çifligare të Toptanasve në çiflikun e Laprakës [8]) u dogjën nga kryengritësit fshatarë më 1914.

Kullat e Goranxisë vinë të shtojnë dhe një lloj tjetër në kategorinë e ndërtimeve mbrojtëse që thirren me emrin e përbashkët «kullë» e që i gjejmë të ndërtuara në vendin tonë që prej kohësh shumë të lashta, si kulla për qëllime vrojtimi e mbrojtjeje, kulla si banesa të fortifikuara, kulla për mbrojtje pasive në banesa e manastire. Sistemi feudal me copëtimin ekonomik e politik, rivalitetin dhe pasigurinë ishte kushti themelor i domosdoshëm për përhapjen e këtyre ndërtimeve të cilat, në formën e kullave të kalave dhe atyre të veçuara, njiheshin dhe përpara formacionit feudal të shoqërisë. Ekzistenca në vendin tonë e ndërtimeve mbrojtëse të tipit kullë që prej kohësh shumë të lashta, dhe larmia e llojeve të tyre në përputhje me funksionin që kryenin në etapa të ndryshme historike e bën të paargumentuar çdo përpjekje për t'i parë disa lloje të ndërtimeve kullë në vendin tonë si huazime.

ZOTO COPY

6) J. G. Hahn — **Vep. e cit.,** 170.
7) M. Krasniqi — **Kulla u Metohiji, «Glasnik Etnografskoo Instituta»,** Srpska Akademija Nauka, VII, 1958.
8) H. I. Dalliu — **«Patriotizmi në Tiranë»** 1930, 104-105.

TAB. I

KULLA Nr.1



Premje tërthore



Rikonstruksioni

DO NOT COPY



Kati i I-rë



Kati i II-të



Kati i III-të

DO NOT COPY

KULLA Nr.2



Pamje e vëndit të zjarrit



Pamje kryesore



Kati i I-rë



Kati i II – të



Kati i III – të .

KULLA Nr 3



Pamje anesore



Pamje kryesore



Kati i I-rë



Kati i II-të



Kati i III-të

DO NOT COPY

Emin RIZA — Thanas KAMBERI

LES «KULLAT» DU VILLAGE DE GORANXI

DO NOT COPY

RESUME

L'époque de la fondation du village de Goranxi n'est pas connue. Le registre de recensement des terres de l'Albanie de 1432 fait état de deux Goranxi: Ashagi Korandji (Goranxi supérieure) et Jukari Korandji (Goranxi inférieure). A notre avis, le village de Goranxi dont les kullas sont l'objet de cet article, doit être identifié avec la Goranxi supérieure du Registre turc.

On compte aujourd'hui à Goranxi quelque 25 kullas, dont 3 seulement sont demeurées dans leur état initial; cependant que les autres ont été adaptées, partiellement ou totalement.

Les kullas à base rectangulaire sont disposées toutes avec leur face la plus large donnant sur la plaine, construites entièrement de pierres et couvertes de dalles.

Les kullas comportent généralement deux étages au-dessus du rez-de-chaussée, mais l'on trouve aussi des kullas de trois étages. La communication entre les étages est assurée par des escaliers intérieurs. Ceux qui relient le rez-de-chaussée au premier étage sont généralement en pierre, alors que ceux qui conduisent au deuxième sont d'habitude en bois. L'unique entrée de la kulla s'ouvre, la plupart des cas, dans l'une de ses faces les plus larges mais dans certains autres, dans la face la plus étroite.

Le rez-de-chaussée est divisé en deux parties par un mur transversal. Dans la première partie, est construit l'escalier de pierre, l'autre partie est le seul local du rez-de-chaussée servant de dépôt de produits agricoles. Ce local ainsi que le vestibule sont éclairés par de petites fenêtres en formes de meurtrières. La seule pièce du premier étage servait également de dépôt de produits agricoles. Le deuxième étage servait d'habitation proprement dite. Il se composait de deux pièces, l'une servant de chambre à coucher collective et à la fois de séjour et l'autre de cuisine. La pièce de séjour est dépourvue de foyer, et ses murs sont garnis de placards. Du côté de la façade qui donne sur la plaine on distingue nettement les marques d'une petite galerie fermée, en surplomb, qui saillait hors de la base de la construction.

Les kullas de Goranxi sont entièrement construites en pierres sèches non taillées et les murs ne comportent pas de chaînes horizontales en bois, ce qui représente une technique assez primitive que l'on ne rencontre dans aucune kulla de notre pays.

Les matériaux de construction employés dans ces tours sont au nombre de trois: la pierre, le bois et la terre, et ils ont tous été recueillis sur les lieux mêmes, la zone surplombant cette zone ayant été autrefois boisée.

Les kullas de Goranxi sont des constructions de nette composition verticale. Leur base, de forme rectangulaire, et qui se distingue de la base traditionnelle plus ou moins carrée, doit s'expliquer par le besoin d'accroître la surface, besoin dicté par le fait que ces bâtiments servaient aussi de dépôts de produits agricoles.

Les kullas ne sont pas pourvues de meurtrières, les petites fenêtres du premier et du deuxième étage, qui s'apparentent cependant par la forme à des meurtrières, ont uniquement une fonction d'éclairage, de même que la plupart des habitations rurales de l'Albanie du Sud. Toutefois, la manière dont la construction se dresse en hauteur, l'escalier intérieur, l'absence de fenêtres au rez-de-chaussée et au premier étage constituent bien des caractéristiques défensives propres à la kulla, construction dont les habitants sont assurés contre toute attaque extérieure, même armée. Les kullas de Goranxi ont pour trait frappant un primitivisme marqué, qui s'exprime tant dans la conception fanctionnelle que dans la technique de la construction, ainsi que dans la grande pauvreté des pièces, celles de séjour elles-mêmes étant dépourves de plafonds et de tout élément décoratif, si simple fût-il. L'aspect extérieur de ces kullas est très rude et nu, les petites fenêtres du deuxième étage rompent à peine la froideur et le laconisme accentués de ces lourds et sombres édifices.

Les kullas de Goranxi, de par leur structure même, laissent nettement apparaître qu'elle n'ont pas servi d'habitations permanentes. L'absence de la moindre commodité au deuxième étage et surtout de tout foyer ou cheminée dans la pièce de séjour indique que ces constructions n'ont pas servi d'habitation durant l'hiver mais simplement de dépôt ou de lieu de séjour provisoire pour les latifondaires, propriétaires des terres de la plaine de Dropull, qui y séjournaient durant l'été et surtout à l'époque de la récolte des produits agricoles pour tirer le maximum des paysans tchiftchis qu'ils exploitaient.

Ces constructions, appelées à juste titre kullas, forment, en raison de leur caractère défensif et de leur développement en hauteur, une catégorie à part parmi les constructions englobées sous le même terme.

DO NOT COPY

Faruk ZARSHATI

TË DHËNA MBI BANESËN E FUSHËS SË ZADRIMËS

DO NOT COPY

Krahina e Zadrimës shtrihet në fushën me të njëjtin emër, një nga më pjelloret e vendit tonë. Kjo fushë përfshihet ndërmjet dy kufijve natyralë, lumit të Drinit në perëndim dhe maleve të Velës e Potogut në lindje. Në veri dhe në jug të dy kufijtë e mësipërm takohen me njëri tjetrin respektivisht në Vaun e Dejës dhe në fshatin Roboshtë të Lezhës.

Fushën e Zadrimës e çajnë përrenj të shumtë dhe të furishëm, që shpesh bëheshin shkaktarë grryerjesh dhe përmbytjesh. Përpara çlirimit lumi Drin gjithmonë u ka sjellë fatkeqësira fshatarëve të Zadrimës, duke përmbytur tokat dhe banesat e tyre; kjo ka bërë që fshatrat të shpërngulen larg tij, gjithmonë duke ju afruar terrenit kodrinor.

Qëllimi i disa ekspeditave të ndërmarra në këtë krahinë ka qënë të përcaktonte banesën e vjetër Zadrimore. Ne vumë re, që kjo banesë në shumicën e fshatrave që vizituam: Roboshtë, Kallmet, Troshan, Blinisht, Fishtë, Dajç dhe Gjadër, qe transformuar pothuajse krejt. Sigurisht që kërkesat e jetës së re të fshatit kanë influencuar shumë dhe kanë qënë determinuese në këtë drejtim, por ne mendojmë, se një nga arësyet ka qenë dhe Drini, i cili «jo më pak se turku u shkaktonte të keqe popujve të Zadrimës». [1]) Megjithatë, ruhen disa ekzemplarë banesash në fshatrat Kallmet dhe Troshan, të cilat vlejnë për të përcaktuar tipin më primitiv të banesave të krahinës. Ndërtimet e reja, që bëhen sot në përshtatje me jetën e re në fshat, ruajnë vetëm volumin dhe formën e vjetër, kurse ana funksionale e pajisja e ambjenteve ndryshojnë. Sidoqoftë, me gjithë mungesën e burimeve për banesën e hershme të kësaj krahine, nga vrojtimi i ekzemplareve që ruhen, mund të nxirren disa konkluzione.

Fshatrat në këtë krahinë janë të përmbledhur, shtëpitë vendosen grupe-grupe, në të cilat banojnë pjesëtarë të një fisi. Lagjet, që mbajnë ose jo emrin e fisit, janë të vendosura mbi kodra, që nuk rrezikohen nga përrenjtë që zbresin nga Vela e Potogu në dimër. Çdo shtëpi ka oborrin e vet të rrethuar me mure guri të lartë. Sipas të dhënave të vëndasve kjo karakteristikë ka qënë për të kaluarën: banesat rrethoheshin kështu për shkak të hajnive dhe të fanatizmit. Sot ato janë me mure guri afërsisht 90 cm. të ngritur nga toka dhe me një gardh hunjsh mbi ta. Në oborr spikat pusi dhe kasollet e bagëtisë. Fshatarët e kësaj krahine janë marrë vazhdimisht me bujqësi e blegtori; tokat e tyre shtriheshin deri në breg të Drinit.

Gjëndja ekonomiko-shoqërore reflektohet qartë në shtëpitë e banimit që ndërtonte fshatari. Ajo më e thjeshta është jerevia. Jerevi vjen nga turqishtja dhe don të thotë: jere – përdhe dhe ev – shtëpi, d.m.th. shtëpi përdhese. Në të gjejmë vatrën dhe burgun (Tab. I-a). Po këto ambjente, d.m.th. burgun dhe vatrën, i gjejmë në një banesë tjetër, por që është dykatëshe: burgu poshtë dhe vatra lart (Tab. I-b). Kur fshatari është më në gjëndje, atëhere bashkangjitur me jerevinë ngreh kullën. Kemi kështu banesën kullë-jerevi. Kjo banesë është trekthinëshe dhe më e përhapura në atë krahinë (Tab. II, Tab. III). Varianti tjetër është ai, ku jerevia ngrihet edhe një kat mbi atë ekzistuesen; kemi kështu një banesë katërkthinëshe (Tab. IV). Le të marrim secilin nga këto variante dhe t'i shohim veç e veç. *Jerevia* është banesë katërkëndëshe (Tab. I-a) me përmasa që afrojnë 14 x 6.5 m. Thamë se në të gjejmë vatrën dhe burgun, të cilën ndahen midis tyre me gardh, perde, ose mjed (që është një mur guri ndarës). Në burg mbahen bagëtitë, gjëja më e vlefshme për fshatarin, i cili don t'i ketë pranë, t'i mbikqyrë, t'i ruajë nga çdo e papritur e t'i mbajë ngrohtë, prandaj ai ndërton burgun pothuaj fare pa dritare, vetëm nga-

ndonjëherë, në të rrallë, hap disa dritare të vogla. Komunikimi me burgun nga vatra bëhet nëpërmjet një dere. Vatra është ambjenti ku zhvillohet jeta. Aty burra, gra dhe fëmijë rrinë së bashku, prandaj ajo merr emrin ngandonjëherë edhe neje. Në të gjejmë një oxhak të rremë, sepse në të vërtetë është një niq i futur 40 cm. në mur, me forma të ndryshme, që nuk kryen funksionin e oxhakut. Zjarri ndizet në një vënd të ngritur deri 6 cm. nga toka me përmasa 110 x 100 cm., i bërë me baltë të ngjeshur mirë. Mbi të vendoset një orendi hekuri, që quhet demir-oxhak, e cila shërben për mbajtjen e druve të zjarrit. Pikërisht mbi këtë pjesë të ngritur në mesin e saj, lart nga trarët e çatisë varet një zinxhir ose vargue, siç e quajnë vëndasit, që shërben për të lidhur kusinë e gatimit. Tymi del direkt nga hatllat duke i nxirë trarët me blozë dhe duke i dhënë ambjentit (vatrës) një pamje të errët. Oxhaku i rremë ka anash dy kamare të vogla në një lartësi 60 cm. nga toka, që shërbejnë për vendosjen e kandilit ose të ndonjë sendi tjetër të nevojshëm. Vatra nuk është e shtruar me dysheme dërrase, por vetëm me dhe të ngjeshur mirë. Gjejmë në të elementë të tjerë funksionalë si rafte muri, sqoll, që është vëndi ku lahen duart dhe enët, dhe dritare të vogla me përmasa 26 x 40 cm. Furra e pjekjes së bukës gjëndej më përpara në vatër në një vënd çfarëdo. Kjo i përkiste kohës kur jeta zhvillohej brënda nga pasiguria. Sot shohim që nuk ka mbetur asnjë furrë brënda; ato ndërtohen jashtë, ngjitur shtëpisë. Ambjenti sanitar i ngjitet vatrës si shtesë. Banesa tjetër dykatëshe, siç është ajo e Preng Zef Vlashit dhe e Mrikë Palok Vlashit (Tab. I-b), ka po ato ambjente: burgun dhe vatrën. Në të dy këto banesa burgu është njëlloj si ai i jerevisë dhe vatra që gjëndet mbi të po ashtu, vetëm me një ndryshim emërtimi: vatrën nuk e quajnë më vatër por «çardak», sepse është e shtruar me dysheme dërrase. Rast tjetër tipik kemi dhe në jerevinë e Gjon Marka Gjokës (Tab. I-a) në fshatin Kallmet, ku një pjesë e burgut të jerevisë është shtruar me dërrasa të ngritur 40 cm. nga toka dhe është quajtur çardak. Kjo banesë nuk quhet më jerevi, megjithëse ka po ato ambjente, por kullë, pra merr emër të tillë vetëm sepse është dykatëshe. Siç duket vëndasit identifikojnë me kullën çdo banesë që ngrihet në lartësi. Në të vërtetë «kullat tipike në formë pirgu mungojnë p.sh. në Malsi të Madhe dhe në fushën e Zadrimës». [2])

Në të dy këto banesa, ngjitja për në katin e sipërm bëhet nga brënda me shkallë guri ose druri. Këto të fundit përbëhen nga dy shtylla lisi të lidhura ndërmjet tyre me dërrasat e shkeljes. Në dysheme lart, tamam ku mbaron ngjitja, vendoset një qepen për t'i mbuluar shkallët, në mënyrë që ambjenti i sipërm të izolohet nga burgu i kafshëve.

«Çardaku» ka po ato elementë që ka edhe vatra në jerevi: furrën e bukës, dritaret e vogla, sqollin, oxhakun e rremë, dollape muri, kamare dhe vëndin e zjarrit po prej balte, vetëm me një bazament nga poshtë me trarë dhe dërrasa që mbajnë baltën (Tab. I-b prerje a - a).

Pamë, pra, jerevinë banesë dy kthinëshe dhe kullën po dy kthinëshe, por të zhvilluar në lartësi. Të shohim tani variantin tjetër, ku njerit prej ambjenteve të jerevisë, dhe pikërisht burgut, i shtohet dhe një kat. Vatra mbetet po ashtu si më parë, vetëm se ajo merr emrin «Vatra e grave», d.m.th. vëndi ku rrinë e gatuajnë gratë. Kati i dytë i kësaj banese ose «çardaku», siç e quajnë vëndasit (Tab. II, Tab. III), shërben për të ndejtur burrat. Burrat dhe miqtë hynin në «çardak» nga jashtë me shkallë guri, ndërsa gratë shërbenin nga brënda nëpërmjet një shkalle prej druri. «Çardaku» ka pamje më të plotë, aty gjejmë oxhakun që kryen pikërisht një funksion të tillë. Jo vetëm që ekziston niqi me dy kamare anash (i quajtur nga vëndasit balku qorr), por sipër vendit të zjarrit ka edhe një xhumlek ose kosh dërrase në formë trungu piramide, i cili nuk e lë tymin të dalë nëpërmjet hatllave, por e mbledh dhe e nxjerr jashtë në çati.

Miku ka vend të caktuar pranë oxhakut. Përballë tij rri i zoti i shtëpisë, që ka një dollap të vogël pranë për mbajtjen e kafes. Po në atë faqe muri, edhe në ato anash, në një lartësi 170 cm., vendoseshin disa kunj druri ku miku varte armët.

Në «çardak», në shumicën e shtëpive të mëdha gjejmë frengji, element ky që i jep banesës karakter mbrojtës. Në banesën që pamë më lart (Tab. III), gjetëm 22 frengji. Bile këtu kishte frengji edhe në derën e oborrit, e cila ishte e lartë sa të hyjë qerrja me bar dhe miku me gjithë kalë. Banesa kullë-jerevi është ajo që predominon në këtë krahinë.

Varianti tjetër është katërkthinësh. Shofim këtu që përveç «çardakut» ngjitet lart edhe vatra e grave, ndërsa poshtë mbeten dy kthina që shërbejnë të dyja për burgje.

«Çardaku» dhe vatra e grave komunikojnë midis tyre me anë të një dere. Në të dy këto ambiente

1) Iniac Zamputi, **Të dhëna të reja mbi gjëndjen ekonomiko-shoqërore e politike të vëndit tonë në shek. XVII.** B.SH.SH., Nr. 2, 1956, f. 171, (fl. 158 e relacionit).
2) Dr. E. Nopcsa **Albanien — Bauten, Trachten, Geräte Nord Albaniens.** Berlin und Leipzig 1925, f. 52.

POR COPY

gjejmë po ato elemente që pamë në banesën kullë-jerevi, respektivisht në «çardakun» dhe vatrën e grave, vetëm me ndryshimin se këto janë ngjitur lart të dyja. Këtë variant më të zhvilluar banese ne e gjetëm në fshatin Troshan të veçuar (Tab. IV), larg banesave të tjera dhe pa oborr të rrethuar me mure. Dritaret këtu janë me dimensione më të mëdha dhe me kafaz hekuri, d.m.th. kemi të bëjmë me një variant të ndërtuar më vonë se të tjerat.

Po këtë banesë ne e gjetëm edhe në fshatin Kallmet (Tab. V), vetëm se këtu janë dy banesa të bashkangjitura në një kohë për dy vëllezër. Secila ka «çardak» më vete, ndërsa vatrën e grave e kanë të përbashkët. Poshtë janë gjithashtu tre kthina që shërbejnë për burgje. Në këtë banesë nuk gjejmë oxhaqe me xhumlek dhe tymi del nga hatllat. Dritaret janë me dimensione më të vogla se sa varianti që thamë më sipër, pra kemi të bëjmë me një banesë më të hershme.

Në të gjitha banesat që kemi parë, pothuajse kemi të bëjmë me po atë teknikë ndërtimi: muraturë guri e çrregullt me llaç gëlqere; vetëm në qoshet guri është i punuar mirë. Në muraturë, përveç qosheve, spikat punimi me mjeshtri i gurit të paturave të dyerve e dritareve dhe të mbulesave të tyre në formë gjysmë rrethi. Brezat nuk dallohen nga jashtë. Lënda e drurit prej lisi është e prerë në vënd. Në të gjitha banesat, çatitë janë të ndërtuara me të njejtën teknikë dhe mbulohen me tjegulla që janë prerë në vënd, ndërsa guri është sjellë gjithmonë nga mali. Dritaret mbyllen nga brënda me një kanatë druri njëfletëshe; po ashtu njëfletëshe janë dhe dyert. Këto të fundit sigurohen shpesh nga brënda me anë të një shuli prej druri, që futet në të dy anët e murit. Strehët e çatisë pothuajse nuk dalin fare jashtë. Tjegullat përfundojnë mbi një kornizë guri në fund të murit, e cila rrethon godinën në të gjitha anët.

Ustallarët që e kanë ndërtuar këtë shtëpi kanë qënë dibranë. Ata ishin grupe shetitës, që vinin nga fillimi i vjeshtës dhe merreshin me ndërtime deri në qershorin e vitit tjetër. Përbëheshin nga skuadra prej 5-6 vetësh, merrnin porosinë për ndërtimin e banesës «kaq pash të gjatë dhe kaq breza të lartë» dhe fillonin punën. Vëndasit bënin punën e pakualifikuar.

Ato pak banesa të vjetra që kanë mbetur pa u transformuar dhe pa u dëmtuar janë të gjysmës së dytë të shek. XIX. Tipike e kësaj krahine është banesa e mbyllur me tipare mbrojtëse. Dritaret e vogla, frengjitë, dyert e siguruara, bagëtia brënda, të gjitha këto plotësojnë këtë aspekt. Por vihet re një ndryshim rrënjësor nga kulla e Matit: banesa e Zadrimës nuk ka kompozimin e egër vertikal dhe pozicionin e saj strategjik, por një zhvillim më tepër hohizontal (në lartësi arrin maksimumi dy kat). Për këtë arësye ne nuk mund ta quajmë këtë banesë «kullë», megjithëse vëndasit e quajnë të tillë. Sigurisht që burime dhe studime të mëtejshme do të na çojnë në vlerësime më të sakta, që do të përcaktojnë më mirë vëndin që zë kjo në banesën shqiptare.

DO NOT COPY

TAB. I















DO NOT COPY



DO NOT COPY

TAB. III









DO NOT COPY









DO NOT COPY

TAB. V







DO NOT COPY

Faruk ZARSHATI

DONNEES SUR LA MAISON TYPE DE LA PLAINE DE ZADRIME

DO NOT COPY

RESUME

La région de Zadrime s'étend dans la plaine du même nom, une des plus fertiles de l'Albanie du Nord.

Cette communication a pour but de rendre compte des résultats de quelques missions menées dans cette région afin d'étudier l'ancienne habitation qui lui est propre.

Les villages de Zadrime sont groupés, les maisons rassemblées par groupes, et chacun de ces groupes est habité par des membres de la même gens. Les quartiers qui portent parfois le nom de la gens qui y vit sont situés sur des collines à l'abri des inondations, phénomène fréquent autrefois dans cette zone. Les paysans s'y sont généralement adonnés à l'agriculture et à l'élevage.

La condition économique et sociale de chaque famille paysanne se reflète généralement dans la maison qu'elle se construisait. La plus simple est celle de type yerevi *du turc yere — sol. et ev — maison, qui veut dire maison à simple rez-de-chaussée. On y trouve le foyer et le «burg» (la prison). Mais nous trouvons les mêmes pièces dans un autre type d'habitation, à un étage, où le «burg» est au rez-de-chaussée et le foyer au premier (Tab. II). Quand la condition de la famille paysanne était meilleure, elle construisait, attenante à la «yerevi», la «kulla». On a ainsi l'habitation du type «kulla-yerevi», Cette maison se composait de trois pièces et elle constituait le type le plus répandu dans la région (Tab. III, tab. IV). Une autre variante est celle où sur la «yerevi» est construit un autre étage, et l'on a ainsi une habitation à quatre pièces (Tab. V). La «yerevi», comme on l'a dit, comporte le foyer et le «burg». Dans ce local est enfermé le bétail, le bien le plus précieux pour le paysan, qui veut l'avoir près de lui, pouvoir le surveiller, le protéger contre tout imprévu et le maintenir au chaud, Aussi le «burg» est-il généralement construit presque sans fenêtres, ou, rarement, avec quelques rares petites fenêtres. La communication du «burg» avec le foyer se fait par une porte. Le foyer est la pièce où l'on vit. On y trouve des éléments fonctionnels tels que la cheminée, des placards, une espèce d'évier de type local, des fours à cuire, de petites fenêtres de dimensions 26 cm x 40 cm. Le sol du foyer est de simple terre battue. Le cabinet d'aisances est attenant au foyer. Quand la maison a un étage au-dessus du rez-de chaussée, les appellations de ces pièces changent; le foyer s'appelle «tchardak» cependant que la maison elle-même est dénommée «kulla». Les habitants de l'endroit dénomment «kulla» toute habitation relativement élevée. En vérité, les «kullas» proprement dites font défaut dans la Grande Malesia et dans la plaine de Zadrime.*

Quand un étage est construit au-dessus d'une des pièces de la «yerevi», le foyer prend alors le nom de «foyer des femmes» autrement dit la partie de la mai-

son où les femmes vivent et font la cuisine. Le premier étage de cette habitation ou «tchardak», comme on l'appelle dans la région, sert de pièce de séjour des hommes. Ceux-ci et les hôtes accèdent au «tchardak» de l'extérieur par un escalier de pierre, les femmes, elles, faisant le service, de l'intérieur, par un escalier en bois.

Dans la plupart des grandes maisons, le «tchardak» est percé de meurtrières, élément qui donne à l'habitation un caractère défensif. Dans une demeure, (Tab. IV) on a compté 22 meurtrières. On en trouve même au-dessus de la porte de la cour, devenue ici plus haute pour permettre l'entrés du char à boeufs chargé de foin et de l'hôte à cheval. La variante la plus achevée de ce type de maison est celle où même «le foyer des femmes» est porté au premier étage (Tab. V). Au rez-de-chaussée sont situés les deux locaux qui servent tous deux de «burg».

Toutes les maisons que nous avons vues présentent la même technique de construction: une maçonnerie de pierres de dimensions irrégulières liées à l'aide de mortier et c'est surtout aux angles que la pierre est bien travaillée. En outre, les pierres de pieds-droits des portes et des fenêtres et les arcs qui les surmontent sont travaillées avec maîtrise. Les tuiles ont été fabriquées sur place. Les avant-toits sont très légèrement en saillie. Les tuiles aboutissent à une corniche de pierres qui fait le tour de la maison.

L'habitation type de cette région est une maison fermée ayant pour trait important sa fonction de défense. Les petites fenêtres, les meurtrières, les portes bien assurées, les locaux permettant de mettre le bétail à l'abri, complètent cet aspect. Quoi qu'il en soit, ce type d'habitation ne peut être appelé «kulla», du fait qu'il n'a pas pour trait une composition rigoureusement verticale et qu'il ne se situe généralement pas sur une position stratégique.

DO NOT COPY

Apollon BAÇE — Gjerak KARAISKAJ

DO NOT COPY

VROJTIME ARKEOLOGJIKE NË RRETHIN E GRAMSHIT

Në Prill të vitit 1970 në rrethin e Gramshit, u organizua një ekspeditë informative, ku merrnin pjesë anëtarët e sektorit të Monumenteve të Arkitekturës. A. Baçe dhe GJ. Karaiskaj. Ekspedita i kreu vrojtimet e saja kryesisht në zonën qendrore të Sulovës, midis Devollit dhe Osumit, në afërsi të Gramshit.

Zona e mësipërme ka një karakter të theksuar kodrinor dhe përçahet prej burimesh e përrenjsh të shumtë. Kodrinat dhe luginat me shpate të buta dhe prania e ujrave të bollshëm e bëjnë vendin mjaft të përshtatshëm për blegtori dhe bujqësi me parcela të vogla. Luginëza e përroit të Senecës që penetron thellë në këtë zonë prej luginës së Osumit, për në drejtim të luginës së Devollit është një vijë kalimi e përshtatshme për bashkimin e rrugëve të dy luginave. Gjurmët e shumta të vëndbanimeve, si të lashta ashtu dhe ato të ditëve të sotme, tregojnë për një jetë intensive. Vëndbanimet gjënden në majë të kodrave në një lartësi absolute rreth 400 m., optimale për kushtet e zonës. Të tërheq vëmëndjen toponomia determinuese shqiptare, që ruhet si e tillë që prej fillimit të shek. IV.

Rezultatet e ekspeditës po i paraqesim sipas itinerarit të ndjekur në teren.

Fshati Darzezë, gjëndet në bregun e majtë të Devollit rreth 12 km. nga Gramshi. Në afërsi të zyrave të kooperativës gjatë hapjes së një kanali u zbuluan gjurmë muresh, që vazhdojnë për rreth 15 m, me tulla kuadratike 29,6 x 29,6 x 4 cm. të ndara diagonalisht në 4 pjesë dhe të lidhura me llaç. Pjesë kolonash prej tullash të rrumbullakta të shtyjnë të mendosh se kemi të bëjmë me një «villa rustica», supozim që e përforcon dhe afërsia me luginën në një teren të kalueshëm. Keramika e ndërtimit dhe e përdorimit të përditshëm e daton ndërtimin rreth shek. të II të erës sonë.

Në «fshatin Kodërqar» (rreth 5 km. në J të Darzezës) sipas informatave janë zbuluar varre të periudhës antike, inventari i të cilëve është zhdukur.

Në «Qafën e Maraçës» midis Kodërqarit dhe fshatit Sultë, po kështu dhe 400 m. më në V, gjënden fragmente të shumtë keramike ndërtimit që i përkasin shek. IV-VI.

Rreth 10 km. në J. të Darzezës gjëndet *fshati Sultë* ku gjatë punimeve bujqësore u zbuluan varre me rrasa guri pa inventar; fragmente keramike ndërtimit vërtetojnë përkatësinë mesjetare të tyre.

Në «Kodrën e Maraçit» rreth 500 m. në perëndim të Sultës në një taracë kodrinore me një hapësirë 100 x 150 m. gjënden fragmente të shumta keramike, fragmente pitosash, peshore konike, parete enësh të zbukuruara me vija të valëzuara, vegje me seksion eliptik ose prej dy shiritash të ngjitur si dhe një sasi e madhe keramike ndërtimi, kryesisht tjegulla solene. Faktura, tipet dhe motivet e zbukurimit të keramikës e datojnë vendbanimin në antikitetin e vonë.

Rreth 15 km. më tej, në një shpat të butë kodrinor të quajtur *«Lami i Koçit»* shihen po kështu fragmente enësh dhe, keramikë ndërtimi të kësaj periudhe.

Në afërsi të tyre tek *«Përroi i Rrënxës»* gjëndet një ujësjellës me tuba keramike me gjatësi 40 cm. dhe diametër 10 cm.

Gjurmë të një ujësjellësi që vazhdon për rreth 500 m. gjënden në *fshatin Grekanj*. Tubacionet e ujësjellsave në bazë të formave dhe brumit duhet



Fig. 1



Fig. 2

DO NOT COPY

ti përkasin periudhës së vonë mesjetare. Po këtu u zbuluan një pitos i madh me volum rreth 0.25 m^3 dhe amfora të ndryshme që tregojnë për jetën në shekujt e parë të erës sonë.

Gjurmë vëndbanimesh antike gjithashtu gjënden në *Marës, Sarasel* dhe *Qafë Tudë.*

«*Kalaja e Prenjasit*» gjëndet rreth 4 km. në L. të fshatit Prenjas. Është e ndërtuar mbi një kodër shkëmbore e cila bie me pjerrësi të madhe në drejtim të J. dhe P. dhe pothuajse thikë në V. mbi përroin e Senecës ose Saraselit. Në drejtimin e L. kodra lidhet butazi me anë të një qafe me një kodër tjetër pak më të lartë.

Prej majës së kodrës që ka formën e një pllajëze kontrollohet lugina e përroit të Saraselit e cila penetron prej luginës thellë të Osumit në drejtim të Devollit. Në JP shikimi ndalet tek Shpiragu dhe Osumi, ndërsa në VL tek masivi kodrinor ku ngrihet kalaja e Irmajt. Me sa duket funksioni i saj ka qënë kontrolli i rrugës që lidhte luginën e Devollit me atë të Osumit. Për këtë qëllim, vendi më i përshtatshëm është ai ku gjëndet kalaja. Lugina këtu ngushtohet së tepërmi duke krijuar një kanion të thellë midis kodrës së kalasë dhe kodrës përballë saj. I vetmi vënd për kalim është një trap i ngushtë shkëmbor buzë përroit. Për ta kontrolluar atë akoma më mirë, në kodrën e fundit është fortifikuar një shpellë natyrale e arritshme me shumë vështirësi, të cilën nuk mundën ta vizitojmë nga afër.

Në kala të shpie prej rrëzës së kodrës një rrugë e ngushtë e shtruar me kalldrëm dhe plloça, që i ngjitet me gjarpërime shpatit VL. Kalaja që ka formë katërkëndëshi 180 x 50 m., me qoshe të rrumbullakuara orientohet me anët e ngushta nga përroi dhe qafa. Muret ruhen relativisht më mirë në anën J dhe P ku gjënden 2 trakte rreth 20 m. të gjatë dhe 3 m. të lartë.

Muret janë ndërtuar me gurë mesatarë, të nxjerrë në vënd, të vendosur në rrjeshta horizontalë të lidhur me llaç të bardhë gëlqereje të një kualiteti të dobët me fuga rreth 1,5 cm. të trasha. Mbrendia e murit përbëhet nga gurë të vendosur në mënyrë



Fig. 3

të çrregullt, por nuk kemi të bëjmë me muraturë të derainur, ndersa gjurmë brezash druri nuk konstatohen. Trashësia e tyre është 1,70 — 1,80 m. në anën nga qafa, ndërsa në anë më të mbrojtura 1,20 m. Gjate mureve dallohen disa kunale të pjerrët me seksion katërkëndësh 15 x 15 cm., të cilat përshkojnë gjithë trashësinë e murit dhe që duket se sherbenin për shkarkimin e ujrave nga niveli më i lartë i terenit brënda kalasë.

Kalaja nuk ka kulla nëpër qoshet, si edhe gjatë mureve. Vetëm në murin J-P gjëndet një grumbull gurësh që të lë të kuptosh per egzistencën e një kulle, në të djathtë të tij ka pasur një portë që kuptohet nga fragmenti i shpatullës së saj veriore. Mbeturinat e pakta të keramikës në teritorin e kalasë i përkasin kohës së vonë antike. Forma e planimetrisë, teknika e ndërtimit dhe keramika e datojnë si një fortesë garnizoni të periudhës së vonë antike, megjithëse gojëdhana e lidh me periudhën e Skënderbeut. Kalaja nuk vazhdon të jetojë pas shek. VI.

Në *muzeun e qytetit të Gramshit* janë grumbulluar një sërë objektesh arkeologjike ndër të cilët me rëndësi janë:

1. Një stelë varri prej guri gëlqeror me përmasat të ruajtura (pothuajse të plota) 56 x 34 x 10,5 cm. (fig. 1) është gjetur në kishën e fshatit Grabovë e sipërme, e ripërdorur në muret e saja. Stela ka formë edikule me fronton me dy akrotere anësore. Në fronton janë gdhëndur rrathë koncentrike prej të cilëve i plotë është qëndrori me diametër 9 cm. ndërsa të tjerët intersektohen me kornizën trekëndëshe. Ndoshta këtu kemi të bëjmë me motivin e diellit. Poshtë saj në Tabula ansata është skalitur një mbishkrim pesë reshtash, i transkriptuar nga Hasan Ceka si më poshtë:

Κλεονικον ε-
τον Δριακον-
τα πεντέ η συν-
βιος μνημης χα-
ριν χαιρε. 1)

Poshtë mbishkrimit është punuar me një thellësi 4,5 cm. në një basoreliev me sa duket portreti i të vdekurit. Punimi është i trashë, i stilit provincial. Figura që paraqitet përballë, tregon një burrë të ri. Në anën e pasme është gdhëndur në basoreliev një kryq me dimensione 48 x 22 cm. me trashësi krahësh 7 cm. (fig. 2). Në kryqin është brëndashkruar një kryq i dytë me dimensione më të vogla. Stela të tilla të gjetura nga Prashniker e Shober datohen në shek. I-II të erës sonë.[2]) datë që e jep dhe formulimi i mbishkrimit. Përsa i përket kryqit të gdhëndur në anën e pasme duket se ai i përket një periudhe të mëvonshme.

Prej Shëmbërdhenjës e kanë origjinën 2 pitose njeri me lartësi 80 cm. dhe diametër 65 cm. ndërsa tjetri 70 x 58. Pitoset kanë formë vezake dhe përfundojnë me fund të sheshtë. Pitosi i parë në vëndin e diametrit maksimal ka 3 vula anepigrafike në formë tufe rrezesh [3]), ndërsa në buzën e sipërme midis dy vulave lexohet emri i pronarit të enës ΓΛΑΥΚΙΟΥ Duket se pitosat e kanë origjinën në punishtet e Irmajt.

Në vëndbanimin e *Bresnikut* është gjetur një sëpatë guri (fig. 2). Sëpata është punuar prej guri të fortë në ngjyrë të zezë në të gjelbër që gjënden me shumicë në këtë zonë. Forma e saj identike me ato të sëpatave të fundit të periudhës së bronxit

1) Në rrethin e II, gërma e katërt është gabim orthografik, duhet të jetë T dhe jo Δ.
2) C. Praschniker, A. Schober — **Archeologische Forschungen in Albanien und Montenegro,** Wien 1919.
3) Vula të tilla gjënden dhe në keramikën e zbuluar në Irmaj: F. Prendi, Dh. Budin. Buletini i shkencave shoqërore, Tiranë 1963 nr. 4; Kalaja e Irmajt.

DO NOT COPY

e datón në këtë periudhë dhe tregon vazhdimësinë e përdorimit të veglave prej guri. Sëpata ka gjatësi 95 m/m ndërsa tehu është 38 m/m, konsumimi i tij tregon përdorimin për një kohë të gjatë. Në pjesën e pasme sëpata përfundon në formë të rrumbullaktë, paksa të gufuar;. duket se funksioni i saj ka qënë i dyfishtë, si sëpatë dhe çekan. Ajo vendosej në një dorezë druri që kalonte në një vrimë me diametrin 20 m/m; për të evituar dobësimin në këtë vënd kemi një trashje të seksionit. Në sipërfaqen mjaft të lëmuar të sëpatës rreth çdo 5 m/m janë skalisur vija të holla, me sa duket për imitimin e plotë të sëpatave prej bronxi. Gjetja e saj në Gradishtën e Bresnikut dëshmon një vazhdimësi të këtij vëndbanimi prej periudhës së bronxit deri në periudhën e parë të hekurit dhe atë të vonë antike. Këto të fundit vërtetohen prej gjurmëve të fortifikimit në majë të kodrës së Gradishtës.

DO NOT COPY

Apollon BAÇE — Gjerak KARAISKAJ

OBSERVATION ARCHEOLOGIQUE SUR LA REGION DE GRAMSH

RESUME

Au cours d'une mission d'études effectuée en avril 1970 dans la zone comprise entre le Devoll et l'Osum, à proximité de Gramsh, ont été repérés un certain nombre d'agglomérations ainsi que d'autres vestiges de culture matérielle jusque-là inconnus.

Au village de Darzezë, *situé sur la rive gauche de Devoll, à quelque 12 km de Gramsh, on a découvert les vestiges d'un pan de mur de près de 15 m de long, fait de briques ayant la forme d'un parallélépipède droit de 29,6 x 29,6 x 4 cm, divisées diagonalement en 4 parties et liées au mortier. Des ruines de colonnes cylindriques de briques et des fragments de céramique également mis au jour, peuvent être datés au IIe siècle de notre ère. Les vestiges de cette construction paraissent être ceux d'une «villa rustica».*

Au village de Kodërqarr, *(à quelque 5 km de Darzezë), on a dégagé des tombes datant de la période antique et garnies de mobilier funéraire.*

A «Qafa e Maraçes», *entre Korderqar et le village de Sulte, ont été faites les mêmes trouvailles et, à 400 m au nord, on a retrouvé de nombreux fragments de céramique de construction, qui semblent appartenir à la période allant du IVe au VIe siècle.*

A quelque 10 km au sud de Darzeze, se trouve le village de Sulte *où ont été découverts, au cours de travaux agricoles, des tombes à dalles de pierre dépourvues de mobilier funéraire et qui appartiennent au moyen âge.*

A «Kodra e Muraçit», *à quelque 500 m à l'ouest de Sulte, sur une terrasse collineuse d'à peu près 100 m sur 150, ont été retrouvés de nombreux vestiges de céramique: fragments de pythos, poids côniques, etc., qui datent de la basse antiquité. A environ 15 km de là, sur le versant d'une molle colline, appelée «Lami i Koçit», on relève encore des fragments de vases et de céramique de construction, datant de la même période.*

A proximité de ces deux lieux, à «Përroi i Rrënxes», se trouvent les vestiges d'un aqueduc fait de tubes de céramique de 40 cm de long et de 10 cm de diamètre, et l'on rencontre aussi des vestiges d'un aqueduc au village de Grekanj, ces deux ouvrages appartenant tous deux à la période du bas moyen âge.

On relève également des vestiges d'agglomération antiques à Marëz, Sarasel et Qafë Tud.

La citadelle de Prenjas *se dresse à environ 4 km à l'est du village du même nom. Elle est construite sur une colline rocheuse, très abrupte au sud et à l'est et qui tombe, à l'ouest, presque à pic sur le torrent de Senecës ou de Sarecel.*

Du pied de la colline, par le versant nord-est, une route étroite et sinueuse revêtue de pierres et de dalles, conduit à la citadelle. Celle-ci est de base rectangulaire

DO NOT COPY

et mesure 100 m sur 50 m. Les murs sont relativement mieux conservés sur les côtés sud et ouest, où subsistent deux tronçons de 20 m de long sur 3 m de haut. Ils sont construits en pierres de grosseur moyenne de provenance locale, disposées en rangées horizontales et liées au mortier de chaux blanc. On n'observe pas de chaînes horizontales en bois. Leur épaisseur est généralement de 1,70 à 1,80 m et, sur les côtés défendus, de 1,20 m. La citadelle n'est pas flanquée de tours aux coins des remparts. Le long du mur sud-ouest seulement on remarque un amas de pierres qui semblent être les vestiges d'une tour. A la droite de cet amas devait se trouver une porte dont on devine l'existence au tronçon de son jambage nord qui en subsiste. Les rares débris de céramique sur le territoire de la citadelle appartiennent à l'époque de la basse antiquité. Par la forme de sa base, par la technique de la construction comme par le type de la céramique, il est permis de fixer à la même époque la date de son érection.

Au musée de la ville de Gramsh ont été rassemblés un bon nombre d'objets archéologiques dont les plus importants sont:

1. Une stèle funéraire en pierre calcaire, de dimensions 56 x 10 x 10,5 cm (fig. 1), conservée presque intacte, et recueillie sur les vestiges de l'église du village de Grabove où elle a été réutilisée pour les murs de cet édifice. La stèle a la forme d'un édicule à fronton avec deux acrotères latéraux. Elle porte une inscription en grec de 5 lignes qui date de la période allant du Ier au IIe siècle de notre ère.

A Shërmbërdhenjës ont été recueillis deux pythos dont le premier porte à sa partie la plus large trois timbres anépigraphiques en forme de faisceau de rayons, alors que sur la partie supérieure de cette inscription, entre les deux timbres, on peut lire le nom du propriétaire du vase, «ΓΛΑΥΚΙΟΥ», nom que l'on rencontre souvent chez les Illyriens. Il semble que ces pythos proviennent des ateliers d'Irmaj.

Sur le territoire de l'agglomération de Bresnik a été retrouvée une hache, (fig. 2), travaillée dans une pierre dure de couleur noire tirant sur le vert, que l'on trouve en abondance dans cette zone, et elle date de la dernière période du bronze. La découverte de cet objet à Gradishte de Bresnik témoigne de la continuité de la vie sociale dans cette agglomération depuis la période du bronze jusqu'à la basse antiquité.

DO NOT COPY

Neritan CEKA — Apollon BAÇE

DO NOT COPY

VROJTIME ARKEOLOGJIKE NË RRETHIN E POGRADECIT LUGINËN E DEVOLLIT DHE SHKUMBINIT

Ekspedita që kishte për qëllim vrojtimin e vendbanimeve të lashta dhe rrugëve antike, në luginat e Shkumbinit dhe Devollit, përbëhej nga autorët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm nga Pogradeci: Nuçi Tira, Vangjush Manastirli, Jorgji Shkurta dhe Sali Pançi. [1])

Kulla e Blacës (Tab. I). Qendra e parë që vizituam ishte kulla e Blacës, pranë fshatit Blacë në juglindje të Pogradecit. Sipas njoftimeve të shokëve të Pogradecit, mbi dy kodrat që ngrihen mbi një bazë të përbashkët, në perëndim të fshatit Blacë, gjendeshin mbeturinat e një vendbanimi të lashtë. Të dy kodrat dominojnë mbi rrugën natyrale që lidh liqenin e Ohrit me fushën e Korçës, nëpërmjet Qafës së Ploçës. Kodrat përbëhen nga formacione gëlqerore prej nga është nxjerrë edhe materiali për fortifikimin e tyre, dhe kanë faqe të pjerrta që pengonin sulmin e armikut (fig. 1).

Kodra veriore e quajtur «Kulla e Blacës» ka një lartësi 1016 m. mbi nivelin e detit. Në krahasim me kodrën tjetër, faqet e saj janë më pak të pjerrta me vetëm një pjesë të thikët nga ana juglindore. Pikërisht këtu kapen gjurmët e një muri gurësh të papunuar me gjerësi rreth 2 m. që ngjitet për nga maja e kodrës. Afër majës ai bashkohet me një rreth muresh të të njëjtit tip, të cilat dikur e qarkonin pllajën e kodrës, që ka një zbritje të butë nga veriu, me sheshe mjaft të përshtatëshme për banim. Muret janë të tipit të hershëm ilir, me gjerësi rreth 3 m. dhe janë formuar nga dy këmisha gurësh të mëdhenj, të papunuar e të palidhur me llaç dhe, me një mbushje gurësh të vegjël e mesatarë. Gjurmë të qarta të tij dallohen në anën jugperëndimore dhe, në një vijë më të gjatë, në anën veriore të kodrës. Gjetjet e keramikës së kësaj periudhe janë shumë të pakta dhe nuk japin ndonjë formë të datueshme.

Rrethimi elipsoidal i kullës së Blacës lidhet nëpërmjet dy muresh paralele me një fortifikim të ndërtuar në kodrën përbri, të quajtur Maja e Shpatit (1004 m.). Fortifikimi i kësaj të fundit është krijuar nëpërmjet një muri të së njëjtës teknikë me gjatësi rreth 400 m., i cili mbyllte hyrjen për në faqet perëndimore dhe jugore të kodrës që ishin më të lehta për t'u ngjitur dhe i ekspozoheshin më shumë sulmit të armikut. Nga ana jugperëndimore, ku ka një kurriz që e lidh me kodrat fqinjë, kthesa e murit është përforcuar me një kullë katërkëndëshe mjaft të rrënuar.

Muret paralele që lidhin fortifikimet e të dy majave kanë një gjërësi 3 m. dhe janë ndërtuar me të njëjtën teknikë. Muri perëndimor është më i gjatë dhe duket se ka qënë përforcuar me dy kulla, tek hyrja, në pjesën më të ulët të qafës. Muri i anës

1) Grupi i bashkëpunëtorëve të jashtëm mori pjesë vetëm në vrojtimin e qendrave të rrethit të Pogradecit.



Fig. 1

lindore është më i shkurtër dhe shfrytëzon rrëzimet natyrale të kodrave në këtë anë.

Maja jugore ka qënë banuar më dëndur gjatë tërë periudhës së parë të hekurit, deri në periudhën qytetare ilire. Keramika e këtyre periudhave gjëndet me shumicë veçanërisht në faqen jugore të saj (Tab. II, 1-5, 7, 8).

Një periudhe të dytë ndërtimi i përket një akropol i vogël në majën e kodrës jugore, i ndërtuar me gurë të vegjël të lidhur me llaç. Keramika, që i korespondon këtij ndërtimi, është e kohës së vonë romake.

Një periudhe të tretë ndërtimi i përkasin muret e vona të rrethimit të kodrës veriore. Ato janë ndërtuar me gurë mesatarë e të vegjël, të lidhur me llaç me rërë të trashë. Në anën jugore dhe në një pjesë të anës perëndimore ky mur i vonë ka shkelur mbi murin e periudhës së parë të hekurit dhe ka ripërdorur materialin e tij, por duke patur një trashësi të pandryshuar prej 1.5 m. gjatë gjithë gjatësisë së vet. Në pjesën tjetër muri është tërhequr më brënda, duke lënë jashtë një pjesë të sipërfaqes që rrethohej dikur nga muri ilir.

Planimetria e këtij muri ka formë elipsi dhe në tërë gjatësinë prej 580 m. nuk ka asnjë kullë. Vumë re vetëm një hyrje në anën perëndimore me një koridor të krijuar prej dy muresh me gjatësi 4.60 m. dhe trashësi 1.10 m., që futen nga porta në brendësi të teritorit të rrethuar, duke krijuar një rrugicë 3.50 m. të gjerë. Në teritorin brënda kështjellës takohen shumë themele banesash, që kanë qënë mbështetur tek muri rrethues. Keramika, që lidhet me këtë ndërtim, është mjaft e varfër, me një baltë të përzier me kuarc dhe me fakturë të ashpër, karakteristike për shek. XI-XIV. (Tab. II, 6).

Gradishta e Slabinjës. Në luginën e sipërme të Shkumbinit vrojtuam Gradishtën e Slabinjës. Kodra me këtë emër, ose siç quhet ndryshe «Bregu i Sopotit» (827 m.) ndodhet në jugë të fshatit Slabinjë, mbi vendin ku takohet Shkumbini me lumin e Trebinjës. Kodra ka formë piramidale me bazë trekëndshe dhe në anën jug perëndimore lidhet nëpërmjet një qafe të ulët me vargun e kodrave të tjera të Bregut të Sopotit. Pikërisht në këtë qafë kalonte rruga nëpër luginën e Shkumbinit, në Hondisht, nëpër qafën e Panjes për në luginën e Devollit. Teritori përqark përbëhet prej kodrash të larta, por të përshtatshme për bujqësi.

Një mur prej gurësh shtufi të lidhur me llaç gëlqereje qarkon faqen veri lindore të kodrës, duke krijuar një planimetri trekëndshe me kulm në majën e kodrës dhe me bazë një nga vijat rushkulluese të saj.

Muri është zhdukur në pjesën më të madhe (në anën veri lindore dhe jug lindore). Vetëm në anën veri perëndimore mund të takohen pjesë të ruajtura, në një ose dy rreshta, me gjerësi rreth 2.5 m., prej dy faqesh me gurë mesatarë dhe me mbushje me gurë të vegjël. Gjatë gjithë gjatësisë nuk dalluam asnjë kullë dhe nuk përcaktuam ndonjë hyrje. Planimetria trekëndshe me kulm në majën e kodrës, dëshmon për një tip të vonë romak ose bizantin të hershëm. Kjo mbështetet edhe nga keramika, kryesisht tulla me përmasa 0.28 x 0,28 x 0.04 m.

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 3

me diagonale të hequra me tri gishta dhe pak fragmente enësh me inçizime vijash të thelluara sipas rrotullimeve të çarkut.

Shkëmbi i Qytetit. Ndodhet në veri të fshatit Shpellë të Mokrës, mbi vendin e takimit të lumit Shkumbin me përroin e Bishnicës. Është kreshta më e lartë e një vargu shkëmbor, që shkëputet nga faqja e malit, duke u ndarë prej tij me një qafë të ulët (fig. 2). Nëpër këtë qafë kalonte rruga tradicionale, që lidhte Mokrën e poshtëme me Korçën, nëpërmjet Gurit të Kamjes dhe me Devollin, nëpërmjet Qafës së Panjës. Ruhet nga kjo rrugë një trase mjaft e mirë, e shtruar me kalldrëm 3 m. të gjerë, prej gurësh të vegjël midis dy bordurash prej gurësh të mëdhenj. Lartësia shkëmbore, ku shtrihet vendbanimi i lashtë, përbëhet prej dy majash që lidhen nga një qafë e cekët. Vendbanimi ka qënë mbrojtur nga ana veri perëndimore, ku lidhet me kreshtën, nga një mur prej gurësh të mëdhenj të papunuar, të lidhur në të thatë, gjurmët e të cilit kapen vetëm tek shkëmbi i anës jugore të qytezës (fig. 3). Muri vazhdonte pastaj me drejtim veri lindor, duke u kthyer në kënd të drejtë, atje ku terreni fillonte e thyhej, pasi kalonte kurrizin e kodrës. Në faqen veri lindore të kodrës, e cila zbret pjerrtas drejt përroit të Bishnicës, ruhen vetëm gjurmë të zbehta të murit.

Me këtë mur lidhen gjetje të keramikës lokale të periudhës së parë të hekurit si dhe disa fragmente të periudhës qytetare ilire.

Mbi këtë mur ka kaluar një mur më i vonë, i bërë me gurë mesatarë e të vegjël të lidhur me llaç të dobët, i cili, në fillim të tij, pranë faqes së thikët jugore të shkëmbit, ka një kullë katërkëndëshe me ballë 4.50 m. Me këtë mur lidhet edhe një akropol i vogël, në majën më të lartë të kodrës. Keramika që i përket këtij muri është e tipeve të kohës së vonë romake.

Nga Pogradeci u nisëm për në rrugën Maliq — Lozhan — Moglicë — Gramsh.

Pranë lokalitetit Moglicë gjetëm këmbët e tri urave mesjetare.

Dy të parat ndodhen nën fshatin Gopesh, në një vend ku lumi ngushtohet dhe disa gurë gjigandë kanë rënë në shtratin e tij (fig. 4). Në bregun e majtë ruhet njëra këmbë e urës, ndërsa tjetra është ngritur mbi njërin nga gurët në mes të lumit. Urat kanë qënë pa hark, me vendosje dërrasash mbi këmbët vertikale. Pak metra më lart, në rjedhjen e lumit, shikohen këmbët e një ure të dytë, e të njëjtit tip. Të dy urat i përkasin një rruge që zbret nga Gopeshi për të shkuar nëpër grykën e Dusharit për në Voskopojë. Të dyja janë prishur nga rrëshqitjet e brigjeve të Devollit dhe nga lëvizjet e shkëmbinjve në shtratin e lumit, mbi të cilët kanë qënë ngritur këmbët e të dy urave.

Pranë lokalitetit të Moglicës, në bregun e djathtë të Devollit, gjetëm këmbët e një ure të tretë. Ruhet këmba anësore me gjurmët e një qemeri dhe

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5

një këmbë tjetër me shënjat e dy qemereve, në zallin e lumit.

Këmba e parë ka në fillim formën e një trapezi me brinjë që ngushtohen për të kaluar në një pjesë katërkëndshe 8.50 x 3.60 m. me lartësi rreth 6 m. Është ndërtuar me gurë lumi mesatarë, të lidhur me llaç me rërë të trashë. Ndërmjet gurëve janë futur copa tullash. Ruhet mirë imposti dhe vetëm pak rjeshta nga qemeri i harkut i cili është ndërtuar me tulla (fig. 5). Harku i tullave, që ka një gjerësi prej 1.90 m., kufizohet nga një kornizë prej tek tulle e dalë 0.08 m. nga sipërfaqja e punuar me gurë. Përmasat e tullave janë 0.56 x 0.34 x 0.05 m., ndërsa fugaturat e llaçit midis tyre 0.04-0.05 m.

Tek faqja e prishur e qemerit dalin vrimat e tre trarëve katërkëndësh me seksion 0.27 x 0.27 m., të cilët përshkonin paralelisht muraturën e këmbës së urës. Dy trarë të tjerë kalonin tangent me harkun e qemerit, duke siguruar lidhjen e brëndëshme të brezit të drurëve. Edhe këmba tjetër ka të njëjtat veçori punimi, vetëm se dallohet mirë derdhja e gurëve dhe e llaçit midis dy faqeve të fasadës të punuara me kujdes me gurë në rjeshta pothuaj horizontale. Dallohen vrimat e trarëve të brezit të drunjtë, që përshkonin së gjeri muraturën e këmbës (trarët në ndryshim me këmbët e bazës janë me seksion të rrumbullakët) (fig. 6). Ndërsa qemeri verior ka qënë bërë prej tullash të të njëjtit tip si i këmbës së bazës, qemeri i krahut tjetër, ka qënë pregatitur prej gurësh lumi, të vendosur në fasadë në një hark të plotë me gjërësi 0.90 m., por të hedhur pa rregull mbi armaturë në pjesën e poshtëme. (fig. 7).

Ura lidhet me rrugën mesjetare Maliq – Strelcë,



Fig. 6

2) P. Lera – **Gjurmë të reja të lashtësisë në rrethin e Korçës,** «Monumentet» 1, 1971, f. 180.

DO NOT COPY



Fig. 7

Moglicë – Zerec – Guri i Prerë – Berat dhe është ndërtim i shek. XI-XII.

Gradishta e Zerecit. Rruga që përmëndëm më lart ka qënë rrahur që në kohën e vonë antike dhe kontrollohej nga kalaja e Gopeshtit (e përshkruar nga Petrika Lera [2]) dhe nga Gradishta e Zerecit. Kjo e fundit ngrihet në një lartësi 1139 m. në bregun e majtë të Devollit, në juglindje të fshatit Zerec.

Përbëhet nga dy maja që lidhen me një kreshtë të pakalueshme. Vendbanimi shtrihej në majën lindore në një pllajë të pjerrët. Nga të gjitha anët tërreni është i thyer dhe vetëm një shteg, në anën lindore, lejon ngjitjen në këtë vend. Prej këtu kontrollohet e gjithë lugina e lumit dhe rruga që kalonte nëpër urën e Devollit, për në Gurin e Prerë.

Keramika tregon për një diapazon të gjerë jete në këtë vendbanim me karakter strategjik. Gjetëm fragmente të periudhës së parë të hekurit, njëri prej të cilëve me pikturimin karakteristik ngjyrë gështenje (Tab. II, 9, 11). Mblodhëm edhe disa fragmente helenistike (Tab. II, 10), romake të vona (Tab. II, 12) e deri në mesjetare.

Karakteristikë për këtë vendbanim të fortifikuar nga natyra është mungesa e mureve të rrethimit.

Më në fund vrojtuam dy vendbanime të lashta, pranë fshatit Bixëllenjë të Elbasanit.

Qyteti. Quhet nga vëndasit një shkamb që ngrihet në perëndim të fshatit Bixëllenjë. Shkambi ka formën e një prizmi me anët lindore e veriore krejt të thikëta (fig. 8) dhe me hyrje të mbrojtur nga jugu e perëndimi. Sipërfaqja e shkambit është pothuaj e rrafshët, por me pak vend të përshtatshëm për banim, nga që është mbushur me maja shkëmbinjsh. Nga ana perëndimore, ku thyerja e shkambit nuk është shumë e thellë, kalonte një mur i dobët prej gurësh të papunuar, që tani pothuaj është zhdukur krejt. Keramika përbëhet nga fragmente të periudhës së parë të hekurit dhe të kohës qytetare ilire.

Në sipërfaqen e qytetit është zbuluar, gjatë punimeve të një ekspedite gjeologjike, gërmadha e një kishe të mesjetës së hershme e tipit bazilikal. Kisha trinefëshe është orientuar me absidë nga lindja. Muret janë ndërtuar me gurë të lidhur me llaç të dobët. Dyshemeja ka qënë shtruar me tulla



Fig. 8

DO NOT COPY



Fig. 9

0.31 x 0.28 x 0.04 me anë të rrumbullakuara dhe me stampën e një delfini (fig. 9) (dallohen katër stampa që ndryshojnë nga madhësia dhe linjat). Ka edhe përdorim të dy llojeve të tjera tullash me trashësi



Fig. 10



Fig. 11

më të vogël, njëra prej të cilave është stampuar me kryq. Tullat me delfin janë ndeshur në meremetimet e shek. VI në kalanë e Elbasanit [3]), dhe kjo na jep mundësi ta datojmë kishën në këtë shekull.

Maja e Shën-Mërisë. Ngrihet mbi të njëjtin masiv shkëmbor në jugperëndim të «Qytetit», jo më larg se 200 m. prej tij. Së bashku me të dominon mbi luginën e Shkumbinit dhe mbi rrugën që vjen nga lugina e Erzenit nëpër përroin e Kushës dhe Qafën e Krrabës. Lartësia ka formë piramidale me bazë trekëndëshe. Ana juglindore është e thikët dhe e pangjitshme (fig. 10), ndërsa dy faqet e tjera zbresin butë drejt një pllaje shkëmbore. Pikërisht këto dy anë janë rrethuar me një mur prej gurësh të papunuar me gjatësi 220 m. Muri ndiqet më mirë në anën veriore dhe perëndimore ku dallohen trakte me gjërësi 2 m. të ndërtuara prej dy faqesh prej gurësh të mëdhenj me mbushje gurësh të vegjël në mes (fig. 11).

Ndeshet keramikë e tipeve të periudhës së parë të hekurit, por dominon ajo e periudhës qytetare ilire. Ka edhe fragmente të periudhave më të vona.

3) Gj. Karaiskaj. **Kalaja e Elbasanit** «Monumentet» I, 1971, f. 65.

DO NOT COPY


BLACE
1016 △
KULLA E
BLACES
△ 1004
MAJA E
SHPATIT
0 50 100 150 200 250 m

DO NOT COPY



DO NOT COPY

Neritan CEKA — Apollon BAÇE

OBSERVATIONS ARCHEOLOGIQUES FAITES DANS LA REGION DE POGRADEC ET DANS LES VALLEES DU DEVOLL ET DU SHKUMBINI

RESUME

Au cours d'une mission d'étude effectuée dans la vallée du Shkumbini et dans celle du Devoll, les auteurs de cet article ont étudié les agglomérations fortifiées ci-après:

La tour de Balça. *A l'ouest du village du même nom, sur deux collines calcaires aux versants relativement raides, qui dominent la voie naturelle reliant le lac d'Ochrid a la plaine de Korçë, se trouvent les traces d'une agglomération fortifiée. Les sommets de ces deux collines sont entourés d'un mur de 3 m d'épaisseur, qui se compose de deux chemises faites de grosses pierres non taillées assemblées sans ciment et d'une partie intermédiaire faite de pierres de moyennes ou petites dimensions. Deux murs parallèles, construits selon la même technique, relient en passant sur un col, les sommets des deux collines. La céramique correspondant à ces constructions appartient à une époque qui s'étend de la première période du fer à la période illyrienne urbaine. A une deuxième période de construction appartient une petite acropole qui se dresse sur la colline sud, aux murs faits de petites pierres liées au mortier. La céramique qui y correspond date de la période de la basse antiquité.*

Le mur d'enceinte de la colline du nord, construit en pierres de moyennes et petites dimensions liées au mortier relève d'une troisième période de construction. A l'intérieur de ce territoire on rencontre de nombreuses fondations de maisons adossées sur le mur d'enceinte. La céramique correspondante date de la période allant du XIe au XIVe siècle.

Gradishta e Slabinjës *est située sur une colline qui domine le confluent du Shkumbini et de la rivière de Trebinje, et à laquelle se joint, sur un côté, un col par où passait la route menant du Shkumbini au Devoll. Cette colline était entourée d'un mur fait de pierres de dimensions moyennes liées au mortier, dont la projection plane formait un triangle. La forme de la citadelle et la céramique découverte sur ces lieux témoignent d'une construction de la basse antiquité.*

Le Rocher de la Cité *se trouve au confluent du Shkumbini et du torrent de Bishnice. Au pied de ce rocher passait l'ancienne route qui reliait la Mokër de jadis à Korçë. Il en subsiste une partie du tracé, qui est large de 3 mètres, revêtu de petites pierres et bordé des deux côtés de gros blocs. Le rocher est entouré d'un mur fait de grosses pierres non taillées, assemblées sans ciment auquel correspond une céramique dont la continuité semble établie depuis la première période du fer jusqu'à la période illyrienne urbaine. Un autre mur d'enceinte et une acropole construits en pierres de moyenne ou de petite grosseur reliées au mortier appartiennent a une deuxième phase. La céramique qui y correspond date de la période de la basse antiquité.*

DO NOT COPY

Gradishta e Zerecit. C'est une agglomération naturellement fortifiée qui se dresse au sommet d'une terrasse rocheuse aux parois escarpées au sud-est du village du même nom. La céramique qui y correspond s'étend. quant à sa datation, sur une période relativement vaste, qui englobe la première période du fer, les périodes hellénistique, romaine et la période médiévale.

La Cité s'étendait sur une masse rocheuse située à l'ouest du village de Bixellenje et enceinte d'un mur peu solide fait de pierres non taillées. La céramique qui y a été retrouvée consiste en des fragments de la 1ère période du fer et de la période illyrienne urbaine.

Sur la superficie comprise à l'intérieur des murs se trouvent aussi les ruines d'une église du VIe siècle du type basilical au sol revêtu de briques empreintes de motifs représentant un dauphin et une croix.

La cime de Sainte Marie se dresse sur le même massif que la «Cité», et toutes deux commandent la voie qui relie la vallée de l'Erzen à Elbasan. Elle est entourée d'un mur de 2 mètres d'épaisseur, fait de grosses pierres non taillées. On y retrouve une céramique qui appartient à la 1ère période du fer, mais la céramique de la période illyrienne urbaine y prédomine cependant.

Outre ces agglomérations fortifiées, cette mission a étudié les vestiges de certains ponts sur le fleuve Devoll.

A proximité du village de Gopesh, on a retrouvé les vestiges des supports de deux ponts médiévaux à poutres, qui assuraient la continuité de la route descendant de Gopesh en direction de Voskopoje, alors qu'à Moglice on a retrouvé les ruines d'un grand pont à arches qui se rattache à la route Maliq-Moglice-Berat. Une des arches était construite en briques de dimensions 0,56 m. x 0,34 x 0,55 et l'autre en pierres. A en juger par la technique de construction qui lui est propre, ce pont doit dater d'une période allant du Xe au XIe siècle.

DO NOT COPY

KRONIKË

DO NOT COPY

JETA SHKENCORE

SESIONI II SHKENCOR I INSTITUTIT TË MONUMENTEVE TË KULTURËS

Për nder të 30 vjetorit të themelimit të P.P.SH. dhe të Kongresit të saj të VI, në sallën e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë, u zhvillua sesioni i dytë shkencor i Institutit të Monumenteve të Kulturës. Ky sesion pasqyronte punën e kryer nga Instituti në fushën e restaurimeve dhe të studimit të arkitekturës gjatë këtyre dy vjetëve të fundit, qysh prej sesionit të parë shkencor të mbajtur në vitin 1969.

Në sesion u mbajtën 28 kumtesa, prej të cilave 12 nga bashkëpunëtorë të jashtëm të Institutit.

Referatin me temë «Rezultate dhe detyra në fushën e mbrojtjes dhe të restaurimit të monumenteve të kulturës» e mbajti drejtori i Institutit Gani Strazimiri. Në referat u theksua se disiplina shkencore e restaurimit të pasurive kulturale është krijuar dhe zhvilluar tek ne vetëm pas çlirimit të vendit tonë, si rezultat i kujdesit dhe interesimit të veçantë, që ka treguar partia dhe pushteti popullor për këtë trashëgimi kulturale të popullit tonë. Koha nga krijimi i Institutit deri në sesionin e tij të parë shkencor ishte periudha e formimit të disiplinës shkencore të restaurimit. Një nga parimet bazë në fushën e restaurimit, që ka udhëhequr Institutin gjatë kësaj pe-



Presidiumi i sesionit shkencor



Pamje nga salla e mbledhjes

riudhe, ka qënë krijimi i bindjes, se çdo restaurim përbën një rast të veçantë dhe duhet zgjidhur si i tillë. Me konservim janë kuptuar të gjitha punimet për mirëmbajtjen, që kryhen në mënyrë të vazhdueshme tek monumentet, për të ruajtur gjëndjen e tyre ekzistuese, ndërsa me restaurim është kuptuar tërësia e punimeve, që ka për qëllim jo vetëm ruajtjen e vlerave të monumentit, por edhe vënien e tyre në pah, duke respektuar gjithçka që trashëgojmë nga këto monumente. Që të dyja këto nocione permbajnë në vetvete elementë të njëri tjetrit.

Metodat e përdorura nga Instituti gjatë punës restauruese për monumentet rrënojë, ose ato të dala prej gërmimeve arkeologjike, kanë qënë anastiloza dhe konservimi i gjendjes «in situ». E para konsiston në rikompozimin e pjesëve apo të elementeve të rrëzuara të monumentit, duke i vendosur në vëndin e tyre të parë. Kjo metodë është përdorur me sukses, kur kemi patur të bëjmë me rrënoja të ndërtuara me bloqe të palidhura me llaç, siç janë muret mbrojtëse ilire, etj. Përdorimi i metodës së dytë ka synuar në ndalimin e degradimit të mëtejshëm të monumenteve, sidomos pas zbulimit të tyre të plotë, nëpërmjet gërmimit. Kjo metodë është përdorur kryesisht kur kemi patur të bëjmë me rrënoja të ndërtuara me lidhës llaçi. Në këto të fundit përdorimi i metodës së anastilozës është reduktuar vetëm në rikompozimin e elementeve të ndërtuara me bloqe guri si kolona, kapitele, porta, arkitra, etj. Gjatë punës me monumentet që ruhen në këmbë, përveç ndërhyrjeve konsoliduese për forcimin e strukturave kryesore të degradimit për t'i shtuar, me këto masa, jetën monumentit, është përdorur edhe metoda e restaurimit çlirues, që konsiston në vlerësimin e monumentit, duke e kthyer në njerën nga fazat e tij ndërtimore. Kjo metodë është përdorur atëhere kur ndryshimet, shtesat apo rindërtimet e mëvonëshme nuk kanë patur ndonjë vlerë të veçantë historike dhe kulturalo-artistike. Në rast të kundërt eliminimi i tyre do të ishte një humbje e palejueshme. Gjithashtu, duke përdorur në këto lloj monumentesh metodën e restaurimit me plotësimin e pjesëve të humbura, është patur parasysh reversibiliteti, që konsiston në kthimin e monumentit në gjëndjen e mëparëshme, kur të jetë nevoja. Në plotësimin e pjesëve apo të elementëve arkitektonike që mungojnë, një kujdes i veçantë i është kushtuar dallimit të tyre nga afër, për të mos vështirësuar dhe dizorientuar studjuesit dhe, në anën tjetër, mos rënia e tyre në sy nga larg për të mos cënuar efektin e përgjithshëm estetik të monumentit. Në referat u prekën, si probleme të veçanta, konservimi dhe restaurimi i qendrave historike, i ndërtimeve popullore, i monumenteve historike, si dhe i monumenteve të artit.

Në kumtesat e mbajtura në sesion përfshihej një tematikë mjaft e gjerë, duke filluar që nga trajtimi i arkitekturës dhe i fizionomisë së qyteteve ilire, deri tek ndërtimet e vona në mesjetë. Pjesa më e madhe e kumtesave kishin karakter përgjithësues, duke trajtuar grupe monumentesh, të një gjinie të shpërndara në gjithë territorin e vëndit tonë, ose në një krahinë të caktuar.

Probleme që lidhen me fizionominë e qyteteve ilire, me arkitekturën dhe me zhvillimin e tyre social-ekonomik, u trajtuan në kumtesat: «Lindja dhe zhvillimi i qytetit ilir» e S. Islamit, «Vështrim arkeologjik në rrethin e Elbasanit» e N. Cekës, «Të dhëna mbi historinë dhe zhvillimin ekonomik të qytetit ilir të Dimalit» e B. Dautajt, «Të dhëna mbi arkitekturën e varreve të qytetit ilir në Selcën e Poshtëme» e V. Manastirliut, etj. Në kumtesën e S. Islamit trajtohet problemi i lindjes dhe i zhvillimit të qytetit ilir, i parë si fenomen i kushtëzuar nga premisat e brëndshme ekonomiko-shoqërore. Qyteti ilir, në kuadrin e përgjithshëm të zhvillimit të shoqërisë skllavopronare dhe të shtetit ilir, trajtohet në aspektet kryesore të tij, siç janë ekonomia, zejtaria, organizimi politik, urbanistika dhe arkitektonika, etj. Konkluzionet mbështeten në të dhënat e përfituara prej gërmimeve arkeologjike të bëra në qytetet tona ilire si dhe, në burimet historike. B. Dautaj, në kumtesën e tij për qytetin e Dimalit, parashtroi në vija të përgjithëshme disa anë të zhvillimit shoqëror ekonomik dhe të kulturës materiale të këtij qyteti të njohur me toponimin «Kalaja e Krotinës», mbi bazën e një studimi paraprak të materialit arkeologjik të zbuluar nga gërmimet e ndërmara në këtë qendër.

Në kumtesën e N. Cekës «Vështrim arkeologjik në rrethin e Elbasanit» jepet për këtë zonë një kuadër i zhvillimit të jetës që nga koha e bronxit, deri në shek. VI të e. sonë. Në të trajtohet në mënyrë të veçantë, zhvillimi i vendbanimeve dhe i jetës së tyre ekonomike, kryesisht gjatë periudhës qytetare ilire. Përcaktohet vendi që ze zona e Elbasanit në kuadrin e Ilirisë, zhvillimin e saj kultural etj.

Ll. Papajani në kumtesën «Qyteti ilir në Klos» trajton çështje që lidhen me kohën e ndërtimit të qytetit, si fazë e parë në zhvillimin urbanistik të Bylisit, me marrëdhëniet ekonomike me qendrat e tjera dhe me teknikën e ndërtimit të mureve rrethues.

Në kumtesën «Fortifikimet antike dhe mesjetare të rrethit të Korçës» të Gj. Karaiskaj dhe P. Lerës, veçohen disa nga tiparet më karakteristike të fortifikimeve të hershme ilire dhe ndiqet evolucioni i tyre planimetrik. Në këtë kumtesë trajtohen gjithashtu edhe ndërtimet mbrojtëse të periudhës së vonë antike, të cilat takohen me shumicë në rrethin e Korçës.

Photocopy

Ndërtimet mbrojtëse mesjetare të një treve të caktuar u trajtuan në kumtesën e A. Baçes «Të dhëna mbi fortifikimet e luginës së Drinos në mesjetë». Përveç trajtimit të ndërtimeve mbrojtëse, në këtë kumtesë jepet evolucioni i shpërndarjes së fortifikimeve prej antikitetit deri në mesjetën e vonë.

Disa aspekte të arkitekturës mesjetare paraturke të shek. XI-XIV, në vendin tonë u trajtuan në mënyrë përgjithësuese në kumtesën e A. Meksit «Arkitektura e kishave bizantine të vona në Shqipëri», duke u mbështetur në studimet e veçanta të 29 kishave të kësaj periudhe të ruajtura në vendin tonë. Larmia e tipeve që hasim në këto ndërtime flet për një zhvillim të mirë të arkitekturës, sidomos gjatë shek. XIII-XIV, si rezultat i forcimit të principatave shqiptare. Nuk mungojnë aty edhe zgjidhjet individuale si në Mesopotam dhe Labovën e Kryqit.

Në kumtesën e K. Zhekut «Zbulime epigrafike në muret rrethuese të Kalasë së Durrësit», si rezultat i deshifrimit të monogramit të perandorit Anastas I (490-518), me origjinë nga Durrësi, të gjetur në tullat e kalasë, jepet një kontribut i ri në datimin me saktësi të mureve më të vjetra të kalasë së Durrësit, në periudhën e sundimit të këtij perandori.

Piktura murale u trajtua në dy kumtesa, në atë të Dh. Dhamos «Rreth një pikture nga kisha e Kallmetit», dhe të H. Nallbanit «Masat restauruese në afreskat e kishës së Sh. Triadhës në Berat». Në këtë të fundit trajtohen probleme të restaurimit dhe të konservimit të pikturës murale; gjithashtu duke iu referuar të dhënave teknike dhe stilistike, si dhe atyre me karakter profesional dhe artistik, bëhet një përpjekje për datimin e pikturës së kishës së Shën-Triadhës. Gjithashtu për disa kisha të pikturuara në këtë periudhë argumentohet mendimi se janë punime të një autori.

Th. Kamberi trajtoi problemin e furnizimit me ujë të qytetit të Gjirokastrës nga mesjeta e vonë, deri në shek. XIX. V. Shtylla trajtoi arkitekturën e banjave mesjetare në Shqipëri, dhe disa aspekte të restaurimit të tyre. Konkluzionet mbështeten në materialin e nxjerrë nga disa banja mesjetare të ruajtura deri në ditët tona në qytetet Elbasan, Durrës, Shkodër, Krujë, Gjirokastër, Çorovodë, Lezhë dhe Tiranë.

Probleme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen e monumenteve, studimin dhe restaurimin e tyre, u prekën në kumtesën e M. Papës «Mbrojtja me ligj e pasurive kulturale».

Në kumtesën e S. Adhamit «Mbi fizionominë urbanistike dhe arkitektonike të qytetit mesjetar të Voskopojës» jepet një tablo e zhvillimit urbanistik të këtij qyteti, qysh prej themelimit e deri në kulmin e zhvillimit të tij, si dhe disa të dhëna për arkitekturën e qytetit. Në këtë kumtesë korigjohen mendimet e shprehura deri sot lidhur me fizionominë e Voskopojës në shek. XVII, si dhe me popullatën maksimale të saj.

Gjërësisht u prekën në këtë sesion edhe probleme të lidhura me arkitekturën e banesave qytetare dhe fshatare të vendit tonë. Në kumtesën e B. Strazimirit dhe E. Rizës «Vështrim mbi arkitekturën e qytetit të Korçës» bëhet klasifikimi i tipeve të banesës korçare dhe arrihet në përfundimin se banesa e mbyllur me erker, që takohet në këtë qytet, përbën një tip më vete në kuadrin e banesës qytetare shqiptare në variantin më të zhvilluar, bëhet stadi më i lartë që arrin banesa e borgjezisë qytetare deri në fundin e shekullit të kaluar dhe provohet se kjo banesë nuk është e tipit maqedon.

«Banesa e hapur në qytet gjatë shek. XVIII-XIX» e E. Rizës ishte një punim përgjithësues për një tip banese të përhapur gjerësisht në qendrat qytetare të Shqipërisë së mesme.

Studimit të banesës fshatare i kushtoheshin kumtesat «Banesa e Zadrimës» e F. Zarshatit dhe «Të dhëna të reja mbi banesën e fortifikuar të Shqipërisë së Veriut» e P. Thomos. F. Zarshati në kumtesën e tij trajton tipin dominues të banesës së Zadrimës, si dhe karakteristikat e saj të përgjithshme arkitektonike. Ndërsa P. Thomo jep të dhëna të reja për banesat e një sërë krahinash të pastudjuara më parë, të vështruara ngushtë me banesat e tipit kullë, që hasen në krahinat e tjera të Shqipërisë së Veriut.

Kumtesa të tjera ishin «Disa shënime dhe vërejtje mbi përkthimin e Sejahatnamesë në shqip dhe gjermanisht» e V. Samimit, «Disa karakteristika të pazarit të vjetër të Shkodrës» e R. Dizdarit, «Detaje metalike të portave në qytetin e Tiranës» e M. Velos, «Kalaja e Re (Jenixhekalaja) e Elbasanit» e K. Biçokut, «Fortifikimet e hyrjes kryesore të kështjellës së Shkodrës» e V. Kamsit, «Restaurimi i një banese me çardak në Berat» e G. Samimit, «Kalaja e Ndroqit» e Gj. Frashërit dhe «Kalaja e Lekës në Selimaj» e N. Lushajt. Ky sesion ishte një shprehje e sukseseve të arritura nga punonjësit e Institutit të Monumenteve të Kulturës, në fushën e restaurimit dhe të studimit të monumenteve. Në krahasim me sesionin shkencor të mbajtur para dy vjetësh, ai shënoi një hap përpara, si nga tematika dhe pjesëmarrja më e gjerë, ashtu edhe nga niveli më i lartë shkencor i tyre.

Ekspeditë restaurimi në monumentet e artit

Në kuadrin e bashkëpunimit kulturor midis R.P. të Shqipërisë dhe R.S. të Rumanisë, gjatë muajit Nëndor të vitit 1970 qëndroi prapë Institutit të Monumenteve të Kulturës prof. Georgi Popesku, piktor

DO NOT COPY

specialist për problemet e mbrojtjes dhe të restaurimit të veprave të artit. Në bashkëpunim me specialistin rumun u organizuan gjatë kësaj periudhe një ekspeditë për restaurimin e afreskave të kishës së Shën-Triadhës në kështjellën e qytetit të Beratit, si dhe u këmbye përvoja për disa probleme të tjera në fushën e restaurimit. Gjithashtu gjatë kësaj ekspedite u restauruan pjesërisht edhe ikona që ruhen në qytetin e Beratit.

Gjatë ekspeditës u trajtuan kryesisht afreskat e kupolës së kishës së Shën-Triadhës, si dhe u eksperimentuan disa masa me karakter pastrimi në kishën e Vllahernës, atë të Kostandinit dhe të Elenës.

Në afreskat e kishës së Shën-Triadhës u kryen pastrime, mbushje e pjesëve të rrëzuara dhe sigurimi i atyre zonave që paraqesin rrezik shëmbjeje, nëpërmjet injektimeve dhe masave të tjera me karakter përforcues.

Në kishën e Kostandinit dhe Elenës u krye çvendosja e një zone me afresk, që paraqiste rrezik shëmbjeje, si dhe u pastrua pjesërisht një zonë tjetër.

Disa ikona mjaft të dëmtuara u pastruan nga shtresat e vernikut të papastër dhe të dyllit të qirinjve, si dhe u përforcuan zonat e dëmtuara nëpërmjet lidhjeve dhe tonimit, në mënyrë që të krijohej një pamje e pëlqyer në gamën e përgjithshme të ngjyrave.

Punimet e kryera krijuan kushte për vazhdimin dhe kompletimin e masave restauruese nga ana e sektorit të artit edhe për zona dhe objekte të tjera të kësaj natyre.

Takim me Prof. Mark Krasniqin

I ftuar nga Universiteti Shtetëror i Tiranës, gjatë muajit Prill 1971 ardhi në vëndin tonë Prof. Mark Krasniqi i Universitetit të Prishtinës. Gjatë qëndrimit të tij në Tiranë, Prof. Krasniqi mbajti në fakultetin e historisë dhe gjuhësisë të U.SH.T. një referat me temën «Arkitektura popullore e shqiptarëve të Kosovës». Në këtë referat autori paraqiti në mënyrë të përmbledhur, po të ilustruar me një material të pasur grafik dhe fotografik, rezultatet e kërkimeve të ndërmarra për studimin e banesës popullore, duke filluar që prej formave më të thjeshta, deri tek tipat më të zhvilluar të banesës fshatare. Ai nuk dha vetëm një paraqitje të zhvillimit të banesës në kohë, por edhe karakteristikat funksionale dhe teknike, si dhe kuadrin shoqëror që ndikoi në krijimin e tipareve të veçanta, sidomos të banesës karakteristike të tipit kullë. Referati ngjalli interes dhe ndihmoi mjaft për njohjen e arkitekturës popullore të shqiptarëve të Kosovës nga ana e specialistëve tanë dhe të personave të interesuar.

Gjithashtu Prof. Krasniqi pati një takim me punonjësit shkencorë të Institutit të Monumenteve të Kulturës, gjatë të cilit ai u njoh me punën që kryhet në këtë Institut për studimin dhe restaurimin e monumenteve të kulturës në vëndin tonë. Gjatë bisedës u paraqitën rezultatet e kërkimeve tona në fushën e historisë së arkitekturës dhe u shkëmbyen mendime lidhur me problemet që i dalin studjuesit në këto fusha.

Si referati, ashtu dhe takimi i mësipërm, ndihmuan për njohjen e rezultateve të arritura dhe të problemeve që dalin në fushat e historisë së arkitekturës dhe të restaurimit të monumenteve të kulturës.

Mbledhja e Asamblesë së Qendrës Ndërkombëtare të Studimeve për Konservimin dhe Restaurimin e Pasurive Kulturale (Romë 26-29 Prill 1971)

Në mbledhjen e Asamblesë së Qendrës Ndërkombëtare të Studimeve për Konservimin dhe Restaurimin e Pasurive Kulturale që u mbajt në Romë më 26-29 Prill 1971 morën pjesë si përfaqësues të vendit tonë Gani Strazimiri dhe Kleanthi Dedi. Në mbledhje u rrahën probleme të studimit për konservimin dhe restaurimin e pasurive kulturale dhe u mbajt një raport mbi aktivitetin e zhvillruar nga Qendra. U vu në dukje, se është bërë një punë e mirë për thellimin e studimeve dhe përhapjen e eksperiencës lidhur me konservimin dhe restaurimin e pasurive kulturale. Rreth Qendrës janë grumbulluar specialistët më të mirë, është krijuar baza e nevojshme materiale dhe funksionojnë shkolla, kurse dhe stazhe teorike e praktike për kualifikimin e kuadrove në profile të ndryshme.

Delegacioni ynë informoi Qendrën për punën e madhe që zhvillohet në vëndin tonë në fushën e mbrojtjes, të restaurimit dhe të konservimit të pasurive kulturale. Gjithashtu u këmbyen mendime për organizimin e punës, për studimet në shërbim të restaurimit dhe të konservimit, si dhe për format e propagandimit të monumenteve.

Në bashkëpunim me shoqatën e shoqërisë Itali-Shqipëri, delegacioni ynë hapi një ekspozitë fotografike mbi monumentet e kulturës së vendit tonë. Ekspozita, që u vizitua nga shumë persona, bëri një përshtypje të mirë dhe popullarizoi më shumë traditat tona, duke bërë të njohura për popullin italian kujdesin e madh të Partisë dhe të pushtetit tonë në ruajtjen, studimin dhe restaurimin e monumenteve të kulturës. Gjithashtu, nëpërmjet shoqërisë, u organizua një bisedë kushtuar monumenteve të kulturës në vëndin tonë, e cila u shoqërua me çfaqje diapozitivash.

DO NOT COPY



Restaurimi i murit rrethues në Kalanë e Persqopit



Facada e banesës së Kikinove në Gjirokastër para restaurimit.

Puna konservuese dhe restauruese gjatë vitit 1971

Sektori i monumenteve antike u përqëndrua gjatë vitit 1971 në qytetet ilire, duke patur si synim kthimin e disa prej tyre në qendra të vizitueshme. Në Lezhë vazhduan punimet e pastrimit dhe konservimit në muret rrethuese dhe u përfituan të dhëna më të sakta mbi planimetrinë e murit të qytetit. U vu nën mbrojtje një kullë që doli gjatë hapjes së themeleve të një godine brënda në qytet. Punimet restauruese patën si objektiv portën e murit të brëndshëm të qytetit. U bë anastiloza e kullës së hyrjes dhe e murit përballë saj.

Në Persqop vazhduan pastrimet në murin verior të qytetit ilir dhe u bë anastiloza e gurëve të një vargu monumental të tipit me qemer. Një varr i tillë ishte objekt i restaurimit edhe në Selcë të Poshtëme. Përveç gurëve që u rivendosën, u pregatitën edhe gurë për të plotësuar një pjesë të shkatërruar të qemerit. Në bashkëpunim me Sektorin e Arkeologjisë të Institutit të Historisë dhe Gjuhësisë u punua edhe për çlirimin nga dherat dhe gërmimin e një varri monumental të gdhendur në shkëmb.



E njëjta banesë pas restaurimit.



Banesë beratase para restaurimit.

DO NOT COPY



E njëjta banesë pas restaurimit

Në kalanë e Klosit u kryen punime pastrimi dhe konservimi në muret rrethuese të qytetit. U zbuluan pjesë të reja të murit rrethues, ku vihet re zbatimi i muraturës katërkëndëshe izodomike, e ngjajshme me atë të Bylisit. Kjo jep mundësi për ta datuar periudhën e parë të ndërtimit me blloqe trapezoidale përpara shek. IV p.e. sonë dhe për të kërkuar në kalanë e Klosit lagjen më të vjetër të Bylisit.



E njëjta portë pas restaurimit



Porta e murit të brendshëm të Lisit, para restaurimit.

Në Dimal u kryen punime konservimi në portikun e qytetit dhe u ndërmorën masa paraprake për restaurimin e tij, duke afruar gurët e rënë nga monumenti.

Sektori i Arkitekturës mesjetare kreu një sërë punimesh me karakter pastrimi dhe konservimi në kalatë e vona antike dhe mesjetare. Në kalanë e Elbasanit u bë pastrimi i njërës nga kullat e hyrjes në portën lindore. U përfituan të dhëna më të sakta mbi planimetrinë e hyrjes dhe u konstatuan gjurmët e një periudhe të dytë ndërtimi në ambjentin e kullës, që datohet në periudhën bizantine. Pastrimi i mureve në kalanë e Beratit dha trakte të reja nga muret ilire si substruksjone të mureve mesjetare. U pastruan gjithashtu disa kulla dhe një hyrje gjatë murit perëndimor të kalasë.

Punime pastrimi dhe konservimi u kryen edhe në kalanë e Kaninës. U zbuluan trakte të reja të mureve ilire prej blloqesh katërkëndëshe me punim të fryrë të faqes së jashtëme. Në muret mesjetare u ndërmorën punime konservimi duke mbushur boshllëqe që dobësonin qëndrueshmërinë e mureve. Në kalanë e Gjirokastrës punimet e pastrimit të ndërmara në shkallë të gjerë çliruan nga dherat një numur të madh ambjentesh, të cilat u adaptuan si salla të Muzeut të Armëve. Ndër objektet ku u kryen punime konservimi nga ky sektor duhet përmendur hamami i kalasë në Elbasan dhe një numur i madh monumentesh kulti të Shqipërisë Jugore.

Sektori i qendrave historike e zgjeroi këtë vit aktivitetin e vet edhe në Korçë e Shkodër, nëpërmjet ngritjes së dy ateljeve të reja në këto qytete. Të dy ateljetë do të kenë si objekte kryesore godinat e

DO NOT COPY

banimit të shpallura monumente kulture. Ateljeja e Korçës e filloi aktivitetin me një seri punimesh paraprake konservuese dhe me marrjen e masave për restaurimin e pazarit të vjetër të qytetit.

Punimet me karakter restaurimi të ndërmara në monumente të kategorisë së parë në Gjirokastër, përfunduan në banesat e Zekateve, Kikinove, Xhenetit dhe Galanzhit. U ndërmorën gjithashtu punime në monumente të kategorisë së dytë, kryesisht në fasada banesash. Në Berat, ndër banesat e kategorisë së parë ku u kryen punime restauruese, përmendim ato të Nishanxhive dhe Xhokaxhiut. Në Gjirokastër në një numur të madh banesash të kategorisë së dytë u kryen punime konservimi dhe restaurimi.

Në aktivitetin e sektorit një vënd të veçantë zunë puna për evidentimin dhe dokumentimin e monumenteve. Për këtë qëllim u organizuan ekspedita në Shkodër e Elbasan ku u bë dokumentacioni i një numuri të madh banesash me vlerë, dhe në Korçë, ku u bë puna paraprake për zonifikimin e qytetit. Në lidhje me punën mbrojtëse, pas pregatitjes së projekt-rregullores për qytetet muze, sektori organizoi një diskutim të gjerë të saj në qytetet Berat dhe Gjirokastër.

Sektori i monumenteve të artit vazhdoi në afresket e kishës së Shën-Triadhës në Berat punën e filluar më 1970. U ndërmorën kryesisht masa me karakter konservimi për të mbrojtur afresket nga dëmtimi i mëtejshëm. Në një shkallë më të gjerë u ndërmorën punime në mozaiket antike dhe mesjetare. Në Apolloni u morën masa konservimi në mozaikët e sektorit D. Po këtë karakter patën edhe punimet në mozaikët e Butrintit. Në mozaikun mural të kohës bizantine në Durrës u restauruan pjesë të dëmtuara të njerit prej paneleve duke i rivendosur dhe plotësuar ato.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

LIGJI I RI:

«Mbi mbrojtjen e monumenteve kulturale e historike dhe pasurive natyrale të rralla». Ligji Nr. 4927 datë 24/XII/1971.

Me qëllim që monumentet kulturale dhe sendet me vlerë dhe pasuritë natyrale të rralla, me rëndësi shkencore, historike, kulturale të mbrohen, restaurohen dhe administrohen drejt dhe të luajnë një rol të madh në edukimin klasor revolucionar dhe estetik të masave punonjëse, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Presidiumi i Kuvendit Popullor

V e n d o s i :

Neni 1

Monumentet kulturale e historike të lujtëshme dhe të palujtëshme si dhe sendet me vlerë dhe pasuritë natyrale të rralla, që kanë vlerë për kulturën dhe historinë vihen në mbrojtje të shtetit.

Neni 2

Studimi, mbrojtja dhe restaurimi i monumenteve kulturale e historike dhe i sendeve me vlerë dhe i pasurive natyrale të rralla që kanë vlerë për kulturën bëhen nga institucionet shtetërore të krijuara për këtë qëllim, nën drejtimin e Ministrisë së Arësimit dhe Kulturës ose nga ministritë e tjera përkatëse.

Neni 3

Ruajtja e monumenteve kulturale e historike dhe e sendeve me vlerë dhe pasurive natyrale të rralla që kanë vlerë për kulturën u ngarkohet komiteteve ekzekutive të këshillave popullore.

Neni 4

Monumentet kulturale vihen në mbrojtje të shtetit me propozim të institucioneve përkatëse dhe aprovimin e Ministrisë së Arësimit dhe Kulturës, kurse sendet me vlerë dhe pasuritë natyrale të ralla me aprovimin e ministrive përkatëse. Mbrojtja e tyre fillon nga dita e shpalljes së vendimit, ndërsa e atyre që janë pronë vetiake nga dita e njoftimit të pronarit ose poseduesit të tyre.

Monumentet kulturale e historike dhe sendet me vlerë dhe pasuritë natyrale të rralla me karakter kompleks ose me rëndësi të veçantë kombëtare, shpallen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në bazë të vendimeve të marra bëhen shënimet përkatëse në ipotekë ose kadastër.

Neni 5

Gërmimi, restaurimi, përdorimi dhe çdo prekje tjetër e monumenteve kulturale e historike dhe e se-

ndeve që kanë vlerë për kulturën ose pasurive natyrale të rralla, si dhe çdo ndryshim dhe ndërtim në truallin e vënë në mbrojtje për rreth tyre, nuk lejohen pa autorizimin e institucioneve përkatëse.

Jetërsimi dhe çvendosja e monumenteve kulturale e historike të lujtëshme ose të palujtëshme bëhet me pëlqimin e institucioneve përkatëse dhe kurdoherë me lejen e komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve.

Neni 6

Nxjerrja jashtë shtetit e monumenteve ose sendeve që kanë vlerë për kulturën të vëna nën mbrojtje të shtetit ndalohet, me përjashtim të rasteve kur, me propozimin e institucionit përkatës dhe aprovimin e Ministrisë së Arësimit dhe Kulturës, lejohet dërgimi i tyre si për ekspozita, koleksione shkencore, për shkëmbim, etj.

Neni 7

Monumentet kulturale e historike dhe sendet me vlerë për kulturën ose pasuritë natyrale të rralla, për nevoja studimi dhe për mbrojtjen e tyre mund të çpronësohen pjesërisht ose tërësisht në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 8

Punimet e restaurimit në monumentet kulturale e historike pronë vetiake (personale) të vëna nën mbrojtje të shtetit kryhen nga shteti, i cili përballon vetëm ato shpenzime që bëhen për ruajtjen e vlerave historike dhe kulturale të tyre.

Shpenzimet e tjera për mirëmbajtjen e objektit (ndërtesës etj) ku ndodhet monumenti kulturał e historik, përballohen kryesisht nga pronari me mjetet e tij.

Në raste të veçanta ato përballohen edhe me kreditë e marruna për përmirësimin e kushteve të banimit, sipas dispozitave në fuqi.

Kur pronari ka marrë kredi dhe nuk shlyen këstet e caktuara të një viti, objekti kultural me vendim të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit, mund të kalojë në pronësi të shtetit.

Neni 9

Kur gjatë punimeve të ndryshme zbulohen monumente kulturale e historike ose sende që kanë vlerë për kulturën, punimet e filluara ndërpriten dhe institucionet, ndërmarrjet ose shtetas të veçantë që i zbulojnë ato të detyrohen të njoftojnë menjëherë nëpërmjet komiteteve ekzekutive të këshillave popullore, institucionet përkatëse, të cilat janë të detyruara të dërgojnë në vënd përfaqësues të tyre brënda pesë ditëve nga data e lajmërimit. Punimet e filluara mund të pësojnë ndryshime, në rast se këtë e kërkon nevoja e mbrojtjes së monumenteve kulturale. Kur vendimi i institucionit përkatës kundërshtohet, çështja vendoset përfundimisht nga organi menjëherë më i lartë. Shpenzimet që do të nevojiten për këto ndryshime përballohen nga institucioni që financon punimet.

Neni 10

Ministria e Arësimit dhe Kulturës ngarkohet të nxjerrë rregulla mbi përcaktimin, studimin, mbrojtjen dhe restaurimin e monumenteve kulturale, të detyrueshme për institucionet, ndërmarrjet, organizatat dhe shtetasit.

PHOTOCOPY

DO NOT COPY

RREGULLORE
PËR MBROJTJEN E MONUMENTEVE KULTURALE E HISTORIKE

I

DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

1. Objekt i kësaj rregulloreje janë monumentet me vlerë historike, artistike dhe ambientale, të krijuara gjatë shekujve, që dëshmojnë për zhvillimin ekonomiko-shoqëror dhe qytetërimin në vendin tonë. Këto ndahen në historike, arkeologjike, arkitektonike, artistike, etnografike dhe ambientale.

2. Monumente historike janë të gjithë vendet, ndërtimet dhe sendet me vlerë, që lidhen me ngjarje të rëndësishme të historisë së popullit tonë, me lëvizjen patriotike e revolucionare të tij, me ndërtimin e socializmit dhe me ato që përkujtojnë jetën dhe veprimtarinë e personaliteteve të shquara shoqërore, politike, revolucionare, ushtarake, të shkencës, të teknikës, të prodhimit, të artit, etj.

3. Monumente arkeologjike janë ato objekte që përbëjnë një dëshmi historike të qytetërimeve të kaluara. Njohja e tyre bëhet nëpërmjet gërmimeve ose mënyrave të tjera të gjurmimit arkeologjik. Këtu hyjnë: shpellat e banuara, vendbanimet buzëujore (palafitet), vendbanimet e hapura apo të fortifikuara, të njohura në popull me emrat qytezë, qytet, gradishtë, kala etj. Rrugët e vjetra, kodërvarret (tumula) dhe varret e dysta, mbishkrimet dhe monedhat e lashta si dhe objektet e tjera me vlerë kulturale si armë, vegla pune, qeramika, etj.

4. Monumente arkitektonike janë gjithë krijimet e epokave të ndryshme historike në lëmin e ndërtimeve, që pasqyrojnë veprimtarinë, aftësinë dhe artin e të ndërtuarit si: qendrat historike qytetare e fshatare, banesat popullore, ndërtimet civile, kulturale, shoqërore, kulti, administrative, mbrojtëse, etj.

5. Monumente të artit janë krijimet, që përbëjnë një dëshmi historiko-artistike të epokave të ndryshme historike dhe të kohës sonë. Këtu hyjnë krijime të pikturës dhe të skulpturës monumentale, pikturës dhe të skulpturës së kavaletit, të arteve dekorative, të arteve të aplikuara etj.

6. Monumente etnografike janë gjithë ato objekte që përfaqësojnë veçantitë e jetesës, të zakoneve dhe të kulturës së një populli, të tilla si vendbanimet, banesat popullore, ndërtimet ndihmëse ekonomiko-bujqësore, pajisjet shtëpijake, veshjet popullore, veglat e punës, armët, punimet artistike popullore në dru, gur, metal, etj. të së kaluarës dhe të ditëve tona.

7. Me monumente kulture ambientale (qendra historiko-artistike dhe arkeologjike) kuptojmë gjithë ato komplekse qytetare apo fshatare të epokave të ndryshme, që përbëjnë një tërësi historiko-artistike bashkë me ambientin natyral që i rrethon.

II.

STUDIMI, KONSERVIMI DHE RESTAURIMI

8. Gërmimet arkeologjike bëhen nga Instituti i Historisë dhe muzetë e profileve përkatëse. Personat e tjerë kryejnë gërmime arkeologjike vetëm kur janë bashkëpunëtorë të institucioneve që udhëheqin gër-

mimet dhe përfshihen në planet e tyre. Instituti i monumenteve të kulturës ndërmerr gërmime në masën dhe nevojat e punës studimore, konservuese e restauruese të monumenteve të arkitekturës.

Ekspeditat që kryejnë gërmime dhe punime konservimi e restaurimi pajisen me autorizim nga institucioni që ndërmerr punimet.

9. Gërmimet dhe punimet konservuese dhe restauruese lejohen në bazë të këtyre kushteve.

a) Kur sigurohet kryerja e gërmimeve, punimeve konservuese e restauruese në bazë të kërkesave shkencore.

b) Kur sigurohet marrja e masave për ruajtjen dhe për konservimin e monumenteve të lëvizëshme që nga dalja në dritë e deri në dorëzimin e tyre në vendet e ruajtjes, ndërsa, për monumentet e palëvizëshme, kur sigurohet marrja e masave për konservimin e tyre paraprak.

c) Kur sigurohet marrja e masave për kryerjen e dokumentacionit shkencor përkatës si dhe botimi i rezultateve shkencore në bazë të pikave 15, 16, 17, 18.

d) Kur sigurohen mjetet financiare dhe pajisja e domosdoshme për kryerjen e kërkimeve dhe të punimeve.

10. Në disa qendra të rëndësishme arkeologjike të lihen pjesë të paprekura, me qëllim që në të ardhmen të mund të zhvillohen kërkime në bazë të sukseseve më të reja të shkencës dhe të teknikës së gërmimeve arkeologjike. Pjesët e rezervuara arkeologjike caktohen nga Instituti i Historisë në bashkëpunim me Institutin e Monumenteve të Kulturës.

11. Me kryerjen e punimeve konservuese e restauruese në monumentet ngarkohen institucionet që i kanë në mbrojtje, në bazë të pikës 19.

Të gjitha pikturat e kavaletit konservohen e restaurohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.

12. Punimet konservuese e restauruese duhet të kryhen në bazë të një studimi, i cili aprovohet nga institucioni që ndërmerr punimet.

13. Monumentet e lëvizëshme, që janë pjesë përbërëse e një monumenti të palëvizëshëm, nuk mund të shkëputen prej tij veçse kur kjo është e vetmja rrugë që siguron ruajtjen e tyre. Për këtë vendos Instituti i Monumenteve të Kulturës në bashkëpunim me Institutin e Historisë.

III

DOKUMENTIMI – BOTIMI

14. Monumenti duhet të pajiset me dokumentacionin shkencor të gjendjes, në të cilin ruhet ai në çastin kur vihet në mbrojtje të shtetit dhe sa herë që pëson ndryshime nga forcat e natyrës ose nga dora e njeriut.

15. Çdo ekspeditë, që ndërmerr gërmime dhe punime konservimi e restaurimi në monumentet, duhet të sigurojë dokumentin e plotë të punimeve në formë ditaresh, shënimesh shkencore, fiksimi grafik-fotografik.

16. Materialet e grumbulluara gjatë gërmimeve dhe punimeve restauruese dorëzohen menjëherë pas përfundimit të ekspeditës në muzetë qendrore ose lokale sipas vendimit të institucionit që organizon ekspeditën.

17. Raportet dhe dokumentacioni shkencor për rezultatet e gërmimeve dhe të punimeve restauruese dorëzohen në arkivën e Institucionit që ndërmerr punimet jo më vonë se tre muaj pas përfundimit të ekspeditës.

18. Rezultatet vjetore të ekspeditave shkencore duhet të paraqiten nga autorët për botim në formë të një raporti paraprak brenda vitit që pason.

Botimi i plotë i materialeve të zbuluara duhet të bëhet brenda tre vjetësh pas përfundimit të ekspeditave. Për ekspeditat shumëvjeçare, që i kushtohen sqarimit të një problemi të caktuar, paraqitja për botim e materialeve bëhet brenda pesë vjetëve nga përfundimi i tyre. Me kalimin e këtyre afateve materialet dhe dokumentacioni përkatës vihen në dispozicion edhe të studjuesve të tjerë.

Këto dispozita kanë fuqi edhe për ekspeditat e deritanishme.

IV.

MBROJTJA – ADMINISTRIMI

19. Me mbrojtjen dhe administrimin e monumenteve kulturale dhe historike ngarkohen:

a) Instituti i monumenteve të kulturës:

– me monumentet e paluejtëshme të të gjitha gjinive;

– me monumentet e luejtëshme, që janë pjesë përbërëse e monumenteve të paluejtëshme.

b) Instituti i historisë:

– me monumentet e luejtëshme, që ruhen në fondet e Muzeut arkeologjik-etnografik të këtij Instituti;

– me monumentet e luejtëshme arkeologjike, artistike (ikonat) dhe etnografike, që ruhen ose janë në zotërim të personave privatë.

c) Muzetë qendrore e lokale:

– me monumentet e luejtëshme, që ruhen në fondet e tyre.

DO NOT COPY

ç) Galeritë qendrore e lokale:

– Me monumentet e luejtëshme, që ruhen në fondet e tyre.

– me pikturën dhe skulpturën e kavaletit në zotërim të institucioneve shtetërore dhe të personave privatë.

d) Organet lokale të pushtetit:

– me monumentet historike, si shtëpitë-muze, lapidaret, pllakat përkujtimore, përmendoret, etj. që u lihen në kompetencë.

20. Monumentet, që vihen në mbrojtje të shtetit, caktohen nga institucionet përkatëse me aprovim të Ministrisë së Arësimit dhe të Kulturës. Mbrojtja e tyre fillon që nga data e shpalljes së vendimit; për monumentet që janë pronë vetiake kjo fillon nga dita që pronari ose zotëruesi i tyre njoftohet për këtë.

21. Monumentet me rëndësi të veçantë kombëtare, shpallen me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të Ministrisë së Arësimit dhe të Kulturës.

22. Rreth monumenteve të paluejtëshme, sipas madhësisë dhe rëndësisë së tyre, caktohen zona mbrojtjeje.

23. Kur arrihet në përfundim se një objekt ka vlerë për tu shpallur monument, por nuk është vënë në mbrojtje të shtetit, përderisa do të kryhet ky veprim, vihet në mbrojtje paraprake nga institucioni përkatës dhe, sipas rastit, në të mund të bëhen punime kërkimore e restauruese.

24. Kur një monument i paluejtëshëm përmban si pjesë përbërëse edhe monumentet të luejtëshme mbrojtja shtrihet edhe në këto të fundit.

25. Ndalohet çdo ndërtim dhe ndryshim në monumentet e paluejtëshme dhe në zonat për rreth tyre të vëna në mbrojtje. Këto veprime mund të lejohen vetëm në raste të jashtëzakonëshme me autorizim të Institutit të Monumenteve të Kulturës.

26. Ndalohet çdo grumbullim masiv (piknike, manifestime, etj.) dhe organizimi i vizitave me grupe më të mëdha se sa është mundësia e qarkullimit normal, në qendrat arkeologjike si dhe në zonat për rreth tyre, të vëna në mbrojtje, kur në sipërfaqe të tyre ruhen monumente të paluejtëshme.

27. Institucionet, që merren me studimin dhe me hartimin e projekteve të planeve rregulluese të qendrave të banuara, detyrohen të marrin parasysh qendrat historike artistike (qytetet, lagjet dhe ansamblet muze si dhe ambientet e tyre) të vëna në mbrojtje, duke krijuar mundësinë e vlerësimit sa më të plotë të tyre në zgjidhjet urbanistike dhe arkitektonike të ndërtimeve të reja.

28. Në qendrat historike artistike monumentet e e arkitekturës ndahen në dy kategori: në ato të kategorisë së parë, të cilat ruhen në tërësi, dhe në ato të kategorisë së dytë, të cilave u ruhet vetëm pamja e jashtëme dhe ambienti për rreth tyre.

29. Për rastet e jashtëzakonëshme ndryshimet, prishjet e plota ose të pjesëshme të një monumenti bëhen me aprovim të organit që e ka shpallur atë në mbrojtje. Në këto raste nuk mund të vihet dorë mbi monumentin para se të jetë kryer dokumentacioni shkencor i tyre. Afatet për këtë qëllim caktohen sipas rastit.

30. Kur gjatë punimeve të ndryshme dalin në dritë rastësisht monumente, punimet e filluara ndërpriten, materialet e gjetura ruhen dhe zbuluesit detyrohen të njoftojnë menjëherë muzetë ose organet lokale të pushtetit dhe Institutin e historisë dhe monumenteve të kulturës.

Institutet e mësipërme, në marrëveshje me njëri tjetrin, duhet të dërgojnë sipas rastit përfaqësuesit e vet brënda pesë ditëve nga data e lajmërimit. Punimet e filluara mund të pësojnë ndryshime në rast se e kërkon nevoja e mbrojtjes së monumenteve. Kur vendimi i institucionit përkatës gjen kundërshtim çështja vendoset menjëherë nga organet më të larta. Shpenzimet që do të nevojiten për këto ndryshime përballohen nga institucioni që financon punimet.

31. Sendet me vlerë kulturale të gjetura ose që dalin në dritë rastësisht duhet t'i dorëzohen Muzeut qendror apo atij lokal më të afërt, i cili është i detyruar të sigurojë ruajtjen e tyre.

32. Sendet me vlerë kulturale, që janë pronë vetiake, mund të jetërsohen vetëm me dijeni dhe nën kontrollin e institucionit përkatës, i cili ngarkohet dhe me inventarizimin shkencor të kësaj pasurie.

33. Monumentet mund të përdoren ose të shfrytëzohen për nevoja të ndryshme, por me kusht që të mos cenohet vlera e tyre historiko-artistike. Përdorimi bëhet me lejen e Institutit të Monumenteve të Kulturës, i cili, në kontratën që lidhet midis tij dhe entit apo personit, përcakton kushtet e përdorimit.

34. Institucionet apo personat, që në këto rrethana përdorin apo shfrytëzojnë monumente, janë përgjegjës për ruajtjen, për mirëmbajtjen dhe për riparimet e vogla të tyre, sipas udhëzimeve të Institutit të Monumenteve të Kulturës. E drejta e përdorimit apo e shfrytëzimit u hiqet, nëqoftëse nuk i mirëmbajnë dhe nuk i përdorin ato sipas kushteve të caktuara në kontratë, duke i detyruar njëkohësisht të përgjigjen ligjërisht për të gjitha dëmet që kanë shkaktuar.

35. Shpenzimet që bëhen për konservimin dhe për restaurimin e monumenteve që janë pronë vetiake (ndërtesës etj.) përballohen nga pronari, shteti ose nga të dy së bashku sipas natyrës së punimeve që do të kryen.

BOTIMOR

Shteti përballon shpenzimet që bëhen për ruajtjen e vlerave historike dhe kulturalo-artistike të monumenteve, të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me nevojat e pronarëve.

Pronari paguan në bazë të manualit të preventivit në fuqi vetëm ato shpenzime që bëhen për mbajtjen e monumenteve në gjëndje të përdorëshme si për çdo rast të zakonshëm.

Nëqoftëse shpenzimet, që duhet të bëjë pronari, përballohen nga shteti, atëhere ai detyrohet t'i shlyejë këto shpenzime me këste mujore sipas afateve që caktohen nga komiteti ekzekutiv i K.P. të rrethit përkatës.

36. Para se të fillojnë punimet e konservimit apo të restaurimit në një monument të palëvizshëm, që është pronë vetiake, duhet të lidhet kontratë midis Institutit të monumenteve të kulturës, që kryen punimet, dhe pronarit, ose përfaqësuesit të tij ligjor. Nëqoftëse pronari ose zotëruesi ndodhet me banim të paditur ose jashtë shtetit, emërohet një kujdestar sipas dispozitave në fuqi. Kur pronari ose përfaqësuesi ligjor nuk pranon të firmojë kontratën, atëhere mospranimi vërtetohet nga komiteti ekzekutiv i k.p. të rrethit ku ai banon dhe punimet kryhen rregullisht.

37. Monumentet që janë pronë vetiake, mund të shpronësohen me propozimin e instiutcionit të interesuar, me vendim të komitetit ekzekutiv të k.p. të rrethit,

Shpronësimi mund të bëhet:

a) Kur monumenti ka rëndësi të veçantë ose këtë e kërkon nevoja e mbrojtjes dhe e studimeve shkencore;

b) Kur shpenzimet e restaurimit i afrohen ose e kalojnë vlerën e monumentit;

c) Kur janë shumë bashkëpronarë dhe vështirësohet mirëmbajtja dhe likuidimi i shpenzimeve për punimet që kryhen në to;

ç) Kur lind nevoja që monumenti të përdoret për qëllime social-kulturale.

Shpronësimi mund të shtrihet dhe në objektet e tjera, kur ato pengojnë soditjen, studimin dhe vlerësimin e monumenteve të vëna në mbrojtje ose në ndonjë mënyrë i dëmtojnë ato. Në këtë rast propozimi bëhet nga institucioni i interesuar.

38. Organet lokale të pushtetit janë përgjegjës për ruajtjen e monumenteve dhe të zonës për rreth tyre.

Për të kryer këtë detyrë ata:

a) marrin masa për të parandaluar dëmtimet ose prishjet e monumenteve;

b) detyrojnë përdoruesit e monumenteve të respektojnë kontratat e lidhura për këtë qëllim;

c) njoftojnë institucionet përkatëse për dëmtimet që pësojnë dhe për nevojat që kanë për punime konservimi e restaurimi;

ç) kontrollojnë të gjitha ekspeditat, që bëjnë gërmime ose punime konservimi e restaurimi, nëse janë të autorizuara për këtë nga institucionet që i organizojnë.

39. Muzetë dhe galeritë ngarkohen të regjistrojnë dhe të sistemojnë monumentet, që kanë në ruajtje, sipas dispozitave përkatëse që nxjerrin organet qendrore apo institucionet e ngarkuara.

40. Ndalohet nxjerrja jashtë muzeve e koleksioneve dhe e objekteve të veçanta. Kalimi me afat të përkohëshëm apo përgjithmonë i një koleksioni ose i një objekti të veçantë një muzeu tjetër të Republikës bëhet me autorizim të Ministrisë së Arësimit dhe të kulturës.

DOKUTCOPY

DO NOT COPY

pronë letrare e Institutit të Monumenteve të Kulturës
pranë Ministrisë së Arësimit dhe Kulturës

DO NOT COPY

NDREQJE GABIMESH

Faqe	Rreshti	Si është	Si duhet të jetë
3	19	Hysen	Hasan
3	14 dhe 28	Gjerark	Gjerak
5		I d e m	
9	25	(Tab. IV, 9, 10)	(Tab. IV, 7, 10)
10	23	(Tab. II, 2, 8)	(Tab. II, 2, 3)
10	Kolona II,2	(Tab. IV, 89)	(Tab. IV, 8, 9)
13	» II,31	(Tab. XII, 7)	(Tab. XIV, 7)
52	21	radikale	radiale
75	49	linore	lindor
95	Shënimi 3,3	1960	1906
95	» 3,5	kal	kai
97	» 9,2	assariotou	Dassaritou
97	» 9,4	«Drithi»	«Drini»
110	11	(Tab. V, 3)	(Tab. IV, 3)
110	Shënimi 40,2	Gracia	Graecia
110	» 40,6	ie uca	De Luca
116	19	1.800	180
121	1	elementeve	ambienteve
143	18	cilat projektit	cilat sipas projektit
226	Kolona II,6	dokumentin	dokumentimin
228	6	preventivit	preventivimit

Tirazhi 2000 Kopje

Formati 70x100/12

Stash: 2204-72

Shtypur: Drejtoria Qendrore e Poligrafisë Shtypshkronja «Mihal Duri» Tiranë –